


PJESA E DYTË




Shekulli XV - XX

Në vëllimin e parë të këtij libri pamë se si Ericksoni i përshkruan shqiptarët me tërë virtytet dhe pasionet e tyre që nga kohët parake deri në fund të periudhës së Bizantit dhe ardhjen e osmanëve. Në vëllimin e dytë, i cili fillon me periudhën e Skënderbeut do të ndjekim linjën e kombit tonë, ashtu siç e përshkruan ai deri në vitin 1939, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Natyrisht autori është ndalur tek momentet dhe figurat kryesore të kombit tonë duke i shtjelluar, përshkruar dhe analizuar ato sipas mënyrës së vet. Ajo që të bie në sy është dashamirësia e pafund por edhe keqardhja e shprehur prej tij në rastet kur shqiptarët, megjithë dëshirën e mirë dhe veprat e mëdha që kanë bërë, nuk ia dolën të plotësojnë ëndërrat e tyre. Në këtë vëllim, bie në sy prania e vetë atij si personazh, si dëshmitar, si lojtar aktiv. Kjo e bën shumë më të besueshme dhe më interesante këtë vëllim dhe në përgjithësi tërë veprën e tij.



“SKËNDERBEU ERDHI SI VETËTIMË NË QIELL TË HAPUR.
PJESA TJETËR E BURRAVE E PRISTE SI BENZINA QË PRET TË
NDIZET DHE TË DYJA BASHKË TË PËRFLAKESHIN.”



I



USHTARI I JEZU KRISHTIT, GJERGJ KASTRIOTI- SKËNDERBEU

Midis *Bijve* më të shquar të *Shqipes* që me madhështinë e tyre i janë imponuar botës mbanë, edhe përkundër braktisjes me të cilën janë përballur, nuk ka tjetër që ta ketë vendosur dhe ruajtur veten aq thellë në zemrën dhe shpirtin e racës së tij sa Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Ai është shumë më tepër se një *Hero Kombëtar* i shqiptarëve. Ai është thujse Zoti i tyre. Sikur të kishte jetuar në ditët e Homerit, ai me siguri do të kishte marrë të njëjtin vlerësim dhe respekt që mori Akili. Ai është përjetësuar aq thellë, sa që kushdo që merr përsipër të shkruajë për të, duhet në radhë të parë të mos bëjë një gabim: ta trajtojë atë në mënyrë prozaike. Zëri dhe lavdia e tij, këngët epike, fanfarat dhe trumpetat militante të mijëra e mijërave *bijve të shqipes*, të tërë këndonin me ritmin e zemrës së tij.

Biografia e parë e këtij burri është shkruar nga një prift katolik i quajtur Marin Barleti¹. Tani ajo ruhet në Muzeun Kombëtar të Republikës së Venedikut. Ai ishte një

¹ De Vita et Moribus Georgii Castrioti, Venecia, 1504.

shkrimtar pothuajse bashkëkohës me Skënderbeun dhe pas vdekjes së Skënderbeut në janar 1468 shkroi biografinë e tij. Sigurisht që kishte shumë bashkëpunëtorë që jetonin në Republikën e Venedikut, që e kishin njohur Skënderbeun personalisht për shkak të marrëdhënieve të kësaj republike me Shqipërinë në atë kohë. Por ishte “Jeta e Skënderbeut” e Barletit ajo që e bëri atë një personazh thuajse legjendar. Është një prej shembujve më të rrallë që unë di në histori, se si kaq shpejt dhe me aq plotëri një personazh i njohur për temperamentin dhe pasionin e tij, t’i japë një “shkëndi të vogël zjarrit të tij qiellor” për t’u kthyer në figurë legjendare, historike, të pavdekshme.

Historia na mëson se ai ishte i biri i Gjon Kastriotit², i cili në vitin 1397 u bë zot i Krujës, një prej qyteteve më të fortifikuara të Shqipërisë. Që në vitin 1417, duke qenë i kërcënuar prej turqve, ai i kërkoi mbrojtje Republikës së Venedikut. Në atë kohë kjo Republikë kishte në zotërim tërë bregdetin shqiptar, prandaj edhe ngurronte të ndërhynte. Kastrioti ishte detyruar të pajtohej me kushtet e diktuar prej turqve, të cilët i kërkuan atij një haraç vjetor dhe marrjen peng të tre djemve, Stanishës, Konstandinit dhe Gjergjit, të cilët u dërguan në Adrianopojë. Data e kësaj pengmarrjeje ndryshon sipas rastit, herë në vitin 1410, herë në vitin 1423. Dy vëllezërit e Gjergjit u zhdukën menjëherë, por Gjergji u ngrit shpejt mbi retë e errëta me të cilat ishte mbështjellë fëmijëria e tij, atje në qendrën e Perandorisë Otomane, pikërisht kur batica e fatit të tij po ecte përpara me shpejtësi të jashtëzakonshme drejt kulmit të vet. Nga historia del qartë se paraqitja e tij e mrekullueshme dhe aq përshtypjëlënëse në atë kohë rinie, bëri që sulltan Murati II ta riemëronte atë *Iskander*, sikundër turqit e thërritnin Aleksandrin e Madh. Për më tepër, atij iu dha çdo mundësi për mësim dhe përparim. Ai arriti shumë shpejt të mësonte turqisht, arabisht, greqisht, italisht dhe sllavisht. Ai u zhvillua fizikisht deri sa u bë atleti më i mirë i ushtrisë turke. Ai thuajse ende nuk e kishte arritur moshën e burrit, kur u vu në komandën e divizionit të kavalerisë së famshme të pesëmijë trupave dhe tregoi talentin dhe aftësitë e tij të jashtëzakonshme.

² Karl Hopf: Griechenland im mittelalter in der neuzeit.

Ai pati një romancë me Zuleikën, vajzën më të vogël dhe më të dashur të sulltanit, e cila që nga grilat e dritares së saj pa se si Skenderbeu e hodhi për tokë me një të goditur gjigandin turk Sikh. Që në atë çast ajo ra dëshpërimisht në dashuri me të dhe arriti të kapërcente kundërshtimin e vendosur të eunukut të vjetër që sulltani kishte ngarkuar të kujdesej për të dhe, nëpërmjet tij, arriti të rregullonte shpesh takime fshehurazi me heroin e ri. Kjo ngjarje romantike dhe të tjera interesante si kjo janë përshkruar prej Marin Barletit. A janë këto të vërteta apo thjesht fryt i fantazisë së gjallë të Barletit, këtë e vë në dyshim profesor Jorga, duke e lënë atë një çështje të hapur.

Një tjetër ngjarje edhe më e rëndësishme prej së cilës mori kthesë e tërë jeta e Skënderbeut, është përshkruar po nga ky autor. Despoti i Serbisë, Gjergj Vaskoviçi, kërkonte të shkëputej prej sovranitetit të sulltanit turk. Skënderbeu u dërgua që të vinte rregullin atje. Brenda dy muajsh ai e mposhti despotin, kur, papritmas, mori urdhër nga sulltani ta linte komandën të njëfarë Emir Hasani dhe të kthehej menjëherë në Adrianopojë. Hasani, siç e njihje Skënderbeu, ishte një maskara, intrigant, i paskrupull dhe një rival i fshehtë për dorën e Zuleikës. Kështu që kjo kthesë e papritshme në fatin e tij ngriti një seri të gjatë pyetjesh të mërzitshme. Ashtu sikundër ia kishte frikën, gjatë mungesës së tij, veshët e sulltanit ishin mbushur me gënjeshtër dhe shpifje kundër tij. Megjithatë, fati i mori gjërat në dorën e vet.

Emir Hasani ra në një telash aq të madh me Vaskoviçin, sa nuk ia doli dot. Ushtria e tij u shkatërrua, pjesa më e madhe u vranë, u plagosën ose u kapën rob. Armëve, pajisjeve, tërë gjërave të mbetura në fushëbetejë dhe në kampin ushtarak turk iu vu flaka prej serbëve në shenjë triumfi. Ata tani kërcënonin ta hidhnin ushtrinë e tyre mbi Shqipëri. Kjo bëri që sulltani t'i bënte thirrje Skënderbeut që të mblidhte një ushtri tjetër kundër despotit serb. Ndërkohë i ishte bërë thirrje Hungarisë që të vinte në ndihmë të Serbisë dhe një ushtri nën komandën e Janosh Huniadit i ishte përgjigjur. Duke patur frikë t'ia besonte një djali kaq të ri komandën më të lartë në një krizë të tillë, sulltani ose duhej të vinte vetë, ose

duhej të dërgonte një gjeneral të komandonte gjërat ndryshe. Sido të ketë qenë, Huniadi i mposhti turqit. Disa prej të dhënave historike thonë se kjo u arrit me një bashkëpunim të heshtur midis tij dhe Skënderbeut. E vërtetë apo jo, ishte kjo koha kur ai vendosi të ndahej me sulltanin dhe të kthehej në Shqipëri si mbrojtës kombëtar kundër turqve.

Në këtë kohë, një prift shqiptar që kishte administruar sakramentin e fundit të nënës së tij në çastin e fundit të jetës, kishte ardhur tek kampi i tij i veshur si lypsar dhe e kishte bindur që, për hatër të saj, të hiqte dorë nga islami, të kthehej në fenë e babait të tij dhe të bëhej mbrojtës i fuqishëm i Shqipërisë. Thuhet, po ashtu, se përnjëherë të gjithë princët dhe udhëheqësit e Shqipërisë ishin bashkuar me një thirrje drejtuar atij për të shkuar dhe për të marrë komandën, duke iu betuar atij për besnikëri dhe aleancë. Kjo ndodhi në vitin 1443. Rrugës për në vendin e tij të lindjes, atij i ndodhi diçka e çuditshme. Ai e gjeti rrugës Emir Hasanin, i cili kishte shpëtuar prej serbëve dhe me një kompani të vogël po kthehej në Adrianopojë. Siç doli më vonë, ai kishte qenë sekretari privat i sulltanit dhe e mbante me vete vulën zyrtare. I marrë peng prej Skënderbeut, ai u detyrua të shkruante një ferman që ia drejtonte valiut të Krujës “që ta kalonte qytetin dhe kalanë në duart e Skënderbeut”.

Fermani, urdhëri pra, u vulos me vulën e sulltanit. Me këtë veprim, kështjella iu dorëzua atij pa kushte dhe Skënderbeu e fitoi të parën betejë strategjike pa çak e pa bam. Kjo u bë kështjella që nuk u mposht kurrë gjatë jetës së tij deri në vitin 1468. Skënderbeu e deklaroi publikisht rikthimin e tij në fenë e krishterë dhe përkushtimin e tij për ta mbrojtur atë me jetën e vet. Lajmi u përhap si zjarri i egër, prej njërit cep të Shqipërisë në cepin tjetër dhe fjalët e Tomas Karlilit (Thomas Carlyle) u bënë realitet:

« Skënderbeu erdhi si vetëtimë në qiell të hapur. Pjesa tjetër e burrave priste për të si benzina që pret të ndizet dhe të dyja bashkë të përflakeshin ».

Pasi u vu në udhëheqje të tërë shqiptarëve, ata shpërthyen siç nuk kishin bërë kurrë më parë në historinë e tyre dhe, fatkeqësisht, asnjëherë më vonë. Njëherë për

njëherë, shqiptarët qenë të bashkuar dhe shfaqën vlera kundrejt armiqve të tyre, turqve, por edhe të tjerëve dhe i treguan botës se çfarë ishin në gjendje të arrinin kur ishin të bashkuar nën udhëheqjen e birit të tyre.

Por le të vijmë tek kthimi i Skënderbeut. Në fillim u bë një mbledhje e madhe e parisë së tërë Shqipërisë dhe bashkë me ta ishte edhe princi Cernojeviç nga Mali i Zi, si edhe një numër përfaqësuesish të Republikës së Venedikut. Kështu u formua *Lidhja Shqiptare* dhe Skënderbeu u zgjodh udhëheqësi i saj më i lartë. Në të vërtetë, përpara se të fillonin armiqësitë, Murati II i shkroi një letër njeriut të tij të favorizuar, duke e qortuar rëndë për braktisjen që kishte bërë, duke e quajtur atë një djalë mosmirënjohës. Por ai e mbyllte letrën me një ofertë me kushte bujare për një marrëveshje midis tyre. Ai mund të njihej si *Princi i Krujës*, sikundër babai i tij kishte qenë njëherë e njëkohë, nëse pranonte të paguante një haraç vjetor si njohje ndaj sovranitetit turk. Megjithatë, ai nuk duhej të bënte aleanca me armiqtë e sulltanit dhe as t'i kundërshtonte aleatët e tij, ku despoti i Serbisë ishte përmendur në mënyrë të veçantë. Përgjigjja e Skënderbeut ishte tejet tallëse, pa njohur shumë prej favoreve që kishte marrë prej sulltanit të vjetër që kishte qenë më shumë si një baba që e kishte adaptuar, sesa një sundues i pengut të tij.

Letrën Skënderbeu e nënshkroi me emrin Gjergj Kastrioti, me mbiemër, Skënderbeu, Princi i Epirit, Ushtar i Jezu Krishtit. Në përgjigje të kësaj letre erdhi një letër tjetër nga sulltani, ku i thoshte se burimet e sulltanit ishin pafund dhe kjo e shtynte që të bënte gjithçka që ta rrëzonte në gjuhë Skënderbeun dhe rebelët që e shoqëronin atë. Koha e këtij letërkëmbimi njihet të jetë viti 1445, dhe që prej asaj kohe dhe deri në vdekjen e sulltanit, gjashtë vjet më vonë, nuk pati as armëpushim, as çfarëdo lëshimi të kërkuar apo bërë nga asnjëra palë.

Lista e betejave të ndërmarrura dhe viktimat e shkaktuara prej tyre provojnë lehtë besimin e tyre të kufizuar ndaj njëri-tjetrit. Në dy betejat e para në Shqipëri, ushtria turke e drejtuar nga vetë Mustafa Pasha, thuhet të ketë lënë 24.000 turq të vrarë dhe të plagosur në fushën e betejës. Mustafa Pasha dhe thujse i tërë shtabi i

oficerëve të tij u kapën rob dhe u burgosën. Murati II tani e mori vetë situatën në dorë, kësaj radhe me një fuqi të jashtëzakonshme prej 140.000 trupash, përfshirë këmbësorinë, së bashku me një forcë të jashtëzakonshme kavalerie dhe dhjetra topa rrethimi. Svetigradi, një fortesë malore në kufirin shqiptaro – maqedon, ishte rrethuar. Rrethimi zgjati pesë muaj. U përdor çdo mjet i mundshëm, mijëra nga trupat më të mira të Muratit ranë në betejë dhe ai ishte në pikën e heqjes së rrethimit kur, atë që nuk e bënë armët, e bëri tradhtia. Një tradhtar nga brenda fortesës kishte hedhur një kërmë qeni të ngordhur në një pus që furnizonte shqiptarët me ujë të pijshëm. Ata i lëshuan armët, nuk pranuan të vijonin luftën dhe kalaja për këtë arsye u dorëzua. Fushata i kishte kushtuar sulltanit 30.000 të vrarë, një çmim i lartë për një kështjellë të ndërtuar mbi një shkëmb të mprehtë si të ishte i latuar, që si i tillë mund të gjendej në çdo mal tjetër të Shqipërisë.

Gjithsesi ishte Kruja vendi për të cilin sulltani vuri në veprim çdo gjë që i mundësonte fuqia e tij ushtarake, në një përpjekje supreme për ta detyruar Skënderbeun të binte në gjunjë. Në rastin më të mirë, kjo ishte një aventurë e pamatur si duhet. Kruja është thujse e varur pezull në grykën e malit, aq e rrëpirtë sa është vështirë për ta arritur. Dy anët e murit prej shkëmbi janë praktikisht vertikale, tërësisht të prera nga lugina poshtë dhe ngrihen disa qindra këmbë.

Në krah të fortesës ngrihet shpatulla prej graniti e maleve. Çfarëdo lloj manovre është e pamundur të ndërmerret nga ai cep. Nuk ka ushtri që të gjejë shteg nga ajo anë. Ana perëndimore që sheh drejt Adriatikut në një largësi prej 35 miljesh, është po ashtu e pangjithshme. Edhe ana veriore e rrëpirës ishte e veçuar në një të tatëpjetë, e cila lejon vetëm ngjitjen në grupe të vogla në qytet dhe në kështjellë, por asesi për një ngjitje masive si, bie fjala, për ushtrinë e përbërë prej 160.000 burrash që kishte mbledhur Murati II për këtë qëllim. Një shkrim i lënë nga Barleti e pasqyron më mirë se çdo gjë këtë rast. Sipas tij, turqit u shfaqën përpara dyerve të qytetit më 5 prill 1450 :

“Në çdo anë të qytetit nuk shihej asgjë tjetër përveç gardhit rrethues njerëzor,

transheve, rrethimit, barakave dhe tendave; zjarre të ndezura ose thëngjij të shuar. Në fushë, në luginë, në majat e largëta, në kreshta dhe lugina gjendeshin burra të të gjithë brezave dhe moshave; këtu spahinj të, atje matanë zaimët, më tej timarët, të gjithë së bashku përbënin kavalerinë e ushtrisë. Në anën tjetër ishte këmbësoria e të gjitha llojeve, e rëndë dhe e lehtë, e rregullt dhe e parregullt, turq prej Anadollit dhe pjesëve të tjera nga Azia dhe bashkë me ta, siç ndodhte përherë me ushtrinë e sulltanit, shumë renegatë të krishterë, francezë, italianë, gjermanë, hungarezë, rumunë, llumi i të gjitha tokave. Aty kishte mbajtës bagazhesh, karrocierë, punëtorë, mjeshtra të çdo lloji, disa të paguar prej sulltanit, disa pa para apo rrogë, të tërhequr nga aventura dhe shpresat për pre. Aty kishte plaçkitës, xhenjerë, rrëmihës me kazma dhe lopata për transhe dhe tunele nëntokësore. Çdo lloj instrumenti i luftës i njohur deri atëherë nga njeriu do të shihej aty; topa të të gjitha masave për hedhje gjylesh, obuza dhe makina për rrethimin e mureve. Aty ishte ngritur edhe një fabrikë për prodhimin e topave dhe municioneve për armët”. Kundër kësaj force të tillë thuajse titanike, cila ishte mbrojtja e shqiptarëve?

Gra dhe fëmijë brenda mureve të kështjellës, të gjithë në vendet e tyre. Të tërë, siç mund të merret me mend, të pajisur ushtarakisht dhe veçanërisht të vendosur për të mbrojtur qytetin. Tek shqiptarët, gruaja kishte luajtur një rol shumë të rëndësishëm në luftë. Gruaja pas burrit të saj, motra pas vëllait, tek kujdesen për furnizimet dhe municionet, ushqimet, nevojat vetjake, që i mbushin armët për ta dhe, kur një heshtë e armikut prek trupin e luftëtarëve, ato e marrin atë, e tërheqin nga fronti dhe i japin ndihmën me të njëjtën qetësi, trimëri, guxim si dhe burrat.

Një prej gjërave më të habitshme që armiqtë kanë vënë re tek shqiptarët gjatë luftërave, është gjetja e grave, njësoj si edhe e burrave, midis të plagosurve dhe të vrarëve në fushën e betejës. Fëmijët e të moshuarit mbeten në shtëpi për t’u marrë me punët e duhura, duke u siguruar atyre ushqime dhe veshje, duke u kujdesur për të plagosurit, duke u lutur në kishat e tyre për mbrotjen nga zoti të shtëpive të tyre dhe altarëve nga duart e turqve të pabesë.

Skënderbeu ishte në disavantazh të madh në numër ushtarësh. Dyzet me një ishte raporti i ushtarëve në favor të turqve, ndërkohë që shpërpjestimi në armatim dhe pajisje ishte edhe më i madh se kaq. Në rrethana të tilla, të ndesheshe me armikun në një betejë të kësaj shkalle do të ishte kulmi i marrëzisë. Duke ia besuar sigurinë e kështjellës kont Uranit, ai vetë, me një numër shenjtarësh të zgjedhur e të saktë qëndroi jashtë mureve të kështjellës, duke lëvizur gjithkund nëpër malet përreth, përveç atyre vendeve ku nuk hyhej dot, prapa qytetit. Ata u vendosën atje tërësisht pa u vënë re, por, në të njëjtën kohë, ishin në gjendje të vëzhgonin prej pozicioneve ku ishin, çdo lëvizje të armikut. Kështjella ishte e tëra e gdhendur në faqe të malit, muret e saj janë zgjatim i këtij masivi shkëmbor dhe bëjnë që çdo sulm apo tentativë për kapjen e qytetit të jetë thuajse një pamundësi njerëzore. Ngushticat që çojnë tek kështjella, janë një kurth i vërtetë vdekjeprurës. Skënderbeu provoi se ishte mjeshtër i madh i taktikës së luftës guerrile. Të fshehur si leopardë malesh, ai dhe trimat e tij mund të kacavirreshin drejt kampit të armikut në orët vdekjeprurëse midis errësirës dhe agimit, e të vrisnin rojet e përgjumura me shpatat e tyre. Thuajse para se armiku ta merrte vesh, një mijë ose edhe më shumë syresh do të kishin kaluar nga gjumi në vdekje. Shpesh ata depërtonin bash në zemër të forcave të sulltanit. Këta të fundit asnjëherë nuk dinin se ku dhe kur do të ndodhte sulmi tjetër.

A po mendonte Karlili për këtë bir shqiptonje kur ngriti zërin me deklaratën e tij të famshme për burrat e mëdhenj, si shkrepëtima prej qiellit? Edhe më shkatërrimtare për turqit ishte ndërprerja sistematike e furnizimit me ushqime dhe material ushtarak e forcave të sulltanit. Këto të gjitha duhej të vinin përmes maleve, ngarkuar mbi samarët e kafshëve dhe nëpërmjet shtigjeve të ngushta që ishin ideale për prita. Skënderbeu i patrullonte të tëra ato male dhe nuk lejonte asgjë që të kalonte përmes tyre. Edhe sikur Murati II të dërgonte një ushtri të tërë me karvanet e tij, kjo nuk do ta ndihmonte t'i kalonte këto shtigje grykash në vargmalet e larta. Skënderbeu vetë thuhet të ketë shfaqur talent të jashtëzakonshëm; bëmat e tij mund të shihen më shumë si akte heroike të Herkullit, sesa të një njeriu

të thjeshtë. Më në fund, pas muajsh përpjekjesh të pafrytshme, sulltani i moshuar, i shqetësuar dhe i ngacmuar pamëshirshëm, ra i sëmurë, i shkurajuar dhe i llahtaritur. Pas katër muajsh rrethimi, ai kishte lënë në luftime më shumë se tridhjetë mijë prej trupave të tij. Ndërkohë, sëmundja, uria, murtaja po merrnin gjithnjë e më shumë jetë, duke e rritur numrin e të vdekurve. Në këto kushte, rrethimi u hoq dhe ushtria e shpartalluar mori rrugën e kthimit për në shtëpi, në Adrianopojë. A shpresonte Murati II se biri i tij i adoptuar do ta lejonte ushtrinë e tij të ikte në paqe? Skënderbeu mund ta kishte menduar një gjest të tillë, por ai sigurisht që nuk e bëri këtë.

Një forcë e madhe prej 100.000 ushtarësh të stërvitur e me pajisjet më të mira, pas disa muajsh të rimarrjes së vetes, mendohej se do të ishte e aftë për të ndërmarrë një tjetër sulm drejt e në zemrën e tokës së *shqiptarëve*³. Duke e ndjerë këtë, Skënderbeu nuk i la asnjë çast paqeje ushtrisë që po tërhiqej, por u ngriti kurthe vdekjeje përgjatë çdo kryqëzimi rruge. Të fshehur pas pemëve, shkëmbinjve, shkurreve, këta *bij të shqipeve* bënë kërdrinë mbi ushtrinë e sulltanit. Përpara se të arrinin kufijtë e tyre, turqit kishin rënë në fushat e gjera, pa arritur ende në fushëbetë ose, në mos kështu, ata i lëshonin forcat dhe demoralizoheshin. Një poshtërim i tillë pati efekt të jashtëzakonshëm tek sulltani plak. Në më pak se tre muaj, ai kishte dhënë frymën e fundit duke iu drejtuar Allahut, të cilit i dorëzoi shpirtin. Në nderim të shumë virtyeteve të tij, është thënë se ai ishte shumë fetar, tolerant, skrupuloz në mbajtjen e fjalës, por i tmerrshëm ndaj atij që shkelte betimin. Ai themeloi shumë shkolla dhe spitale, si dhe një prej xhamive më të mëdha në botën myslimane, atë të *Utch-Cherafelit* në Adrianopojë.

³ Shqip në original.



SKËNDERBEU, ALEKSANDRI I MADH, NJËEMËRAK ME TË, SI DHE CEZARI FITUAN TË DREJTËN TË ISHIN HERONJTË E VETËM TË SHQUAR QË NUK KANË HUMBUR KURRË QOFTË EDHE NJË BETEJË. POR AI I TEJKALOI ATA TË DY NË VIRTYTET E TIJ VETJAKE DHE KARAKTERIN E TIJ TË PATHYESHËM. AI ISHTE NJË BURRË ME BESNIKËRI FETARE TË SHKALLËS MË TË LARTË, I SINQERTË, NJERËZOR, BUJAR I SAJDISSHËM ME ÇDOKËND, MADJE EDHE ME MË TË PËRUNJURIN.



II



SKËNDERBEU, PERIUDHA E DYTË

Lënia e Krujës nga turqit u festua njëherazi me martesën e Skënderbeut. Nusja e tij e zgjedhur ishte Donika, motra shumë e bukur e një fisniku shqiptar. Në të vërtetë, rrallë ka ndonjë rast tjetër në historinë e Shqipërisë që mund të krahasohet me këtë gëzim. Në mes të luftës, mes betejash të tmerrshme që kishin të bënin jo vetëm me lirinë e racës së tyre, por po aq edhe me fenë e tyre, vinte kjo martesë. Në çastin kur ajo u bë, vendi i vogël kishte formuar aleanca me Republikën e Venedikut, me mbretin e Napolit, Alfonsin e Aragonit dhe kishte lidhje të fuqishme me Francën. Shqipërisë i ishte shfaqur një mundësi e rrallë për t'u çliruar njëherë e mirë nga vasaliteti i më shumë se një mijë vjetëve, i mundësohej të ngrihej përsëri në këmbët e veta, të qëndronte drejt dhe të ecte me mbretërit, duke mos u kërkuar asnjë favor, duke mos paguar haraçe, duke mos njohur pushtet tjetër veç atij që ajo zgjidhte vetë.

Dhe çfarë i qëndronte përballë si një alternativë e dytë: rënia në greminën e errësirës mendore, morale dhe shpirtërore, më thellë, më errët, më tmerrshëm madje

edhe sesa ajo që ai komb i vogël kishte njohur ndonjëherë në tërë historinë e tij. Të mbetej vijimisht nën zotërimet e të tjerëve, që zgjasnin njëzet vjet, pesëdhjetë vjet, një shekull... t'u nënshtrohej pandërprerë mësynjeve si luzma fluturuese të pushtuesve të pamëshirshëm. Të ndjente thellë plagët e marra kohë pas kohe, të shoqëruara me dhimbje që po ashtu kërkonin shërim. Pasoja të tilla kishte sjellë reja e zezë përmbi kombin, e cila arriti që t'i vinte poshtë malet e tyre dhe t'i mbulonte me velenxën e zezë për katër shekuj e gjysmë.

Kaq e habitshme është natyra njerëzore, saqë edhe përballë një kërcënimi të tillë, i tërë kombi u lëshua drejt e atje në atë mëngjes të 27 prillit 1451, tek festimi i martesës së heroit të tyre. Çfarë tubimi i madh që ishte! Do të shihej aty çdo tip shqiptari. Malësorë të fuqishëm, belhollë si vashat, shpatullgjerë, me gjoks të thellë, të zhdërvjellët si shelgje dhe të lehtë në ecje si rëshqebull mali, me sy dhe veshë aq të mprehtë. Ishte njeriu i fushës, bariu i kodrave, peshkatari i liqenit, burrat që jetonin së bashku, *fëmijët e nënës Natyrë*, të cilët mbanin tiparet e granitit të thatë, të tharë nën rrezet e diellit dhe që ishin bërë me xhunga dhe nyje, si nyjet e një lisi mali, për qëndresën dhe forcën – ata ishin të gjithë aty. Prej çdo pjese të tokës kishin ardhur ata, nga Petrela, kështjella e gurit mbi mal, e lartë, e largët si një çerdhe shqiponje, nga Ohri, selia e lashtë e mbretërve bullgarë, nga Durrësi, me çmimin e të cilit i madhi Jul Cezar mendonte se ia vlente ta rrethonte fatin e tij për të fituar; nga Ulqini dhe Shkodra, njëherë e njëkohë të sunduar prej mbretërve të tyre të shquar ilirë; nga Drishti, Tivari, Lezha dhe pastaj nga Venediku, nga Mali i Zi, nga Kataro e Ragusa, nga ishujt përgjatë bregdetit dalmat – ishuj thesarë për prë të paraardhësve të racës së tyre heroike. Madje, edhe nga kryeqendra të ndryshme italiane kishin ardhur dasmorë të shquar. Mbreti i Napolit, djalin e të cilit Skëndërbeu do ta ndihmonte për të rimarrë fronin pak kohë më vonë, ishte vlefshmërisht i përfaqësuar. Princat vendas ishin të gjithë aty me shpurat e tyre, duke e bërë edhe më elegante, edhe më shumëngjyrëshe pamjen e asaj dasme. Nusja ishte nga jugu i Shqipërisë dhe tërë prijësit guximtarë të jugut ishin aty me shenjat më të shkëlqyera mbretërore, duke u munduar, kush më shumë se tjetri, ta

nderonte princeshën. Ata kishin ardhur nga Lugina e Vjosës,⁴ *Aousi* i lashtësisë dhe nga vendi famëmadh e i largët i Dodonës. Udhëheqësit e betejave ishin aty, ata që për më shumë se dhjetë vjet kishin bërë veprime prej guximtarësh, që do t'i kishin bërë të fitonin çfarëdo lloj medaljeje, çmimi, përveç atyre që meritonte princi i tyre, Skënderbeu. Duke luftuar siç kishte bërë secili prej tyre, në një raport të padrejtë – një kundër dhjetëve – ata kishin arritur pikën më të lartë të guximit dhe mjeshtrisë në beteja, çka i veçon ata nga njerëzit e të njëjtit lloj. Zota apo njerëz, fama e të cilëve ka marrë formën e pavdekësisë?!

Një ose dy prej tyre meritojnë të përmenden veçmas. Aty ishte Konstandin Hamzai, ose Hamza Kastrioti, nipi i Skënderbeut, i pari që i dha besën për aventurën e madhe dhe besnike deri në atë çast. Më vonë ai u korruptua prej një gruaje djallëzore dhe xheloze, e braktisi udhëheqësin e tij, dheun e tij dhe fenë e tij. Më pas ishte Moisi Golemi, dikur tradhtar i komandantit të vet, shefit të vet, por që pas një humbjeje shkatërrimtare (ndërsa sulltani e kishte dërguar atë njëherë kundër Skënderbeut me një ushtri të fuqishme), u kthye të thyente shpatën e tij në këmbët e veta dhe kërkoi ndjesë – duke përjetuar më vonë vdekjen e një martiri.

Mund të kemi harruar këtu të shohim nga afër atë që na thotë Barleti, përshkrimin se çfarë ndodhi më tej. Pas të gjithave, kush mund të thotë se kjo nuk është e bazuar në fakte? Ka çështje të caktuara të cilat kanë të bëjnë me gjëra më të rëndësishme të përdorimit të përditshëm në jetë, të cilat bëjnë mirë të mos i shqyrtojmë tepër shkencërisht dhe si fakte. Ato janë si lulet në një kopsht që vlejné për t'u parë, për t'u adhuruar, për t'u krenuar me to dhe përkulur përpara tyre. Një banket i madh u shtrua me të tëra nderimet e duhura. Kryepeshkopi dhe metropoliti i Durrësit që drejtonte ceremoninë, propozoi një dolli për "*Ushtarin guximtar të Jezu Krishtit*" dhe të gjithë pinë së bashku. Një tjetër dolli u ngrit për lumturinë e bashkëshortes së tij dhe lavdinë e fëmijëve të saj në të ardhmen, e cila u pi me entuziazëm të madh. Më në fund u ngrit edhe ambasadori, i dërguari i

⁴ *Vjosa* kalon në Greqinë Veriperëndimore dhe në juglindje të Shqipërisë. Ajo ka një gjatësi rreth 272 kilometra, nga të cilat 80 kilometrat e parë janë në Greqi, ndërsa pjesa tjetër e këtij lumi kalon nëpër Shqipëri. Në Shqipëri, në Vjosë, derdhen dy lumenj dytësorë, Drino dhe Shushica.

mbretit të Napolit, i cili këndoi një elegji për këtë hero, veprën e tij dhe për atë që kishte bërë për vendin; në emër të këtij vendi, ai i kërkoi atij t'u tregonte atyre diçka për jetën e tij, duke pas qenë njëherë e njëkohë i parapëlqyeri i sulltanit, si ai kishte mundur të ndërpriste lidhje kaq të forta, të hiqte dorë nga feja myslimane dhe të bëhej kampioni i fesë së baballarëve.

Kjo kërkesë u përkrah me shpejtësi prej gjithë të pranishmëve, dhe Princi më në fund ra dakord që t'u jepte atyre një shpjegim të shkurtër të jetës së tij dhe caktoi ditën tjetër për mbledhje. Ai e dha shpjegimin e tij me modesti të madhe, ndjenja të forta, duke i bërë dëgjuesit e tij të qanin ose të qeshnin sipas rastit, duke ilustruar me dritë-hijet e ngjarjeve që u tregonte. Ai veçoi dy gjëra që arsyetonin ndërrimin e fesë:

Së pari, si shqiptar, nderi i tij ishte gjëja më e shtrenjtë; së dyti, kështu ai mund t'i shërbente çështjes më të lartë që ishte liria e vendit dhe popullit të tij. Kjo deklaratë që ishte edhe biografi edhe *rrëfim* për fenë, është pranuar të ketë qenë baza mbi të cilën është vendosur tërë historia e jetës së tij.

Sulltani pasardhës i Muratit II ishte një karakter shumë i ndryshëm nga babai i tij. Ai ishte i vështirë, imponues, mizor, i paskrupullt, hakmarrës, gjëmëmadh. Është e njohur përgjigjja që ai i dha një veziri që guxoi ta pyeste se përse po bëheshin përgatitje aq të ethshme për luftë: “Nëse ti do të dije diçka që është qoftë edhe sa një fije e vetme e mjekrës time, unë do t'ju digjia të gjallë”. Kur shqiptonte një dënim me vdekje, ai gjithmonë e bënte këtë duke qeshur. Dikush e ka përshkruar pamjen e tij të jashtme me një hundë si sqep papagalli. I tillë është njeriu që shfaqet tani në horizontin lindor të Shqipërisë, si një ogur i zi, pararendës i një shkatërrimi të tmerrshëm dhe me ndikim tejet të madh.

Gjatë dy viteve të para, Mehmeti II kishte të tjera trazira dhe ambicie që kërkonin vëmendjen e tij personale. Ai kishte vendosur të bëhej zot i padiskutueshëm i Konstandinopojës, çka e arriti në vitin 1453. Tre vjet më vonë, edhe Greqia u vu nën sundimin e tij. Serbia, sigurisht, kishte qenë prej një kohe të gjatë një

prej aleateve më të forta të Turqisë. Aty mbetej gjithmonë Shqipëria si një hithër djegëse, torturuese, e ngulur në disa zona të padepërtueshme që po e çmendte atë vetë. Në këtë situatë, Mehmeti II kishte vendosur të bënte udhëtimin e tij me tërë forcat drejt e në zemër të Europës, ku kishte shumë gjëra për të zgjidhur me kombet e krishtera dhe Papën, i cili kishte guxuar të projektonte një Kryqëzatë të Shenjtë kundër tij. Krishtërimi besonte që pasi të kishte marrë Konstandinopojën, kreun e Perandorisë Lindore, Mehmeti II nuk do të humbiste kohë për të goditur me tërë forcën e tij të papërkulshme tërë katedralet e tjera të Europës. Në rrethana të tilla, njeriu mund të mendojë se një këshill i madh do të thirrej prej krerëve të të gjitha fuqive të kërcënuara tanimë, me qëllim që të mblidheshin rreth një kauze të përbashkët kundër armikut. E pabesueshme siç është, asgjë nuk u bë për të përballuar atë situatë. Dy forcat që përballonin, frenonin ose bllokunin vërshimin që po afrohej, ishin hungarezët nën Huniadin dhe shqiptarët nën Skënderbeun.

Papa Piu II⁵ shpalli Kryqëzatë kundër të pafeve, duke thirrur një *Consistory*⁶ për këtë qëllim. Përpara se të bëhej kjo mbledhje e prijësve të *Kishës*, erdhi ai plak, i quajtur Pikolomini për shkak të trupit të tij tepër të vogël, i cili u tha:

“Në qoftë se u them të tjerëve ‘Shkoni!’, kjo do të ketë pak efekt; ndërsa në qoftë se them ‘Më ndiqni mua!’, kjo po, do të jetë më e efektshme; kështu unë kam zgjedhur të shkoj vetë, duke ftuar në këtë mënyrë me vepra e jo vetëm me fjalë princat e krishterë që të më ndjekin.” Ankona ishte caktuar si vendi i takimit. Kreu i plakur i Papatit, besnik i fjalëve të tij, u nis në udhëtim, por vdiq ende pa u larguar nga sytë anijet që lanë bregun e që mbartnin kryqtarët që do zbarkonin në Durrës.

⁵ Papa Piu II (*Pope Pius II*), emri i vërtetë *Enea Silvio Piccolomini* (18 tetor 1405 – 14 gusht 1464) shërbeu si papë nga data 19 gusht 1458 deri sa vdiq, më 1464. Papa Piu II, “karakteri i të cilit pasqyron thuajse të gjitha tendencat e epokës kur jetoi”, lindi në Korsinjano në territorin e Sienës, në një familje fisnikësh që po shkonte drejt rrënimit. Vepra e tij më e madhe është historia e jetës së tij, *Commentaries*, e vetmja autobiografi e shkruar nga ndonjë papë. Megjithëse u sëmur nga ethet, Papa Piu II e la Romën për të shkuar në Ankonë, me shpresën se do t’i ngrinte moralin ushtrisë së kryqëzatës. Por ushtria e kryqëzatës mbeti e bllokuar në Ankonë për mungesë transporti dhe kur, më në fund, u shfaq flota venedikase, Papa që po jepte shpirt mundi ta shihte atë vetëm nga dritarja. Ai vdiq dy ditë më pas, më 14 gusht 1464 dhe u pasua nga papa Pali II (1464–71). (Shënimi im – MB)

⁶ Kisha Katolike e Romës (*Roman Catholic Church*): Kuvendi i kardinalëve që drejtohet nga Papa, për miratimin solemn të akteve papale, siç është kanonizimi i shenjtorëve. (Shënimi im – MB)

As edhe një princ i vetëm i krishterë nuk iu përgjigj asaj thirrjeje dhe banda e vogël që shoqëronte Papën, e varrosi atë aty ku ai vdiq dhe më pas u kthye në shtëpi. Imagjinoni se sa e madhe duhet të ketë qenë brenga dhe zhgënjimi i hidhur i asaj ushtrie të vogël veteranësh, të shpërndarë dhe të lodhur, që prisnin në anën tjetër të Adriatikut për ndihmën që do t'u vinte që andej. Por tani ata nuk kishin kohë që të merreshin me keqardhjen e tyre.

Më në fund Mehmeti II gjeti një shqiptar tek i cili besonte se mund të mbështetej për të mposhtur Skënderbeun dhe shqiptarët. Deri atëherë çdo përpjekje për ta arritur këtë kishte dështuar. Përgjatë dhjetë vjetëve luftë, turqit nuk kishin arritur të fitonin qoftë edhe një betejë të vetme. Ky ishte një prej jeniçerëve, një shqiptar i marrë peng, që kishte jetuar midis turqve qysh në fëmijëri. Ai quhej Ballaban Badera dhe sulltani i dha atij kartabjankë edhe në ushtri, edhe në pajisje. Tri ushtri u nisën njëra pas tjetrës kundër Skënderbeut dhe tri herë ato u mundën, u thyen, u shkatërruan dhe u përzunë jashtë vendit. Suksesi i tij i vetëm ishte në kapjen rob të Moisi Golemit dhe shtatë prijësve të tjerë, të cilët me zellin e tyre kishin arritur shumë thellë brenda radhëve të armikut dhe nuk ia dolën të shpëtonin. Këta u morën si trofe lufte në Konstandinopojë, ku sulltani mizor i poshtëroi me tortura çnjerëzore. Në përpjekjen e tij të katërt, Ballabani nisi forcën më të madhe që ishte ndërsyer ndonjëherë kundër Shqipërisë. Skënderbeu, duke inskenuar përherë betejat e tij në malet që ua njihte aq mirë terrenin dhe ku zënia e pritave ishte e kollajshme, e ndau forcën e tij (ai kurrë nuk numëroi më shumë se 10.000 deri në 15.000 burra) në katër pjesë dhe ndërmori një sulm të njëkohshëm nga të katër anët. Këtë herë ishte thënë që tre të katërtat e ushtrisë turke të vendoseshin në *hors de combat*⁷. Përpjekja e pestë u bë me dy ushtri, të cilat ishin përgatitur të sulmonin njëherazi në dy pika të ndara, me shpresë se në mos njëra, tjetra do arrinte të shpërthente dyert e kështjellës.

Skënderbeu e zbuloi planin disa kohë para betejës, kështu që e provokoi ushtrinë lindore ta fillonte betejën përpara se ajo të ishte gati, duke i dhënë asaj një

⁷ Frengjisht në original.

goditje shpartalluese. Me të mbaruar punë me të, ai u kthye për t'u ndeshur me ushtrinë tjetër. Kjo e dyta pothuajse u asgjësua dhe gjenerali i saj, Jakupi, u vra nga vetë dora e Skënderbeut.

Tani Mehmeti vendosi të ndërmerre një përpjekje tjetër për të kapur Krujën. Ai mblodhi një ushtri prej 150.000 burrash për këtë qëllim. Ai kishte qenë dëshmitar i përpjekjeve të babait të tij, sulltan Muratit, për ta shkatërruar këtë *“fole shqiponjash”* në ato male, dhe ishte i sigurtë se vetëm ai mund ta arrinte atë që babai i tij kishte dështuar ta bënte. Muaj të tërë përpjekjesh të pafrytshme dhe humbja e tridhjetë mijë burrave e shkurajuan edhe atë. Kështu, duke lënë Ballabanin të vazhdonte rrethimin, ai tërhoqi një pjesë të ushtrisë për të ndjekur kursin më të lehtë: që me plaçkitje dhe rrënim të popullsisë së paarmatosur të fshatrave, të arrinte atë që donte. Këtu ai ishte plotësisht i suksesshëm. 8000 vetë u vunë në kthetrat e vdekjes, me metoda të tmerrshme dhe djallëzore.

Pas qëndresës së suksesshme ndaj rrethimit të Krujës dhe duke parë se mbetjet e ushtrisë së mposhtur po tërhiqeshin nga vendi, Skënderbeu vendosi të bënte një udhëtim të shpejtë në Romë, që t'i kërkonte ndihmë Papës. Atij iu dha mundësia të fliste përpara princërve dhe prelatëve të *Kishës* dhe mendohet se në atë rast, në mbyllje të fjalimit të tij, ai tha këto fjalë për t'u mbajtur mend:

“Pasi turqit kanë nënshtruar Azinë dhe Greqinë, pas masakrës së princeshës Konstandinopojë, të Trabzonit dhe Sllavonisë, pas nënshtrimit të Peloponezitet dhe shkatërrimit të pjesës më të madhe të Maqedonisë dhe Epirit, ky pushtim i papërmbajtur tani ka si qëllim ta bëjë Romën një Konstandinopojë të dytë, të marrë nëpër këmbë Kryqin, të shpalojë Gjysmëhënën në *Capitol Hill* dhe të skllavërojë popujt e botës. Pas njëzet e dy vjetësh lufte të pandërprerë, i mbetur vetëm me atë çfarë ka shpëtuar nga ushtria ime, me shtetin tim të shteruar nga burimet për shkak të shumë betejave, në një vend, trupi i të cilit nuk ka pjesë të paplagosur, shoh se kanë mbetur vetëm disa pika gjaku për t'u derdhur në emër të Republikës së Krishterë. Në tërë vendin tim, me kaq shumë princër, kaq shumë

kapitenë, kaq shumë luftëtarë fisnikë, sot ka mbetur vetëm një ushtri e vogël; prej tërë fateve tona të lashta, neve na ka mbetur vetëm guximi dhe zemrat tona të pamposhtura. Për dashurinë e Qiellit (Zotit), nëse ende nuk është tepër vonë, ejani e na lehtësoni atje, në anën tjetër të brigjeve të Adriatikut, sa kohë që janë ende gjallë edhe disa atletë të fundit të Jezu Krishtit”.

Në përgjigje të kësaj kërkesë zemërnxitëse, Papa i dhuroi Skënderbeut një kupë, një bekim të shpatës së tij dhe 3000 dukate.

Nga Roma ai shkoi në Venedik, ku siguroi disa mijëra burra, dhe me ta u kthye për të rifilluar luftën e pabarabartë dhe për të mundur ushtrinë turke nën komandën e vëllait të Ballabanit, të cilin ai e vrau dhe pas kësaj e tërë ushtria u asgjësua. Vitin që pasoi, Mehmeti u kthye mbrapsht pas një tjetër përpjekjeje për të kapur Krujën. Gjashtë muaj u harxhuan në këtë përpjekje të pasuksesshme. Pas kësaj ai u tërhoq nga vendi, dhe u kthye duke përdorur rrugën nëpër Elbasan.

Skënderbeu ishte tani në fund të udhëtimit të jetës e të fatit të tij. Ai kishte përfituar nga një armëpushim për të thirrur një kuvend, me tërë udhëheqësit shqiptarë në Lezhë. Aty ai u godit nga një ethe fatale dhe vdiq në mes të bashkëpatriotëve të tij të përkushtuar dhe miqve të tij.

Ai do ta linte vendin e tij në duart e Venedikut, shpirtin e tij në dorë të Zotit dhe vetë u shtri në vendin e prehjes së tij të përjetshme. E vetmja gjë që dua të citoj këtu është se armiku i tij më i madh, Mehmeti II, kur i thanë se Skënderbeu kishte vdekur, thuhet të jetë gëzuar aq shumë, sa e përqafoi lajmëtarin, por i bëri edhe një nderim armikut të tij duke thënë:

“Një luan si ai nuk është parë kurrë mbi tokë dhe kurrë nuk do të shfaqet përsëri!”.

Skënderbeu, Aleksandri i Madh, njëemërak me të, si dhe Cezari fituan të drejtën të ishin heronjtë e vetëm të shquar që nuk kanë humbur kurrë qoftë edhe një betejë. Por ai i tejkaloi ata të dy në virtytet e tij vetjake dhe karakterin e tij të pathyeshëm. Ai ishte një burrë me besnikëri fetare të shkallës më të lartë, i sinqertë,

njerëzor, bujar i sajdisshëm me çdokënd, madje edhe me më të përunjurin. Në betejë ai kthehej në një Aleksandër, kushëriri i tij i gjakut të “shqiponjave.” Ai ishte një shakullimë furie që përçonte tmerr në zemrën e armiqve dhe frymëzonte pasonjësit e tij me guxim të pashembullt. Ata besuan tek pamposhtmëria e tij, çka ishte gjysma e suksesit të betejës. Ai e mbante kokën lart, kishte vështrim tejshkues, kapje instinktive të gjërave të shpejta dhe ndjeshmëri të hollë të gjithçkaje. Me këto cilësi ai tejkalonte edhe më të guximshmin prej burrave, edhe ata që e ruanin përherë prej rrezikut të panevojshëm. Ajo çfarë mrekulloi të gjithë kur ky shpirt “shqiponjë” ndërroi jetë, ishte ajo çfarë tha një prej miqve më të mëdhenj, Lek Dukagjini, i cili eci drejt verandës së shtëpisë ku kishte vdekur prijësi i tij dhe u bëri thirrje njerëzve që po prisnin aty:

“Dëgjoni, dëgjoni, të gjithë ju, princa, njerëz, maqedonë dhe shqiptarë! Sot mburoja e vendit tonë ka rënë, fortesa jonë është shkatërruar deri rrafsh me tokën. Tërë forca jonë ka shteruar, qyteti dhe vendi ynë është i shtrirë përdhe dhe i pandihmë. Po, tërë shpresat tona kanë marrë fund me vdekjen e këtij burri!”.

Ta lëmë Mehmetin II të shtojë fjalën e tij të fundit:

“Vdekja e tij është një shkatërrim i madh për Krishtërimin, pasi ai ka humbur shqytën dhe mburojën e tij”.

Skënderbeu vdiq më 17 janar 1468. Ka kaluar kohë e gjatë që atëherë. Por ai vazhdon të jetojë në kujtimet e racës së tij, në doket dhe zakonet. Ende edhe sot këta malësorë shqiptarë veshin rrobat e zisë kombëtare për prijësin e tyre të vdekur – të krishterë dhe muhamedanë, njësoj. Kështu ruhet kujtimi i tij, i mbajtur gjallë dhe i fuqishëm në zemrat e racës shqiptare edhe sot e kësaj dite.



NË NJË MËNYRË A TJETËR, TURQIA IA DOLI TË LËSHONTE NJË PERDE TË ERRËT NDARËSE MIDIS KËTIJ VENDI TË VOGËL DHE EUROPËS. NJË PREJ FORMAVE MË TË PËRDORURA PREJ SAJ ISHTE PARAQITJA E SHQIPTARËVE SI NJERËZ TË EGËR, TËRËSISHT TË PASHPRESË PËR T'U PËRMIRËSUAR, KAQ TË RREZIKSHËM SA TË THUHEJ SE NUK DO TË KISHTE EUROPIAN QË TË NDJEHEJ NDONJËHERË I SIGURT NË TOKËN E TYRE.



III



LUFTË – REZITENCË – MIZORI

“Preja kokën dhe trupi rrëzohet vetë!” Kjo thënie që i atribuohet Mehmetit II e mori kuptimin e vet tragjik me vdekjen e Skënderbeut. Jo se shqiptarët i lëshuan armët përdhe, dhe pa bërë përpjekje të tjera e ulën qafën dhe iu nënshtruan zgjedhës turke. Jo! Ata nuk ishin të tillë. Çdo prijës u kthye tek fortesa e tij, i vendosur ta mbrojtë atë me çdo mjet, me forcat e veta. Shqipëria Veriore u vu nën mbrojtjen e Republikës së Venedikut dhe osmanët nuk u morën aq shumë me të deri në vitin 1474, pra, afër gjashtë vjet pas vdekjes së Skënderbeut. Gjatë kësaj kohe, vendi u pushtua thuajse në tërë pjesën e brendshme, duke lënë ende të lira vetëm qytetet bregdetare të cilat, për shkak të lidhjeve të tyre me Europën, do t’i tërhiqnin turqit në ngatërresa serioze.

Për të mbrojtur Shkodrën e rrethuar prej turqve që i komandonte Sulejman Pasha, venedikasit dhe malazezët i bashkuan forcat me shqiptarët. Rrethimi dështoi, por ai u përsërit edhe një herë, katër vjet më vonë. Në këtë kohë, edhe Kruja edhe Lezha ranë në duart e turqve. Forcat e mbledhura për rrethimin e dytë ishin të

karakterit më të jashtëzakonshëm, nëqoftëse mbështetemi në statistikat e kohës: 200.000 trupa, 2539 topa për bombardime, 109 mortaja, 10 zjarrhedhësa. Artileria ishte e pajisur me topa që hidhnin gjyle qindrakilogramëshe të rënda. Topat persianë hidhnin dyfishin e asaj peshe. Megjithëse e qëlluar nga të gjitha anët, kështjella i qëndroi çdo bombardimi dhe çdo sulmi. Mehmeti II e drejtoi vetë fushatën. Ai ishte dëshpërimisht i vendosur që t'i jepte fund qëndresës shqiptare. Por prapë dështoi dhe u detyrua të tërhiqej, duke lënë në komandë një prej gjeneralëve, Ahmet Pashën. Kështjella dhe qyteti nuk iu dorëzuan turqve edhe dymbëdhjetë vjet pas vdekjes së Skënderbeut. Por më në fund, kjo ndodhi në vitin 1479. Atë që nuk e bënë dot as gjylet e topave, as shpatat, e bëri uria. Durrësi ra në duar të turqve në vitin 1499, Tivari e Ulqini në vitin 1571, ndërsa Venediku vazhdonte të mbante Pargën, Prevezën dhe Butrintin në Epir.

Ç'ndodhi si rezultat i këtyre ngjarjeve, mund të merret me mend lehtësisht. Pas dorëzimit të Krujës dhe Shkodrës një numër i madh i banorëve të tyre u arratis drejt Republikës së Venedikut për t'u mbrojtur. Në të vërtetë, ushtria venedikase ishte mbushur me rekrutë nga mijërat e veteranëve të luftimeve që ishin zhvilluar në Shqipëri. Nga viti 1492 – 1496 Venediku ishte për vete në luftë në më të shumtën e kohës. Midis çështjeve të tjera ishte njëra që kishte të bënte drejtpërdrejt me Shqipërinë, dhe Durrësin në veçanti. Kryepeshkopi i tij (Fermiando Martino) thuri intriga me mbretin francez për t'ia dhënë Shqipërinë atij. Pastaj Republika e Napolit formoi një lidhje të të gjithë Italisë dhe Francës. Mijërat e ushtarëve dhe civilëve shqiptarë u sakrifkuan në këtë luftë.

As që mund të merrej me mend se si një burrë me karakterin e Mehmetit II do të lejonte një vend të vogël si Shqipëria, e cila i kishte shkaktuar atij aq shumë trazira dhe shqetësime, sa tërë pjesa tjetër së bashku, të mos vihej nën regjimin turk dhe pa një ndëshkim të rëndë. Kjo ishte shkruar të bëhej. Metoda e zgjedhur ishte shumë e efektshme dhe mizore. Hordhi të organizuara të jeniçerëve, shumë prej tyre renegatë shqiptarë që ishin dërguar në Adrianopojë si pengje që kur ishin fëmijë, ishin kthyer të liruar nga zgjedha për t'u ndërsyer ndaj vendit të tyre, për

t'u hakmarrë, për të plaçkitë, varrë e shkatërruar, të tunduar nga nxitja e tyre dhe instinkti shkatërrues. Vendasit që u shitën tek turqit, ishin zogj këрма të atij lloji që gjenden në çdo racë. Ata raportonin tek pushtuesit emrat e atyre që dalloheshin për patriotizmin e tyre. Këta zogj këрма e të padenjë spikatnin për shpikjet e tyre edhe më mizore. Mijëra burra shqiptarë u morën me forcë në ushtrinë otomane. Mijëra të tjerë, burra, gra dhe fëmijë u morën peng në Konstandinopojë dhe aty u masakruan nga Sulejmani I, pasardhës i Mehmetit II. Fshati Arnautköy (fshati i shqiptarëve) u emërua prej shqiptarëve të asaj kohe vendi ku ata i grumbulluan pa asnjë mëshirë. Papa Pali II, duke i shkruar Filipit, dukës së Burgonjës për këtë ngjarje, i thoshte:

“Është për të ardhur keq kur i sheh këta fatkeqë që humbin atdheun e tyre, tek kalojnë detin Adriatik drejt Italisë, me varkat e tyre të pasigurta dhe kërkojnë strehë për të shpëtuar prej barbarizmave të të pafeve në anën tjetër të detit”.

Shembuj të mizorisë së turqve raportohen nga kronikanë të asaj kohe. Në vitin 1527, në një fshat u vra një familje muhamedane. Në shenjë hakmarrjeje turqit grumbulluan tërë fisin dhe masakruan 800 pjestarë prej tyre, aty për aty, në vend. Ndërsa këto vrasje për hakmarrje kishin përfshirë pjesën e brendshme të Shqipërisë, një numër i madh i banorëve arratiseshin prej rajoneve të tyre dhe zbrisnin në bregdet, veçanërisht në Akrokeraune (Acroceraunia), jugu i Vlorës, dhe në anën tjetër, në ishullin e Korfuzit. Në Epir u formua bashkësia e trembëdhjetë fiseve të mbetura midis maleve të Seleidës. Më i madhi i këtyre fiseve ishte ai i suliotëve, për të cilin do të mësojmë më shumë në kapitujt që vijojnë. Thuhet të kenë qenë 12.000 njerëz në këtë bashkësi.

Nieburi, në *Historinë e Greqisë*, bën këtë koment:

“Të thirrur prej një kauze të përbashkët nga feja e krishterë, të ballafaquar me të njëjtin rrezik, shqiptarët e Epirit, Arkananisë dhe Maqedonisë u vunë nën flamurin e Kryqit si grekë. Të shkolluar në greqisht dhe të prekur nga fatkeqësia e tmerrshme që i kishte zënë, këta bij të Shqipërisë mbetën të tillë deri në fund të jetës, me shpirtin

e tyre bujar”.

Këto fise, së bashku me mirditorët në veri, për shkak të numrit, forcës dhe vendosmërisë së tyre, ia dolën të gëzonin disa lëshime të veçanta nga Porta e Lartë, çka i bëri ata të mbanin dhe ushtronin fenë e tyre. Por me tërë këto ujëra të turbullta që rridhnin brenda territorit shqiptar (ndonëse as gjysma e tyre nuk është thënë ende), ishte e pashmangshme të shmangej largimi i një numri të madh të tyre në mërgim, drejt tokave të huaja.

Ne do të vlerësojmë tani këtë shpërndarje të racës shqiptare. Së pari, shkakun i kësaj shpërndarjeje nuk ishte thjesht se populli po ndëshkohej prej turqve. Ata kishin përjetuar kaq shumë gjatë shekujve, sa kjo tashmë ishte kthyer në një mënyrë normale të jetuarit, herë si një furtunë e rrebesh në malet e tyre e herë si një thatësi e zgjatur ose një murtajë.

Ata i përballuan këto vështirësi me stoicizmin e tyre në çdo kohë. Ata i mësoi mësuesi më i madh i tyre. Ky ishte pikërisht “*kismet*”. Por, këtë herë ai ishte diçka i ndryshëm, më shkatërrues, më asgjësues se asnjëherë. Ai kishte një cilësi mallkuese pa kufi. Shqiptarët⁸ kishin jetuar për shekuj me fytyrë drejt lindjes. Që andej kishin ardhur edhe shumica e fshikullimave ndaj tyre. Ata ishin aq ngjitur me Perandorinë Bizantine, sa të ndjenin thellë kamzhikun e turqve në Lindjen e Afërt, shkatërrimet e paimagjinueshme të këtyre popujve të krishterë që kishin nderuar dhe adhuruar. Prej një zgjuarsie të lindur, ata e dinin se diçka shumë më e madhe se ajo që kishin frikë i priste, kur këta turq të egër luftonin me zjarr e hekur për zotërimin e qyteteve të tyre, shtëpive të tyre, altarëve të tyre, trupit dhe shpirtit të tyre. Ajo botë e krishterë do të rrinte e të bënte sehir kur delja të shqyhej prej ujëqërve, bash pak më tej derës së tyre; dhe ajo botë e krishterë mbetej kaq e plogët dhe e papërgjegjshme rreth asaj që mund të ndodhte. Siç më del mua, ka vetëm një shpjegim. Jeta kishte ikur që aty dhe ishte kthyer thjesht në një nocion, në një varr me trupa të pakallur, plot me kocka njerëzish të mbaruar që lëviznin si hije.

⁸ Shqip në original.

Aty nuk kishte asgjë prej asaj flake që shpërthen nga pena e Uiliam Blleikut kur shkruan:

*“Ndëshkimi mendtor nuk do më shuajë dot mua,
As shpatën gjumi nuk e zë në dorën time,
Deri sa Jeruzalemin të kemi ndërtuar,
Në tokën e këndshme të Anglisë së gjelbëruar”.*

Me shpresat e tyre të shkërmoqura, pa udhëheqësit e tyre të shkuar mbi të cilët ishin mbështetur, ata ishin si delet pa bari. E vetmja alternativë e tyre ishte t'i nënshtroheshin fatit, dëshirës dhe kënaqësive të turqve, të mohonin fenë e tyre, të pranonin Muhametin si profetin e tyre, ose të arratiseshin në toka të tjera. Kjo e fundit u bë zgjedhja e vështirë që do ndërmerrenin jo vetëm dhjetëra e mijëra, por qindra mijëra të këtyre bijve të shqipës, grave dhe fëmijëve. Përveç atyre që iu dha azil mëshirues në Republikën e Venedikut, kolonitë e këtyre mërgimtarëve u vendosën edhe në Sicili, Greqi, Dalmaci, Rumani, Bullgari dhe, madje, edhe në Egjipt. Kjo hegira⁹ vazhdoi për më shumë se dy shekuj. Kur pjesëtarët e një bashkësie të caktuar e ndjenin se mënyra se si vepronin nuk shkonte më me pushtuesin, atëherë ata mblidheshin së bashku dhe bënin plan se çfarë gjërash mund të merrnin me vete para se të fillonin kalvarin e arratisë. Dr. Hahni, Fallmerajeri, Tajani dhe të tjerë vlerësojnë se kjo mori luftërash, përpjekjesh, përndjekjesh, masakrash, azilësh që më në fund i vunë turqit në zotërim të padiskutueshëm të Shqipërisë (zyrtarisht i njohur prej Fuqive të Mëdha të Krishtera të Europës), u kushtoi jetën jo më pak se dy milionë njerëzve të kësaj race.

Kur shohim se sulltanët, në përpjekjet e tyre për të zotëruar këtë racë shqiptonjash ndoshta nuk patën kurrë një ushtri më të madhe se 150.000 burra në fushë të betejës, në të njëjtën kohë, forcë kjo të cilën Skënderbeu dhe trimat e tij e mbajtën larg vetes për njëzet e pesë vjet, atëherë lind pyetja: Çfarë bëri Europa me politikat e saj të krishtera për të mos sakrifikuar milionat e djemve të

⁹ Emigrim

këtij vendi të rënë për të shpëtuar ata vetë prej tyre? Ajo në fakt i lejoi turqit të pushtonin territore europiane dhe e vetmja gjë që bënë pritën vëllezërit e tyre të krishterë kur merrnin rrugën e mërgimit drejt tokave më në perëndim. Lejimi i vdekjeve të panumërta, shkretimit, hakmarrjes çnderuese, tokat e djegura dhe njerëzit e përzënë që ata lejuan, e shumëfishojnë shumë herë poshtërimin dhe turpin e ndodhur, në tërësi.

Përpara se të kalojmë tek “koha me e errët e prapambetjes”, siç na nevojitet të bëjmë, me qëllim që të njohim diçka prej historisë së pushtimit turk, do të ishte mirë të bënim një shqyrtim të përgjithshëm. Afërsisht mund të thuhet se Shqipëria u mbajt në kthetrat e sulltanatit të Turqisë nga janari i vitit 1479 deri në janar të vitit 1913, një periudhë kjo prej 434 vjetësh. Rëndësia politike e Shqipërisë për sulltanët ishte se kjo përbënte pjesën më të madhe të territorit ku ishte e pranishme Turia në Europë. Kjo do të na ndihmojë të vlerësojmë faktin se, ndërsa Stambolli lejonte shoqëritë misionare të krishtera të shpërndareshin në masa të mëdha në Anadoll, duke propaganduar kryesisht midis armenëve, ajo mbajti qëndrim krejt të ndryshëm kur ishte fjala për shqiptarët, kudo dhe kurdo bëhej fjalë për ta. Kjon ndodhte sepse Shqipëria duhej të ruhej nga krishtërimi evropian dhe çdo gjë që të kujtonte edukimin dhe mësimin e krishterë. Shërbimi shëndetësor dhe sanitar duhej të mos ekzistonte. Turqit i përdorën ata në mënyrë të pamëshirëshme, duke mos lëshuar pe ndaj kurrëfarë përpjekjeje të tyre për të përparuar dhe zhvilluar vendin e tyre. Nëntëdhjetë për qind e kësaj vinte për shkak të pozicionit gjeografik të Shqipërisë, pasi gjendej në kufi me Europën dhe botën perëndimore.

Në një formë apo në një tjetër, Turqia ia doli të lëshonte një perde të errët ndarëse midis këtij vendi të vogël dhe Europës. Një prej formave më të përdorura prej saj ishte paraqitja e shqiptarëve si njerëz të egër, tërësisht të pashpresë për t’u përmirësuar, kaq të rrezikshëm sa thuhej se nuk do të kishte evropian që të ndjehej i sigurtë në tokën e tyre. Për të përforcuar idenë e tyre të mbrapshtë dhe për ta bërë të besueshme këtë lloj propogande, Porta e Lartë do t’i shtynte shqiptarët tash e parë në revolta, të cilat më pas ajo i shtypte mizorisht dhe pastaj i publikonte

si ndodhi të tmerrshme nëpër botë. Me mjete të tilla ajo u kthye me “mirësi” në një polic mbrojtës të Europës, mbrojtëse nga dhuna dhe gjakderdhja që mund t’i shkaktonin këta luanë, nëse do t’ia dilnin ndonjëherë të thyenin zinxhirët ku ishin lidhur. Kaq bindëse u bënë për mendjet e Europës këto raporte djallëzore, sa erdhi një çast kur besohej se nuk kishte asgjë të mirë që mund të vinte nga Shqipëria, çfarëdo të ishte ajo. Çdo lloj simpatie, çfarëdo lëvdate, sado e thjeshtë dhe e vogël që të ishte, sado thjesht që të shprehej për ato çfarë ky vend kishte bërë nën udhëheqjen e heroit të vet, Skënderbeut, do të kalonte menjëherë në harresë, do të përlyhej me shpifje dhe do të tulatej nën krahët e zinj shpresëvrasës të Turqisë.

Gjatë këtyre katër shekujve të gjatë, përveç një ose dy dërgatave qeveritare që shkuan për të parë gjendjen në vend, pak europianë depërtuan në atë vend. Në shtyp thuajse nuk përmendeshin fare. Edhe ato që shkruheshin kishin qëllim t’u ulnin vlerën, t’i lerosnin dhe të bënin të neveriteshe prej talljeve ndaj gjoja veseve të tyre primitive. Për fat të keq, e njëjta prirje për t’i paraqitur të tillë mbizotëron edhe sot. Nga këndvështrimi i qytetërimit perëndimor, sigurisht aty ka patur pak për t’u lavdëruar gjatë këtyre shekujve të keqsundimit turk.

Përsa i takon gjuhës së tyre dhe shkollimit, analfabetizmi shtrihej gjerë e gjatë në 99 % të popullsisë dhe në tërë territorin e vendit si në zonat e zhvilluara, ashtu edhe në fshatrat e humbur, si tek të varfërit, ashtu edhe tek të pasurit. Por, po t’i përfshinin këtu edhe gjuhët turke, greke, franceze, gjermane, italiane dhe ndonjë gjuhë tjetër, atëherë ky vlerësim do të reduktohej në masë të madhe.

Kjo ka ndikuar së tepërmi për t’i bërë shqiptarët njerëz të shpërfillur nga bota perëndimore. Nuk është marrë fare parasysh fakti se kombit i ishte ndaluar përdorimi i gjuhës shqipe në formën e vet të shkruar: shkollat kombëtare, gjuha, abetaret, shtypja e librave të çfarëdolloj natyre ishin shpallur *yasak*¹⁰. Për “krimin” e sjelljes së abetareve për të mësuar gjuhën shqipe, atdhetarët shqiptarë përndiqeshin, internoheshin, dëboheshin nga vendi i tyre. Primitivizmi i vendit ishte objekt tjetër

10 *Turqisht*: Rreptësisht të ndaluara.

qortimesh të mëdha kudo që Shqipëria zihej në gojë.

E vërtetë është se aty nuk kishte rrugë. Karvane me kuaj kalonin nëpër rrugët e ngushta malore tërë kthesa, pastaj në fushat e dendura me pyje dhe moçale. Dhe asgjë tjetër. Krahinat e ndryshme të vendit, qytetet dhe qendrat e banimit ishin të ndara nga njëra-tjetra prej barrierash natyrore thuajse të pakalueshme. Njerëzit e Shqipërisë së Jugut me ata të Veriut ishin aq larg sa ç'ishin edhe malet në hënë me njëri-tjetrin. Po kaq të rralla ishin kontaktet midis njerëzve në rrethana të tilla. Të njëjtat kushte primitive kushtëzonin mënyrat e veprimit në shtëpitë e tyre, me fushat e tyre, me bagëtinë e tyre, drithërat e tyre, mënyrën e tyre të jetesës.

Gjërat e tjera, si kultivimi i fushave, mbjellja dhe korrja e të lashtave, lufta me motin, të ftohtët dhe vapa, shiu dhe furtuna, thatësira dhe reshjet, ngricat, erërat, shiroku dhe stuhitë, murtajat dhe sëmundjet, mjerimi dhe vdekjet - të tëra këtyre ata u bënë ballë si çdo popull tjetër dhe ishin mësuar me to. Ajo me të cilën ata nuk u mësuan asnjëherë me të, ishte ta duronin si kategori të jetës së tyre të jetuarit nën pushtetin e shpatës së të huajit. Dhe kjo, aq sa ishte e lavdishme ishte edhe fatale për ta. Unë as i mbroj as i qortoq shqiptarët për këtë. Unë thjesht po përpiqem t'i tregoj për ta popullit tonë kaq modern dhe të qytetëruar se sa thellë është zhytur kjo racë në “*honin e errët të natës*” dhe të nxjerr në dritë kohën e tyre të lavdishme e cila duket të jetë tërësisht e harruar.


*Ligështimi, fjalë e lëshuar pa kujdes,
Shqetësim i rëndë si re në një mëngjes,
Vetullngrysur, ajrin duke dëshiruar,
Për të shuar dhimbjet në trupin e mjeruar.*

Për t'i dhënë djallit atë që meriton, le të flasim me fjalët e vjetra turke të sulltanëve të cilët, pasi i “zbutën” shqiponjat, i lanë ato tërësisht të vetmuara.


Vetëm kur filluan t'i nxirrnin probleme vetes, muhamedanë, ortodoksë grekë e katolikë, kur shpesh hakmerreshin ndaj njëri-tjetrit, kur brigandizmi kundër

qeverisë do të shpërthente në masë, kur bejlerët kundërshtarë do të fillonin të grindeshin dhe ziheshin mes fiseve, atëherë sjellja e forcave për t'i shtypur ata bëhej e nevojshme dhe praktikisht e justifikuar. Për t'i sjellë ata në vëmendjen e qeverisë së Stambollit, niseshin ekspedita të caktuara që i dënonin të gjitha palët njësoj, si fajtorin, si të pafajshmin. Kjo ishte e vetmja rrugë që i sillte ata tek vëmendja e pushtuesit. Megjithatë, nuk është e drejtë të thuhet se shqiptarët ishin tmerrësisht të shtypur prej sunduesve të tyre turq. Në pjesën më të madhe ata lejoheshin të jetonin në ato kushte në të cilat shqiptarët ishin mësuar të jetonin. Uria, varfëria, zbatja, sëmundjet, kushtet josanitare, vdekshmëria e fëmijëve dhe grave - këto gjëra dukeshin se nuk i shqetësonin ata dhe aq shumë. Nëse kjo i shqetësonte, ata përsëri mbaheshin... Fjala e tyre, e cila dukej se përdorej thujse aq sa dhe fjala 'Allah' dhe që kishte po aq rëndësi, ishte "Kismet".

Kjo fjalë përdorej për të justifikuar tërë të këqijat që u binin popujve të shtypur; fjala kishte përfutur një lloj shenjtërimi të veçantë, si diçka që nuk duhej kërkuar shumë afër, diçka tek e cila nuk mund të ndërhyhej, të vihej në dyshim apo të ndryshonte. Ajo ishte si një prej cilësive misterioze dhe hyjnore; ajo që ngjiste, duhej pranuar pa mëdyshje, përderisa aty nuk kishte spitale, sisteme sanitare, asnjë kontroll mbi sëmundjet ngjitëse, asnjë kujdes për të sëmurët mendorë, të moshuarit, jetimët; po ashtu as edhe një spital të vetëm për të çmendurit. Kjo po e drejtonte kombin në mënyrën më të rrezikshme drejt egërsisë. Deri kur duhej mbajtur ky kurs i pranuar thjesht si një *Kismet*?



AJO ÇFARË KËRKONIN SUNDIMTARËT E TËRQISË ISHTE NJË KATEGORI BURRASH TË ZOTË PËR TË UDHËHEQUR, TË BESUESHËM DHE PLOTËSISHT TË DEVOTSHËM NDAJ SULLTANATIT DHE INTERESAVE TË TIJ. KY TIP U GJET TEK SHQIPTARËT.



IV



LUANI I JANINËS

Biografia personale e Ali Pashës, për aq sa merret ky libër me të, mund të tregohet me pak fjalë. Ali Pasha ishte shembulli i veçantë i një tipi, i një personaliteti dhe karakteri që ishte produkt i rrallë dhe i pazakonshëm i sulltanatit turk. Po të ishte sheik arab ose aziatik, për shembull, ai nuk do të ishte aq i dallueshëm midis qindra mijërave pjesëtarëve të tjerë të një race të caktuar. Si evropian, gjithsesi, ai bëhet një fenomen i çuditshëm. Turku, individualisht, nuk është një lloj djalli. Por ai është njeri apatik, dritëshkurtër, mendjengushtë, me paragjykime të thella, pa ambicie ose me personalitet arbitrar dhe të frikshëm. Në shtëpinë e tij dhe me fqinjët që e rrethojnë ai është i mirë, bujar, i ndershëm; në veprimet e tij i gëzohet miqësisë së tij mbi një filxhan kafeje shumë më tepër sesa të shesë disa metra fije pambuku tek myshteria. Vendose këtë tip të punojë në administratën e një perandorie dhe do të mësosh shumë lehtë se cili është. Në një kohë shumë të shkurtër, gjithçka rreth tij bëhet mishmash dhe kaos gjithandej. Edhe puna më e thjeshtë zhagitet për javë, muaj e ndoshta vite. Në këtë mjedis të tillë, ajo çfarë kërkonin sundimtarët e Turqisë ishte një kategori burrash të zotë për të udhëhequr,

të besueshëm dhe plotësisht të devotshëm ndaj sulltanatit dhe interesave të tij. Ky tip u gjet tek shqiptarët.

Rezultat i kësaj kërkesë ishte numri i lartë i zyrtarëve civilë dhe ushtarakë, guvernatorë provincash, ministra kabineti, vezirë të mëdhenj të cilët, si shqiptarë, ishin jashtë çdo përpjesëtimi me popullsinë muhamedane në Shqipëri. Rojet e sulltanit ishin shqiptarë, siç ishin edhe ata që ruanin pasurinë e tij dhe haremin. Ndërkohë, shumë prej këtyre burrave, gjykuar me standardet më të larta të karakterit, në rangjet e turqve, më poshtë apo më lart se ata, edhe pse të tunduar nga ajo që shihnin rreth vetes, nuk e lëshuan asnjëherë veten, u vetëmohuan në dëm të vetes së tyre, duke ruajtur integritetin e tyre vetjak deri në fund të jetës. Ishte bërë si rregull që zyrtarët shqiptarë të dërgoheshin jashtë Shqipërisë, në pjesë të tjera të perandorisë, në Anadoll dhe në Lindjen e Afërt.

Brenda Shqipërisë, sulltani ishte kujdesur të mbante një trupë të parisë së bejlerëve, të cilëve do t'u besonte që t'i shërbenin atij. Ai do t'i favorizonte ata me toka të dhuruara dhe pasuri të tjera, duke i vënë në këtë mënyrë nën detyrimet e tij. Prej këtyre burrave të shpërblyer pritej që ta mbanin popullin të qetë, të ushtronin autoritet të pranueshëm mbi të. Ata duhej të jepnin drejtësi dhe do të ruanin qetësinë, do të arbitronin mosmarrëveshjet personale, do të përdornin ndikimin e vet në emër të këtij apo të atij, do të ushtronin detyrat e qeverisjes vendore. Kjo bënte që asgjë të mos arrihej thjesht prej punës së përbashkët të njerëzve, por prej favoreve të blera tek beu. Me një shumë të mirë parash, njeriu mund të blinte dhe të siguronte thujtë çdo favor që ia merrte mendja. Pa dyshim që një favor i tillë kishte çmimin e tij dhe vit pas viti këta bejlerë e rritnin pasurinë dhe ndikimin e tyre. Prej kësaj klase vinte Ali Pasha i Tepelenës, i cili u bë një prej përfaqësuesve më famëkeq të tyre – sipërmarrës *par excellence* prej asaj dore njerëzish që luanin rol të dyfishtë midis Turqisë dhe Ballkanit, nga njëra anë, dhe Fuqive Perëndimore, nga ana tjetër. Secila palë dëshironte ta shtinte atë në dorë. Ai luajti një rol të spikatur midis këtyre dy botëve.

“Aliu lindi në qytetin e Tepelenës në vitin 1744. Babai i tij ishte një dervish që u martua me të bijën e një beu dhe më vonë vrau trashëgimtarin dhe u bë beu më i madh i Tepelenës. I ati vdiq kur Aliu ishte 10 vjeç. Nëna e tij, që ishte gruaja e dytë, mbeti e ve shumë e re, me dy fëmijë jetimë, Aliun dhe një vajzë. Me qëllim që të mbronte veten dhe fëmijët e saj nga armiqtë e tyre dhe kundërshtarët që ishin me shumicë, ajo u betua për pastërti morale, ngjeshi armët dhe u vu në krye të një çete shqiptare, ose një bande guerrille. Aliu prej asaj kohe u ushqye me ambicie, urrejtje dhe lakmi”¹¹.

Ai e filloi karrierën e tij i ri. Në moshën katërmëdhjetë vjeçare u bë kreu i një bande të rinjsh kusarë, të cilët vidhnin lopët e bejlerëve dhe pashallarëve. Kurt Pasha, beu më i fuqishëm jo vetëm i Beratit, por i tërë Shqipërisë Qendrore, duke parë se si i humbiste shumë shpesh gjëja e gjallë, e ndoqi bandën deri sa e shkatërroi atë, duke e marrë peng Aliun, e më pas duke e mbajtur atë në kontrollin e tij për disa vite me radhë. Kur Aliu i kërkoi dorën e së bijës, atij iu tregua dera pa zhurmë, duke mbjellë kështu një gjakmarrje që do të zgjaste tërë jetën. Aliu organizoi një tjetër çetë, e cila bëri kaq shumë dëme, sa Kurt Pasha vuri si shpërblim 5000 pjastra për vdekjen e tij. Aliu i ngjeu rrobat e tij në gjak, i dërgoi ato tek pashai dhe mblodhi shpërblime për vdekjen e vet. Kaq i suksesshëm ishte ai në veprimet e tij kundër pashës, sa tërhoqi vëmendjen e një rivali të Kurt Pashës, njëfarë Kapllan Pasha, valiu i sanxhakut të Delvinës, tek i cili gjeti mikpritje dhe më vonë u martua me të bijën e tij Um – Gylsysten. Ai ishte në atë kohë 24 vjeç.

Përpara se të shkruajmë për karrierën marramendëse të Aliut, është e rëndësishme të kemi një pamje të përgjithshme të kushteve në të cilat jetoi ai. Në atë kohë Epiri ishte nën kontrollin e tre pashallarëve që e merrnin pushtetin drejtpërdrejt nga vetë sulltani. Ata ishin pashai i Janinës, i Delvinës dhe i Paramitisë. Me rangje më të ulta në pozicione dhe autoritet shtetëror ishin një seri bejlerësh që ishin nën sovranitetin e njërit apo tjetrit prej këtyre pashallarëve, të cilëve u paguanin haraçin; të tillë ishin, për shembull, bejlerët e Himarës, Kardhiqit dhe

¹¹ Gabriel Remerand: *Figurat e mëdha të Lindjes (Les grandes figures de l'Orient)*.

Gjirokastrës. Këta burra ishin paria e familjeve të lashta, të mbushur me arrogancë mendjemadhe dhe kryeneçësi, që e shihnin veten si të barabartë me secilin pashë a guvernator, çfarëdo që ata të ishin në autoritetin e sulltanit. Ata ishin jashtë mase xhelozë ndaj njëri-tjetrit, çka i bënte që herë pas here të ndërmerrnin aventura deri në plaçkitje të tufave të bagëtive të njëri-tjetrit, të përfshiheshin në gjakmarrje të shpeshta për sherre pronësie tokash, etj. Asnjë prej tyre nuk ishte i prirur kundër kusarisë, prandaj ata sulmonin e plaçkitnin sa karvanet e tregtarëve, aq edhe detachmentet e trupave të ushtrisë turke. Shpesh lufta guerrile vazhdonte me muaj, madje edhe me vite të tëra, midis njëri-tjetrit ose kundër pashait kundërshtar. Ishte një linjë e dëshpëruar në të cilën fituesi i merrte të gjitha, vetëm për të zënë radhën që të bëhej më pas viktima e një kundërshtari tjetër më të fuqishëm.

Popullata e krishterë ishte pak më mirë se sa vasalët nën këta bejlerë muhamedanë dhe pashallarë. Urrejta e idhët vlonte në zemrat e të krishterëve kundër turqve osmanë dhe tërë lajkatarëve me gjak shqiptar, që shpesh ishin më fanatikë dhe më hakmarrës se sa vetë turqit. Këta të krishterë nuk i shikonin më shqiptarët muhamedanë si vëllezër me të njëjtën lidhje gjaku. Tërë lidhjet e tjera racore dhe besnikëria u shkatërruan deri në themel prej procesit përçarës e mizor që e kishte ndarë trupin e racës në dy pjesë, në dy kampe armiqsh e të huajsh.

Shpesh qiramarrësit e krishterë të bejlerëve muhamedanë shpërthenin në rebelime të hapura, duke çuar në raprezalje mizore dhe barbare. Në shënimet e tij për këtë kohë, *Pukëvili*¹² përmend se si ishin ushqyer këto pasione, se si në një fshat të caktuar, një bej muhamedan, duke kaluar së bashku me shërbyesën e vet dhe një numër qensh, e detyroi fshatin që t'i jepte ujë qenve të tij. Më vonë këta fshatarë sollën tek beu një derr të gjallë si shpagim. Gjëra të tilla duken si pa rëndësi për ne, por për këta njerëz këto ishin aq fyese, të vrazhda dhe të shëmtuara, sa që një popull krenar nuk mund t'i duronte kurrë. Për ta ndërlikuar edhe më shumë situatën e pashpresë, aty gjëndeshin edhe sekte të ndryshme; muhamedanë liberalë dhe ortodoksë, të njohur si suni dhe bektashi, të cilët injoronin pesë faljet e ditës,

¹² Kujtime mbi jetën dhe pushtetin e Ali Pashës së Janinës (Memoires sur la Vie et la Puissance d'Ali Pascia de Janina).

pinin verë dhe quheshin prej sunitëve si aspak më të mirë se paganët. Pastaj vinin ata që nuk ishin as të krishterë, as muhamedanë, por diçka prej të dyjave. Këta mund të festonin edhe për Virgjëreshën Marie, edhe të agjëronin gjatë Ramazanit. Kaq shumë ndarje, kaq shumë fraksione...

Kur i sheh njeriu gjërat në tërësi, me pamjen e tyre të plotë, me kaq shumë fraksione ndërluftuese, me fe konfliktuale dhe demoralizim të përgjithshëm, atëherë kupton se sa të turpshme dhe skandaloze ishin ato. Ka një histori të lidhur me një bej, një aga (rang më i ulët) në Leskovik, i cili për dhjetë vite të tëra nuk doli një herë jashtë shtëpisë së tij. Për më tepër, ai nuk guxoi as të kalonte dritaren me hekura të dhomës ku fshihej, sepse kishte frikë se do të vritej prej armiqve të tij¹³. Kur shoqëria vjen në një gjendje të tillë që mbetet kështu për shekuj të tërë, kjo mund të sjellë vetëm egërsim në sjellje dhe demoralizim të përgjithshëm. Në këtë veçanti, ndoshta, kishte pak për të zgjedhur midis qenve të çobanëve molosianë¹⁴, të njohur edhe në historinë e lashtë për egërsinë e tyre, të rritur bash në këtë tokë për të cilën po flasim, dhe çobanëve të cilët janë zotët e vetëm të tyre.

Edhe toka ishte shkelur, edhe njerëzit kishin vuajtur aq shumë fizikisht dhe shpirtërisht, sa të mbusheshin me kaq shumë urrejtje dhe dhunë, sa të meritonin plotësisht titullin e dhënë dhe rangun që mbanin midis kombeve të qytetëruara të Europës. Fëmijët në djepet e tyre përkundeshin me urrejtje dhe rriteshin bashkë me farën e plaçkitjes dhe të luftës, të hakmarrjes dhe gjakmarrjes.

Përsa u takon marrëdhëniet midis të krishterëve dhe muhamedanëve, edhe aty kishte pak për të zgjedhur. Të dytët ishin më të fajshëm sepse, në një farë mënyre, ishin ata “sunduesit”, kishin më shumë autoritet, ishin më të fuqishëm edhe në numër, edhe në pasuri. Sikur ata të kishin marrë një qëndrim më pajtues në drejtim të popullsisë së krishterë, është pothuajse e sigurtë se mund të ishin vendosur marrëdhënie më të mira.

¹³ Shih Pukëvilin

¹⁴ *Moloserët* janë një kategori qensh të mëdhenj dhe të fortë, ku pëmbliidhen disa raca, të cilat ndoshta kanë të njëjtën origjinë. Ky emër vjen nga *Molisia*, rajon i Epirit të lashtë.

Por ashtu siç ishte, njeriut i kujtohet përgjigjja e zemëruar e Shilokut, që i dha persekutorit të tij të krishterë, te *Tregtari i Venedikut*:

*“Ligësinë që më mësuat do ta vë në jetë dhe, që të mos më dalë keq, do të bëj çmos t’ua kaloj mjeshtrave të mi”.*¹⁵

Me një të kaluar të tillë siç është përshkruar tashmë, nuk do të jetë e vështirë të plotësojmë tipin dhe karakterin e Ali Pashës, ose ndonjë burri tjetër që deshi të trashëgonte pushtetin dhe fuqinë e tij. Siç na e përshkruajnë biografë të ndryshëm, si Gabriel Remerandi, Pukëvili, Liku (Leake), H.Hollandi, Hobhausi, Ropi (Roppe) dhe të tjerë, ai nuk ishte fizikisht një tip shqiptar, siç e kemi njohur ne. Në moshën 60-vjeçare, ai ishte një burrë i shkurtër, i deformuar prej trashësisë së tij tejet të shprehur. Sytë e tij të futur thellë, syshkrepëtimë, ishin tipari më goditës në fytyrën e tij. Ai mbante mustaqe tejet të gjata, të cilat ishin bërë me njolla prej pirjes së pandërprerë të duhanit, me pipin prej qelibari. Duart e tij thuhet të ishin shumë të hijshme dhe gishtërinjtë të mbushur me gurë të çmuar. Ai mbante përherë në dorë tespije që përbëheshin prej 19 perlash orientale të një mase jashtëzakonisht të madhe, të cilat thuhej se ishin marrë me forcë nga një tregtar që e kishte joshur të vinte në Janinë. Edhe armët e tij, pistoleta, si dhe pushkët e tjera ishin zbukuruar njësoj me xhevahire të çmuara, ar, argjend dhe gdhendje me dorë. Rrobat e tij, përveç çallmës që mbante mbi kokë, ishin aq të shkëlqyera si material, të bukura në ngjyrim dhe të pasura në zbukurime, sa dhe ato të një monarku oriental. Qeshja e tij shpërthyesë, e egër, grykore thuhej të ishte frikësuese. Aliu ishte i pajisur me një pasion të dhunshëm, me një ambicie pa kufi, ku bashkohej gjithashtu pandershmëria e mashtrimi aq sa nuk gjendej një i dytë si ai. Ai prirej nga një oreks për pasuri të pakufishme, çka përbënte forcën motivuese të jetës së tij.

“Ai ishte i bukur, i zoti, penetruar, aktiv, i gjallë, tej mase i zgjuar, i aftë për të ndjerë kushtet dhe rrethanat me intuitë; temperamenti i tij nervoz e mbante atë në një gjendje të shqetësuar të përhershme, duke e tërhequr në sipërmarrje të jashtëzakonshme, me ëndrrat, projektet të cilat kërkonin një ushtri shërbëtorësh

¹⁵ Shekspir (Shakespeare): ‘*Tregtari i Venedikut*’.

dhe individësh të çdo klase dhe lloji për t'i zbatuar.”

Pukëvili, duke e konfirmuar këtë, vlerëson si më poshtë:

“Ai i hapi udhë një plani për të ndërtuar një kështjellë pikërisht atëherë kur kishte dhënë urdhër për të djegur një fshat. Ndërkohë që po dëgjonte një ferman që po lexonte, ai rregulloi llogaritë e pronarit të hotelit. Ai nënshkruante një dënim me vdekje e fill pas tij një kontratë martesë”.

Nuk kishte vizitor që të arrinte takim me të, sido të ishin rrethanat, nëse nuk do të paguante më parë bakshishin që i kërkohej, një rrobë veshjeje, një dele të gjallë apo fruta, sipas vlerave të tyre të përcaktuara, bazuar në rëndësinë e secilit. Personi që pranohej, i qasej me sytë e ulur, me duart të lidhura kryq, përpara gjoksit (një gjest kujdesi ky) dhe i përgjunjur përpara tij, i puthte këmbën dhe i përgjigjej pyetjeve të pashait, pa diskutuar apo dhënë shpjegime. Kujtesa e tij ishte e tillë që jeta e çdonjërit i stampohej menjëherë në mendje, sapo njeriu paraqitej përpara tij. Të huaj, të panjohur, zyrtarë të rangjeve të larta e gjenin atë të dashur, fisnik dhe tej mase të sjellshëm. Oborri i tij ishte brilant, si më i miri oborr europian; ai reflektonte tërë shkëlqimin, elegancën dhe luksin e një mbreti.

Kështjella në të cilën jetonte ai në Janinë gjendej në majë të një pike vështrimi nga ku shihej liqeni. Hyrja e saj ishte një portë e montuar në një mur masiv, i cili përmbyllte anët e truallit ku ishte vendosur kështjella. Ndërtesa vetë ishte prej druri, në formë drejtkëndëshe, ku përfshinte oborrin, duke lënë një korridor për rojet që endeshin para-mbrapa ditë e natë. Një tjetër pjesë përmbante haremin, megjithëse Aliu – sipas zakonit të muhamedanëve të Shqipërisë – kishte vetëm një grua. Ngjitur me pallatin kishte ndërtesa të tjera të panumërta, kuzhina, magazina dhe depo, arsenal armësh, dhomat e thesarit, burgun etj. Një ushtri shërbëtorësh, të veshur me rroba të ndritshme, me modele plot me ngjyra jete, shpërndanin nëpër oborr rrëmujshëm ushtrinë e vogël të shitësve dhe klientëve që sillnin mallrat e tyre brenda rrethit të tij të mbyllur. Aty dëgjohehin të fliteshin gjuhë të ndryshme që përplaseshin nëpër tërë pallatin si rrapëllimë e zhurmshme përrënjshe të

rrëmbyeshëm. Aty gjendeshin jevgjitë, gjahtarë me trofetë e tyre, akrobatë, aktorë, arinjtë lozanjarë, tregtarë grekë dhe hebrej, korrierë tartarë, skllave zezake të pallatit, puthadorë e servilët të vezirit. Aty kishte rusë, serbë, bullgarë, turq, shqiptarë, grekë, levantinë, arabë, italianë që secili veçmas dhe të gjithë së bashku i kontribuonin atij pallati. Po të shohim fillimin e karrierës së Ali Pashës është e vështirë të thuhet se ka patur diku gjetkë në botë një oborr tjetër që mund të krahasohej me të tijin. Ishte një fantazmagori e shkëlqimit barbar, e shkrirë në luksin dhe madhësitinë e oborrit të Luigjit XV.

Aty kishte dy role shumë të dallueshme të luajtura prej këtij burri të jashtëzakonshëm; njëri ishte ai i një europiani, ku luante lojë diplomatike mbretërisht; ndërsa tjetri ishte roli i tij si një turko-shqiptar, me cilësitë më të mira të të dyve, i zvetënuar prej përdorimit më djallëzor dhe më të dobët. Loja në petkun e njërit rol kërkonte ndihmën e lojës në rolin tjetër, sikundër kemi patur rastin ta dëshmojmë. Gjithsesi, dëshiroj t'i jap lexuesit tim një pamje mendore të këtij burri të mahnitshëm në rolin e tij të diplomatit europian dhe të asaj se çfarë ishte ai në gjendje të arrinte dhe të përmbushte.

Ka patur një periudhë të gjatë kohore kur Ali Pasha mbështetej në favoret e Napoleonit të Madh. Ishte viti 1797, kur u shfaqën fillimisht interesat e Napoleonit në Shqipëri dhe lidhjet e tij me Ali Pashën. Prej *Traktatit të Campo – Formios*¹⁶ që Napoleoni i imponoi Austrisë dhe Republikës së Venedikut, ato u zhveshën prej zotërimeve mbi Adriatik dhe Jon, përfshirë edhe një numër ishujsh dhe terrenesh tokësore, qytetet e Prevezës, Konicës, Pargës ose Butrintit. Bonaparti udhëzoi që Aliun t'i bëheshin tërë favoret, madje të ndihmohej që t'i ngjallej shpresa për t'u bërë mbreti i Shqipërisë. Francezët u detyruan të mbështesnin Aliun në ambiciet e tij për ta vënë Shqipërinë nën kontroll. Kështu shefi i Shtabit të ushtrisë së Napoleonit u dërgua në Janinë për të biseduar kushtet me Aliun, nëse ishte e

¹⁶ Traktati i Kampo-Formios (*The Treaty of Campo Formio*) – (në original edhe *Peace of Campo Formio*) u nënshkrua më 18 tetor 1797 nga Napoleon Bonaparti dhe konti Filip fon Kobenzl, respektivisht si përfaqësues të Francës dhe monarkisë austriake. Ky traktat shënoi fitoren e fushatave të Napoleonit në Itali, rënien e Koalicionit të Parë, si dhe përfundimin e fazës së parë të luftës revolucionare franceze. (Shënimi im – MB)

mundur të sigurohej mbështetja e tij e plotë për kauzën franceze. Gjatë këtij takimi Aliu bëri *faux pas*¹⁷. Ai i mbushi mendjen gjeneralit Rozé se ai vetë ishte dishepulli më i besueshëm i fesë së jakobinëve dhe se donte të ndërmernte kultin e Karmanjolës (Carmagnole).¹⁸Vitin tjetër, ndërsa Napoleoni kishte shkuar mjaft larg në luftë me Egjiptin dhe kishte tërhequr thuajse tërë garnizonet e tij nga Epiri dhe ishujt ngjitur, Ali Pasha, me pëlqimin e Portës, përfitoi nga ky rast për të zgjeruar territoret e tij. Butrinti dhe Preveza ishin të fortifikuara nga të tëra anët. Francezët në Butrint, të sulmuar ashpër, kishin vetëm 400 prej trupave të tyre për mbrojtje, por kishin armatosur dhe rekrutuar edhe 300 grekë. Ali Pasha u dërgoi fjalë këtyre të fundit që të tërhiqeshin, ose në të kundërt ai do t'i shkonte një për një në tërë shpatës...Edhe pse brenda fortifikimeve, garnizoni u detyrua të dorëzohej, grekët ia mbathën me të katra në frikë e në tmerr sapo dëgjuan britmat e këmbësorisë shqiptare. Qyteti u plaçkit dhe u dogj, të tërë ata që ishin të krishterë, gratë dhe fëmijët u vunë prej ushtarëve para vdekjes. Tërë natën masakrat dhe vrasjet nuk ndaluan. Në mëngjes, një turrë e kobshme kokash të ushtarëve francezë dhe 160 grekëve qëndronte zbuluar. Thuhet se negri trupmadh që vepronte si ekzekutor, ra i vdekur nga lodhja dhe kutërbmi i rëndë i gjakut, para syve të Ali Pashës.

Një pjesë e francezëve, e përbërë nga 8 oficerë dhe 147 burra që kishin mbetur, u detyruan të shkonin tek vendi i masakrës, të kriposnin kokat e francezëve të vrarë, t'i fusnin nëpër thasë dhe t'i transportonin për në Janinë. Aty populli i gjuajti me gurë. Që andej, ata u shpunë në Konstatinopojë, duke mbajtur kokat e bashkëpatriotëve të tyre në atë mënyrë aq makabër e të tmerrshme. Ishte mes dimri dhe, duke kaluar nëpër male, shumë prej tyre iu dorëzuan të ftohtit dhe

¹⁷ Frengjisht në original: Hap i gabuar.

¹⁸ *Karmanjola (La Carmagnole)* rrjedh nga një emërtim i një lloj xhakete të shkurtër që mbanin *sans-culottes*, militantë të klasës punëtore, e përshtatur nga kostumi i fshatarit të Piemontit, emri i të cilit rrjedh nga qyteti Karmanjola (Carmagnola) Ky është titulli i një kënge franceze që u krijua dhe u bë shumë e famshme gjatë Revolucionit Francez. Ajo u bazua mbi të njëjtën melodi dhe kërcim energjik, me të njëjtin emër që mund të jetë sjellë në Francë nga piemontezët. Kënga u krijua fillimisht në gusht të viti 1792 dhe më pas asaj iu shtuan elemente të tjera (u ripunua) më 1830, 1848, 1863–64, dhe 1882–83. Autorët e saj nuk dihen. Kjo këngë është triumfalisht sarkastike për fatin e mbretëreshës së Francës, Marie Antuanetës dhe mbështetësve të monarkisë franceze. (Shënimi im – MB)

lodhjes. Këtyre iu pre koka njëri pas tjetrit. Kokat e tyre të prera i shtoheshin peshës së tmerrshme të atyre që vazhdonin të jetonin dhe t'i mbartnin ata. Në Konstandinopojë të mbijetuarit u rrasën nëpër thasë, ashtu siç arritën atje, të gjallë dhe u hodhën në det, si oficerët, ashtu dhe të tjerët, pa dallim. Vetëm gjeneral Lazalseti (Lasalcette), adjutanti i gjeneral Rozesë, dhe dy apo tre të tjerë u mbyllën në burgun shtetëror.

Kapja e Butrintit dhe Prevezës ia rritën pa masë emrin dhe famën Ali Pashës në Europë midis armiqve të Napoleonit. Porta e Lartë i dha një titull të barabartë me atë të një konti anglez. Admirali Nelson, flota e të cilit mori një udhëtim në Egje në atë kohë, dërgoi një prej oficerëve eprorë tek Ali Pasha për të paraqitur “tek pushtuesi i Prevezës përgëzimet e pushtuesit të Aboukirit” dhe, gjithashtu, për t’i shprehur keqardhjen e thellë të admiralit që ai nuk mund të vinte vetë për ta përqaftuar dhe për t’i dhënë në dorë titullin “Hero i Epirit”. Por disa vjet më vonë, në vitin 1806, kur Napoleoni ishte në prag të luftës me Rusinë dhe atij i duhej miqësia dhe mbështetja e Turqisë dhe “Heroit të Epirit”, gjithçka që kishte ndodhur midis Aliut dhe Francës u harruan. Ambasadori i Napoleonit, Besiers, u dërgua me dhurata tek Ali Pasha.

“Këto - thotë Pukëvili, konsulli francez në Janinë, - e bënë atë rrezatues dhe ai u gëzua nga dhuratat”. Kur Aliu, në kthim të gjestit, i dërgoi dhurata Napoleonit, ai urdhëroi ministrin e tij të Marrëdhënieve me Jashtë që të njoftonte Aliun se, “nëqoftëse Korfuzi do të binte nën pushtetin tim, unë kurrë nuk do të gjeja një gardë më të mirë sesa ajo e Ali Pashës për t’ia lënë në dorë”.

Napoleoni po dërgonte armë dhe municione për t’i shpërndarë midis parisë shqiptare, prandaj Aliu synoi me lakmi të madhe pjesën e luanit. Ai dërgoi edhe një prej njerëzve të tij në Konstandinopojë për të ndërmjetësuar me ambasadorin francez në emër të tij. Napoleoni mendonte se Ali Pasha nuk kishte nevojë për shtesë furnizimesh për luftën, për t’i bërë ballë çfarëdo sulmi që Rusia mund të ndërmernte në zotërimet e tij apo në ato franceze. Napoleoni i shkruante ambasadorit të tij: ‘Ali Pasha nuk ka nevojë për ndihmë; 2.000 deri në 5.000 rusë

në Korfuz nuk mund ta sulmojnë atë në malet e tij. Nëse ai dëshiron disa fuçi baruti dhe fishekë, le t'ia japim.' Më në fund u shtuan disa mjete artilerie dhe oficerë për t'i drejtuar ato. Ali Pasha rekrutoi tani një regjiment shqiptarësh për Napoleonin, të cilët i bënë atij një shërbim shumë të madh”.

Konsulli francez, Pukëvili, ishte pajisur me aftësi të mëdha dhe dhelperi të jashtëzakonshme për të luajtur lojën midis francezëve dhe anglezëve kundër njëritjetrit dhe kështu të mbronte interesat e vendit të tij. Forcat franceze të xhenierëve ishin pajisur me mjete për të fortifikuar Janinën në mënyrën më moderne të kohës, si dhe për të ndërtuar pika fortifikimi dhe mbrojtjeje përreth Prevezës. Si shpërblim ndaj kësaj, Aliu vendosi 4000 forca shqiptare nën komandën e oficerit francez Nikola. Në këtë kohë francezët po thurnin intriga me perandorin austriak, Francis për ta ndarë Perandorinë Osmane midis tyre. Aliu u kërkoi francezëve që t'ia kalonin Pargën atij, por banorët deklaruan se ata më mirë do të vrisnin veten, se sa t'i nënshtroheshin Aliut. Prandaj Napoleoni nuk pranoi dhe e shtoi Pargën tek shtatë ishujt Jonianë që ata qeverisnin. Lufta midis Francës dhe Turqisë dukej e pashmangshme, prandaj Aliu mbrojtjen e kërkoi nga Franca. Pukëvilit, të cilit ia besoi bisedimet, ai i tha: “Më ruajtë Zoti i Madh, unë jam skllavi dhe shërbëtori i tij”. Në të njëjtën kohë, ai mbante lidhje të fshehta me Portën e Lartë dhe thurte intriga me anglezët.

Më 12 nëntor 1807, një skuadër e vogël angleze u shfaq përpara Prevezës. Kapiteni i saj zbarkoi dhe u prit prej Aliut. Në bisedën që vijoi, Aliu premtoi ndihma të ushtrisë së tij për të kapur ishujt jonianë. Kjo ndodhi katër ditë pasi Pashai i kishte dërguar një letër falenderimi komandantit francez, Sebastianit, mbushur plot me lajka, ku i shprehte mirënjohjen e tij për miqësinë e Francës dhe ndikimin e saj mbi Portën e Lartë në marrjen prej tij të Prevezës, Konicës, Pargës dhe Butrintit. Biseda me kapitenin anglez nuk kaloi pa u shpërblyer. Kapiteni Uiliams Martin Leake, një oficer gjenial, ish-instruktor i ushtrisë otomane, bëri një udhëtim nëpërmjet Epirit për të vëzhguar terrenin për anglezët, nën rroben e një arkeologu. Rezultati i këtij raporti e çoi kabinetin britanik t'i dhuronte Aliut

Urdhërin e Kavaljerit të Shën Gjergjit, si dhe shumë monedha angleze për të mbushur xhepat e tij aq të thellë. Tani, duke u bërë më i guximshëm se asnjëherë, Aliu filloi të kapte në rrugë korrespondencën franceze me Portën e Lartë, duke bërë edhe publikata të vulave franceze për qëllimet e tij.

Pasi filluan të dyshojnë, francezët bënë një protestë të fuqishme ndaj Portës, e cila në kthim i shkroi Aliut që të pushonte sjelljen antagoniste ndaj francezëve dhe të hiqte dorë nga tërë intrigat me anglezët, të cilët ishin në atë kohë në luftë me turqit. Me ta marrë këtë porosi, Aliu dërgoi një ambasador në Maltë për të biseduar me anglezët. Ai ofroi ushtritë e tij për të përzënë francezët nga ishujt jonianë dhe Parga. Kjo ofertë u pranua nga kabineti anglez, i cili i premtoi Aliut ta bënte mbret të pavarur të Shqipërisë. Edhe shtatë ishujt, të cilët të tërë së bashku do t'u merreshin me zor francezëve, do t'i jepeshin Aliut, me kusht që ai t'i paguante haraç *Kurorës Angleze* dhe t'i transferonte *Porto Palermon* aleatëve të tij. Kapiteni Leake u vendos dhe banonte si i deleguar i Anglisë tek Aliu. Një arsenal i tërë pajisjesh lufte dhe municioni u vendosën në Prevezë. Në Sicili anglezët përgatitën gjithashtu një ekspeditë për të bashkëpunuar, me shpresë se Ali Pasha do ta ndizte luftën midis Francës dhe Turqisë. Ndërkohë, Pukëvili, i cili ishte kthyer në shoqëruesin e pandashëm të Aliut, sa kohë që ai i kishte vicklat mirë me Napoleonin, ishte bërë po ashtu edhe një i burgosur virtual, i mbajtur pa mundësi komunikimi. Lidhjet midis anglezëve dhe Aliut u bënë më të afërta dhe më miqësore. Lordi Bajron dhe shoqëruesi i tij, J.C. Hobhaus, vizituan Ali Pashën, i cili i trajtoi ata me mikpritje princërore, u pagoi të tëra shpenzimet e qëndrimit dhe i dërgoi në një tur nëpër Epir me eskortën e tij mbrojtëse madhështore. Lordi Bajron u impresionua jashtë mase dhe ia shpërbleu këtë me poemën e *Çajld Haroldit*, tashmë shumë e njohur për të gjithë. Pavarësisht se shtatë ishujt jonianë ranë në duart e anglezëve pasi iu rrëmbyen Francës dhe, po ashtu, edhe Parga dhe Shën Maure, të cilat i ishin premtuar Aliut, marrëdhëniet e tyre ishin ende më miqësoret.

Në një prej këtyre shndërrimeve, herë me njërën palë e herë me palën tjetër, ndodhi që trupat shqiptare që shërbenin për francezët, të bindeshin që të ndërronin

kahje e të shkonin tek anglezët me të gjitha armët dhe pajimet që kishin. Kjo u bë me nxitjen e primatit grek të Shën Maures. Ndhimesa e Aliut konsistoi në furnizimet e luftës dhe lejen për anglezët për të pajisur një port në territorin e tij turk. Tani ndodhi edhe shkëmbimi i dhuratave. Në fillim anglezët dërguan tek Aliu një mjet plot me kafe dhe sheqer. Kjo u pasua prej një vizite personale të gjeneralit anglez, Osvald, në Prevezë.

Aliu ishte tejet i dashur kur merrte dhuratat. Në mes tyre kishte një dyzinë pistoleta, tre karabina, gjithçka e mrekullueshme që bëhej me dorë dhe tre kuaj arabë të pajisur me tërë aletet më të spikatura. Disa ditë më vonë arriti në Janinë një trupë angleze që shoqëronte një dyzinë kuajsh të ngarkuar me argjend. Për muaj të tërë, në një ditë të caktuar, Aliu merrte subvencionin e tij me monedha floriri angleze dhe spanjolle. Falë kësaj mbështetjeje britanike, Durrësi, Vlora, Berati, Ohri dhe madje edhe Dibra, me kohë, e njohën sundimin e Ali Pashës. Paratë angleze dhe spanjolle luanin sigurisht rolin e tyre në bindjen e këtyre krahinave për t'iu nënshtruar atij.



SIKUR ALI PASHË TEPELENA TË KISHTE QENË NJË SKËNDERBE I DYTË, FUNDI DO TË ISHTE I NDRYSHËM DHE E TËRË HISTORIA E MËPASTAJME E BALLKANIT DO TË NDRYSHONTE, GJITHASHTU. ME SHQIPËRINË SHTET TË PAVARUR, NË FILLIM TË SHEKULLIT XIX, KU TË PËRFSHIHESHIN TËRË TERRITORET E SAJ QË NË ATË KOHË SIGURISHT QË DO TË KAPNIN DYFISHIN E SIPËRFAQES SË SOTME, PROBLEMI MË I MADH DHE MË I RËNDËSISHËM I BALLKANIT, I LIDHUR ME ÇDO KOMB E ME ÇDO RACË BRENDA KËTIJ GADISHULLI, AI SHQIPTAR PRA, DO TË ISHTE ZGJIDHUR NJËHERË E PËRGJITHMONË.



V



ALI PASHA, TRIM I ÇARTUR

“Me shpresë për të merituar parajsën, duke e bërë tokën një ferr.”

Pelegrinazhi i Çajld Haroldit

Lordi Bajron

Le të mos harrojmë, siç ndodh me racën shqiptare dhe udhëheqësit e saj, kombet e krishtera të Europës, të cilat luajtën pjesën e tyre në disa prej ngjarjeve më të turpshme që kanë lënë shenjat e gjakut në faqet e historisë tragjike të Shqipërisë.

Çështja e parë është ajo që ka të bëjë me himariotët. Ata ishin një prej fiseve që migruan brenda për brenda vendit në kohën e pushtimit turk drejt këtij bregdeti malor të jugut të Epirit, me shpresë se do të shpëtonin nga terrori i turqve dhe do të ruanin fenë e tyre të krishterë. Ali Pasha kishte hasur në zemërimin e tyre të përhershëm, pasi ata i bllokunin rrugën për pushtimin e mëtejshëm të këtij bregdeti. Venediku kundërshtonte çdo masë ekstreme që ai ndërmernte për nënshtrimin e tyre.

Në vitin 1798, ndërkohë që ishte në ditë të mira me Francën, ai i mikloi francezët që ta lejonin të bënte luftë me himariotët. Deri në atë kohë francezët kishin refuzuar ta lejonin. Sulmi kundër himariotëve u planifikua të ndërmerrej në mesnatën e Pashkëve. Fshatarët ishin mbledhur të gjithë nëpër kishat e tyre për meshën e mesnatës dhe festën e ringjalljes. Të tërë po luteshin dhe po prisnin çastin ngazëllyes kur prifti do të shqiptonte fjalët “*Christos a nesti!*”¹⁹. Në këtë çast ushtarët e Ali Pashës shpërthyen dyert e kishave, i rrëmbyen dhe i mbytën priftërinjtë përpara altarëve, pastaj u lëshuan me shpata mbi besimtarët, burra, gra a fëmijë qofshin, në një masakër të pamëshirshme dhe djallëzore. Ata që shpëtuan, ia mbathën drejt maleve ku u kapën dhe u dërguan në Artë. Terrori i shkaktuar solli nënshtrimin e himariotëve, të cilët u pajtuan të pranonin islamimin në masë. Për këta Aliu ndërtoi xhami dhe teqe në çdo fshat dhe dërgoi hoxhallarë për t’i mësuar njerëzit me fenë e re. Thuhet se ky sukses i Ali Pashës i dha kënaqësi të madhe Portës së Lartë, e cila e shpërbleu atë me titullin “Luani i Janinës”.

Hapi tjetër i tij ishte nënshtrimi i suliotëve të paepur. Këta ishin fqinjët e himariotëve, por edhe më të qëndrueshëm e më të fortë në malet e tyre thuajse të pakalueshme. Kur lexoj çfarë shkruan Henri Hollandi ²⁰, ndiej se ia vlen ta përshkruajmë edhe këtu shtëpinë e suliotëve:

“Ne erdhëm tek një pikë ku honi i kësaj humnere të thellë shpalosej papritmas përpara nesh, i gjerë dhe thuajse me rënie përpjendikulare, që po ta vështroje, të merreshin mendtë. Atje poshtë dukeshin linja të errëta që i formonte lumi që vëshronte atje poshtë. Një pamje si kjo, që unë nuk e kam parë kurrë më parë, tejkalon çdo tjetër jo vetëm nga madhështia e saj por, gjithashtu, edhe për nga thepisjet, rrëpirat befasuese, si dhe thellësia e zymtë, e errët, së cilës nuk ishte e lehtë t’i gjeje një si veten”.

Duke vështruar mahnitshëm në një largësi gjashtë-shtatë milje midis maleve gati 1000 metra të larta, sheh se si ana e pjesës fundore fillon të ngrihet tek bregu

¹⁹ *Krishti u ngjall.*

²⁰ Henri Holand (Henry Holland): Udhëtimet në ishujt e Jonit dhe Shqipëri, Tesali e Maqedoni në vitet 1812-1813 (*Travels in the Ionian Isles and Albania, Thessaly, Macedonia, during years 1812-1813*), Londër 1915. (Shënimi im – MB)

i ujërave. Këtu lumi i vërtetë Akeron fillonte të zgjerohej e të rritej. Këtu edhe mitologjia ishte e pasur me tregime të Piritoit, Tezeut dhe Herkullit, dhe ndoshta me zbritjen e Orfeut në Ferr. Këtu ishte vendndodhja e fiseve të lashta, Tesprotia, ku rrinin edhe gardianët në qelinë e shenjtë të Dodonës. Në breglumini masiv që fomonin këto male, shtrihej një pllajë e gjerë, ku suliotët kishin shtëpitë e tyre. Po të lëmë mënjanë fenë e krishterë që ata praktikonin, çdo gjë tjetër tregonte se ata ishin larg së qeni shembull i virtytit, mirësisë, faljes dhe kthimit të faqes tjetër atij që i qëllon me shuplakë. Besnikëria e tyre ishte më shumë e llojit të fuqisë muskulore, ndërsa shpata luante një pjesë të rëndësishme në jetën e tyre.

Ndërkohë, si gjithkujt tjetër edhe atyre u duhej të jetonin në kushtet kur furnizimi me ushqime ishte i pakët për shkak të luftërave të pandërprera që duhej të bënin kundër pashallarëve të ndryshëm, të cilët kërkonin të qeverisnin dhe mblihdnin haraçe prej tyre. Prandaj nuk ishin të rralla sulmet ndaj tufave të bagëtive dhe çobanëve të fqinjëve të tyre në tokat më të ulta. Kur Aliu u bë pashai i Janinës, ai vendosi që të arrinte aty ku të tjerët nuk kishin mundur dot. Ai e dinte se ata ishin të ndarë prej grindjeve dhe xhelozive midis fshatrave. Ai e dinte, gjithashtu, se në parinë e tyre jo të gjithë ishin prej atyre që nuk merrnin rryshfet, prandaj vendosi ta vinte në përdorim edhe këtë armë, ashtu si dhe shpatën. Përplasja e parë ushtarake e tij me ta ndodhi në pranverën e vitit 1790, kur ai dërgoi atje një ushtri prej 3000 burrash. Suliotët kishin një forcë të stërvitur prej 1500 vetësh.

Ngushticat e maleve të tyre ishin zënë dhe bllokuar, por, në fakt, asnjë përpjekje nuk u bë për të depërtuar nëpërmjet kështjellës së tyre malore prej graniti. Të lënë pas dore për shkak të luftës midis Turqisë dhe Rusisë, suliotët kishin gëzuar njëfarë paqeje gjatë pothuajse një viti. Gjatë kësaj kohe, ata bënë pushtime të panumërta në territoret e Aliut, madje edhe në rrethinat e Janinës, dhe kështu siguruan për vete një magazinë furnizimi me ushqime dhe municione për të luftuar kundër Aliut dhe ushtrisë së tij, për të cilin ata ishin të sigurtë se do të kthehej.

Pashai tani përdori një strategji tjetër. Ai donte të fillonte luftë kundër parisë

së fuqishme kundërshtare të Gjirokastrës, prandaj i ftoi suljotët, të udhëhequr prej dy prijësve të tyre, Boçarit dhe Zhavellas (Tsavellas), që t'i bashkoheshin atij, duke u premtuar pagë dyfish më të madhe se e zakonshmeja. Duke menduar se ky veprim mund të sillte mirëkuptim, Zhavella pranoi, duke marrë me vete shtatëdhjetë burra. Ata u takuan dhe u mirëpritën. Më vonë, pas katër orësh marshim, ata u ndalën për të pushuar me armët të shtrira pranë vetes përdhe. Përveç dy vetave, papritmas, i tërë grupi u arrestua dhe u burgos. Edhe këta të dy u qëlluan për vdekje. Ndërsa po kalonin lumin, njëri prej të burgosurve shpëtoi dhe i njoftoi suljotët për atë që kishte ndodhur.

Atëherë Aliu dërgoi prijësin Zhavella për të bërë marrëveshje paqeje, duke i mbajtur peng djalin e tij. Por ai me guxim, në vend të kësaj, i urdhëroi njerëzit e vet të luftonin deri tek i fundit dhe i dërgoi një letër Ali Pashës ku i thoshte se ai ishte armiku i tij më i betuar dhe i papajtueshëm, duke shtuar se nëqoftëse djali i tij vritej, ai do të merrte hak me çfarëdo lloj çmimi. Jeta e djalit u ruajt, por ai mbeti i burgosur në Janinë, ndërsa lufta u përtëri. Kur ushtria po kalonte nëpër shtigjet e ngushta, gratë e Sulit, të dërguara afër honit aty pari, rrokullisën gurë si ortekë të vdekjes dhe bllokuan plotësisht shtegkalimin, duke e ndarë ushtrinë pjesë-pjesë.

Ata i kapi një panik i tmerrshëm dhe rreth 1000 burra ikën drejt Janinës për të shpëtuar. Shtatëqind, që u ndanë nga masa tjetër, u sulmuan prej suljotëve dhe u vranë deri tek më i fundit i tyre. Suljotët tani e kishin marrë iniciativën dhe nuk e lanë Ali Pashën për asnjë çast të qetë. Ai u ndie aq i pasigurt prej tyre, sikur të mos i mjaftonin armiq tjerë të fuqishëm në të tëra anët, që ishin gati ta godisnin atë kurdo t'u jepej mundësia më e vogël. Sapo bëri paqe me suljotët, duke rënë dakord që ata të zgjeronin territorin e tyre brenda gjashtë krahinave të Janinës, Aliu lëshoi tërë të burgosurit suljotë dhe fiksoi një çmim prej 100.000 pjastrash për çdo njësi të caktuar toke që suliotët do të rikthenin nga ato që i kishin marrë gjatë konfliktit.

Në vitin 1801 pati një rikthim të luftës, me dhunë më të madhe se kurrë. Këtë herë, një numër armiqsh të Ali Pashës u mblodhën së bashku me suljotët në një

Lidhje të Epirit, për mbrojtje reciproke dhe sulme kundër tij. Duke parë se nuk ia dilte dot t'i mposhte vetëm me armë, Aliu liroi një shumë të madhe floriri, e cila vlerësohet të ketë qenë 4.000 000 piastra. Me këtë ai fitoi mbi pashallarët e tjerë aq sa iu desh për të mbajtur nën kontroll ata që kishin hyrë në lidhje kundër tij. Pastaj ai u përqendrua më shumë se kurrë për t'i dhënë fund rrezikut suljot. Më së pari, ai u mundua t'i blinte prijësit e suljotëve me ryshfete floriri. Boçari, babai i heroit të madh të Luftës Greke për Pavarësi shkoi aty bashkë me klanin e tij. Dhëndri i tij, një kapiten grek, veproi si agjent i Aliut në këtë transaksion të ulët. Një grek tjetër, të cilin Aliu tani e korruptoi me floririn e tij ishte metropoliti i Janinës, i cili u dërgoi fjalë suljotëve se do t'i shkishëronte nga *Kisha Ortodokse Greke* nëse nuk i nënshtroheshin Ali Pashës.

Muftar (Mukhotar) Pashës, djalit të madh të Aliut, i ishte dhënë pushteti për fushatën. Suljotët mbetën në gjendje rrethimi për mëse një vit. Çdo shteg, sado i ngushtë që të ishte, nëpërmjet të cilit dikush mund të zvarritej drejt maleve të tij mbrojtëse, ishte bllokuar e mbyllur si me tapë, siç besonin ata. Pas kësaj pasoi zia. Gjellët përziheshin me gjethe e dhé. Më pas u kapën mullinjët e blajës së drithit dhe gratë suljote u detyruan të thyenin misrin me gurë. Aty u përhapën lajme për një anije franceze të ngarkuar me miell dhe municione në portin e Pargës. Suljotët, të dëshpëruar, dërguan 400 burra dhe 170 gra për të gjetur një mënyrë për të arritur tek anija, të blinin tërë furnizimin që ata mund të transportonin dhe të lehtësoheshin sado pak.

Në një veprim që mund të quhet një mrekulli, ata ia dolën dhe çdonjëri prej tyre u kthye i sigurtë me një ngarkesë të çmuar ushqimesh dhe municionesh. Porta e Lartë nuk e kishte *sanksionuar* këtë luftë të Aliut. Por kur ai u tregoi atyre se francezët po i furnizonin suljotët me ushqime dhe municione, Porta dha urdhër që lufta të bëhej deri në fund. Suljotët u mbajtën deri në dhjetor të vitit 1803, kur i pranuan kushtet e mëposhtme: Së pari, Suli të evakuohej dhe banorët të shpërndaheshin e të vendoseshin ku të donin në një vend tjetër në Shqipëri ose edhe jashtë saj, nëse dëshironin. Së dyti, t'u sigurohej transport për njerëzit dhe mallrat

e tyre, përfshirë edhe armët. Së treti, pengjet e marra prej pashait të liroheshin. Së katërti, t'u jepej tokë kudo nëpër Shqipëri, sa më bujarisht. Një kopje e tekstit të marrëveshjes është ruajtur ashtu siç është nënshkruar prej Veli Pashës, djalit të dytë të Aliut, katërmbëdhjetë kapitenëve të ushtrisë së tij dhe parisë së suljotëve.

Dy mijë syresh u nisën për në Parga. Në udhë e sipër, ata u sulmuan prej ushtrisë së Veli Pashës. Një mijë të tjerë kërkuan të vendoseshin në Zalongos, një vend që ndodhet tetë orë larg në jug të Sulit. Këta, po ashtu, u sulmuan pa paralajmërim nga ushtria e Ali Pashës, dhjetë ditë pasi ishte nënshkruar pakti, më 22 dhjetor 1803. Gjatë betejës që pasoi, kur shpresat për të shpëtuar kishin mbaruar, gjashtëdhjetë gra suljote me fëmijët e tyre në krahë u hodhën nga një humnerë, duke lëshuar një klithmë që i tmerroi edhe sulmuesit e tyre muhamedanë. Natën tjetër, Pukëvili, i cili bëri që shumë shkrimtarë t'i referoheshin kësaj lufte bazuar në ato që shkruajti ai, shton se u bë një përpjekje për të shpëtuar nëpërmjet errësirës nga kordoni që i rrethonte ata. Gjatë kësaj përpjekjeje, nënat u detyruan t'u përdridhnin qafën fëmijëve të tyre kur ata qanin, për të mos u zbuluar kështu nga sulmuesit e tyre. Përkundër gjithë kësaj përkujdesjeje për të mos rënë në sy, ato prapë u zbuluan. Pas kësaj, kuptohet se çfarë vinte: masakra. Një grup tjetër me njëzet vejjusha suljote bashkë me fëmijët e tyre u detyruan të pranonin skllavërinë. Me këtë akt të neveritshëm, dhjetë gra suljote, bashkë me vejjushën e kapitenit Boçi, gjetën strehë në një kullë ku ishte ruajtur municion. Kur trupat shpërthyen derën dhe ishin gati t'i nxirrnin që andej, ato ia vunë zjarrin barutit dhe shpërthyen kullën, duke vlarë veten bashkë me armiqtë. Tërë suljotët, ende në duart e Ali Pashës, u dërguan në Janinë, ku Aliu shfryu tërë ngarkesën hakmarrëse ndaj tyre. Dyqind prej tyre i çoi në gijotinë. Ky çast i fundit është shkruar në një raport të një gjenerali francez, dërguar ambasadorit francez në Konstandinopojë. Aty ai shton:

“Disa u rropën, të tjerë u poqën për së gjalli, ndërsa të tjerëve, përfshirë edhe grave shtatzëna, ua nxorren zorrët jashtë dhe fëmijëve ua prenë trupin copa-copa”. Shumë syresh u shpërndanë midis çifligjeve të Aliut për të shërbyer si skllavër. Në Sul, Aliu vendosi dyqind familje muhamedane. Kjo shënon fundin e historisë së

pushtimit të Sulit, e cila filloi në vitin 1790 dhe përfundoi në vitin 1805. Ali Pasha mori një famë që i kalonte tërë ato të mëparshmet në ndere dhe dekorata. Pukëvili, i cili nuk ishte mik i anglezëve, thotë se informacioni sekret që ai zotëronte, konfirmonte faktin se ata i kishin dhënë mbështetje aktive Ali Pashës në këto fushata për të përparuar me planet e tyre të përbashkëta për nxitjen e një revolte të gjerë kundër Perandorisë Osmane, me qëllim që të vendosnin një mbretëri të pavarur në Shqipëri, me pashanë si sundimtar.

Le të shtojmë edhe një shënim tjetër historik në këtë kapitull të pakëndshëm. Kjo ka të bëjë me qytetin e krishterë Gardiki²¹. Thuhej se përbuzja e pamëshirshme e Aliut ndaj këtij vendi kishte për bazë një fyerje që i ishte bërë nënës dhe motrës së tij prej banorëve të atjeshëm nja dyzet vjet më parë. Kjo e dhënë nuk është e verifikuar. Unë po e përmend këtu për ndonjë lehtësim të mundshëm që mund t'i bëhet këtij krimi. Ky qytet kishte kundërshtuar të vihej nën pushtetin e tij, ndërkohë që nën patronazhin anglez ai e kishte siguruar pushtetin mbi Beratin, Vlorën, Durrësin, Dibrën dhe Ohrin. Kur, më në fund, edhe ky qytet u kap, thuhet se Aliu ia la këtë çështje ushtrisë e cila, për çudinë e gjithkujt, përbëhej prej suljotëve që kishin gjetur strehë në Korfuz, pas dëbimit të tyre nga Suli dhe që më vonë ishin rikthyer në vendin e tyre.

Kur u takua me ta, Aliu iu drejtua:

-“Unë i mbaj armiqtë e mi në pëllëmbë të dorës. Po me ju çfarë duhet të bëj?”

-“Na komando” - u përgjigjën ata.

-“Çfarë lloj vdekjeje do t'i shkaktonit armiqtë në Korfuz, po t'ju dërgoj atje?”, u hakërrye ai.

-“A mjafton vdekja e tyre prej armëve tona?” - iu kthyen ata.

“Shumë mirë atëherë, qenkemi marrë vesh”.

Atëherë banorët u dërguan grupe-grupe të përbërë prej pesëmbëdhjetë vetësh tek një breg lumi ku u lanë të burgosur. Pastaj u rreshtuan dhe u qëlluan me

²¹ Kështu shkruhet në original, por ndoshta fjala është për Kardhiqin (Shënimi im – MB)

armë, ndërsa të plagosurit i shkuan në shpatë. Në përbërje të trupave ekzekutuese gjendeshin edhe tre banorë të Gardikit, të cilët kundërshtuan të shtinin me armë mbi njerëzit që mbanin të njëjtën fe me ta. Për këta Aliu urdhëroi që të arrestoheshin dhe të çoheshin në plumb. Njëri prej tyre i kërkoi mëshirë atij duke thënë:

“Të kam shërbyer shtatëmbëdhjetë vjet”. Ndërsa Aliu iu përgjigj me një klithmë të egër: “Ndërsa unë e kam pritur këtë ditë dyzet vjet”. Më pas Aliu kalëroi përsipër këtyre trupave fantazmë të vdekur dhe nuk la t’i varrosnin, deri sa të vinte motra e tij dhe të vështronte bashkë me të këtë spektakël të tmerrshëm. Në mbrëmjen e kërdisë, trupat e Ali Pashës kaluan mespërmes Gardikit ku gjendeshin nënat, gratë, bijat dhe fëmijët e viktimave. Për dy ditë këta ushtarë shqiptarë, që thuhet të ishin në masë suljotë dhe mirditorë, të dy palët të krishterë, u përfshinë në akte të tilla derisa erdhi motra e Aliut, Shanisaja.

Në vitin 1814 u mbajt *Kongresi i Vjenës* ku do të merreshin vendime mbi zotërimet në ishujt jonianë që i kishin takuar Francës dhe po ashtu edhe mbi qytetet e Butrintit, Konicës, Prevezës dhe Pargës, brenda tokave shqiptare. Një vit më pas, në Traktatin e Parisit, ishujt jonianë u vunë nën protektoratin britanik. Aliu tani i vuri tërë energjitë e tij për të siguruar për vete të paktën lëshimin e Pargës. Politika angleze e asaj kohe u drejtua në mbajtjen edhe të Shqipërinë, edhe të Greqisë brenda kufijve të Turqisë në Europë. Pas bisedash të shkurtëra, ata u morën vesh për t’ia lënë Pargën Aliut. Ne kemi parë se si ai ia kishte kërkuar Pargën francezëve disa vite më parë, kur ajo ishte në zotërimin e tyre, por kjo i ishte mohuar.

Në atë kohë banorët kishin dërguar fjalë tek francezët se përpara se t’i dorëzonin zotërimet e tyre tek Aliu, ata do të vetëshkatërroheshin në masë. Tani, dhjetë vjet më vonë, kur ky favor i bëhej atij prej anglezëve dhe jo prej francezëve, u vendos që banorët e Pargës, të cilët dëshironin të bënin të njëjtën gjë, të kishin të drejtë të viheshin në proteksionizmin anglez. Në një rast të tillë, Pashai duhej t’i kompensonte ata për pasurinë e tyre, çka do të vlerësohej nga një komision

i përzier me anglezë dhe turq. Deri këtu pargiotët nuk ishin pyetur fare. Tani ata dërguan një petition te komandanti anglez, kolonel lejtnant de Boseti, ku i shkruanin:

“Çfarë kompensimi mund të vlerësohet si i barabartë me ato që ne do të duhet të braktisim – truallin e të parëve tanë, pavarësinë tonë së cilës ne dhe familjet tona i kemi kushtuar jetën? Çfarë vendi na pret ne në ishujt jonianë në krahasim me mirëqenien dhe pasurinë që kemi patur në Pargë?”

Kur nuk u gjet zgjidhje tjetër, pargiotët u dorëzuan “me heqje dorë, por me dhimbjen më të thellë për fatin e keq që i priste, duke dëshiruar, gjithashtu, të jepnin prova të besnikërisë ndaj mirëbërësit të tyre, kombit britanik”.

“Dhe të gjithë deklarojmë, MonsinJOR, se ata dëshirojnë të emigrojnë për të shpëtuar nga aktet e barbarizmeve dhe shfarosjes që ata i kishin parë kaq herë tek fqinjët e tyre të kthyer në viktima”.

Pasuria e këtij populli përbëhej prej 839 shtëpish, të ndërtuara shkëlqyeshëm me gurë, kopshte të tëra ullishtesh, limonash dhe agrumesh. Vlerësimi i parë ishte 500.000 stërlina – një shumë përtej mundësive të Ali Pashës për t’i paguar. Një kompromis përfundimtar që e arritën të dy komisionet ishte shuma prej 150.000 stërlinash.

Në datën 15 mars 1819, sipas një shpalljeje të anglezëve, trupat e Aliut së shpejti do të hynin në qytet. Kjo provokoi një emocion të thellë. Banorët zhvarrosën trupat e të afërmeve të tyre nga varreza ku ata preheshin për shumë shekuj, organizuan funeralë duke i djegur ato në turra drush prej ulliri. Më pas, ata deklaruan para oficerit anglez të ngarkuar me këtë çështje, gjeneralit Maitland se në qoftë se Ali Pasha do të shkelte në territorin e tyre përpara se ata të largoheshin, më mirë do t’i vrisnin vetë gratë dhe fëmijët e tyre, sesa të binin në duart e trupave të Aliut për t’u çnderuar dhe nëpërkëmbur prej ushtarëve të tij. Në datën 10 maj 1819, 4000 pargiotë hipën në anijet e siguruara për të marrë arratinë e përhershme dhe për t’u shpërndarë nëpër ishujt e ndryshëm nën protektoratin britanik.

Kështu kaloi nën zgjedhën turke një qytet dhe popull i cili që prej vitit 1447, kur kishte rënë për herë të parë nën protektoratin e doxhës së Republikës së Venedikut, F. Foskanini, kishte qenë i lirë. Lajmet për dorëzimin e një populli të krishterë në mes të popullatës muhamedane, dhe veçanërisht tek Ali Pasha, karakteri i të cilit ishte kaq i njohur për të gjithë, lanë një shije të hidhur në tërë opininonin publik të Europës. Pranimi nga ana e kabinetit të *St. Xheimsit (St. James)* të një transaksioni të tillë shkaktoi habi tronditëse për tërë besimtarët e krishterë.

Karakterit i Aliut nuk ka se si të ishte i panjohur për qeverinë britanike. Barbarizmat e tij ishin regjistruar në histori dhe viktimat e tij që ishin ende gjallë, të gjithë rreth porteve, tregonin historitë e tyre njëra më e tmerrshme se tjetra. Në të vërtetë, ndërsa flamuri britanik valëvitej mbi qytetin e Pargës në vitin 1814, Aliu i kishte detyruar himariotët të dorëzonin tokën dhe pasuritë e tyre, me qëllim që të krijonte një çiflig për të birin, Veli Pashën. I paepur, Aliu marshoi me trupat e tij në malet e tyre në zemër të dimrit, me të ftohtin e tij therës dhe i detyroi banorët, njësoj si bagëtinë, me burra, gra dhe fëmijë të merrnin arratinë. Kur djali i tij më i vogël, Saliu, u martua, Aliu e shndërroi tërë zonën e Zagorisë në një çiflig për të. Kjo përfshinte dyzet fshatra dhe afro 5.000 familje²².

Këtu kemi mbaruar me këtë karakter kaq të diskutueshëm. Tek e fundit, ai u përpoq t'i përdorte tërë aftësitë e tij të jashtëzakonshme për të nxitur trazira në emër të vendit të tij të shtrenjtë. Në vitin 1820, ai ngriti flamurin e revoltës kundër turqve, në emër të Shqipërisë. Kur pa se premtimi i dhënë për shumë vite me radhë, herë prej Napoleonit dhe Francës, herë prej anglezëve për t'u bërë mbret i Shqipërisë së pavarur nuk po bëhëj realitet, ai vendosi ta bënte këtë vetë.

Po të shohim jetëshkrimin e tij, do të mahnitemi kur të shohim se si ai gati sa nuk ia doli kësaj. Praktikisht, të tërë në Shqipëri iu bashkuan atij në revolucion, edhe suljotët, të cilët ishin njësia fisnore më e madhe kundër tij.

²² R.A.Davenport, Jeta e Ali Pashë Tepelenës (*Life of Ali Pasha of Tepelin*), Londër 1837.

Sikur Ali Pashë Tepelena të kishte qenë një Skënderbe i dytë, fundi do të ishte i ndryshëm dhe e tërë historia e mëpastajme e Ballkanit do të ndryshonte. Me Shqipërinë një shtet të pavarur në fillim të shekullit XIX, ku të përfshiheshin tërë territoret e saj, të cilat në atë kohë sigurisht që do të kapnin dyfishin e sipërfaqes së sotme, problemi më i madh dhe më i rëndësishëm i Ballkanit, i lidhur me çdo komb e me çdo racë brenda tij, ai shqiptar, pra, do të ishte zgjidhur njëherë e përgjithmonë. U pa që Aliu dështoi në përpjekjen e tij. Pas dy vjet përpjekjesh, ku ai gati sa nuk ndoqi shembullin e Skënderbeut që të kthehej në të krishter, ai e pa se nuk mund t'i qëndronte kësaj edhe më tej. Anglia e pa që nuk ia vlente t'i hynte një lufte me Turqinë për të ruajtur Shqipërinë dhe, në fakt, ishte më mirë ta linte vendin nën kontrollin e Turqisë.

Më në fund, ai u tërhoq brenda kështjellës së tij në Janinë, i rrethuar vetëm nga një dorë besnikësh të tij. Në shkurt të vitit 1822, ai u ther me thikë pas shpine nga Mustafa Pasha, një emisar i sulltanatit, i cili kishte ardhur të merrej vesh me të. Më pas, atij iu pre koka dhe iu dërgua në Konstandinopojë, si një siguri e pamëshirshme se komplotet dhe kundërkomplotet, revoltat dhe rebelimet, ambiciet dhe ëndërrat e Ali Pashës kishin marrë fund përgjithmonë. Në të njëjtën kohë, tërë familja e tij u shfaros.

Karakter i këtij burri ishte tej mase kundërthënës. Edhe psë historia e tij është kaq komplekse, shpesh njerëzore e shpesh mizore, me tërë impulset e mira e të këqija që mbartte, ai prapëseprapë ia vlen të zërë një vend të lartë midis heronjve të kësaj race të shquar. Në anën tjetër, nëqoftëse do të bëhej e kundërta dhe do të vëreheshin tërë të këqijat e natyrës dhe jetës së tij, ai do të zinte vend në radhën e Bluebeard-it²³, si një prej njerëzve më të neveritshëm dhe me mendjen më kriminele


²³ “Bluebeard” (frenjisht: *La barbe bleue*; shqip: mjekërbluja) është një përrallë franceze e shkruar nga Charl Perro (Charles Perrault) dhe është një nga tetë përrallat e këtij autori që u botuan për herë të parë nga Barbin në Paris, në janar 1697 në vëllimin *Histoires ou Contes du temps passé*. Përralla rrëfen historinë e një fisniku të dhunshëm, që i vriste bashkëshortet dhe përpjekjet e njëres prej grave për të mos patur fatin e paraardhësve të saj. Zhill (Gilles) de Rais, aristokrat dhe vrasës serial në shekullin e 15-të, mendohet se ka qenë frymëzimi për krijimin e personazhit ‘mjekërbluja’, bashkë me Konomorin e Nëmur (*Conomor the Accursed*), mbret i hershëm breton. Pëllumbi i bardhë (*The White Dove*), Zoti Dhëlpër (*Mister Fox*) dhe Zogu i Fitçerit (*Fitcher’s Bird*) janë përralla të ngjashme me “Mjekërblunë”. (Shënimi im – MB)

në histori, me një aftësi të pafund për dhunë dhe gjakderdhje. Pukëvili rrëfen se si dhjetë vjetët e fundit të jetës së tij ai i kaloi i tmerruar prej vdekjes së gruas së tij. Ajo ishte një grua jashtëzakonisht e respektuar prej të tërë njerëzve, të krishterë dhe muhamedanë njësoj. Kur Aliu po hakmerrej pa asnjë mëshirë ndaj suljotëve, duke ndier frikën se mos ata i ktheheshin djemve të saj dhe atij, ajo u përpoq që t'i mbronte ata. Ai shpërtheu me tërbim, mori një revole, shtiu mbi gjithçka që i doli përpara, por jo mbi atë vetë, dhe me këtë ai e tronditi aq shumë, sa asaj i ra të fikët dhe fill pas kësaj vdiq. “Aliu u tmerrua prej vdekjes së saj”, thotë autori. Kaq shumë u tmerrua prej vdekjes së saj, sa që prej asaj kohe ai nuk flinte dot vetëm. Ai frikësohej të nxirrte duart jashtë jorganit, shihte hijen e saj dhe fillonte të qante me dënësë duke pëshpëritur: “Gruaja ime, gruaja ime! Më shpëto nga mallkimi yt!”. Autori e pa atë tek dridhej nga frika, ndërsa tiparet e saj Aliu i shihte tek djemtë, të cilët ia kujtonin atë. Kështu, të paktën, Drejtësia Hyjnore e Nemesisit²⁴ brenda mbretërimit në vetëdijen e tij ishte mbajtur gjallë dhe ndëshkuese në disa masa të krahasueshme me krimet e tij. Si shumë të tjerë të llojit të vet në histori, që kanë kërkuar të zbatojnë një ligj për vete dhe të imponojnë të kundërtën për të tjerët, ai e gjeti veten më në fund në pozitën kur “ra brenda në varrin që e hapi për të tjerët”.


*Shqiponja e goditur, e shtrirë mbi një pllajë,
Nuk fluturon më mbi re, as mbi ograjë,
Si shigjetë dikur, me pendë të forta, të gjata,
Tani krahë-palosur, zemër heshtur e ngrata.*

Çajd Harold, Bajron

²⁴ Perëndesha e hakmarrjes.



FRAGMENTI MË I MADH RACOR I SHKËPUTUR DHE NDARË
NGA TRUPI I VENDIT TË VET, U VENDOS NË GREQI. SE SA
ËSHTË NUMRI I TYRE, ASKUSH NUK MUND TA THOTË ME
SIGURI. GREKËVE VETË KJO NUK U INTERESON, PASI NUK
DUAN TË DINË PËR ETNOLOGJINË. PËR TË VEÇUAR LIDHJEN
E TYRE RACORE, DUHET TË KEMI DIJENI TË PËRGJITHSHME
ENCIKLOPEDIKE NË TË CILAT TË MOS MUNGOJNË TË DHËNAT
NJERËZORE.



VI



DISA COPËZA PREJ PORTOFOLIT TË KOHËS

Të shkruash historinë e racës shqiptare është si të ngresh mbi shpinë një prej maleve të atij vendi. Vijnë kohëra kur është e pamundur të ndjekësh rrugën e drejtë, sepse ka shumë e shumë segmente të kësaj historie. Ndikimi i turqve mbi shqiptarët ishte si një goditje me efekt shkatërrimtar. Aty nuk kishte përzierje, nuk kishte harmonizim, as nga ato gjëra që popujt e qytetëruar shpresojnë t'i shkëmbejnë kurdo që ndërhyjnë në gjërat private të njëri-tjetrit. Goditjes që tronditi Shqipërinë iu ngjit pas vetes egërsia e ftohtë e vrazhdë e xhunglës, përpara së cilës asgjë nuk ishte e shenjtë, as gjërat më të shtrenjta si graria, fëmijëria, shtëpia, trualli, të ruajtura që prej njëqind brezash prej bijve dhe bijave besnike të këtij vendi.

Vendi i shqiponjave të Shqipërisë nuk është si Amerika, me kaq shumë tokë të saj të pashenjtëruar, qoftë për të huajt e sotëm ende pa shtëpi, qoftë edhe për indigjenët që bridhnin njëherë e një kohë nëpër fushat e saj. Si kontinent Amerika ka ngjallur krenari të pallogaritshme, por ajo nuk është dashuruar kurrë, nuk është

ledhatuar asnjëherë si nuse, nuk ka hyrë kurrë brenda shpirtit të popullit të vet për t'u bërë pjesë e mendimit dhe ndjenjës më të thellë dhe më të ëmbël. Pak ferma në Amerikë janë trashëguar mbi dy breza. Në Shqipëri janë derdhur shumë lotë mallëngjimi për ndarjen nga atdheu i mëparshëm. Shqipëria është e tëra ajo çfarë Amerika nuk është.

Në Shqipëri, fjala e burrit është mali i tij i veçantë prej guri, ose një livadh i shtruar në një anë mali. Patriotizmi i tij, rrënjët e tij familjare të ushqyera prej një rrjedhjeje gjaku prej mijëra vjetësh, krenaria e burrërisë dhe fisit të tij, të tëra e kanë qendrën aty. Ky është çelësi që të çon tek qëndresa e dëshpëruar e suljotëve dhe pargiotëve ndaj forcës së pamëshirshme, sakrilegjit dhe goditjes fatale të Ali Pashës, bazuar në burimet e tij të pashterrshme të pasurisë dhe fuqisë njerëzore. Të 200.000 shqiptarët që kërkuan strehë në Itali dhe Sicili, të mirëpritur në të dyja ato vende, janë prapëseprapë njerëz të huaj në një vend të huaj, madje edhe tani pas mëse katër shekujsh e gjysmë. Siç dëshmojnë gjuha shqipe e folur në shtëpitë e tyre, letërisa e tyre, këngët e tyre, aty ka një mall të fortë dhe të paçrrenjosshëm, të ngulur thellë në zemrën e secilit prej tyre në arrati, duke qëndruar besnikë, siç dinë të jenë vetëm ata edhe ndaj atdheut të tyre të dytë. Ky shkatërrim i racës shqiptare i hodhi ciflat e kësaj race shumë larg, në çdo drejtim të Ballkanit, madje deri në Egjipt dhe, pa dyshim, deri tek kufijtë e largët të Perandorisë Turke në Azinë e Vogël. Fragmenti më i madh racor, i shkëputur dhe ndarë nga trupi i vendit të vet, u vendos në Greqi. Se sa është numri i tyre, askush nuk mund ta thotë me siguri. Grekëve vetë kjo nuk u intereson, pasi nuk duan të dinë për etnologjinë. Për të veçuar lidhjen e tyre racore, duhet të kemi dijeni të përgjithshme enciklopedike në të cilat të mos mungojnë të dhënat njerëzore. Përveç kësaj, kjo duhet ta ketë shkatërruar tërë atë strukturë kombëtare, që ishte ndërtuar me aq kujdes dhe në mënyrë aq të natyrshme gjatë shumë e shumë shekujve. Në kohën e tyre klasike, kryeshtetarët ishin krenarë për lidhjet me të huajt dhe aftësitë e tyre për t'i bërë për vete në ecurinë e mbarë të jetës së kombit. Por kjo nuk ka ndodhur edhe në kohët moderne. Grekët me zgjuarsia e kanë shmangur çështjen, duke adaptuar një

‘nënë’, *Kishën Ortodokse Greke*, që ajo të lindte zogj aq të larmishëm sa të mos gjenden asgjëkundi në Lindjen e Afërt. Gjithsesi, ka patur shumë studiues që e kanë hulumtuar këtë çështje për të na dhënë një përgjigje rreth saj. Ka historianë të veçantë që kanë nxjerrë nga duart studime shumë serioze rreth kësaj çështjeje.

George Finley²⁵ shënon numrin 520.000 shqiptarë dhe i lokalizon ata kryesisht në vendet e mëposhtme: Atikë dhe Megara, një pjesë të madhe në Beoti, në Peloponez, në tërë Korintin dhe Argosin, e po ashtu në Arkadi, në ishujt e Hidras dhe Spezit, Maratonë, Platea, Salamis, Mantinea, Ira dhe Olimpia, dhe shton se këto ishuj janë të “banuar prej shqiptarëve dhe jo prej grekëve”. Historianë të tjerë e kanë pranuar këtë vlerësim si qenësisht të drejtë. Në të vërtetë, ka një fakt shokues që duhet vëzhguar gjatë shqyrtimit të kujdesshëm të kësaj liste të vendbanimeve moderne shqiptare – ato mbajnë saktësisht emrat e vendbanimeve të lashta pellazge të së njëjtës racë dhe të të njëjtit popull. A mund të mos merret kjo si një linjë e kujtesës dhe vetëdijes racore që e ka mbajtur këtë popull të lidhur si me kavo të çelikut rreth vatrës dhe altarit të vet të lashtësisë? Me një popullsi të tillë, të shpërndarë në një hapësirë kaq të gjerë nëpër tërë Peloponezin, njeriu bëhet kureshtar të dijë se si ndjehen tani këta njerëz? Çfarë kontributi kanë dhënë për vendin ku u ngulën dhe u përshtatën? Grekët kanë qenë të pakursyer në sharjet ndaj shqiptarëve si racë. Megjithatë, ata asnjëherë nuk kanë jetuar pa praninë e tyre në mesin e vet dhe madje në numër shumë të madh. Përse racës shqiptare, të ndarë kështu më dysh nuk i janë dhënë meritat e duhura për kontributet e veta në historinë greke? Por nga ana tjetër nuk mund të thuhet se shqiptarët kanë ndonjë vlerësim të madh për grekët.

Unë kam jetuar shumë gjatë me ta, aq gjatë sa ta di mendimin e tyre të ndershëm për ato çfarë u kanë bërë fqinjët e tyre të jugut. Më të shumtët e komenteve të tyre rreth kësaj çështjeje nuk flasin për mirë, kështu që e mira është të mos i përmendim. Në Greqi, ndërkohë ku ka një ftohtësi të caktuar dhe qëndrim tejet fisnor midis vendbanimeve shqiptare, prapëseprapë konflikte nuk ka. Arsyeja mund

²⁵ Historia e Greqisë (History of Greece), Vëllimi VI, f.28.

të gjendet tek fakti se *Kisha Ortodokse Greke* është emëruesi i përbashkët që i bën tërë grupet e ndryshme racore gati pjesë të të njëjtit trup, një rregullim ky shumë praktik dhe i suksesshëm. Në jetën tregtare dhe industriale të kombit grek njeriut i duhet thjesht të studiojë raportin në ato fusha në të cilat shqiptarët mbizotërojnë, bazuar në faktet e konstatuara. Kësaj i ndihmojnë vëzhgimet e historianëve dhe shkrimtarëve të besueshëm, të cilët jo vetëm kanë kaluar vite të tëra në Greqi, por kanë patur edhe çdo lehtësi dhe mundësi t'i shkojnë të vërtetës deri në fund. I tillë është Pukëvili²⁶. Afro dhjetë vjetët që shërbeu si konsull i përgjithshëm i Francës në Janinë, si dhe njohuritë e tij për gjuhën e vendit i dhanë atij mundësinë e kontaktit sa zyrtar aq edhe privat me njerëzit. Një fakt shtesë është i sigurtë, që ai nuk ishte i motivuar as politikisht, as për ndonjë arsye tjetër që të ishte përkrahës i zjarrit të popullit shqiptar. Gjithsesi, ai i nderon ata me fjalët:

“Nëse vështrojmë kolonitë e tyre të shpërndara nëpër tërë Korintin, Atikën apo Argosin që ata e ngritën që nga rrënojat, Athinën, së cilës i kanë sjellë një jetë të re, atëherë do të shohim se sa shumë janë larguar ata nga jeta parake. Ata shkojnë drejt përmirësimit të përhershëm, pa humbur energjitë dhe natyrën e tyre amtare. Në të njëjtën kohë duhet të pranojmë superioritetin e tyre ndaj grekëve për mendjemprehtësinë e tyre, që i bën të arrijnë çdo gjë që duan në shtëpinë e tyre”.

Por, më qëllim që ta gjykojmë edhe më në detaje, le të shohim mirëqenien e lartë të ishujve Hidra dhe Spezia, gurët e zhveshur e të shkretë të të cilëve janë njësoj ose edhe më keq se çdo vend tjetër në Mesdhe, por, nga ana tjetër, këto ishuj janë më të lulëzuarit dhe më të zhvilluarit.

Xhorxh Hadingtoni²⁷ bën këto vëzhgime në ishullin Hidra:

“Popullata e tij prej 40.000 vetëve është e tëra shqiptare dhe aty flitet vetëm gjuha

²⁶ Udhëtim në Greqi dhe historia e Luftës për Pavarësinë e Greqisë (*Voyage dans la Grece, et Historie de la Guerre pour l'Independence de la Grece*), 1821.

²⁷ Xhorxh Hadington (George Haddington): “*Visit to Greece, 1823-1824*”; ai lindi më 7 shtator 1793 në Tuxford, Nottinghamshire dhe vdiq më 20 korrik 1869 në Durham; ishte prift anglez, udhëtar dhe historian i kishës. (Shënimi im – MB)

shqipe anembanë ishullit. Unë nuk kam parë në asnjë vend tjetër një popullatë të veshur në mënyrë kaq uniforme sa ajo në Hidra... Aty njeriu nuk dallon dot qoftë edhe shenjën më të vogël të varfërisë apo mjerimit. Aty nuk gjen asnjë shenjë trazire apo rrëmuje, lëre pastaj ndonjë shenjë që të tregojë luftë apo gjurmë të saj. Aty njerëzit flasin paqësisht, hanë haviar dhe ushqime të tjera që i prodhojnë vetë, si dhe bukën më të bardhë në botë. Aty gjendet një racë zotërinjsh që gëzojnë bekimin e përbashkët të bollëkut dhe paqes".

Dr. Alfred Filipsoni²⁸, pasi bëri një studim të veçantë për shqiptarët e Peloponezit, i nderoi ata me fjalët në vijim:

"Ata janë më të gjallë, më të qëndrueshëm, më të fuqishëm dhe më punëtorë e të palodhur se sa fqinjët e tyre grekë".

G.B. Depingu, tek *La Greece*, thotë:

"Shqiptarët²⁹, këta bujq jashtëzakonisht punëtorë, janë vendosur mbi rrënojat e qyteteve madhështore. Ata i përdorin pushkët po me atë mjeshtëri që përdorin edhe veglat e punës".

Ndërsa Emersoni³⁰ na thotë:

"Nuk kemi qëllim të shkruajmë gjëra që ulin grekët. Qëllimi ynë është të tregojmë të vërtetën në lidhje me shqiptarët. Por, kur shohim se si shkrimtarët grekë kanë bërë gjithçka që kanë patur në dorë për të shpifur dhe diskredituar shqiptarët, atëherë do të ishte e udhës të themi se çfarë kanë thënë të huajt në fillim të epokës së tyre të pavarësisë".

²⁸ *Alfred Filipsoni (Alfred Philippson)*, (1 janar 1864 – 30 janar 1953), *Zur Ethnographie des Peloponnes* ishte gjeolog dhe gjeograf gjerman. Lindi në Bon dhe ishte djali i Ludvig Filipsonit. U shkollua në gjimnazin dhe universitetin e qytetit të lindjes dhe në universitetin e Laipcigut ku mbrojti doktoraturën më 1886. Më 1892 u bë *Privatdozent* në Bon, shtatë vjet më vonë u emërua asistent profesor dhe më 1904 iu kërkua të ishte profesor i gjeografisë në Bernë. Pasi kishte bërë disa udhëtime nëpër Itali (rajoni i Pulias), Greqi, Turqi dhe në Azinë e Vogël, ai botoi: *Studien über Eäasserscheiden*, Berlin, 1886; *Der Peloponnes*, 1892; *Evropa* (me Neumannin) Leipzig, 1894; *Thessalien und Epirus*, Berlin, 1897; *Beiträge zur Kenntnis der Griechischen Inselwelt*, Gotha, 1901; *Das Mittelmeergebiet*, Leipzig, 1904. Ai botoi edhe disa ese në periodikë të specializuar, si *Das fernste Italien*, *Geographische Reiseskizzen und Studien*, Leipzig, dhe *Apulien*, Holandë, 1937.

²⁹ Shqip në origjinal

³⁰ Emerson: Tablo e Greqisë në vitin 1825 (*Tableau de la Grece, A Picture of Greece in 1825*)

Sa për pjesën që kanë luajtur shqiptarët në jetën politike të Greqisë, ka një dëshmi shumë më të pasur. Që prej shekullit XV, atëherë kur Skënderbeu po zhvillonte luftërat e tij të guximshme kundër turqve në Shqipëri, në Peloponez ndodhi një ngjarje tipike, edhe pse e izoluar. Ajo tregon se çfarë po ndodhte me këto shqiponja të papërmbajtshme, këta “bij të shqipes” kudo ku kishin zënë foletë e tyre të arratisë. Në vitin 1453, duke ndjekur rënien e Konstandinopojës, dy vëllezërit, Demetreusi dhe Thomai, despotët sundues të Peloponezit, të frikësuar për jetët e tyre, u arratisën në Itali, por udhëheqësit grekë nga Konstandinopoja ua prishën mendjen që të ktheheshin. Shqiptarët, që përbënin pjesën dërrmuese të popullatës dhe kishin vuajtur mjaft në duart e tyre, panë që ky ishte rasti për të rrëzuar nga pushteti shtypësit e tyre dhe të fitonin lirinë. Prandaj tridhjetë mijë prej tyre u ngritën në kryengritje. Të paaftë për t’u bërë ballë sulmeve të tyre, dy despotët dërguan kërkesa të parreshtura për ndihmë edhe në Venedik, edhe në Konstandinopojë. Venediku u përpoq të luante rolin e arbitrit, por sulltani (siç bënte zakonisht) dërgoi një ushtri për të mbrojtur despotët, duke i parapëlqyer ata më shumë se shqiptarët, si më të shtruar. Pas kësaj vijuan katër vite anarkie me turqit, grekët, Venedikun dhe Romën, të gjithë duke ndërhyrë, herë në njërën anë e herë në anën tjetër, por gjithmonë në marrëveshje kundër shqiptarëve të pafat. Më në fund, këta kishin rënë në kurth në një kështjellë të caktuar, ku ishte vënë një gjendje rrethimi e tillë sa shqiptarët nuk merrnin dot as furnizime ushtarake, as ushqimore. Në fund, të mbetur pa ujë dhe vetëm me pak gjellë, ata prenë edhe kaun e fundit që u kishte mbetur, e përdorën gjakun e tij për ta përzier me bukë dhe kështu i mbajtën ata që luftuan deri në fund. Kur u dorëzuan, pasi nuk patën rrugë tjetër, atyre ua thyen kyçet e këmbëve dhe të duarve me çekiçë druri. Prej kësaj kështjella mori emrin “Tokmak Hissari” ose “Kështjella e çekiçit të drurit”.

Në *Revolucionin Grek* të vitit 1820, shqiptarët mbizotëruan kaq shumë në luftë, sa kronikanët e asaj periudhe nuk mënuan të pohojnë hapur:

“Po të mos ishin ata, emri revolucion nuk do të kishte patur kuptim”.

M. Eugen Pitardi,³¹ profesor në Universitetin e Gjenevës, ndaj të cilit jam kaq shumë borxhli për materialin e këtij kapitulli, thotë:

“Roli që luajtën shqiptarët në rigjallërimin e Greqisë është bërë i njohur prej tërë historianëve, francezë, anglezë apo gjermanë qofshin... Përpara së njëjtës kryengritje të grekëve, një autor shkruante se i vetmi element vërtet i aftë për të ushtruar ndikim mbi të ardhmen e Greqisë, ishin shqiptarët. Grekët vetë as që kishin kurrëfarë force”.

Koloneli i nderuar Liecester Stanhope,³² në letrat e tij *“Letra dhe dokumente mbi Revolucionin Grek”*³³, ku paraqet një studim serial të kësaj teme, bën komentin e mëposhtëm për grekët e asaj periudhe:

“Që një komb i tillë, pasardhës luftëtarësh, poetësh, historianësh dhe filozofësh që paraqesin tek ne tipat fisnikë të klasës së tyre respektive, të ishte zhytur kaq poshtë në shkallën e energjisë morale sa të bëhej skllav i pabelbëzueshëm i një race të pafë e të paqytetëruar, ishte një fenomen tepër i dukshëm për të mos u vënë re, dhe tepër poshtëruës për të mos u dënuar universalisht. Dikush mund të mendojë se grekët modernë kishin degjeneruar kaq shumë dhe ishin larguar aq shumë nga talentet dhe shpirtmadhësia e stërgjyshërve të tyre, aq sa dhe Bufi i Minervës, i ulur gjatë një beteje mbi shpatën e Akilit që ishte shndërruar përsëri në një shigjetë apo furkë leshi për shoqëruesit e zhburrëruar në Gjykatën e Likomedesit”.

Jo vetëm që forca tërheqëse e revolucionit përbëhej në masën më të madhe prej shqiptarësh, por udhëheqësi më i shquar i këtyre forcave ishte Marko Boçari,

³¹ M.Eugen Pitard (Eugene Pittard): Shqiptarët në vendin e tyre dhe në vendet e tjera (Les Albanais chez eux et a L'Etranger).

³² *Leicester Fitz Gerald Charles Stanhope, 5th Earl of Harrington* (2 shtator 1784 – 7 shtator 1862) ushtarak dhe fisnik anglez, i njohur si *Hon Leicester Stanhope* deri më 1851. Ai lindi në Dublin më 1784. Më 1 tetor 1799 u bë nënlejtant në Regjimentin e Parë të Gardës dhe mori gradën lejtnant më 20 tetor 1802. Më pas kaloi në Regjimentin e 9-të të Këmbësorisë. Në 19 mars 1803 dhe më 2 prill 1803 mori gradën e kapitenit në Regjimentin e 10-të të Dragonjve (të Princit të Uellsit). Më 9 nëntor 1803, kaloi te Karabinierët (Garda e 6-të e Dragonjve) dhe më 27 janar 1813 në Regjimentin e 17-të të Dragonjve. Pasi mori gradën major, më 29 qershor 1815 u emërua zëvendës-agjutant i përgjithshëm në East Indies. Teksa shërbeu në këtë post, kaloi në Regjimentin e 47-të të Këmbësorisë dhe u emërua zëvendës-intendent i përgjithshëm më 24 prill 1817. Nga fundi i vitit 1817 deri më 1818, Stanhope dhe regjimenti i tij morën pjesë në Luftën e Tretë Anglo-Maratane. Ai dha dorëheqjen si intendent më 29 mars 1821 dhe mori gradën kolonel-lejtnant i paatashuar më 26 qershor 1823. (Shëimi im – MB)

³³ *Letra dhe dokumente për Revolucionin Grek* (Letters and Documents on the Greek Revolution).

suljoti që thirrej prej grekëve Leonida i Dytë i tyre. Duke u krahasuar me disa prej akteve heroike të Skënderbeut, ai u përpoq me dorë të vetme të mbante linjën kundër një dyzine turqish që e përqëndruan sulmin e tyre mbi të dhe kështu ai mposhti tetë prej tyre me shpatën e tij përpara se të binte, i goditur nga një plumb në ballë. Megjithëse luftoi kundër armiqve të Greqisë, në çastin e vdekjes së tij ai tha se po e jepte jetën për vendin e tij, duke pohuar: “Vëllezërit e mi, po ia kthej borxhin vendit tim, po vdes i kënaqur”.

Këtu duhet thënë se shqiptarët shpresonin shumë te fitorja e luftës për pavarësinë e Greqisë, pasi dy popujt atëherë do të bashkoheshin për ta çliruar edhe Shqipërinë nga duart e të njëjtit armik. Por kjo shpresë u shkatërrua e tëra në mënyrën më të vrazhdë. Kur djali i Marko Boçarit e pa nënën e tij të mbetur të ve, të veshur me tesha zie për burrin e saj të ri që ra hero (ai ishte vetëm tridhjetë vjeç kur vdiq), ai i tha këto fjalë:

“Pse je veshur në të zeza, nënë? Përse po qan? Ne duhet të jemi të lumtur, ndaj duhet të veshësh rrobat e festës, sepse babai im vdiq me nder duke luftuar me turqit”.

Gjenerali anglez Bentam (Bentham)³⁴ shprehu dëshirë të merrte përgjegjësi për arsimimin e djalit të saj në Angli, por nëna, me zgjuarsia ose ndoshta jo dhe aq, nuk desh të ndahej prej tij. Kështu ajo ia kushtoi jetën e saj arsimimit dhe edukimit të tij me traditat dhe virtytet e të atit dhe popullit të tyre. Vëllezërit e Boçarit, Odiseja dhe Gura, Kristo Zavalla, Zaimi dhe Kanarisi vazhduan të udhëhiqnin shqiptarët. Ishte flota detare greke ajo që e mori përsipër nderin e revolucionit. Pas shkatërrimit të flotës greke në Psira, flota e re që u bë mbështetësja kryesore e shpresave të kombit, përbëhej tërësisht prej shqiptarëve. Tre ishujt shqiptarë të Hidrës, Spezias dhe Psiras u bashkuan për ndërtimin e anijeve e më pas për pajisjen e tyre. Në të gjithë flotën numëroheshin nga 112 deri në 116 anije të cilat kishin të montuar tetë deri në njëzet topa me dy deri në tre korveta në anijet

³⁴ *Sër Samuel Bentam (Bentham)* (lindi më 11 janar 1757 në Angli, vdiq më 31 maj 1831 në Londër) ishte inxhinier mekanik dhe arkitekt i njohur anijesh në Angli. Atij i njihen disa shpikje, sidomos në arkitekturën e anijeve, përfshirë armët. (Shënimi im – MB)

më të mëdha. Flota që e shoqëronte, përbëhej prej një numri anijesh me fuqi zjarri të madhe, të provuara për efektshmërinë e tyre në rast nevojë. Flota detare përbëhej prej burrash të marrë nga anijet tregtare. Edhe nëse nuk ishin provuar drejtpërsëdrejti më parë, ata, prapëseprapë, ishin pronarë anijesh tregtare, këpucarë, tregtarë hekurishtesh, argjendarë dhe bakërpunues, bujq dhe kopshtarë ose edhe barinj të tufave. Admirali ishte zgjedhur prej pleqve të Hidrës, e cila siguroi dy të pestat e tërë flotës. Shpenzimet e flotës që vlerësoheshin rreth 800 dollarë për çdo anije, çdo muaj paguheshin prej tregtarëve si një sigurim për ngarkesat e tyre që lundronin në ujërat e Egjeut dhe të Mesdheut.

Disiplina në bordin e këtyre anijeve ishte diçka e një lloji të ri, ose pararendëse e autokracisë së flotave të sotme detare. Aty nuk kishte as grada, as rangje dhe as ndonjë përpjekje për të shtrënguar disiplinën.

Sipas shënimeve të Xhorxh Hadingtonit që flet për kushtet e tyre, “admirali, kur zgjohej dhe donte të ndërmernte veprime të rëndësishme detare mund të mos e gjente gjysmën e ekuipazhit aty, pasi kishin shkuar për vizita nëpër shtëpitë e tyre, ose për të mbledhur tufat e deleve nëpër kodra. Kapiteni e hante darkën i vetëm, shoku i tij gjithashtu përtypte havjarin e tij dhe fasulet i vetëm. Të tjerët në radhë ishin katër detarë që qëndronin në atë drejtim dhe kishin tavolina të ndryshme të ndara. Dhe prapëseprapë, në cilësitë, shkathtësinë, gjallërinë, zgjuarsinë e tyre ata nuk ishin inferiorë individualisht ndaj çfarëdo detari tjetër në botë. Në atë botë të tyre të një demokracie të vogël dihej se çdo detar bëhet njësh me objektin e çdo ekspedite, ka në përgjithësi mendimin e vet dhe nuk ngurron të përmbushë detyrat e veta më së miri, qoftë ai kapiten, admiral ose kushdo tjetër në flotë, deri tek detari i fundit. Ishte ky lloj organizimi që bënte që secili prej tyre të kishte të njëjtën shkallë efikasiteti dhe bashkëpunimi. Por gjithsesi, falë gjenisë dhe guximit të admiralit shqiptar Andrea Miauli, flota greke arriti tërë ato fitore të jashtëzakonshme”.

Në këtë karakter të veçantë të shqiptarëve del në pah fare qartë kuptimi i

thënies *paras cum paribus, më thuaj me kë rri, të të them se kush je*. Edhe vetë Aleksandri i Madh, siç e dimë, motivohej prej këtij ligji, kur ai erdhi tek legjionet e tij maqedone. Gjeneralët dhe diplomatët e huaj e kanë mësuar këtë tepër vonë, për të keqen e tyre. Shembull është rasti i një gjenerali gjerman që shërbente në ushtrinë turke. Ai e qëlloi me shpullë një ushtar shqiptar në Pallatin Yildiz³⁵ dhe e pagoi me jetën e vet fyerjen që i bëri atij, aty për aty. Ose konsulli rus në Manastir, Rostkovski, i cili kishte fituar zakonin e kalërimit nëpërmjet rreshtave të ushtarëve turq, pa treguar respektin e duhur për shkak të pozitës së tij zyrtare. Gabimisht, ai hasi në një ushtar shqiptar, që kishte bërë karrierë në rangjet turke dhe gjeti vdekjen e menjëhershme.

Këtë kapitull do ta mbyllim me një shënim të shkurtër për një tjetër segment që jeton nga kjo racë e jashtëzakonshme, e cila, pasi është shqyer copa-copa gjaku dhe është shpërndarë në të katër anët dhe në të gjitha format, duket ende e zonja për të vazhduar jetën e saj racore pa asnjë ndryshim material apo ndërprerje.

Kolonitë shqiptare në Itali patën një përvojë krejt të ndryshme, edhe më të vështirë se ato në Greqi, parë nga pikëpamja e racës. Në Itali ata qenë përshtatur duke qëndruar shumë më afër me jetën e shtetit italian. Në përgjithësi ato koloni u vendosën në provincën e Kalabrisë dhe në Sicili. Alfonsi V i Aragonës, mbret i Napolit, në përpjekjet e tij për të forcuar mbretërinë e tij bashkë me Kalabrinë, i gjeti shqiptarët shumë të përdorshëm për atë qëllim. Prandaj një numër i madh i shqiptarëve u ftua që të shkonin dhe të vendoseshin në tokat e tij të shkretuara. Shumë veteranë të luftërave shqiptare, bashkë me familjet e tyre, shkuan atje. Komandanti i tyre u bë guvernator i Kalabrisë. Si rezultat i këtij emigracioni u populluan plot

³⁵ *Yıldız Palace*, u ndërtua më 1880 dhe u përdor nga sulltan Abdylhamiti II. Zona e pallatit ishte me pyje natyrore dhe u shndërrua në rezidencë perandorake qysh gjatë sundimit të sulltan Ahmetit I (1603-1617). Disa sulltanë pas Ahmetit I i kalonin pushimet atje dhe dy sulltanë, Abdylmexhid dhe Abdylaziz ndërtuan çifligjet e tyre në ato toka. Nga fundi shekullit të 19-të, sulltan Abdylhamiti II u largua nga *Dolmabahçe* nga frika e një sulmi nga deti mbi pallat, i cili ngrihet mbi brigjet e Ngushticës së Bosforit. Ai zgjeroi *Yıldız Palace* dhe urdhëroi arkitektin e famshëm italian, Raimondo D'Aronco, të shtonte disa ndërtesa të tjera. Kur ai u vendos atje, pallati u bë selia e katërt e qeverisë osmane, pas *Eski Saray* (Pallati i vjetër) në Edirne, *Top Kapı* dhe *Dolmabahçe*, në Stamboll. (Shënimi im – MB)

katërmbëdhjetë fshatra. Aty vihej re se si bujqit shqiptarë nuk shpërndareshin në familje të veçanta nëpër fshat, të ndarë nga njëri-tjetri me kilometra, çka do t'i bënte ata të jetonin të izoluar në vetminë e tyre. Në vend të kësaj, ata vendoseshin së bashku në një fshat, në mes tokash që i ndanin sipas nevojave të familjeve. Kështu ndihma që Skenderbu i kishte dhënë Ferdinandit për t'u rikthyer në fronin e tij, po u shpërblehej shqiptarëve me çifligjet e Tranit, Shën Xhovani Retundos dhe Sipotos. Këtu ishin vendosur shumë prej pasuesve të Skenderbeut në të gjallë të tij dhe të Ferdinandit, ndërsa shumë të tjerë po vendoseshin pas vdekjes, duke formuar së bashku një koloni shumë të madhe në Italinë Qendrore. Përpara vitit 1480, aty kishte dhjetë koloni të njohura, të vendosura në provincën e Otrantos dhe Leçes. Në vitin 1534, shqiptarët nga Peloponezi, të cilët më parë shërbenin në flotën detare të perandorit Karli V, kur qyteti i tyre ra edhe një herë në duart e turqve, emigruan në masë, duke lundruar në dyqind barka. Disa prej tyre u vendosën në Sicili, të tjerët iu bashkuan bashkëpatriotëve në koloni të tjera, të mbeturit u vendosën në ishullin Lipari. Në vitin 1744, gjatë sundimit të Burbonit të Napolit, ata që kishin mbetur nga një trup i gjerë i të krishterëve, që kishin shpëtuar nga turqit dhe kishin marrë strehë në malet Akrokerune (Acroceraunia), pasi luftonin me urinë, kolerën dhe përndjekjen thuasje deri në pikën e shfarosjes, kërkuan strehë në Itali. Të udhëhequr nga tre priftërinj, ata arritën të merrnin tokë në provincën e Abruzit. Në tërësi, rreth tetëdhjetë fshatra dhe qytete të Sicilisë dhe Italisë u populluan nga mbi 200.000 shqiptarë.

Ato çfarë shkruhen për këta të huaj të çuditshëm, disa parapëlqejnë t'i thërrasin ata barbarë, gjatë më shumë se katër shekujve, nuk janë të tilla që mëmëdheu të ndihet i turpëruar. Kushdo që ka udhëtuar nëpër kolonitë e tyre, ka lënduar pa as më të voglin dyshim zellin e tyre të plotë, karakterin e tyre të bindur ndaj ligjit, respektin e tyre tradicional, nderimin ndaj grave dhe mungesën e plotë të dhunës. Ata raportojnë se, ndërkohë që në fshatrat fqinjë, joshqiptare, vihen re brenda një jave të vetme disa raste dhune, në këto fshatra shqiptare mund të kalojnë vite të tëra pa asnjë të tillë. Sapo u përshtatën me vendin e ri ku ishin vendosur, ata i

shërbyen atij sa herë ia kërkonte nevoja. Në luftën e Karlit III, mbret i Napolit, për ndarjen nga Austria, një regjiment shqiptar luajti rol vendimtar në Betejën e Veletrisë³⁶ e zhvilluar në vitin 1744, në çastin më kritik të saj. Gjatë luftërave për një Itali të bashkuar, katër batalione shqiptarësh shërbyen në ushtrinë e Garibaldit. Kaq shumë e vlerësoi ai kontributin e tyre, sa më vonë ai vetë drejtoi një lëvizje për pavarësinë e Shqipërisë, duke deklaruar se kauza shqiptare ishte edhe kauza e atij vetë. Kjo erdhi kryesisht për shkak të mbështetjes së madhe që kolegji shqiptar i Shën Mitër Koronës i kishte dhënë atij. Ai kolegji edhe sot vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në jetën e shqiptarëve të Italisë dhe marrëdhëniet e tyre me atdheun e tyre të dytë.

Këto koloni shqiptare, aq sa i kanë shërbyer interesave të Italisë kur ajo rrezikohej prej luftës, po aq i kanë shërbyer edhe në jetën civile. Disa u shquan së tepërmi në art, në shkencë, në politikë dhe në letërsi. Të tjerë, nëpërmjet martesave janë bërë të shquar me lidhjet që kanë me disa prej familjeve më të fuqishme të shtetit. Midis tyre spikat emri i Françesko Krispit³⁷, këtij burrë-shtetasi që i bëri një shërbim të pashoq bashkimit të Italisë dhe vetë Italisë së Bashkuar e moderne. Ai është një përfaqësues gjakpastër shqiptar, krenar për racën e tij, përherë mik besnik dhe i fuqishëm.

Edhe pse këto koloni kanë bërë kaq shumë për vendin ku u përshtatën, ato nuk e kanë harruar asnjëherë 'nënën' që i lindi dhe i rriti. Ata ende flasin gjuhën e saj në shtëpitë e tyre, e botojnë në këtë gjuhë disa gazeta të tyre, revista, recensione. Ata e mësojnë atë në shkollat dhe kolegjet e tyre. Disa prej patriotëve më të zgjuar


³⁶ Beteja e Veletrisë (*The Battle of Velletri*) u zhvillua më 12 gusht 1744 gjatë luftës për fronin austriak mes Austrisë dhe Mbretërisë së Napolit, e mbrojtur nga trupat spanjolle. Pasi mori Veletrinë në një sulm gjatë natës, ku kapi rob një pjesë të mirë të bashkëpunëtorëve të afërt me oborrin mbretëror të mbretit Karl, ushtria austriake u fut në betejë me ushtrinë spanjolle të Karlit, në dalje të qytetit. Austriakët u zbrapsën shpejt nga spanjollët dhe trupat e *Éalloon Guard-ës* dhe u tërhoqën drejt Romës në veri, të ndjekur nga Karli. (Shënimi im – MB)

³⁷ **Francesco Crispi** (1819 – 1901) politikan italian nga Sicilia. Ai ishte figurë e rëndësishme e Rilindjes italiane dhe mik i ngushtë i Xhuzepe Mazinit dhe Xhuzepe Garibaldit. Ai ishte një prej arkitektëve të bashkimit të Italisë në vitin 1860. Ai ka qenë Kryeministër i Italisë nga vitet 1887 deri në vitin 1891 dhe përsëri nga viti 1993 deri në vitin 1896. Ai ishte bir i një familje arbëreshe e zhvendosur nga Shqipëria në shekullin e XV. Ai ishte i pagëzuar si ortodoks dhe gjuhë të parë kishte gjuhën shqipe. (Shënimi im – MB)


dhe entuziastë që ka kjo racë, gjenden midis kësaj popullate në Itali. Nëse Italia tregon një interes të madh sot në ruajtjen e shtetit shqiptar dhe racës së tij, siç po bën në fakt, ajo thjesht po i kthen një borxh nderi që i ka për shërbimin që i kanë bërë dyqind kolonitë shqiptare në rrjedhë të katër shekujve, duke ushqyer rremat e jetës së saj me gjakun e tyre.

Midis shqiptarëve që erdhën nga jashtë për të marrë pjesë në festimet e njëzetepesë vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1937, ishte edhe një grup i madh i këtyre kolonive nga Italia, të drejtuar prej një pasardhësi të shquar të familjes së Skënderbeut. Këta burra dhe gra u përzien natyrshëm me shqiptarët vendas që merrnin pjesë në këto festime, flisnin lirshëm dhe e kuptonin shumë mirë njëri-tjetrin, duke mos treguar asnjë shenjë të të qenit të huaj, edhe pse kishin qëndruar katërqind vite në dhë të huaj. Një rast i tillë nuk haset lehtë në historinë e ndonjë race tjetër.

Disa vjet më parë qeshë i ftuar për t'i folur një grupi shqiptarësh në Bruklin, Nju-Jork. Nuk kisha të dhëna në lidhje me paraardhësit e tyre. Kur arrita në hollin e madh ku do të mbahej mbledhja, u gjeta i rrethuar nga mëse pesë-gjashtëqind burra, gra e fëmijë, disa me kostume kombëtare, të tjerët të veshur *alla franga*, por që flisnin të gjithë shqip. Imagjinoni mahnitjen time sapo mësova se këta ishin jo shqiptarë në kuptimin e zakonshëm të kësaj fjale, por emigrantë nga shqiptarët e kolonive të Italisë. Me sa munda të mësoj, asnjëri prej tyre nuk kishte qenë ndonjëherë në Shqipëri. Për mëse një orë u folën atyre në gjuhën shqipe, duke u përpjekur të bëja më të mirën që mundesha për t'u dhënë një pamje të Mëmëdheut të tyre, tipareve fizike e kushteve të përgjithshme të jetesës, dhe t'u bëja të ditur për ato që po mundoheshim të bënim për ta për një arsim, shëndetësi, bujqësi, jetë sociale më të mirë dhe më të pasur, e po ashtu edhe për një jetë shtëpiake sa më të begatshme. Pastaj vërshoi lumi i pyetjeve nga të gjitha anët e kësaj salle – shqiptarë të uritur, të etur, të përmalluar, të dashuruar me vendin e të parëve. Por shqiptarë dy herë të zhvendosur, që e kishin kaluar një herë detin dhe një herë oqeanin, që donin të dinin sa më shumë rreth racës së Mëmëdheut të tyre të nderuar, të çmuar e krenar. Ky ishte në të vërtetë – *Një Rast i Paharrueshëm!*



...NJË RACË E LASHTË DHE E NDRYSHME NGA ÇDO RACË
TJETËR QË I RRETHON, SHQIPTARËT E SHOHIN NACIONALIZMIN
E FQINJËVE TË TYRE TË MBROJTUR PREJ FUQIVE TË NDRYSHME
EUROPIANE, NDËRSA DËSHIRAT E TYRE PËR PAVARËSI SI
ÇËSHTJE TË NJË RËNDËSIE TË DORËS SË DYTË.



VII



“DHE GJAKU, DHE MISHI, KAQ TË LIRË!”

*E shenjtë është toka ku luftuan,
Dhe vendi i shenjtë, ku ranë për dhe,
Trualli ku jetën bujarisht dhuruan,
Dhe e lagën me gjakun valë-rrëke.
Vdekja e Anglisë së Re*

Isaac McLennan

Le të kthehemi edhe një herë në tokën e shqiptarëve, për të kaluar përsëri në shtigjet e lodhshme të historisë së tyre të përgjakshme, siç vijnë ngjarjet që nga vdekja e Ali Pashës në vitin 1822, deri tek Kongresi i Berlinit në vitin 1878. Gjatë kësaj periudhe prej pesëdhjetë e gjashtë vjetësh, Shqipëria thujse u zhduk fare nga analet e historisë europiane. Si dhe të krishterët e hershëm nën Romën pagane, ata sikur u futën nën tokë. Përmbi ta ra heshtje e çuditshme, e bezdisur, e mbushur

me qetësi vdekjeje kudo. Sjellja e patregueshme e Ali Pashës dhe karakteri që ai kishte shfaqur para botës perëndimore, ambicja e tij e shfaqur në kohë të caktuara me aq shumë patriotizëm i kishte arritur disa prej qëllimeve të tij të larta e fisnike, duke mbajtur gjallë shpresat e kombit të tij. Kur më në fund ai shpалosi projektin e tij ambicioz për të çliruar Ballkanin nga zgjedha turke, atëherë ai nxiti zemrat dhe gjakun e bashkatdhetarëve të tij edhe në atdheun e tyre, edhe në dhé të huaj. Në mënyrë të veçantë kjo ngjalli shpresa tek shqiptarët në Greqi, të cilët e mbështetën pa kursim dhe pa asnjë kusht revolucionin grek. Dështimi i kësaj sipërmarrjeje që në fakt ishte një dështim i rëndë, i zhyti shqiptarët në rrënim edhe më të thellë.

Në vitin 1830 ndodhi një ngjarje tjetër tragjike. Katërqind pjesëtarë të parisë shqiptare, fisnikë, bajraktarë, flamurmbajtës u ftuan prej vezirit të madh, Reshid Pashës³⁸, për të marrë pjesë në një konferencë të organizuar në Manastir, me qëllim që t'i rrafshonin dallimet midis tyre. Konferenca vazhdoi disa ditë. Delegatët turq ishin shumë të mirëkuptueshëm, pajtues, lëshues, të gatshëm për kompromis dhe për të plotësuar çdo kërkesë të shqiptarëve dhe u morën vesh për çdo çështje që u ngrit aty. Kur të tëra gjërat “u rregulluan”, erdhi edhe koha për t'i “festuar”. Shkëlqesia e tij, Veziri i Madh, do të shtronte një banket të madh për të festuar arritjen e paqes. Për këtë ai zgjodhi një vend larg qytetit, në rrugën që të çonte nga Manastiri në Ohër, ku do të bënte një *Ziafet*.³⁹ Sofrat u shtruan në një luginë me sipërfaqe të ngushtë, thujse e tëra e rrethuar prej gurësh të mëdhenj e të lartë sa shtëpitë. I tërë grupi arriti së bashku, me në krye prijësit e shquar, Arslan dhe Veli Beun. Sapo zunë vend, mëse njëmijë trupa turke, të cilat ishin fshehur pas shkëmbinjve që ngjanin si mure rrethuese, shpërthyen nga të gjitha anët duke e vrarë tërë parinë e atëhershme shqiptare. Ata u gjetën të tradhtuar, të paarmatosur, të pambrojtur dhe kështu u masakruan. Njëri prej shqiptarëve që i shpëtoi masakrës, ishte Mustafa Bushatlliu, pashai i Shkodrës. Në atë shkartsje të vazhdueshme të lidhjeve besnike

³⁸ *Mustafa Reshid Pasha* (turqisht: *Koca Mustafa Re id Pa a, Mustafa Rashid Pasha i Madh*), (13 mars 1800 – 17 dhjetor 1858) ishte burrë shteti dhe diplomat osman. Në kohën që e përmend autori, ai ende nuk ishte bërë Vezir i Madh. Ai e ushtroi këtë detyrë gjashtë herë nga viti 1846 deri në vitin 1858. (Shënimi im – MB)

³⁹ Turqisht në origjinal – banket, gosti.

dhe kombinacioneve e intrigave të çifligarëve që sulltani i njihte shumë mirë, ai kishte dashur ta tërhiqte në anën e vet Mustafa Pashë Bushatin për të shtypur Ali Pashë Tepelenën.

Për të kuptuar pak shkakun e ndryshimeve të tilla, duhet të kthehemi tek njerëzit e kohës së Homerit, për të hequr një paralele të saktë ku besnikëria bazohej në ndjenjat personale. Shqipëria veriore i frikësohej dhe e urrente Ali Pashën për arsyet e veta. Ai kishte ambicie për t'u bërë zot i Gegërisë, ndërkohë që ishte një toskë i përçmuar dhe i përbuzur, të cilit një gegë nuk do t'i besonte kurrë, aq më pak t'i nënshtrohej atij si një sunduesi.

Kur shfaqet një çështje e tillë, tërë ato më të mëdhatë, interesat kombëtare hidhen në ajër. Aty qëndron dobësia fatale e këtij populli të papërkulur e krenar. Aty gjenden edhe rrënjët e helmuara të më shumë se gjysmës së mizerjes dhe vuajtjeve që heq ai. Me vdekjen e Ali Pashës, qëndrimi i Mustafa Pashë Bushatit ndryshoi plotësisht. Ai ishte tani gati të merrte tërësisht rolin që kishte luajtur Ali Pasha dhe pothuajse në një vijë paralele me bëmat e tij. Ai kërkoi të bëhej aleat me serbët, bullgarët, grekët, në një përpjekje të kombinuar për të çliruar Ballkanin nga turqit (që për kohën në fjalë do të thoshte se ai ishte vetë Shqipëria). Për ta bërë revolucionin edhe më të madh, edhe më të suksesshëm, ai i bëri thirrje edhe Ruisë. Këtu nxori krye edhe shqiptari tjetër i madh, Mehmet Ali Kadivi (Khadive) i Egjiptit, i fuqishëm dhe me ambicie të tijat për të rrëzuar sulltanatin turk dhe për të dalë vetë në krye të një perandorie edhe më të madhe, e cila ndërthurte Turqinë dhe Egjiptin, dhe të paktën një pjesë të madhe të Ballkanit. Kështu, ai u ftua të hynte në aleancë, dhe është e lehtë të merret me mend se sa me zell e priti ai këtë.

Por, meqë midis Ruisë dhe Mehmet Ali Pashës⁴⁰, në duart e të cilëve kishte

⁴⁰ *Muhammad Ali Pasha* (shqip, Mehmet Ali Pasha; turqisht, Kavalah Mehmet Ali Pa a(4 mars 1769 – 2 gusht 1849), ishte komandant shqiptar në ushtrinë osmane dhe u bë *Vali* dhe *Khedif* i vetëshpallur i Egjiptit dhe Sudanit. Ndonëse nuk ishte nacionalist modern, ai konsiderohet si themeluesi i Egjiptit të sotëm, falë reformave të thella që kreu në ushtri, ekonomi dhe kulturë. Ai sundoi gjithashtu në territoret levantine, të Lindjes së Afërt jashtë Egjiptit. Dinastia që ai krijoi, do të sundonte në Egjipt dhe Sudan deri në Revolucionin Egjiptian të vitit 1952. (Shënimi im – MB)

rënë fati i shqiptarëve dhe i pengjeve të tjera të vogla të Ballkanit, si zakonisht, mund të merret me mend se ekzistonte edhe një marrëveshje që Napoleoni ia kishte propozuar carit Aleksandër I në Tilsit⁴¹. Napoleoni do t'i linte Rusisë Besarabinë, Moldavinë, Vllahinë dhe Bullgarinë Veriore, ndërsa do të merrte për vete Shqipërinë, Tesalinë, deri në Gjirin e Selanikut, Peloponezin dhe Kretën. Këtë e kundërshtoi cari, pasi nuk iu duk e mjaftueshme dhe kërkoi Rumaninë dhe Konstandinopojën për vete. Se ç'marrëveshje, nëse pat ndonjë të tillë, ishte arritur midis carit dhe Mehmet Aliut, kjo nuk dihet. Që e donin të dy dëshpërimisht kryeqytetin turk, Stambollin, kjo është e padiskutueshme. Edhe një fjalë në lidhje me Mehmet Ali Pashën në këtë pikë. Ai ishte i biri i një shqiptari nga shtresë e mesme, madje jo tamam bir beu, i lindur në fshatin Voskop, tetë kilometra në perëndim të Korçës. Ngjitja e tij në fronin e Egjiptit lexohet si historia e *Lizës në botën e çudirave*. Historia e tij na kujton shqiptarin tjetër, Anastasin, i lindur në një familje fshatare të guximshme pranë qytetit të Durrësit. Ai gjeti punë në Pallatin e Bizantit. Perandori Zeno vdiq dhe la gruan të vé, e cila kishte të drejtë të zgjidhte në tërë botën, por pikasi pikërisht këtë shqiptar, një rojtar dere, për burrë. Kështu ai u bë Anastasi I, Perandor i Lindjes, për njëzet e shtatë vjet.⁴²

Por, le të kthehemi tek Mehmet Ali Pasha. Me të ardhur në pushtet, ai filloi të ndërtonte një ushtri dhe flotë të fuqishme, duke marrë në punë oficerë francezë për këto qëllime. Një profesor francez i mjekësisë i dha një kurs të plotë mësimesh mjekut të tij privat. Në një kohë të shkurtër, ai u vu në zotërim të plotë të Egjiptit,

⁴¹ *Tilsiti*, të cilit iu njoh statusi i qytetit më 1552, u shtri përreth një kështjelle të *Kalorësve Teutonikë* (*Teutonic Knights*), e njohur si *Schlauner Haus*, e ndërtuar më 1288. Ajo është më e njohura për shkak të Traktatit të Tilsitit që u nënshkrua atje në korrik 1807. Marrëveshja paraprake për traktatin ishte arritur nga perandorët Aleksandri i Rusisë dhe Napoleoni i Francës, në një barkë të ankoruar në lumin Neman. Ky traktat, që krijoi Mbretërinë e Uestfalisë dhe Dukatit e Varshavës, plotësoi poshtërimin e Mbretërisë së Prusisë nga Napoleoni, ku asaj iu mor gjysma e territorëve. Ky traktat paqeje jetëshkurtër njihet edhe për një arsye tjetër. Tri ditë para nënshkrimit, mbretëresha e Prusisë Luizë (Louise) (1776–1810) u përpoq ta bindte Napoleonin në një bisedë private që ai të zbuste kushtet e rënda që kishte vënë mbi Prusinë. Ndonëse nuk arriti ndonjë rezultat, kjo përpjekje e Luizës e rriti shumë popullaritetin e saj te prusianët.

⁴² *Anastasi* (*Anastasius*) lindi në Durrës (Dyrrhachium); data nuk dihet, por mendohet se ai ka lindur jo më vonë se viti 430 apo 431. Ai lindi në një familje ilire, ishte djali i Pompeut (i lindur 410), fisnik i Durrësit (Dyrrachium) dhe gruas së tij Anastasia Konstantina (e lindur 410). E ëma ishte ariane, motra e Klearkut, gjithashtu ariane, dhe mbesë e Galit (i lindur 370), djali i Anastasisë (e lindur 352). (Shënimi im – MB)

si çdo faraon paraardhës, megjithëse, sa për emër, Egjipti ishte nën sovranitetin e Stambollit.

Ishte ky burrë që e vuri kaq shumë në lëvizje këtë aleancë kundër sulltanatit, sa ta bënte rënien e Stambollit një çështje të vetë fatit. Por Anglia dhe Franca, të alarmuara për mundësinë që Rusia mund të kapte një dalje në Mesdhe nëpërmjet Bosforit dhe, gjithashtu, nga frika e një shkapërderdhjeje të pamënjanueshme dhe të pakontrolluar të Ballkanit, u rreshtuan përkrah Mahmutit II, me fuqi të kombinuar mbretërore dhe republikane. Kështu lufta mori fund pa filluar ende. Rusia tani gati sa nuk shihej me sy nga Stambolli dhe Mehmet Ali Pasha nuk ishte aq larg ndaj këtij qëndrimi. Traktati i Adrianopojës,⁴³ i diktuar prej këtyre dy fuqive, rezultoi në ruajtjen e fronit dhe zotërimeve europiane nga ana e sulltanit, pa ngritur as dorën. Pas tërë këtyre, ajo çfarë mbetet është: “U bëftë ç’të dojë, vetëm mbreti të na rrojë!”.

Pengu, copa e vogël, e varfër, përjetoi një kohë tejet të vështirë në këtë “lojë mbretërishe”. Nga viti 1835, kur Britania dhe Franca shkatërruan shpresat e Shqipërisë për pavarësi, deri në vitin 1860 kjo copë e vogël e parëndësishme u përpoq ta luante lojën e vetme. Brenda asaj kohe shqiptarët organizuan jo më pak se pesëmbëdhjetë kryengritje e revolta të ndara. Të pashpresa – padysim; të nëmura për të dështuar që në fillim – po. Por, ata që e njohin veten si *bij të shqipes* nuk mund të bënin asgjë më pak. Kushedi, ndoshta ata përkundnin shpresa idealiste (kaq e shkurtër është memoria racore ndër kohëra). Nëse do të përpiqeshin aq

⁴³ Traktati i Paqes i Adrianopojës (*The Peace Treaty of Adrianople*) i njohur si Traktati I Edirnesë (*Treaty of Edirne*) i dha fund Luftës ruso-turke 1828-1829 mes Rusisë dhe Perandorisë Osmane. Ai u nënshkrua më 14 shtator 1829 në Adrianopojë nga konti rus Aleksej Orlov dhe Abdyl Kadirbej i Turqisë. Perandoria Osmane i lejoi Rusisë akses në Danub dhe në kështjellat *Akhaltsikh* edhe *Akhalkalaki* në Gjeorgji. Sulltani njohu zotërimin e Gjeorgjisë nga Rusia (bashkë me Imeretian, Mingrelian, Gurian, *Erivanin* dhe *Nakhishevanin*, që i ishin dhënë carit nga Persia në Traktatin e Turkmenshait një vit më herët. Traktati i hapi Dardanelet për të gjitha anijet tregtare, duke lehtësuar kështu tregtinë e drithërave, bagëtime dhe lëndës së drurit, ndonëse u desh *Taktati i Hünkâr skelesit* (1833) për të zgjidhur çështjen e kësaj ngushtice mes nënshkruesve. Sulltani rigarantoi autonominë e premtuar për Serbinë, premtoi autonomi për Greqinë dhe e lejoi Rusinë të pushtonte Moldavinë dhe Vllahinë, deri sa Perandoria Osmane të paguante një dëmshpërbim të madh. Traktati përcaktoi, gjithashtu, kufirin mes Perandorisë Osmane dhe Vllahisë në Danub, duke i kaluar Vllahisë rajonet *Tirnu*, *Giurgiu* dhe *Br ila*. (Shënimi im – MB)

shumë të sakrifikonin edhe më në altarin e përgjakur të çlirimit kombëtar, ndoshta fati do t'i ndihmonte si Pendarin e Konkordit dhe Bunker Hillin⁴⁴.

“Qëlllo që të dëgjohet në tërë botën!”⁴⁵ Në një çast të caktuar, udhëheqësit shqiptarë i bënë një thirrje prekëse Greqisë që t'i ndihmonte për ta çliruar vendin e tyre nga zgjedha turke. Sikur të mos kishin qenë këta shqiptarë që derdhën gjakun e tyre dhe të mos kishin qenë po ata që e drejtuan revolucionin grek, për t'u siguruar grekëve lirinë që gëzonin... Natyrisht, një kërkesë e tillë në Greqi ra në vesh të shurdhër, pasi kjo e fundit ushqente ambicie të tjera ndaj Shqipërisë. Kjo i pamundësonte asaj kthimin e një përgjigjeje ndaj kësaj kërkesë. Në vitin 1863 shqiptarët iu drejtuan me një thirrje të hapur fuqive të krishtera për mëshirë. Përgjigjja e tyre ishte si ajo e priftit dhe e Levites⁴⁶ në rrugën për në Xheriko:

“Kalo në anën tjetër!” Garibaldi ishte i vetmi burrë që shprehu mirëkuptim për çështjen e tyre. “Sigurisht që do të isha i lumtur t'i kushtoja gjithçka që mbetet prej jetës sime këtij populli krenar”, – ishte përgjigjja e tij ndaj kërkesës personale të princshës shqiptare Elena Gjika ose, siç njihet më mirë, Dora D'Istria.

Në luftën e vitit 1877 midis Rusisë dhe Turqisë, e para dërgoi emisarë të saj nëpër tërë Shqipërinë, duke u kërkuar shqiptarëve të ngriheshin në revolta dhe

⁴⁴ Beteja e Kodrës Bunker (*The Battle of Bunker Hill*) u zhvillua më 17 qershor 1775, kryesisht në Kodrën Brid (*Breed*) dhe përreth saj, gjatë rrethimit të Bostonit në fillim të Luftës Revolucionare në Amerikë. Beteja ka marrë emrin e *Kodrës Bunker* që ndodhet pranë, e cila u përshi fare pak nga beteja dhe ishte fillimisht objektivi në këtë betejë, së cilës në disa raste i referohen si “Beteja e Kodrës Brid”. Kësaj i është kushtuar poema “Pendari” shkruar nga Oliver Uendell Holmes. (Shënimi im – MB)

⁴⁵ Kur Paul Revere kalëroi nën dritën e fortë të hënës përmes Leksingtonit drejt Konkordit, i shoqëruar nga Dauesi dhe Preskoti natën e 18 prillit 1775, ai mbante me vete sinjalin për pavarësinë e kombit. Përtej lumit Charles (Charles) ai pa dy drita në këmbanoren e kishës në Boston, çka tregonte se trupat britanike ishin nisur për të kapur furnizimet e forcave patriotike në Konkord. Që këtë buron shprehja: *Qëlllo që të dëgjojë e tërë bota!* (Shënimi im – MB)

⁴⁶ *The parable of the Good Samaritan* është një parabolë që tregohet nga Jezui dhe përmendet vetëm në njërin nga Librat e Ungjillit. Sipas Ungjillit të Lukës, psallme 10:25–37, një udhëtar (që mund të jetë hebre ose jo) e rrahin, e grabisin dhe e lënë gati të vdekur në mes të rrugës. Aty kalojnë fillimisht një prift e më pas një levit, por të dy bëjnë sikur nuk e shohin. Më pas aty kalon një samaritan. Samaritanët dhe hebrejtë përgjithësisht nuk e honepsnin njëri-tjetrin, por ky samaritan e ndihmoi të plagosurin. Jezui thuhet se e tregoi këtë parabolë duke iu përgjigjur një pyetjeje lidhur me identitetin e “fqinjtit” që *Leviti* na këshillon ta duam. Portretizimi i një samaritani me nota pozitive duhet t'i ketë shokuar hebrejtë. (Shënimi im – MB)

duke u premtuar atyre pavarësinë, në qoftë se fitonin. Prenk Doda i Mirditës dhe shumë fise veriore iu përgjigjën kësaj thirrjeje. Këta ishin midis heronjve të Plavës dhe Gucisë, të cilët dhanë jetën pa iu dhimbsur fare që ata dhe fqinjët e tyre sllavë të fitonin lirinë. Se çfarë ngjau me këtë luftë, do të flasim në një kapitull tjetër. Por, do të ishte me vend të rishikonim situatën përse i takon turqve në Ballkan, të cilin kishin katër shekuj që po e mbanin nën thundrën e vet të hekurt.

Ajo karakterizohet si një “rrymë e trazuar dhe e përgjakur që përshkonte shekujt”. Çdo përshkrim tjetër do të ishte i pavlerë. Turku erdhi në Europë si pushtues, i huaj në fe, doke dhe zakone, në karakter, mentalitet dhe me ideale krejtësisht të largëta me familjen europiane. Nuk mund të mos merret parasysh që Europa përherë ka qenë një shtëpi e ndarë, që sllavët, teutonët, saksonët dhe latinët, polakët dhe hungarezët ziheshin në mënyrë të pandërprerë dhe ishin të mallkuar të luftonin kundër njëri-tjetrit dhe në çfarëdo lloj kombinacioni të mundshëm. Ata kishin patur xhelozitë e veta, ambiciet dhe përplasjet e tyre të rivalitetit, por përsëri kishin arritur të pajtoheshin dhe të vepronin së bashku, të adhuronin së bashku, të dashuronin së bashku. Por me turkun gjërat ishin tërësisht ndryshe. Ai nuk i takonte së njëjtës kategori, nuk fliste të njëjtën gjuhë as mendërisht, as shpirtërisht. Ai ishte përherë Ishmaeliti⁴⁷ i Europës. Dora e tij ishte përherë kundër çdo dore tjetër, siç ishin tartarët, siçëtët, persianët, hordhitë e Xhingiz Khanit në ditët e tyre. I tillë ishte turku në ardhjen e tij. Njësoj si ata, edhe ai erdhi jo për t’u ushqyer, por për të gllabëruar, jo për të ndërtuar, por për të shkatërruar, jo për të mbjellë apo korrë, por për të mbledhë e rrëmbyer ato që të tjerët kishin prodhuar, duke mos paguar as çmimin më të vogël në pazarin e bërë.

Gjatë tërë historisë, ata që kishin mundur të mbanin një këmbë në Europë më së shumti kishin arritur ta mbanin atë në më pak se një shekull. Ndërsa turqit jo vetëm u lejuan të qëndronin më shumë se katër shekuj, por edhe të shkelnin mbi tërë atë që ishte më jetikja dhe e shenjta për jetën e popujve të Ballkanit. Dhe

⁴⁷ Sipas Ungjillit, ishmaelitët (*Ishmaelites*) janë pasardhës të *Ishmaelit*, djalit të madh të Abrahamit.

ajo që është më e pashpjegueshmja është se arritën t'i mbanin Fuqitë e Europës mospërfillëse dhe jokundërshtuese ndaj tërë kësaj. Po përse u lejua turku të ikte pa u ndëshkuar, pas përdhunimit që u kishte bërë këtyre popujve të Ballkanit mu në prani të Europës së krishterë? Në dritën e fakteve të zbuluara gjatë këtyre njëzet e pesë vjetëve të fundit të shekullit të njëzetë, përgjigjja del të jetë shumë e qartë. Me tërë këto paragjykime kombëtare dhe racore, xhelozit dhe urrejtje, të nxitura dhe të kultivuara, padyshim për shkak të ambicieve të kundërshtarëve për territore, pasuri dhe pushtet, Europa kurrë nuk e gjeti veten të bashkuar si një e tërë. Nëse do të arrihej të ngrihej ndonjëherë një Perandori e Madhe Europiane, siç aspironte ta bënte Karli V ose Napoleoni, është e sigurtë që Ballkani do të ishte përfshirë brenda saj dhe sulltani do të ishte përzënë mbrapsht drejt Azisë, nëse nuk do të ishte shkatërruar fare.

E tillë ishte fuqia dhe zemërimi i forcave që punonin për përçarje, saqë zor se kishte ndonjë prej këtyre fuqive që do ta brente ndërgjegjja për të bërë aleancë me sulltanin, me qëllim që të siguronte disa përparësi të përkohshme për vete, në kurriz të një fuqie tjetër të krishterë. Ashtu si Shiloku mes tregtarëve të Xhenovës urrente dhe përçmonte fshehtas, turku ishte më i vlefshëm për ta dhe për politikën e intrigat e tyre sesa këto 'bebe qaramane' të Ballkanit. Ndërkohë administrata turke e provincave të saj europiane ishte bërë më intolerante se kurrë, padyshim për shkak të faktit se po këto fuqi europiane po bëheshin për ditë e më tepër më të padurueshme në ndërhyrjet e tyre në punët e saj të brendshme. Bashibozukët e saj, ose trupat e parregullta, ishin kthyer në njerëz të lënë të lirë mbi popujt e pambrojtur të Ballkanit dhe një kryengritje ose protestë që mund të ndodhte, përfundonte në masakra dhe tortura të pafund. Edhe kur kryengritjet dhe rebelimet shpërthyen ngado, përsëri Europa nuk po lëvizte:

Një njeri dhjetë milje larg, i mbytur,

Zor se paqen tënde e trazon,

Si një njollë e kuqe në dorën tënde, zhytur,

*Apo fëmijë i torturuar, që zemra i lëngon,
 Që kurrë nuk do të shohë një qeshje, diku mbetur,
 Ose të kërkojë një pushim, në një botë të tretur.
 Dhe vjen së bashku një fjiçz e hollë,
 Zhjytur në një det të kaltër të thellë,
 Hollohet nëpër klube si tymi që shkon fjollë,
 Midis shakash dhe hokash gjithë lezet,
 Se një qytet në flakë është më pak se një zjarr,
 Që ty dhe mua na mban mbi një mangall.*

Alfred Noyes.

Pastaj erdhi një shpërthim në mënyrë krejt të papritur. Dy amerikanë, Eugene Shuileri⁴⁸, konsull i përgjithshëm në Stamboll dhe J.A.MacGahan, një korrespondente gazete, bënë një hetim të kushteve dhe shkruan një seri artikujsh në gazeta, të cilët nxitën më në fund zemërimin e drejtë të Europës. I nderuari Jozef Parkeri, pastor në lagjen *Temple*, Londër, shpërtheu në një prej psallmeve të tij të famshme të së enjtes me: “*Zot, mallkoje Abdyl Hamitin!*”. Ndjenja ishte e tillë që jo vetëm “shërbëtori i Jezu Krishtit” nuk kishte dalë jashtë detyrës së tij para Zotit, por ai ishte brohoritur si mbrojtës i guximshëm, i ndritshëm i fesë.

Rusia ishte e para në fushë me trupat e veta, duke shpresuar që të përvetësonte indinjatën morale që rritej. Në këtë luftë ajo kishte mbështetjen e gjallë të Serbisë, Bullgarisë, Malit të Zi dhe Rumanisë dhe, pjesërisht, mbështetjen morale edhe të Shqipërisë. Turqit u mposhtën në çdo front dhe për të shmangur humbjen e plotë të zotërimeve ballkanike nënshkruan *Traktatin e Shën Stefanit*, i cili i dha Serbisë

⁴⁸ *Eugene Shuiler (Schuyler)* (lindi në 26 shkurt në Nju-Jork, vdiq më 16 korrik 1890 në Venedik të Italisë) ishte studiues amerikan i shekullit të 19-të, shkrimtar, eksplorator dhe diplomat. Ai është përkthyesi i parë amerikan i Turgenjevit dhe Tolstoit. Ai ishte diplomati i parë amerikan që vizitoi territoret ruse në Azinë Qendrore. Në cilësinë e konsullit të përgjithshëm amerikan në Konstandinopojë, ai luajti një rol kyç në nxjerrjen në pah të krimeve mizore turke në Bullgari në vitin 1876, gjatë Kryengritjes së Prillit. Ai ishte ambasadori (titulli në original ‘ministër’) i parë amerikan në Rumani dhe Serbi dhe shërbeu si ambasador edhe në Greqi. (Shënimi im – MB)

dhe Rumanisë pavarësinë, krijoi një principatë të gjerë bullgare, nëpërmjet së cilës Rusia shpresonte të përfitonte daljen në Egje dhe në Mesdhe. Britania e Madhe, me një kërcënim për luftë, e hodhi poshtë këtë traktat dhe kjo bëri të nevojshëm *Kongresin e Berlinit*. Që *Kongresi* ishte i lidhur me shqetësimet më të mëdha, e tregon fakti se çdo qeveri që mori pjesë në atë *Kongres*, dërgoi kryeministrin e vet dhe diplomatët më të aftë për t'i përfaqësuar aty. Britania e Madhe përfaqësohej nga lordi Beaconsfield dhe Salisbury; Franca nga Uadingtoni, Austria nga Andresi, Rusia prej të madhit Gortçakof dhe Shouvalof; Gjermania prej Bismarkut, i cili e drejtoi Kongresin dhe prej Fon Bulou dhe Hohenlohe. Turqia dërgoi Mehmet Aliun dhe Sadullah Efendinë.

Puna e parë që iu desh të bënte *Kongresi*, ishte të anulonte *Traktatin e Shën Stefanit*. Të tjerat erdhën më vonë. Malit të Zi dhe Serbisë iu dha pavarësia, por të ndara nga Sanxhaku dhe Novi Pazari. Bosnja dhe Hercegovina do të “pushtoheshin dhe administroheshin prej Austrisë”. Bullgaria do të bëhej autonome, duke zgjedhur princin e vet, por nën sovranitetin formal të Fuqive. Rumelia Lindore ishte bërë një krahinë autonome nën autoritetin turk, por me policinë e vet dhe me guvernator të krishterë. Novi Pazari, Shqipëria, Maqedonia dhe një pjesë e madhe e Rumelisë (Traka e Lashtë) iu la përsëri turqve, pa kushte apo modifikime.

Veprimet e ndërmarra tregonin strategji të rëndësishme, por edhe padrejtësi të jashtëzakonshme dhe aftësi politike tejet të kufizuara. Këtë e them pa marrë parasysh fatin e zi që i kishin rezervuar vendit të vogël e të pandihmë, Shqipërisë. Përsëri ishte Shiloku, mes tregtarëve, i cili mori vlerësimin më të lartë. Prania e tij midis tyre ishte ende e përdorshme.

Ai korridor midis Malit të Zi dhe Serbisë që ndante dy grupe të së njëjtës racë, gjuhë, fe dhe interesa politike, të dy të favorizuar nga Rusia, parandaloi një bllokim të madh për Rusinë që të shfrytëzonte për veten e saj skajet fundore të Perandorisë. Një tjetër korridor, madje edhe më i rëndësishëm, i cili zgjatej qartazi mospërmas Ballkanit, nga Deti i Zi dhe ana perëndimore e Bosforit deri në

Adriatik, ishte një barrierë shumë e efektshme kundër çdo Federate Ballkanike, e cila mund të përpiquej të hynte në lojën diplomatike europiane e pavarur dhe, në të tyren, provonte ngacmimin më të madh të mundshëm. Përveç këtyre, dhe kjo ishte shumë e rëndësishme, aty gjendej e hershmja *Via-Egnatia* që shtrihej nga Adriatiku në Konstandinopojë, ende e paprekur dhe ende në duart e një fuqie të cilën askush prej tyre nuk ndihej e detyruar ta respektonte. Madje as që pyesnin se cili ishte interesi i saj në këtë katraurë të krijuar. Fuqitë e Mëdha treguan fare pak respekt për integritetin racor të Shqipërisë, duke shkëputur prej saj territoret veriore që iu dhuruan Malit të Zi dhe thuajse një mijë milje katror prej territoreve të saj të jugut që iu falën Greqisë.

I vetmi akt njerëzor që u shënuar në rekordet e *Kongresit të Berlinit*, ishte ngritja e një komisioni për të studiuar kushtet e Shqipërisë dhe Maqedonisë, me qëllim që ato të përmirësoheshin, por... brenda juridiksionit të sulltanatit. Ata do të përpiqeshin t'i vishnin një lëkurë qengji *Pallatit të Ujku*t në Yilldiz, Stamboll. Komisionerët, lordi Fitzmaurice dhe George J. Gosben, Esq, e morën punën shumë seriozisht dhe raportet e tyre mbi kushtet, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e tyre, shkaktuan mjaft bezdi për fuqitë që i sponsorizuan ata.⁴⁹

Fragmenti që vijon, i marrë nga raporti i publikuar, hedh dritë mbi kushtet në Shqipëri. Pas një studimi të plotë të territorit, lordi Fitzmaurice dërgoi telegrame tek qeveria e Madhërisë së Tij, duke i kërkuar që reformat të “zbatoheshin menjëherë në vilajetin e Shkodrës, Janinës, Kosovës dhe Manastirit”. Ky u dërgua më 26 maj 1880. Një muaj më vonë, një telegram tjetër përmbante këtë informacion edhe më befasues:

“Unë kam patur një bisedë këtë mëngjes me kolegët e mi austro-hungarezë në lidhje me Shqipërinë. Ata thonë se është tashmë një firman i nënshkruar dhe vulosur, që pret të publikohet, i cili përmban një Shqipëri të Madhe me rajonet e Kosovës, Manastirit, Shkodrës dhe Janinës”. Më 28 korrik, një telegram tjetër me

49 Korrespondencë në lidhje me ligjin e ri për provincat europiane të Turqisë (*Correspondence Respecting the New Law for the European Provinces of Turkey*), botuar nga Harrison & Son, Londër 1880.

të njëjtën përmbajtje jep këtë informacion: “Popullata shqiptare numëron rreth 2.000 000 shpirt; territori është i ndarë në tri krahina.

I. Shqipëria e Epërme që përfshin:

(a) Shkodrën dhe rajonin malor deri në jug të Malit të Zi dhe në veri të lumit Mat, me një popullsi prej rreth 120 000, shumica e të cilëve janë të krishterë;

(b) Pejën, Gjakovën, Prishtinën dhe rajonin deri në kufirin serb, ku pjesa më e madhe e popullsisë është thjesht muhamedane, me përjashtim të një zone midis Mitrovicës, ku gjendet një numër i caktuar serbësh në Fushë Kosovë. Në këtë rajon ka 400.000 shqiptarë myslimanë dhe 80.000 të krishterë.

II. Shqipëria Qendrore e përbërë prej:

(a) Prizrenit, Dibrës së Vogël, Matit, Krujës, Tiranës, Durrësit, Kavajës, Peqinit, Elbasanit. Këto krahina, së bashku me krahinën e katolikëve, përbëjnë rajonin që njihet në përgjithësi si Gegëria deri në lumin Shkumbin, i cili shënon kufijtë fundorë me Shqipërinë Jugore. Popullata i kalon 500.000 banorët, shumica e të cilëve janë myslimanë.

III. Shqipëria e Poshtme që shtrihet nga:

(a) Lumi i Shkumbinit deri në kufi me Greqinë. Popullsia është thujse njësoj e ndarë midis Kishës Ortodokse Greke dhe myslimanëve dhe numron rreth 800.000 frymë.

Përcaktimi i parë zyrtar i kufijve të Shqipërisë është shumë i rëndësishëm, po të kemi parasysh ngjarjet e mëpastajme, duke nisë me luftërat ballkanike e deri tek luftërat botërore, të cilat i kam trajtuar në shkrimet e mia. Zemërimin e thellë dhe gjithnjë në rritje që shkaktoi në Shqipëri propozimi i bërë për t’u lëshuar pjesë të rëndësishme të territorit të saj fqinjëve të vet, Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, e përshkruan raporti i lëshuar prej të nderuarit Gosben:

“Zemërimi i thellë i shqiptarëve nuk mund t’i mvishet thjesht manovrave turke dhe as të mohohet se është tërësisht i natyrshëm. Duke qenë një racë e lashtë dhe e ndryshme nga çdo racë tjetër që e rrethon, shqiptarët e shohin nacionalizmin e fqinjëve të tyre të jetë vendosur nën mbrojtjen e fuqive të ndryshme europiane, ndërsa aspiratat e tyre për pavarësi, të jenë trajtuar, po prej tyre, si çështje të një rëndësie të dorës së dytë... Sigurisht që janë propozuar shkëmbime terroresh por, më në fund, këto kanë rënë në kurriiz të shqiptarëve dhe këtyre u është dashur të sakrifikohen në përfitim të sllavëve dhe grekëve, pa marrë parasysh asnjë nga parimet e kombësisë”.

Por edhe pse ishte kështu, shqiptarët vetë nuk ndejtën duarkryq. Fillimisht në jug, toskët i bënë thirrje tërë botës në emër të Epirit dhe tërë Shqipërisë:

“Ne protestojmë dhe deklarojmë solemnisht përpara Zotit dhe njerëzimit, se Epiri i Lashtë ose Shqipëria e Poshtme, Epiri i Ri ose Shqipëria e Mesme, Shqipëria e Epërme ose Gegëria, janë të gjitha aq të njëjlojta në qenien e tyre shqiptare, sa ç’është territori që zotërojnë në rrjedhë të të tëra kohërave, qysh kur mbahet mend prej njeriut, dhe asnjë popull tjetër nuk i ka patur ato në zotërim. Ne betohemi në gjakun e të parëve tanë dhe mbi shpatën e pathyeshme të heroit tonë kombëtar, mbretit Skënderbeg, se ne dhe bijtë tanë do të dimë se si ta zotërojmë atë me po atë përkushtim si të vetë baballarëve tanë, do ta zotërojmë atë të paktën deri sa në zemrat tona të rrahë kujtimi i atij gjaku”.

Më pas, një këshill i gjerë kombëtar i tërë udhëheqësve shqiptarë u thirr në Prizren dhe kështu u themelua *Lidhja e Prizrenit*. Ajo është një histori tejet drithëruese; përballë Fuqive dhe Turqisë, ata kundërshtuan me aq këmbëngulje dhe shpirt sakrificë propozimin për lëshimin e territoreve të tyre te fqinjët e vet, saqë, më në fund, u bënë modifikime të qenësishme. Në thirrjen e tyre drejtuar Fuqive ata thoshin pjesërisht kështu:

“Ne jemi gjykuar gjithmonë padrejtësisht. Arti djallëzor i qeverisë turke, duke iu frikësuar tërë kohën bashkimit të fiseve tona dhe rikthimit të pavarësisë së vendit, ka ndezur me thashetheme famëkeqe mosmarrëveshjet tona, ka rizgjuar xhelozitë e fjetura, i ka fryrë zemërimin të ndarjes, ka përfituar prej prerjes dhe grabitjes së

burimeve tona njerëzore dhe monetare, e ka bërë këtë vend të bukur një kamp të përgjakur trazirash”.

Në deklarinimin përfundimtar të çështjes, lordi Granville, kryeministri i Qeverisë Britanike të Madhërisë së Tij, mori drejtimin duke propozuar që t’i lëshohej një ultimatum Turqisë, duke i kërkuar asaj që brenda tri javësh shqiptarët t’i dorëzonin Malit të Zi bregdetin prej Tivarit deri në lumin Bunë, duke përfshirë kryeqytetin e lashtë ilir të Ulqinit, si dhe Podgoricën, Zhabjakun, Fundinën dhe territorin e fisit të Trepshit. Austria protestoi kundër kërkesave të këtij ultimatumit ashtu siç ishte formuluar prej qeverisë britanike por, më në fund, iu bashkua asaj. Më 28 qershor 1880, ultimatumit iu paraqit *Portës së Lartë* prej ambasadorit britanik dhe, në të njëjtën kohë, një flotë britanike qëndroi jashtë portit të Ulqinit për të ekzekutuar me topa dhe të shtëna kërkesën e vënë përpara këtij kombi jetim që po e tkurrnin në mënyrën më të padrejtë dhe të pamëshirshme.

Shqiptarët, të ballafaquar me forcat e bashkuara të Fuqive të Mëdha të Europës, tërhoqën nga territoret e tyre të kërkuara jo vetëm forcat e tyre luftarake, por gjithashtu edhe popullatën, e cila migroi në masë, për të mos rënë nën zgjedhën e sundimit malazez. Abdyl bej Frashëri, themelues dhe president i Lidhjes së Prizrenit, si dhe shumë udhëheqës të tjerë, bashkëpatriotë të tij, u arrestuan dhe u burgosën prej qeverisë turke, ku u mbajtën deri në vdekje.

“Ligësi, bëhu ti e mira ime!”



“UNË JAM KAQ I LUMTUR QË DO TË NA TREGONI PËR ATA NJERËZ TË ÇUDITSHËM ME FLOKË TË BARDHA DHE SY TË SHNDRITSHËM! PËR HIJET E HOMERIT DHE TË ALEKSANDRIT TË MADH! DHE... LE TË MOS NGUTEMI... A JANË MADHËSHTORË ATA? SI KANË ECUR ATA JO VETËM “ME MBRETËRIT”, POR SI U KANË DHËNË TË TJERËVE NJË NUMËR TË MADH SUNDUESISH KOMBESH DHE PERANDORISH? KJO ËSHTË NJË HISTORI QË IA VLEN TË TREGOHET, PASI EDHE VETË SHQIPTARËT, SI EDHE PJESA TJETËR E BOTËS, NUK E DINË.”



VIII



SHQIPJA – SHQIPËRIA – SHQIPONJAT – SHQIPTARËT

Shqipërisë i nevojitet më shumë një përkthyes sesa një historian. Karlile e shpreh mendimin e vet mbi historinë më shumë se me fjalë.

“Ah, çfarë malesh të hirta, të vdekura! Eshtra të djegura, të fundosura në thellësinë e filozofisë historike!”

Shlimani (Schlieman)⁵⁰ gërmon në “male të hirta eshtrash të djegura” dhe i vë emrin “Trojë”. Por, kur mundohemi të mësojmë për Trojën, për rrugët e gjera të saj, instinktivisht kthehemi tek Homeri dhe Herodoti për të përdorur “formën e tyre rrëfimore të historisë”.

⁵⁰ *Hainrih Shlimani (Heinrich Schliemann)*, (6 janar 1822 – 26 dhjetor 1890) ishte afarist dhe arkeolog gjerman. Ai ishte mbrojtës i realitetit historik të vendeve që përmenden në veprat e Homerit. Shlimani kreu gërmime arkeologjike në Trojë, si edhe në qendrat arkeologjike *Mycenae* and *Tiryns*. Me kontributin e tij, ai e forcoi edhe më shumë idenë se *Iliada* e Homerit dhe *Eneida* e Virgilit pasqyrojnë zhvillimet historike aktuale. (Shënimi im – MB)

Duke i hyrë rrëfimit të kësaj historie të *Shqipërisë*, e gjej veten në një lloj detyrimi moral. Gjatë tridhjetë vjetëve unë i kam bërë vetes pyetje të tilla si këto:

“Kush janë shqiptarët? A janë grekë? A janë sllavë? A janë të afërt me turqit? A kanë gjuhë të tyre? Prej nga vijnë ata?”. Pastaj shumë shpesh dikush më lutet të jap disa leksione, të cilat unë jam gati t’i jap, dhe ai më thotë:

“Unë jam kaq i lumtur që do të na tregoni për ata njerëz të çuditshëm me flokë të bardha dhe sy të shndritshëm! Për hijet e Homerit dhe të Aleksandrit të Madh! Dhe... le të mos ngutemi... A janë madhështorë ata? Si kanë ecur ata jo vetëm “me mbretërit”, por si u kanë dhënë të tjerëve një numër të madh sunduesish kombesh dhe perandorish? Kjo është një histori që ia vlen të tregohet, pasi edhe vetë shqiptarët, si edhe pjesa tjetër e botës, nuk e dinë”.

Për shkak se ata vijnë aq natyrshëm në rolin e tyre epik, unë dëshiroj të rindërtoj skenën ku shpaloset drama e tyre e jetës. Por, po t’i krahasoja ata me gjendjen e tyre të sotme, kjo do të ishte mizore. Ndërsa po të zbatoja standardin e *Almanakut Botëror*, kjo do të ishte e shëmtuar.

Të bësh një paraqitje komike të kushteve të tyre të prapambetura, të veçorive të zakoneve të tyre dhe të luash dhe të qeshësh me ta, siç është bërë kaq shpesh prej gazetarëve endacakë dhe shkrimtarëve të revistave amatore, është gjë e turpshme. Ka edhe një stil tjetër:

Ai i agjentëve politikë të propagandës.

Puna për të cilën ata paguheshin, ishte të diskreditonin çdo gjë për të cilën kjo racë krenohet: karakteri, virtytet, qëndrimet e tyre të gabuara dhe pretendimet për jetën e tyre, e drejta e tyre e dhënë prej Zotit për të jetuar si pjesëtarë pa pretendime të familjes njerëzore.

Këtu në Amerikë ata që lexojnë, nuk merren kaq shumë me gjëra të tilla, por pa kthehu dhe jeto në Ballkan, dhe do të shohësh se kjo është një gjë krejt tjetër.

Ezopi ka një fabul, e cila më vjen në mend:

“Qeni ia kishte futur gjumit në grazhdin e kaut dhe i lehte dhe përpiquej ta kafshonte sa herë kau i qasej grazhdit, me shpresë se do të hante tallën e vet”.

Në rastin më të mirë, ajo që do të tregoj, do të duket e çuditshme dhe, për shumë vetë, një histori e pabesueshme. Ndoshta unë mund të gjej vend ku të fshihem në thënien:

“Është e habitshme, por e vërtetë, sepse e vërteta është përherë e çuditshme, më e çuditshme se sa trillimi”.

Në kërkim të një gjendjeje prej nga ta filloj detyrën time, ndoshta nuk mund të bëj asgjë më shumë se sa të citoj nga Kristofer Morleji, i cili përshkruan një skenë në një *Quakers Meeting House*⁵¹ në Oksford:

“Një vajzë shtëpiake e turpshme u ngrit papritmas pas njëfarë heshtjeje. Ishte një mëngjes i lagësht pranveror me ajër aromatik. Zëri i saj dridhej nga tmërri, por ajo ia doli të thërrasë:

“Unë mendoj për qiellin, pemët dhe hijen e tyre, erën dhe aromën e çdo gjëje”.

Ndërsa unë do të shtoja:

“...Unë mendoj për malet, të ashpra e të vrazhda, për majat dhe shpatet e tyre të zbuluara para diellit, reve, furtunës dhe vetëtimave përcëlluese... për fëmijët që kapen pas gjirit të tharë dhe të shterur, pa strehë dhe siguri, pa ushqimin e nevojshëm që dëshirojnë...Mendoj për tërë kujtimet dhe ditët gjysmë të harruara, kur një dritë e habitshme i lante ato në një bukuri të thjeshtë, me muzikën e largët të Memnonit⁵², e cila ngjizej në katër nota, përkundrejt furtunës së lindjes dhe perëndimit të diellit

⁵¹ Quakersat i bashkon një mënyrë të jetuari, sesa një seri besimesh fetare. ‘Ne duam që ta përjetojmë Zotin drejtpërdrejt, brenda vetes dhe në marrëdhëniet me të tjerët dhe botën që na rrethon’. Në këto takime të drejtpërdrejta me Zotin e gjejnë quakersat kuptimin dhe qëllimin e jetës. (Shënimi im – MB)

⁵² Shën Memnoni (*Saint Memnon the Wonderworker*) — shenjtor i hershëm i krishterë nga Egjipti, në një nga manastiret egjiptiane. (Shënimi im – MB)

dhe rënies së tmerrshme të fuqisë.”

Janë shqiptarët dhe malet e tyre.

“Njerëzimi duhet të shihet si një pjesë e rendit natyror dhe jo si i ndarë dhe i vendosur mbi të”.

Kjo thënie është e vërtetë për shqiptarët në kuptimin e vet më të veçantë. Ata janë njerëz të malit. Malet kanë qenë mburoja dhe fortesa e tyre kundër mësymjeve të popujve, kulturave, ideologjive, sistemeve politike, qytetërimeve, feve të tjera që i zinin vendin njëra-tjetër; ata kanë shpërthyer nëpërmjet barrierave të tyre malore dhe janë tërhequr vetëm sa për t'u ngritur dhe për t'ia nisur përsëri në rrjedhë të mijëra vjetëve. Si njerëz të maleve, ata i kanë dhënë vetes një emër. Jo një emër që u është imponuar nga të huajt. Për shembull, *Albania*, siç e dimë të gjithë, vjen prej rrënjës latine *Alb* – i bardhë. Emri i tyre ka një kuptim të thellë, ka një përmbajtje shpirtërore, është i qëndrueshëm për të gjithë ata që e mbajnë, është më i thelli, më i besueshmi në karakterin e tij.

Një emër aq i shenjtë dhe i rëndësishëm për ta, sa ai i Jakobit, në *Vaun e Jakobit* ⁵³ prej engjëlillit me të cilin ai u kacafyt gjatë tërë natës. Ai emër është *Shqiptar*, që do të thotë *njeriu-shqipe*. Fjala për shqipen është *shqiponjë* dhe *Shqipëri* do të thotë *Toka e Shqipeve*. Ata kanë një këngë shqiponje që është kthyer në një farë himni kombëtar midis njerëzve të maleve. E perifrazuar ajo është si vijon:

“Shqiponja është shpendi më i fuqishëm që fluturon në qiell, prandaj ajo quhet mbretëresha e shpendëve. Nuk ka shpend që ta sulmojë shqiponjën. Ajo është mbi çdo shpend tjetër, siç është luani mbi tërë qeniet mbi tokë. Ajo fluturon shumë lart në qiell dhe kur e sheh një zog poshtë, zbrat pikthi nëpër ajër, si një fishek mbi të dhe i ngul

⁵³ Lumi Zarka (*The Zarqa River*) është degëzimi i dytë më i madh i lumit Jordan, pas lumit Yarmouk. Ai është lumi i tretë në rajon për nga sasi të derdhjes vjetore dhe kalon në njërin nga zonat me popullsi më të dendur në lindje të lumit Jordan. Niveli i tij rritet në afërsi të Amanit dhe më pas kalon nëpër një luginë të thellë e të gjerë (që identifikohet me lumin biblik Jabok) drejt Jordanit, 1 090 metra më poshtë. Ky lumë është shumë i ndotur dhe restaurimi i tij është një ndër përparësitë kryesore të Ministrisë së Mjedisit të Jordanisë. Gjeologjikisht lumi Zarka është krijuar para rreth 30 milionë vjetësh. Origjina e këtij lumi është *Ain Ghazal*, një qendër e madhe arkeologjike që daton në periudhën neolitike. Zbulimet arkeologjike përgjatë rrjedhës së lumit tregojnë se flora dhe fauna e kësaj zone ka qenë dikur e pasur. (Shënimi im – MB)

kthetrat në gjoks dhe e shqyen » .

Tërë shpendët e tjerë e njohin dhe i frikësohen shqiptonjës. Kur e shohin atë në krah, mbeten vërtet të pashpresë. Shqiptonja e ndërton folenë e saj në malet e larta, mbi shkëmbinj dhe gurë. Është kjo arsyeja përse e thërrasim veten shqiptarë, sepse jemi heroikë, të fuqishëm si vetë shqiptonja. Edhe gjuha jonë është quajtur shqip, sepse ne flasim gjuhën e shqiptonjës. Çdo sfidë që pranon shqiptari, është një provë që e bën vetëm shqiptonja. Dhe për këtë ai ndihet shumë krenar. Ai, si shqiptonja, e sheh diellin drejtpërdrejt, pa i kapsallitur sytë. Në të njëjtën mënyrë e sheh ai mikun dhe armikun, pa marrë parasysh se çfarë rangu ka në shoqëri. Shqiptarët thonë:

“Mali me malin nuk takohet, po njerëzit takohen një ditë”. Me fjalë të tjera, ata nga karakteri nuk janë imitues të të tjerëve, nuk pretendojnë, nuk «përzihen», por qëndrojnë veçmas dhe individualisht, njësoj si malet e tyre.

Mua më pëlqen kjo që thotë Tomas Karlile⁵⁴:

«Ligji më i lartë i kulturës është: lëre tjetrin të bëhet ai që është krijuar i aftë për të qenë: lëre të shtrihet, nëse mundet, deri në hapësira pafund; rezistoj tërë pengesave dhe flaki tutje tërë të huajt, veçanërisht ata me qëllime të mbrapshta, duke e treguar veten se kush je në pamje, në brendi dhe në formë, cilado qoftë ajo”.

A thua t'i ketë patur parasysh shqiptarët kur i ka shkruar këto rreshta?

Që kjo sjell keqkuptim, fyerje, hasmëri, është e pashmangshme. E tërë loja politike moderne është e huaj dhe e padurueshme për natyrën e shqiptarëve. Në të vërtetë, duhet theksuar gjithsesi se një numër gjithnjë në rritje i udhëheqësve të tyre politikë, që i kanë mësuar dinakëritë në shkollat e diplomacisë turke ose në shkollat hipokrite europiane, tani i nxënë shumë shpejt të gjitha klishetë e

⁵⁴ *Tomas Karlile (Thomas Carlyle)*, (4 dhjetor 1795 – 5 shkurt 1881), shkrimtar satirik skocez, eseist, historian dhe mësues në peirudhën 'viktoriane'. Ai e quante ekonominë *shkenca e zymtë (the dismal science)*. Tomas Karlile shkroi disa artikuj në *Edinburgh Encyclopedia*, dhe ngjalli debat me komentet e tij sociale. (Shënimi im – MB)

profesionit. Madje, shumë herë ata ua kalojnë edhe instruktorëve të tyre.

Megjithatë, ajo që ndodh ndonjëherë është se ndonjë prej këtyre djemve të mençëm, edhe pse mund të jetë shumë i zgjuar dhe i vyer për vendin e vet, me të gjetur një vend më të sigurtë për të jetuar jashtë, pas studimeve qëndron atje, në vend që të kthehet midis të afërmeve të tij dhe të shqiptonjës. Aty ka përherë një inat ndaj atyre që për një fitim të vetin, e lënë follenë e tyre.

BESA SHQIPTARE

Këtu ndoshta është koha dhe vendi më i mirë për të paraqitur shkurtimisht një prej cilësive themelore të karakterit shqiptar. Ajo që është më themeloria, do të thoja, dhe që shkon më thellë në histori se feja e tyre, më larg se interesi i tyre vetjak ose familjar, dhe më thellë se vetë jeta, është fjala e nderit, pra *BESA*⁵⁵. Nëse nderi i shqiptarit vihet në dyshim, ai jep jetën për ta mbrojtur atë. Aty nuk ka diskutim. Rreth kësaj nuk ka 'PO' ose 'JO'. Ai nuk mund të qëndrojë në shtëpinë e tij si baba, bashkëshort apo si djalë, nëse nuk e respekton këtë. Gruaja, nëna ose fëmijët e tij nuk do ta falin kurrë. Ai nuk mund të vazhdojë jetën si pjesëtar i fisit, nuk mund të dalë e të shihet në fshat apo në një rrugë malore, derisa ose deri kur ai ta ketë vënë nderin në vend. Nëse nuk ndodh kjo, edhe vetë malet do të çirreshin kundër tij. Kaq e rëndë është pesha e kësaj fjale të shenjtë për ta, e quajtur: *BESË*.

Besa shqiptare është bërë kaq e njohur në tërë Ballkanin dhe Lindjen e Afërme, saqë është kthyer në një pasaportë kombëtare kudo që shqiptari vendos të shkojë. Thuajse pa asnjë përjashtim, rojet e bankave, legatave apo ambasadave, rojet e personave të zyrave të larta të cilëve u është besuar një mision sekret apo përgjegjësi, janë shqiptarë. Që prej kohëve kur u organizua më së pari legjioni i jeniçerëve që ruanin sulltanin, rreth pesë shekuj më parë, ishin shqiptarët që i zotëronin ato rangje. Kaq keq u përdor besnikëria e tyre, saqë sulltanët u treguan të pafytyrë dhe i dërgonin ata kundër popullit të vet në mënyrë aq të panatyrshme, me qëllim që t'i mposhtnin kryengritjet e tyre, duke e ditur se ata ose do t'i

⁵⁵ Shqip në original.

shkonin deri në fund çdo çështjeje, ose do të sakrifikonin veten. Abdyl Hamiti, i njohur si “*Sulltani i kuq*” për krimet e tij të tmerrshme gjakatare, ia doli të sundonte një perandori të mbushur me trazira pafund për tridhjetë e tre vjet dhe të mos i hynte gjembi në këmbë, falë mbrojtjes që i ofronin dyqind truprojet shqiptare.

Kjo është diçka që shkon thellë në rrënjët e jetës së kombit. Një herë e pyeta një mikun tim, i cili kishte humbur shumë prej borxheve të këqija. Me një pamje prej njeriu zemërbutë, i habitur nga pyetja që po ia drejtonte dikush që i dinte gjërat më mirë se ai, u përgjigj se nuk mbante mend të kishte humbur gjë. Ky diskutim u pasua nga një ngjarje e cila më bëri shumë përshtypje.

Një malësor fshatar, i veshur me tesha të vjetra, thuajse i mbuluar me arna, por i pastër, erdhi dhe e pyeti tregtarin nëse ai mund t’i jepte hua pak farë misri. Ai i tha tregtarit emrin e vet dhe të fshatit, dhe i shpjegoi se si thatësira e vitit të kaluar kishte qenë aq e keqe dhe drithi ishte bërë aq kokërrvogël, sa nuk bënte për farë. Veç asaj, atij i ishte dashur që edhe atë farë që e kishte ruajtur për ta mbjellë në pranverë, ta përdorte për ushqim, pasi kishte pllakosur zia e urisë. Ai i premtoi se sapo të kornte drithin e ri, do të ishte tregtari i pari ai që do të merrte hakun e vet. Unë nuk vura re asnjë ngurrim, as të bëhej ndonjë pyetje apo të kërkohej ndonjë farë garancie. Tregtari e dha drithin. Fshatari e mori dhe iku.

Rastisi që në vjeshtë, ndërsa po rrija tek dyqani i këtij tregtari, një malësor që më ngjau si i njohur, erdhi dhe hyri brenda. Ai përshëndeti me fjalët *Tu-ngjat-jeta*⁵⁶. Pas shkëmbimit të zakonshëm të përshëndetjeve dhe pyetjeve, ai nxori nga xhepi një portofol, e zbrazi nga monedhat, i numëroi dhe i lëshoi në tavolinën e tregtarit. Ishte po ai që kishte marrë hua drithin dhe tani po e paguante borxhin të tërin. Tregtari i çoi fjalë *kafexhiut*⁵⁷, i cili solli tre filxhanë me kafe për të nderuar malësorin dhe mua që u ndodha aty. Folëm thjesht dhe rehatshëm për shumë gjëra, ndërsa po rruftnim kafetë. Pastaj me një përshëndetje tjetër, ai u ngrit dhe u largua nga dyqani me ndjenjën e lehtësimit moral.

⁵⁶ Shqip në original.

⁵⁷ Shqip në original.

Në tokën e shqiponjës gjëra të tilla kanë përparësi ndaj çdo gjëje tjetër.

Ja dhe një ngjarje tjetër shumë e thjeshtë, por shumë kuptimplote. Një mëngjes dikush trokiti në derën e jashtme të oborrit rrethues të shtëpisë ku banonim. Shkova dhe e hapa derën, kur pashë aty një fshatar të panjohur tek priste. E ftova të hynte brenda, por ai kërkoi ndjesë, duke më thënë se kishte ardhur për pazar dhe se shtëpia e tij ishte nëntë orë larg në male. Pastaj më tha diçka të çuditshme:

“Unë kam diçka tuajën. E gjeta atje larg në male para disa ditësh. E kam ruajtur deri sa të vija e ta sillja vetë. Ja ku e ke !”, - më tha dhe nxori nga xhoka e tij gazetën *London Times*.

Diku dhjetë ditë më parë, unë kisha bërë një udhëtim me kalë nga Manastiri. Për këtë m'u deshën shtatë ditë udhë. Konsulli britanik më kishte dhënë disa gazeta angleze për t'i lexuar gjatë rrugës. *London Times* ishte një prej tyre dhe kur e mbarova së lexuari, e hodha në një shkurre në anë të malit. Shqiptari e kishte parë atë. Ai ishte tërësisht analfabet, por dinte diçka të rëndësishme, që ajo i takonte një njeriu tjetër, një *amerikani* nga Tirana, siç më quanin, dhe që sipas tij, vetëm ai e lexonte atë. Nuk e di se çfarë kishte menduar ai me vete. Është e lehtë të merret me mend se ai nuk ia dinte vlerat gazetës, por me siguri ai dinte vlerat e nderit të vet. Pikërisht në nderim të qenies së vet, ai mendoi se gazeta i duhej dorëzuar pronarit që e kishte.

A i ofrova unë diçka atij për këtë shërbim? Nëse do ta bëja këtë, do ta fyeja shumë rëndë. Shpërblimi për të ishte fakti që ai e kishte dorëzuar këtë në dorën time dhe unë e respektova për këtë deri në përunjësi. E ftova brenda, pimë kafe së bashku, pastaj u përshëndetëm dhe ai iku. Dera e rëndë e oborrit që u mbyll sapo ai doli, mbylli edhe siparin e asaj skene me aq vlera të larta morale të këtij shqiptari dhe shënoi herën e fundit, që ishte edhe e para, që unë e pashë atë njeri. Dhe unë kam medituuar me nderim dhe respekt të veçantë për atë dhe shumë të tjerë të racës së tij që janë si ai. Ky nderim është rritur ndër vite, duke më kujtuar fjalët e të Madhit:

“Qëndroji besnik gjërave të tua, ndërsa unë do të sundoj mbi shumë gjëra të tjera!”.⁵⁸

58 *Bibla* sipas Mateut.



SIKUR TË KISHA KËRKUAR TË IKJA NGA AMERIKA NË KËRKIM
TË NJË STREHE QË TË ISHTE KAQ LARG NGA QYTETËRIMI, TË
BRAKTISJA TËRË KËNAQËSITË, SHTROJËN E BUTË TË JETËS,
JETËN QË BALLAFAQOHET ME URINË, TË FTOHTIT, MUNGESËN
E VESHJES DHE NEVOJAT MË ELEMENTARE TË SAJ, MARRË NË
TËRËSI, UNË NUK DO MUND TË BËJA DIÇKA MË TË MIRË SESA TË
ZGJIDHJA SHQIPËRINË.



IX



BOTË E ÇUDIRAVE

“Do të doja të isha më mirë i paditur, se sa i pajisur me zgjuarsinë dhe parandjenjën e djallit”.

Akili

Tirana, në zemër të Shqipërisë, një qendër e fortë muhamedanësh, një qendër e fortë myslimane, qendër e ndikimit dhe propagandës turke, ishte zgjedhja ime për t’u vendosur dhe, duke parë se nuk kishte kthim prapa, Kenedët dhe stafi shqiptar u pajtuan me këtë zgjedhje timen.

Më 1 tetor 1908, zoti dhe zonja Kenedi, z. Cilka dhe pesë Eriksonët i paketuan gjërat dhe bashkë me to nëpër karroca nisëm udhëtimin për në Tiranë. Në fakt nuk po ecnim as drejt veriut dhe as drejt perëndimit, siç mund të tregojë busulla, por drejt portit të lashtë të Sarandës. Arsyeja ishte e thjeshtë. Ajo ishte e vetmja rrugë që mundësonte karrocën me katër rrota ; do ecnim drejt bregdetit ku mund të merrnim një avullorë drejt Durrësit, porti ku donim të arrinim. Rruga tjetër do të kërkonte

kuaj që do të kalonin nëpër shtigje të ngushta, në lartësira malore jashtëzakonisht të rrezikshme. Ne ecnim dhe nuk e dinim ende se kur do të arrinim. Katër ditë udhëtim, për njëqind e njëzet e pesë milje në vijë ajrore. Udhëtimi bëhej thuajse vetëm atëherë kur ishte dritë. Kishte vende ku rruga thuajse zhdukej fare ose kur duhej të truponte lumenjtë pa ura, por nëpër va. Natën flinim në hanet vendase, në dhoma që ishin sipër stallës së kuajve. E diela ishte e fundit, por më e keqja ditë. Z. Kenedi ishte detyruar të binte në gjynah, pasi prerazi nuk pranoi të ndërprisnin udhëtimin njëzet e katër orë para *Sabatit*. Ai ishte aq i mpirë dhe i mërzitur, saqë as përshëndetjes sime të mëngjesit nuk iu përgjigj. Në fakt, gjynahu, pas tërë gjërave të tjera, gjendej në kokën tonë. Ushqimi ishte shumë i paktë dhe uji i pijshëm me shumë kursim, pasi ishte vështirë ta gjenim.

Arritëm në Sarandë në orën gjashtë të mbrëmjes, në një han ku morrat dhe papastërtia ishin të tmerrshme. Ushqimet që na ofruan, nuk i pranonte stomaku ynë. Kjo bëri që të merrnim një barkë dhe të iknim në Korfuz. Varkëtari na siguroi se për një orë e gjysmë, më së shumti dy, do të ishim atje. Lundruam deri sa arritëm matanë detit, të nesërmen në mëngjes në orën dhjetë. Tërë fëmijët i kishim me vete ; ata as kishin ngrënë, as pirë që në pasditën e kaluar kur kishim lënë portin. Po Korfuzi ishte qiellor me pastërtinë, ushqimin dhe pamjen e vet. Që prej asaj kohe, unë kam kaluar shumë muaj të jetës sime në atë ishull dhe kam ndier përkëdhelitë e tij, siç më pëlqen të them, pasi në të kishte diçka prej brishtësisë dhe dashurisë së gjithanshme. Në mbrëmje i hipëm barkës dhe u nisëm për në Vlorë, prej nga të nesërmen duhej të merrnim një barkë tjetër për Durrës. Në Durrës arritëm në orën dy të pasdites. Aty u ankoruam larg nga bregu. Një lundër erdhi e na mori me tërë bagazhet dhe na nxori në skelën e ndërtuar me drurë të ashpër, të pagdhendur. Asnjëri prej nesh nuk kishte qenë aty ndonjëherë. Ishte si një vend i çuditshëm edhe për vetë zotin Cilka. Ne mezi po duronim deri sa të vinte koha për t'u rehatuar dhe kaluar natën. Pastaj u dëgjua një zë i butë që na u drejtua në gjermanisht:

*Guten Abend*⁵⁹. Ai që foli, ishte një djalë i ri shqiptar, i cili kishte disa vite që jetonte në Kajro, por që tani ishte me leje në shtëpi. Pasi mori përsipër përkujdesjen ndaj nesh, ai na kaloi nëpërmjet doganës, na çoi në shtëpinë e tij për të kaluar natën e më pas tek një restorant ku kishte porositur për ne ushqimet më të mira të mundshme.

Mëngjesin tjetër gruaja dhe fëmija mbetën në shtëpi, ndërkohë që pjesa tjetër e jona, përfshirë edhe mikun tonë të ri, Konstandin Hortovën, mori rrugën për në Tiranë. Atje arritëm në orën pesë e gjysmë. Ishte një largësi prej dyzet kilometrash. Cilka u rrëzua dy herë nga kali, ndërsa zoti Kenedi ra përmbi jelën e kalit kur po hynim në pazarin e qytetit. Dita e mbërritjes sonë ishte e enjte 8 tetor 1908, ose dy muaj e shtatë ditë që nga dita kur u shkëputëm nga gjiri i Bostonit. Udhëtimi Durrës – Tiranë tani bëhet rehat – rehat për pesëdhjetë minuta.

Duke iu kthyer muajve që kalova në Shqipëri, sa nga kujtimet, sa nga ditarët e shkurtër që kam mbajtur, mund të them se nuk pashë gjëra të veçanta që të bëjnë përshtypje shumë të madhe. Binte në sy fakti që zona të tëra, të gjera, të vendit dukeshin tmerrësisht të shkreta, të egra, xanxare dhe të paprekura prej artit të jetës së qytetëruar. Lumenjtë vërshonin të harbuar prej ujërave të mbledhura prej përrrenjve malorë dhe shpërndareshin mbi fushat dhe luginat, duke përmbytur mijëra hektarë të një toke aq pjellore, sa po të kultivohej, do t'ua ndryshonte jetën dhe do t'ia hiqte urinë të paktën një të tretës së popullsisë. Ky shkretim i natyrës kishte ndikim mbi tërë format e jetës, mbi qentë, macet, delet, lopët, kuajt, mbi njerëzit, burrat, gratë dhe fëmijët. Kjo dëshmonte qartë se jeta ishte e para dhe e fundit, se me të luftohej veçse për ekzistencë ose, po të përdorim fjalët e Jobit “*ata e mbështillnin veten në vetminë e përpjekjeve për të jetuar*”.

Sikur të kisha kërkuar të ikja nga Amerika në kërkim të një strehe që të ishte kaq larg nga qytetërimi, të braktisja tërë kënaqësitë, shtrojën e butë të jetës, jetën që nuk e njeh urinë, të ftohtët, mungesën e veshjes dhe nevojat më elementare

⁵⁹ Mirëmbërëma! (gjermanisht).

të saj, marrë në tërësi, unë nuk do mund të bëja diçka më të mirë sesa të zgjidhja Shqipërinë. Kjo u duk sheshit që javën e parë të qëndrimit tonë në Tiranë. Miqtë tanë, Kenedët dhe Cilkët, nuk kishin ç'bënin më me ne. Ata mbrehën kuajt dhe karrocat dhe u kthyen në Korçë.

Udhëtimi nëpër Sarandë, Vlorë, Durrës e pastaj Tiranë që mori më shumë se një javë, u shoqërua me parehatinë e patregueshme nëpër hanet e pista mbushur me morra. Atyre u lipsej edhe një javë tjetër deri sa të ktheheshin në “ishullin e bekuar”, dhe unë jam i sigurtë se “bretkosat” e Aristofanit do të kishin “kuakur” edhe më fort kur të shihnin atë që pamë ne.

Kjo situatë, gjatë viteve të para na bëri të vuajmë më shumë se ç'mund ta tregojnë fjalët. Për fatin tonë të mirë, kur pala e Korçës iku, nuk mbetëm fare vetëm. Konstandin Hortova vendosi të kalonte me ne sa më shumë nga ditët e pushimeve. Kjo ishte e vështirë edhe për të, edhe për familjen e tij. Ai kishte qëndruar larg shtëpisë së vet për dhjetë vjet dhe mund të kalonin edhe dhjetë të tjera deri sa ai të kthehej përsëri pranë familjes. Në fakt, lidhjet mes pjesëtarëve të familjeve shqiptare janë shumë të forta.

Ai qëndroi edhe ca ditë dhe më pas na dha lamtumirën, mori avulloren dhe u kthye. Por, a mund të harrohet ndihma që ai na dha? Gjëja e parë që bëri, na siguroi një shtëpi beu, në të cilën ai kishte jetuar dikur dhe me një qira shumë të arsyeshme. Ajo ishte e re dhe nuk kishte parazitë. Shkuam aty sapo ajo u lirua. Hani ku kishim qëndruar ishte i tmerrshëm, shumë i keq për një burrë, por edhe shumë më i keq se aq për një familje. Rastësisht ajo shtëpi e parë që lloji të ishte edhe më e mira që patëm gjatë viteve që kaluam në Shqipëri. Ajo ishte e vendosur në *Rrugën e Dibrës*, një rrugë kalimi me një rrjedhë uji të freskët malore që rridhte prej shkëmbinjve të malit të Dajtit. Shtëpia kishte dy kate, me një dhomë të madhe ndenjeje në katin e parë. Kati i parë ishte i pamobiluar, përveç selamllëkut⁶⁰ apo dhomës së burrave, e cila shihte nga porta që hapej në një rrugicë të ngushtë. Përballë ishte një mur

⁶⁰ Turqisht në original.

guri solid, i lartë, deri tek kati i dytë. Duke qenë se ishte pasuri e një beu mysliman, të tëra dritaret ishin të mbuluara me grila, nëpërmjet të cilave mund të shihje nga brenda jashtë, por jo edhe nga jashtë brenda.

Shtëpia rrethohej prej një muri qerpiçi. Rreth tij kishin mbirë shumë barëra të egra. Aty kishte gjëra të hedhura, poçerina, gjëra të papërdorshme dhe plehëra të çdo lloji. Por ne u rehatuam aty pa humbur kohë. Nuk kishim shumë gjëra për të lëvizur, pasi pajisje shtëpiake nuk kishim. Ato ishin nisur me kontenierë nga Sjatëlli nëpërmjet Kinës, Indisë, Kanalit të Suezit, Mesdheut, Selanikut, prej nga *Misioni Amerikan* duhej t'i kalonte sërish me det tek ne në Durrës. Ato arritën në marsin e vitit pasardhës. Për ta bërë të plotë tablonë e largimit tonë nga qytetërimi, unë nuk e kisha llogaritur mirë atë që familja ime nuk do të bënte dot pa gjëra të tilla si krevatët, tavolinat, karriget, stufa, enët e kuzhinës, pjatat, sendet e argjendit dhe takëmet e linjta të shtratis, batanijet, llampat, perdet e dritareve, qilimat dhe tapetet dhe, më së fundi, por në asnjë mënyrë të parëndësishme, pajisjet për ngrohje, banjot dhe pajisjet sanitare për tualet. Disa gjëra të thjeshta të nevojshme gjendeshin në pazarin e qytetit, por, qëkurse gjërat tona ishin në udhëtim dhe fondet tona ishin të pakta, ne nuk blemë asgjë më shumë se artikujt më të domosdoshëm.

Por kufizimet tona nuk përfundonin as këtu. Një ndër problemet më serioze ishte gjuha. Pastaj vinte mënyra se si trajtoheshin bagëtitë e prera, mish i tyre i ekspozuar në natyrë, i varur në çengelë, mbushur me miza, grenza e insekte. Mungonin frutat me të cilat ishim mësuar. Po ashtu, një numër perimesh as që njiheshin fare. Qepët, lakrat, groshët, vezët, bamjet, preshtë dhe hudhurat ishin ato që përbënin ushqimet tona. Buka ishte ose e thartë, ose e papjekur, ose e tharë, ose e bërë me miell të zi, pa dyshim prej misri, e pjekur pa kripë ose pa maja. Kishte qumësht deleje ose dhie. Por ai ishte aq i pasanitarizuar, sa që kurrë nuk mund të përdorej i pazier. Pas zierjes, ai fermentohej dhe kthehej në atë që shqiptarët e quajnë *kos*, ndërsa turqit *jogurt*. Qymyri i drurit, i thërrmuar dhe i vënë në shesh, përdorej për zjarr dhe gatim. Për këtë qëllim përdorëshin ibrikë të mëdhenj dhe kazanë prej bakri. Këta duhej të kallajiseshin nga brenda për t'u ruajtur nga

ndryshku dhe për të qenë të përdorshëm. Për fat, furra publike, pasi nxirrte bukën, i merrte tepsitë e gjellëve prej shtëpive dhe i piqte për një çmim shumë të ulët.

Për dyshekë përdornim një cohë të ashpër, të mbushur me sanë. Nënkresat ishin bërë prej së njëjtës cohë si dhe dyshekët. Një jorgan, prodhim vendi me një çarçaf, ishte mjeti me të cilin mbulohehim. Krevatët ishin thuajse rrafsh me tokën, pasi vendi më i afërt ku mund t'i gjeje ishte Italia ose Austria. Nga tetori deri në mars jetuam në këto kushte. Megjithatë, nuk ishte dhe aq keq. Pa grilat e dritareve, mund të vështronim yjet natën, ndërsa fëshfërima e ujit të një prrocke të vogël që kalonte pranë nesh dhe që përdorej për të ujitur kopshtin, herë pas here i shtohet harmonisë së asaj jete. Por netët e dimrit ishin të ftohta dhe prrocka e ujit ngrinte dhe shushurima e ujit mbytej nga mbulesa e akullit. Megjithatë yjet vazhdonin të na vështronin e të na ruanin dhe kjo na ndihmonte. Dritat jashtë ishin tejet të zbehta, të rralla dhe vetëm me vajguri – ato lëshonin erën e tyre të keqe, që përzihej me atë të tymit të oxhakëve. Sigurisht që aty nuk kishte vend për ata djem dhe vajza që kishin frikë sado pak nga nata.

Gjatë qëndrimit në Korçë me Kenedët, në mjediset tona gjuha që flitej ishte vetëm anglishtja. Me Konstandinin flisnim gjermanisht. Kur ai iku, mbetëm tërësisht gojëkyçur. Komunikimi u reduktua tërësisht në gjuhën e gjesteve dhe shenjave krejt të papërshtatshme. Për ta ilustruar këtë, po jap një shembull që do ta titulloj:

“Po dhe Jo zëvendësojnë njëra-tjetrën”.

Një ditë shitësi i frutave në rrugicën tonë kishte sjellë ca pjeshkë shumë të mira, të parat e stinës. Duke mos ditur se si të kërkoja me politesë, ta lavdëroja për frutat e mira që kishte dhe t'i bëja të ditur që doja patjetër ca prej tyre për familjen time, ndalova gjithsesi përpara dyqanit të tij. Ai ma bëri me shenjë, sikur më thoshte “eja këtej dhe shihi vetë”. Ai duhej të ishte i lumtur që të më peshonte një çantë plot, por jo, ai thjesht më pa, bëri me shenjë drejt frutave dhe më pyeti, në shqip padyshim, nëse unë desha disa prej tyre dhe sa. Unë iu përgjigja duke pohuar me

kokën që e luaja fort lart e poshtë. Kjo vetëm sa bëri që gjithçka të ndërpritej menjëherë. Megjithatë, ai do ketë thënë me vete “ky i huaj i çmendur nuk e di çfarë janë pjeshkët”, prandaj më drejtoi tek disa të tjera të vogla, të zeshkëta, të rrudhura, që dukeshin të ishin pjeshkë të prekura nga sëmundjet dhe më pyeti nëse më pëlqenin ato. Unë po aq fuqishëm e tunda kokën majtas e djathtas.

Shpëtova mirë që nuk peshoi dy okë pjeshka të këqija për mua. Unë i dhashë paratë në dorë, ai i zgjodhi ato që deshi, ndërsa unë i mora dhe ika në shtëpi. Duke u kthyer, pashë një vend tek prrocka, mbuluar me mbeturina dhe barëra të këqija. I hodha aty pjeshkët dhe u ktheva në shtëpi me duar bosh. Por, kështu mora një mësim. Kur duhet të them *Po*, më duhet ta tund kokën sa majtas, djathtas, ndërsa kur dua të them *Jo*, duhet ta tund atë lart e poshtë. Ishte pak e vështirë që, ashtu si në *Bibël*, të hapje një temë interesante: *Lëre Jo-në tënde të jetë JO dhe Po-në tënde të jetë PO*”.

I mësuar në Shqipëri me këtë mënyrë komunikimi, kur shkova në Itali dhe bëra të njëjtin gjest në kabinën e një shoferi, ai e mori në të kundërtën e vet, prandaj mbeta duke pritur në trotuar, me çantën time në dorë.

Ç’botë e çuditshme!



BIJTË E SHQIPES U MBLODHËN NGA TË GJITHA ANËT PËR TË
NDIHMUAR SHKOLLËN E TYRE KOMBËTARE. NJËZET VJET MË
VONË, KUR SHKOLLA NORMALE E ELBASANIT ISHTE RRITUR,
AJO ENDE MBAHEJ SI SHKOLLA MË E RËNDËSISHME NË TËRË
VENDIN. AJO PËRGATITI KATËRQIND MËSUES NË RRJEDHËN E
VAZHDUESHME TË JETËS ARSIMORE, DUKE U RRITUR GJITHNJË
BASHKË ME KOMBIN.



X



NGA T'JA NIS MË PARË?

Është kthyer në një veprim të zakonshëm ndërprerja e transmetimeve radiofonike për të njoftuar ndonjë lajm të ri të sapoardhur. Edhe unë po ndalem në rrethana të ngjashme, për të raportuar diçka më të detajuar, pikërisht aty ku jemi në historinë tonë, në një shtëpi vendase në Elbasan. Shtëpia është e pamobiluar. Ajo ka vetëm disa dyshekë të shtruar përtokë, me mbulesat më të domosdoshme. Ne bëmë një javë këtu, shumica prej nesh të shtrirë në krevat gjatë tërë kohës, përfshirë edhe beben tonë, tanimë tremuajshe.

Ne ishim të sëmurë që përpara se të iknim nga Durrësi, por kur arritëm në Elbasan, sëmundja na pushtoi tërësisht të gjithëve. Njëri pas tjetrit ngjitëm shkallët dhe u hodhëm nëpër krevatë, ashtu siç ishim të veshur, dhe pritëm ashtu për ditë të tëra që të qetësoheshim. Shfaqja e parë e sulmit të kësaj sëmundjeje ngjiste shumë me sikletin që të shkakton deti kur të zë, ose me dhimbjet që të shkakton dhuna. Vuajtjet më të mëdha i përjetuan Kerri dhe fëmijët. Earli dhe e ëma ishin në gjendje delirante gjatë tërë netëve, dhe pjesërisht edhe ditën. Pas kësaj erdhën ethet

që nganjëherë shoqëroheshin me temperaturë mbi 40 gradë Celsius. Një doktor vendas na vizitoi dhe bëri gjithçka munda. Por sëmundja do të plotësonte ciklin e saj. Sikur këto të mos mjaftonin, kishim pësuar edhe djegie nga dielli. Edhe aty ku trupat nuk ishin të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj diellit, rrezet kishin depërtuar nëpërmjet rrobave dhe na kishin djegur lëkurën e butë. Faqet, krahët, këmbët e bebit ishin fluskuar, edhe pse unë e mbaja nën një çadër për ta mbrojtur. Malaria ime ishte më pak akute sesa e të tjerëve, sepse unë e vuajta atë pesë-gjashtë javë para se të udhëtonim. Por më ishte shpifur nervi shiatik, si për të plotësuar atë që kishte lënë mangut malaria. Ai më ishte ngjitur sikur donte të mbushte plot kupën e dhimbjes. Përtej çdo parashikimi, dhimbja torturoese e sëmundjes njerëzore është e aftë të luajë me nervat e njeriut dhe t'i japë nervit shiatik edhe një shtysë tjetër, sidomos gjatë tri ditëve udhëtimi, hipur mbi samarin e një kali që udhëton nëpër xhunglën shqiptare. Kësaj tabloje dhimbjeje të tmerrshme i shtoheshin edhe rrugët gjarpëruese, të pashtuara, plot pengesa. Çështja më e ngutshme për ne tani ishte se çfarë duhej të bënim me shtëpinë tonë. Ne nuk mund t'i varnim shpresat pafundësisht te dëshira e mirë e ndonjë samaritani që do ta ndihmonte familjen tonë. Lagjja e të krishterëve të këtij qyteti ishte tmerrësisht e populluar dhe me shtëpi shumë primitive. Familjet kishin bazë të gjerë dhe në një shtëpi jetonin shumë vëllezër, në stilin e bejlerëve të pasur. Një ofertë mikpritjeje nga ajo lagje do të ishte në pajtim me traditat dhe zakonet shoqërore të atyshme, pasi bejlerët, si krerë të bashkësive apo fiseve, pritej që të kujdeseshin për të huajt. Në të vërtetë, vajtja jonë në Elbasan ishte bazuar në një ftesë personale të një familjeje. Prandaj kishim vendosur të shkonim atje. Më në fund morëm një shtëpi aq të kalbur e të shkatërruar, sa që mezi mund ta quajë shtëpi të banueshme, qoftë edhe për lakuriqët e natës që fluturonin në numër të madh përmes dritareve të saj të prishura. Por zgjedhja ishte ose atë, ose asgjë tjetër dhe, natyrisht, duke mos dashur të merrnim asgjënë, morëm shtëpinë.

Pa dyshim gjërat e shtëpisë ishin ende në Tiranë dhe ne paguanim qira të plotë mujore. Nuk kishte asnjë shpresë që të ktheheshim atje. Misioni ishte i vendosur kategorikisht kundër kësaj. Ata besonin në vendimin gjyqësor dhe, siç thuhet në

Bibël, “kushdo qoftë ai që nuk ju pranon dhe dëgjon kur të ikni që andej, shkundeni pluhurin e mbetur nën këmbët tuaja për një dëshmi kundër tyre”.

Përveç kësaj, shiu kishte filluar dhe kthimi mbrapa do të ndeshej me një baltovinë të pakapërcyeshme. Disa prej gjërave tona edhe mund të arrinin tek ne me kuajt që vinin përmes maleve, po kush do të kujdesej për to? Ndërkohë që po përpiqeshim ta zgjidhnim këtë problem, nga Amerika, dhe pikërisht prej *Kolegjit Oberlin*, arriti *Kristo A. Dakoja*, një shqiptar të cilin bordi e kishte dërguar për të punuar si ndihmësi im. Ai pranoi menjëherë të shkonte në Tiranë dhe të shilte çfarë mund të bëhej për të sjellë sa më shumë orendi që të ishte e mundur. Ai e bëri këtë pa ngurrim dhe ngarkesa erdhi me kuaj në mënyrë të shkëlqyer. Disa gjëra që nuk i kishte sjellë dot, siç ishte pianoja, i kishin ngarkuar nëpër qerre me buaj dhe i kishin nisur rreth e rreth nëpërmjet Durrësit, në atë rrugë që ne e kishim bërë më parë.

Kishte vetëm një shans dhe ata vendosën ta kapnin atë, me shpresë se do të kalonin para se shtegu të bëhej i pakalueshëm. Medet, medet! Ata nuk kishin bërë as një të tretën e udhëtimit, pra kishin përshkuar një pjesë të vogël të rrugës kur u ndeshën me atë pjesë që ishte e pakalueshme. Qerret ishin bllokuar dhe kjo ishte e tëra. Gjëra të vjera si pianoja, mobiljet, stofrat, qilimat, çarçafët etj., u hodhën në një stallë të thjeshtë. Vetëm disa muaj më vonë, në pranverë, kur u bë e mundur që t'i transportonim ato, më në fund arritën te ne. Por tanimë ishte shumë e vështirë t'i njihje. Pëlhurat, p.sh., ishin mykur kaq shumë sa mund të të mbeteshin në dorë. Mobiljet, pianoja, të linjtat, qilimat, më mirë të mos i përmendim. E tëra kjo shkaktoi një zemërthyerje për të gjithë ne, pjesëtarët e familjes.

Por ajo që dilte si çështje edhe më serioze, ishte vështirësia për të bashkërenduar punët tona me ato të shqiptarëve. Siç është thënë edhe më parë, ne nuk ishim një mision i pavarur, por pjesë e *Misionit Ballkanik*, i cili kishte stacione në Bullgari, Maqedoni, dhe në Selanik. Kishte rreth njëzet anëtarë të këtij misioni që duhej të votonin në lidhje me propozimet që kishin të bënin me punën tonë. Ata kishin

miratuar Tiranën si stacion, dhe jo Elbasanin. Ne duhej të kishim marrë miratimin përpara se të fillonim çfarëdo lloj pune. Për këtë qëllim, mbledhja vjetore ishte caktuar të mbahej në Korçë. Kur erdhi koha për këtë, unë kisha zënë shtratin dhe nuk arrita të merrja pjesë në mbledhje.

Ishin vetëm dy anëtarë të misionit, përveç Kenedëve, që kishin ndonjë ide të formuar nga informacionet e dorës së parë lidhur me Shqipërinë. Pjesa më e keqe e tërë kësaj situatë ishte mungesa e plotë e bashkëpunimit midis Kenedëve dhe meje. Ata vinin në Elbasan dhe kalonin javë të tëra pa asnjë qëllim, duke propozuar plane sot, thjesht për t'i anuluar të nesërmen. Propozimet ishin pa fund, por vepra asnjë. Nervat do të tendoseshin, do të humbiste durimi, fliteshin fjalë që nuk kishin vlerë për askënd. Në të vërtetë, ata ishin të vendosur që ne të na merrnin në Korçë dhe të hiqnim dorë nga Shqipëria Veriore dhe Qendrore, duke e përqendruar punën në atë qytet.

Udhëheqësve shqiptarë u ishim neveritur por, nëse flas për veten time, mua më ishte neveritur vetja dhe tërë kohën isha i pikëlluar për situatën. Një prej burrave të mëdhenj të Shqipërisë, Aqif Pasha i Elbasanit, një burrë i jashtëzakonshëm, me karakter të patundur, me ndikim në tërë Shqipërinë, si mbi myslimanët, edhe mbi të krishterët, më thirri një ditë dhe më dha një prej mësimëve më të vështira që kam marrë ndonjëherë në jetën time. Përmbajtja e asaj që më tha, ishte e tillë:

“Unë e di se ju keni ardhur në Shqipëri për të bërë punë të mira, për t’i edukuar shqiptarët dhe aftësuar ata që të jenë më pak fanatikë dhe të urrehen më pak me njëri-tjetrin. Nëse ju do t’ia arrini kësaj, ne mund t’ia dalim të zgjidhim problemin më të madh që ka kombi ynë. T’u jepet shqiptarëve vetëm një fe, dhe kështu të bashkohen në një vëllazëri shpirtërore. Por, për të arritur këtë, ju duhet të përfitonit nga rasti i kësaj mundësie të jashtëzakonshme që na është dhënë në këtë kohë që po flasim, kur udhëheqësit tanë kudo që janë, e dinë nevojën e menjëhershme dhe janë përgatitur të punojnë dhe sakrifikojnë për të. Do të ishim të pashpresë nëse presim që cilado prej tri feve të vjetra që gjenden këtu, ajo muhamedane, e krishterë romake apo ajo ortodokse, të përfshijë dy të tjerat dhe shqiptarët të bashkohen në një fe të vetme.

Kanë ndodhur aq shumë gjëra të panevojshme, përplasje deri në gjakderdhje midis tyre; ka patur përzierje të panevojshme të politikës nga jashtë në këto ngatërresa, me qëllim thartimin e këtyre marrëdhënieve midis shqiptarëve, bazuar në dallimet fetare, deri në nxitje vëllavrasëse. E gjitha kjo ka patur si qëllim ta bënte bashkimin tonë të pamundur.

Protestanizmi mund ta mundësojë këtë, sepse ai është i lirë nga këto pengesa dhe nxit arsimimin, përparimin, lirinë politike dhe fetare, drejtësinë shoqërore, të gjitha këto që neve na nevojiten kaq shumë dhe që ne i ëndërrojmë e i dëshirojmë kaq shumë. Por ju duhet t'i bindeni maksimës amerikane: "Koha është flori". Nëse ndodh ndonjëherë, kjo do të merrte shumë kohë".

Një udhëheqës tjetër shqiptar, Lef Nosi, pjesëtar i Kishës Ortodokse Greke, gjithashu më pat thënë:

"Ne e dimë që ju e keni barin e duhur shërues, që po t'i jepet popullit tonë, do t'ia shpëtojë jetën. Por çfarë po bëni ju për këtë? Ju vetëm sa na e tregoni atë. Kur ju kërkohet ta hapni dhe të na e jepni ta pimë, ju na thonin: "Prisni pak, se ende nuk jemi gati. Ne po vdesim. Nëse vërtet na doni dhe nëse doni të na ruani, hapeni barin shërues të sëmundjes dhe na shëroni. Nëse nuk e bëni këtë, ju lutem, na lini të provojmë diçka tjetër ose na lini të vdesim në paqe".

Por ku gjendej forca e vërtetë e papajtueshmërisë në veprimin midis këtyre tri feve që i mbante ato në mosmarrëveshje dhe përçarje me njëra-tjetrën, deri në ndezje të gjakmarrjes midis tyre? I pari ishte pan-islamizmi i përhapur në 70 për qind të popullsisë që e kishte pranuar tashmë atë.

Deviza e tyre ishte: Shkatërroje Shqipërinë si komb, varrose ose përthithe atë në rrjedhën e gjakut të Perandorisë Osmane!

Pastaj vinte Kisha Ortodokse Greke, e mbështetur nga Greqia dhe një zhurmë propagandistike tepër e gjallë e financuar dhe subvencionuar me mjete të tilla të pakufizuara prej vetë qeverisë. Qëllimi i tyre i vetëm është të shkëpusin Shqipërinë

e Jugut nga pjesa tjetër e vendit, dhe ta bashkojnë me Greqinë.

Elementi i tretë i mosmarrëveshjeve është një tjetër, i dyfishtë: Austria dhe Italia, ziliqare ndaj njëra-tjetrës, armike politike, rivale tregtare, të dyja që bëjnë çmos të shfrytëzojnë elementin katolik në Shqipëri, i cili përbën rreth 12 për qind të popullsisë, si një mjet për të futur një këmbë në Ballkan dhe për të vendosur një avanpost të tyre këtu. Në këtë vend gjendesha unë me duar të lidhura. Pas muaj e muaj përpjekjesh, ia dola të merrja për *Misionin* një copë të vogël toke për një shkollë dhe një qendër për punën tonë. Por sa i përfunduam tërë këto përpjekje, qeveria turke u tregua më e shpejtë, ndërhyri dhe më shpronësoi. Ata na thanë se u duhej për një depo baruti, sikur Shqipëria kishte ngelur keq për një të tillë, kur i tërë vendi ishte duke plasur prej tyre.

Në këtë kohë, ndërsa ne rendnim poshtë e lart, por pa sukses për të hapur shkollën, udhëheqësit shqiptarë u mblodhën së bashku dhe vendosën të hapnin një shkollë normale kombëtare në Elbasan. Ata kishin arritur të merrnin një farë premtimi prej Turqve të Rinj, nën kontrollin e qeverisë, për një politikë të mbajtjes së duarve larg dhe, pa pritur që të ndryshonin mendjen, siç bënin rëndom, ata u morën menjëherë me projektin. U mor pa humbur kohë me qira një shtëpi beu dhe u mblodhën fondet. Mjeshtrat vendas vunë çdo gjë që duhej në vendin e vet.

Mungonte vetëm një gjë, por që ishte kryesore - mësuesit. Ku do të siguroheshin ata? Kjo ishte çështja më e vështirë për t'u zgjidhur. Duheshin dy ose tre shqiptarë të kualifikuar që të jepnin mësim në gjuhën e tyre. Kishte plot që mund të jepnin mësim në turqisht, greqisht, frëngjisht, gjermanisht po...në shqip? Edhe kjo u zgjidh.

Bijtë e Shqipes u mblodhën nga të gjitha anët për të ndihmuar shkollën e tyre kombëtare. Njëzet vjet më vonë, kur *Shkolla Normale e Elbasanit* ishte rritur, ajo ende mbahej si shkolla më e rëndësishme në tërë vendin. Ajo përgatiti katërqind mësues në rrjedhën e vazhdueshme të jetës arsimore, duke u rritur gjithnjë bashkë me kombin. Figura të tilla si Luigj Gurakuqi, i cili më vonë u bë Ministër i Arsimit,

Orhan Pojani, Grigor Cilka, Gjergj e Sevasti Qiriazi, Mithat Frashëri, Dervish bej Biçaku, Ahmet Dakli, Refik Toptani, Hafiz Ibrahim Dalliu, Thoma Papapano, Hamdi Ohri, Nikollë Kaçori, Josif Haxhi Mima, Simon Shuteriqi, Dhimitër Buda, Abdullah Rushit Ahmeti (Struga), Abdulla Koprëncka, Kristo Dako, Emin Haxhi Ademi, Selman Blloshmi, Andrea Konomi, Idhomenë Kosturi etj., i dhanë dritë asaj shkolle dhe arsimit shqip. Në këtë drejtim ndihmesë dha edhe *Federata Pan-shqiptare V/ATRA* nga Bostoni, në SHBA, duke dërguar Sotir Pecin si mësues në atë shkollë. Fillimi i kësaj shkolle përballej me mungesë tekstesh, librash. Ishin multigrafët që shërbenin si shumëfishues të mësimave ditë pas dite dhe kështu shkolla lulëzoi.

Më në fund, edhe ne i gjetëm fondet për të hapur shkollën e djemve. Kristo Dako, i cili ishte marrë me ne me muaj të tërë, kishte rënë i sëmurë nga malaria. Po ashtu ai ishte dhënë aq shumë për të gjetur njeriun e jetës dhe ishte aq i shpërqendruar, sa nuk i dilte koha për punët e shkollës. Një numër i mire nxënësish e filluan shkollën, por brenda një kohe të shkurtër ky numër ra deri në dy nxënës. Më pas erdhi martesë e zotit Dako me zonjushën Sevasti Qiriazi, drejtoresha e *Shkollës së Vajzave* në Korçë. Kjo i dha fund shërbimit të tij në Elbasan dhe ne nuk gjetëm dot dikë tjetër që ta zëvendësonte. Shkolla u mbyll. Bëra edhe një përpjekje tjetër për ta hapur një shkollë timen dhe mora me qira një shtëpi të madhe në lagjen e myslimanëve. Po ashtu gjeta një shqiptar i cili kishte përvojë në mësimdhënie në gjuhën greke, por që dinte mjaftueshëm edhe gjuhën e vet. U binda se e dinte aq sa të jepte mësim. Ai erdhi si ndihmësi im dhe shumë shpejt arritëm të kishim një shkollë që lulëzonte, e përbërë prej djelmoshash të rinj. Githçka po shkonte më së miri, por sa zgjati? Aj medet, jo për shumë kohë.

“Depoja e barutit”, për të cilën qeveria turke ishte treguar aq e paduruar, tani gjeti një formë të re shpërthimi të papritur. Sepse i gjithë vendi ishte bërë “depo baruti” e revoltës politike. Për muaj të tërë ishin marrë masa shtypëse nga qeveria turke kundër shqiptarëve nacionalistë. Njëri pas tjetrit, koncensionet që u ishin bërë shqiptarëve që kërkonin autonomi filluan të tërhiqeshin. Shkollat u mbyllën, shtëpitë botuese u konfiskuan, udhëheqësit nacionalistë u arrestuan, u arratisën

ose u burgosën pa ngritur as padi, pa bërë asnjë gjyq kundër tyre. Kishte të tjerë të cilëve iu konfiskuan pasuritë, por edhe që u dënuan me vdekje. Njëri pas tjetrit miqtë e mi të ndryshëm u zhdukën dhe grupet e kryengritësve, të përbërë prej rreth njëzet e pesë deri në disa qindra vetë, ishin mbledhur për luftë guerrile kundër qeverisë.


Elbasani ishte një qytet që e mbështeti fuqishëm këtë Lëvizje Kombëtare në Shqipërinë Qendrore dhe nuk kaloi shumë kohë përpara se qeveria në Konstandinopojë të merrte masat më të ashpra për t'i mposhtur dhe për t'i prerë fijet e tyre me Shqipërinë.

Në këto ditë, emri i Shefqet Turgut Pashës ishte sinonimi i një sjelljeje të egër, tejet mizore, të vrazhdë, çka i karakterizonte turqit në raste të tilla kur bëheshin gati të shtypnin revoltat. Ata e sillnin situatën deri në atë gjendje sa të thoshin: “Këtë kërkuat, ja ku e keni!”. Edhe pse Elbasani nuk ishte qyteti i parë që do të fshikullohej, nuk vonoi shumë. Vizita e tij në Elbasan do të kujtohet për aq kohë sa do të jetojë ndonjë prej atyre që shpëtuan. Më së pari, ushtria e tij, që siç thuhet numëronte dhjetë mijë vetë, kishte rrethuar qytetin me një kordon, në mënyrë që të këpuste çdo lloj mundësie për të shpëtuar. Pastaj u deklaruan tri ditë gjendje e jashtëzakonshme në tërë qytetin. Urdhëri i kërkonte çdo burri, gruaje apo fëmije të qëndronte brenda murit rrethues të shtëpisë së vet. Ata nuk duhej të dilnin jashtë as për ujë, as për bukë.


Në ditën e dytë dhe të tretë kjo u hoq për një orë, për të lejuar sigurimin e gjërave më të domosdoshme. Ndërkohë skuadra të vogla trupash me bajoneta të hapura në mënyrë sistematike kaluan nëpër rrugët e qytetit, duke bastisur shtëpi më shtëpi dhe duke kërkuar për armë dhe çfarëdo letre të shtypur në gjuhën shqipe. Kudo ku u gjetën ato, kryefamiljari u arrestua dhe u burgos. Turkofilë, grekofilë, spiunë, tradhtarë, shumica e të cilëve të njohur mirë prej popullit, tani raportonin tek shtabi i ushtrisë emrat dhe adresat e të gjithë shqiptarëve që kishin marrë pjesë në lëvizjen nacionaliste. Qindra prej këtyre të fundit u arrestuan. Kur

burgjet u mbushën plot e përplot me shqiptarë sa nuk nxinin më, atëherë filluan të përdoreshin shkollat për t'i mbajtur ata. Tonelata letre që ishin përdorur për të shtypur abetaret, poezitë, historinë, jetën e Skënderbeut, të gjitha u mblodhën dhe u shndërruan në një zjarr të madh në qendër të qytetit. Qindra armë të vjetra dhe revolverë, shumë pushkë me strall, shpesh të praruara me ar dhe argjend dhe të zbukuruara me filigramë, shpata shumëshekullore të vjetra, të zbukuruara me gurë gjysmëxehvahiri, thika damasku garderobesh të rralla dhe me vlera të mëdha përbënin plaçkën e mbledhur dhe të dërguar në Stamboll, që pastaj shiteshin në dyqanet e antikuarëve të qytetit. Deri në këtë pikë, mua nuk më ngacmuan, por e ndjeva se kjo do të ishte e pashmangshme. Unë kisha pasur shkollën time, kisha plot libra shqip në shtëpinë time, të cilat kundërshtova t'i digjja. Prandaj e ndjeva se ishte vetëm çështje kohe deri sa të vinte radha ime. Unë kisha flamurin tim amerikan që valëvitej te dritarja e shtëpisë, jo se shpresoja se do të më mbronte, por thjesht për ta treguar atë. Pastaj trokitja me kondakun e pushkëve në derën e shtëpisë sime, që unë e ndjeja se ishte e pashmangshme, u dëgjua rëndshëm.

Çuditërisht kjo më dha një ndjenjë lehtësimi. Unë me familjen time, me shtëpinë time, pasurinë time kisha bërë shumë për këta njerëz dhe do të vuaja edhe ndëshkimin, po në të mirë të tyre. Poshtë më priste një bimbash turk, me një dyzinë ushtarësh me bajoneta të hapura. Ai shtyu portën me forcë. Me vete kishte sjellë një përkthyes zyrtar shqiptar. Unë i tërhoqa vëmendjen tek flamuri im amerikan, duke i dhënë të kuptonte se isha i mbrojtur. Përgjigjja e tij ishte se një mbrojtje e tillë më sigurohej vetëm nëse isha brenda një rrezeje prej nëntë orësh nga një konsullatë amerikane.



SHQIPËRIA VETË MERITON NJË NDER SHUMË TË VEÇANTË PËR
KONTRIBUTIN QË KA DHËNË PËR TË POPULLUAR PARAJSËN ME
NJERËZIT E SAJ TË NDESHËM, TË BUKUR DHE TË PAFAJSHËM.



XI



JETË E BËRË FERR

Paragrafi i parë i këtij kapitulli mund të kalohet prej lexuesit, pa humbur ndonjë gjë prej tregimit. Është një histori e mirënjohur, e treguar shpesh në qarqet sportive për lojtarin e golfit që vdiq dhe shkoi në parajsë. Kërkesa e tij e parë ishte për fushën e golfit. Kur iu tha se aty nuk kishte një të tillë, ai paraqiti kërkesë për vend tjetër. Po, kishte fusha diku më poshtë. “A janë të mira ato?”, pyeti ai. Për këtë i dhanë siguri të plotë. Ai kërkoi leje të transferohej, çka iu dha menjëherë. Vajti te fusha dhe pa se ajo ishte më e mira që kishte parë ndonjëherë. Pastaj pyeti nëse kishte klub, dhe përsëri mori përgjigje pozitive. “Po mirë, topat ku janë?”, pyeti ai.

Pas tërë kësaj, pasoi zhgënjimi.

“Vetëm topa nuk kemi”, iu përgjigjën.

“Po përse, si është e mundur?”, këmbënguli ai.

“Epo ky është ferri i tij”.

Por ka shumë mënyra për ta bërë botën ferr për njerëzimin. Lufta është një prej tyre dhe, sigurisht, Shqipëria e ka provuar atë shumë herë në historinë e saj.

Më së shumti, luftërat e saj janë bërë për t'u çliruar nga zgjedha e huaj. Sigurisht që ka patur disa premtime të dhëna prej fuqive ndërluftuese të cilave u nevojitej ndihma e shqiptarëve. Por ato i harronin premtimet e tyre sapo bëhej shërbimi e sakrificë, dhe ata e kryenin punët e tyre. Ky ishte ferri që shqiptarëve u jepej si shpërblim ndër shekuj për krenarinë e tyre të fjalës së dhënë dhe punës së bërë në emër të saj.

Ndoshta nuk ka asnjë qeveri në mijëra vjetët e fundit të historisë europiane dhe asaj të Lindjes së Afërt që ta ketë treguar veten më të aftë në atë lojë sesa sulltanati turk. Siç del nga historia, Shqipëria ka qenë fusha e tij e parapëlqyer për eksperimente. Arsyeya për këtë është e qartë, kur e shohim vendndodhjen e saj aty ku shtrihet bash tek dera e shtëpisë së Europës. Një kontinent i cili gjatë periudhës së pushtimit turk të Shqipërisë nga viti 1468, kur vdiq Skënderbeu, deri në vitin 1913, në përmbyllje të Luftës së Dytë Ballkanike, kaloi nëpër një metamorfozë të plotë; nga imperializmi autokratik, tek format liberale dhe demokratike të qeverisjes; nga feudalizmi me sistemin e vet të vasalëve, bujkrobërisë, skllavërisë, tek të drejtat e njeriut, liritë individuale, rendi i drejtë shoqëror, arsimi për masat, përdorimi universal i shtypit të shkruar, telegrafi, parlamenti ku diskutohen hapur çështjet publike me përfaqësues të zgjedhur të popullit që merr në drejtim lirinë e plotë të fjalës dhe mbledhjes. Gjykatat, ku edhe të varfërit, edhe ata pa ndihmë mund të paraqiten dhe të kenë të drejtat e tyre të garantuara. Feja, si mjet shërbimi dhe nevojë për njeriun e thjeshtë. Ligji dhe rendi, që respektojnë pronën private të vendosur gjithandej. Pajisjet e jetës për individin, familjen, bashkësinë dhe shtetin, të shumëfishuara me një mijë herë. Shkencat mjekësore, kujdesi ndaj fëmijëve, higjiena dhe kushtet sanitare, vaksinat dhe anti-toksinat për parandalimin e sëmundjeve, spitalet, senatoriumet, qendrat shëndetësore me pajisjet e tyre të shkëlqyera moderne, një armatë e tërë specialistësh të trajnuar më së miri. Të gjithë merren me çdo formë të dobësisë njerëzore, mendore edhe fizike, institutet e lëmshës, fondet e pensioneve, shtëpitë për të pastrehët, shërbimi social edhe prej bashkësisë, edhe prej kishës, madje edhe të botës së kafshëve shtëpiake dhe atyre të

egra po ashtu, që të kenë mbrojtje, të kenë të drejtën për të marrë pjesën e vet të bekimit të një qytetërimi kristian të njohur pothuajse në mënyrë universale. Kjo listë e gjatë, siç na del kur e lexojmë, është vetëm një pjesë e vogël e bekimit të cilin qytetërimi modern ka sjellë në botën e sotme. Duke mos arritur të gëzojë asgjë nga ato dhurata të jetës që u përmendën më sipër, Shqipëria për afër katërqind e pesëdhjetë vjet, edhe pse ishte vetëm 45 milje detare e ndarë nga një botë e tillë, u privua në mënyrën më të pabesueshme. E sërish sulltanati turk ia arriti ta realizonte atë që dëshoi. Kjo është po aq e vërtetë, sa historia e Ferrit.

I adhur në Shqipëri në vitin 1908 me gruan dhe tre fëmijë të vegjël dhe duke patur rastin që t'i bija këtij vendi kryq e tërthor, nga jugu në veri, nga lindja në perëndim, duke e patur shtëpinë në dy qendra të mëdha banimi bash në zemër të vendit, në Tiranë dhe Elbasan, duke jetuar jetën e vendasve me tërë nevojat dhe privacionet, e quaj veten njeri të kualifikuar sa prej përvojës, aq edhe prej njohjes që kam, për të folur me kompetencë në lidhje me këtë çështje.

Prandaj, duke dëshiruar “të flas të vërtetën, tërë të vërtetën dhe aspak më pak se të vërtetën”⁶¹, dua të paraqes këtu këtë dëshmi timen, siç ishte dhe siç e gjeta në atë kohë. Prej një përshkrimi të tillë ndoshta përjashtohen dy përqind e popullsisë, por jo më tepër.

Aty nuk kishte spitale, as senatoriume, as praktikues sanitarë të pajisur me njohuritë më të fundit, me mjeshtri dhe furnizime mjekësore. Nuk kishte asnjë kirurg që dikush t'i besonte të binte në duart e tij, as shtëpi moderne me pajisje sanitare, asnjë kontroll mbi sëmundjet ngjitëse. Obstetrika ishte e tëra në duart e grave vendase, pa asnjë dijeni profesionale shkencore për një gjë të tillë. Përqindja e mortalitetit, po të kihen parasysh kushtet e jetës në përgjithësi, kapte shifra të frikshme. Popullsia rurale, që zinte një vend prej 89% të tërë popullsisë, jetonte në pjesën më të madhe në shtëpi pa dritare, pa stufa, pa dysheme, pa krevatë, pa ndërrim teshash për natën dhe për ditën, pa pajisje banjoje, me tualete pellgje, pa mbrojtje

⁶¹ Kjo është formula që në ShBA, njerëzit kur vihen nën betim e thonë para gjykatës.

ndaj mushkonjave malarike. Menuja e tyre shumë rrallë mund të përmbante mish ose peshk, madje as perime, vezë apo pula. Buka e misrit bëhej vetëm me ujë, pa kripë, me ose pa maja, dhe piqej në çerep dhe saç të mbuluar me prush.

Kjo ishte, në të vërtetë, “ajo me çfarë jetonte ky popull”. Jam i sigurtë se në tërë këtë popullsi rurale nuk ka patur një vend ku të gjendej një fetë buke gruri, përveç se në raste të rralla, kur një fshatar kishte mundur të shiste diçka të mirë në pazar dhe më pas kishte blerë dhe sjellë në shtëpi atë gjë që ishte e rrallë për familjen. Përveç kësaj, në stinën kur delet lindnin qengjat dhe këta tregtoheshin, familja e thartonte qumështin dhe prodhonte atë që ne e quajmë “yogurt”, ndërsa në shqip quhet “kos”. Malaria prekte popullatën në mënyrë masive. Sëmundjet dhe të ushqyerit keq, tuberkulozi, zmadhimi i shpretkës, sëmundjet e syve, ulçera dhe kanceri, sëmundjet e lëkurës ishin gjithandej të përhapura. Sëmundjet ngjitëse, siç është lia, fruthi, skarlatina, difteria, tifoja merrnin jetë njerëzish, pa u penguar asgjëkund, ashtu si zjarri merr pyllin pa dallim.

Bujqësia ishte skajshmërisht dhe tërësisht primitive. Plugjet vendase bëheshin prej drurit të lisit dhe një dege që shërbente për ta mbajtur. Në fund të kësaj dege të gjatë ngulitej zgjedha që vihej në qafën e qeve. Pasi plugohej, toka pritej të përthahej dhe më pas plugohej edhe një herë për ta shkruftuar më mirë. Kjo ishte mënyra se si mbillej, se si punohej dhe më pas korrej. Të njëjtat mjete po aq primitive përdorreshin edhe për korret, mbledhjen dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore.

Analfabetizmi ishte 100%, thjesht për arsyen se qeveria turke jo vetëm që i ndalonte shkollat kombëtare, por edhe më keq se kaq, impononte dënime për ata që guxonin të sillnin një abetare si kontrabandë prej jashtë, ku grupe të caktuara nacionaliste i shtypnin ato. Turqishtja ishte gjuha zyrtare, me pak ose aspak kundërshtim për mësimin e gjuhëve të tjera, si greqishtja, italishtja, gjermanishtja. Gjithsesi, nuk kishte nxitje të arsimimit, madje as edhe për pjesë të Kuranit të dhënë prej hoxhallarëve ose myftinjve. I tërë autoriteti qeveritar ishte në duart

e turqve, me valiun në krye, i vendosur në Manastir, në Maqedoni. E njëjta gjë ndodhte edhe me gjykatat. Taksat kishin si kufi qiellin. Një praktikë e parapëlqyer ishte konfiskimi i zgjedhës së qeve, pa të cilën bujku nuk mund të plugonte fushën e tij derisa të dorëzonte shumën e kërkuar. Lufta guerrile ishte thuajse një zbatimje, ndërsa gjakmarrja merrte jetët e mijërave. Kur kokrrat e drithit numëroheshin përkundër frikës vjetore të urisë dhe mjaftonin për ta luftuar atë, kjo ishte një gjë e rëndësishme për familjen.

Duhet të jetë e kuptueshme tashmë për lexuesit tanë, që sulltanati turk ishte shumë i suksesshëm në krijimin e një ferri vuajtjesh për pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare. E megjithatë, ende as gjysma nuk është treguar për këtë. Për ta kuptuar këtë më mirë, është e domosdoshme të shohim veprimtarinë e qeverisë në mbretërinë e fesë. Thuhet se Shqipëria ka qenë e ndarë në dy fe shtetesh apo krahinash: veriu, i lidhur me Romën dhe pjesa e mesme dhe e jugut me Bizantin.

E kam theksuar këtë në këtë mënyrë, me qëllim që ta bëj të qartë se kjo nuk ishte thjesht ndarje fetare që nuk kishte lidhje me atë politike. Në atë kohë nuk ka patur një dallim të tillë. Qeveria dhe kisha ishin e njëjta gjë. Kur pjesa veriore e Shqipërisë, e cila përfshinte Shkodrën dhe Lezhën, i ishin caktuar Romës, që do të thoshte kontroll politik, qeverisë, si dhe fetar, njerëzit ishin jo vetëm katolikë romakë, por edhe qytetarë romakë. Në anën tjetër, banorët e tjerë të Shqipërisë nuk ishin vetëm besimtarë të Kishës Ortodokse Greke, por ishin edhe qytetarë të Bizantit. Rezultati i kësaj ishte që guvernatorët romakë vendosnin standardin e jetës dhe autoritetin në veri, ndërsa zyrtarët grekë, në pjesën tjetër të vendit.

Kjo ndarje ndodhi pas *Sinodit të Kishës*, të mbajtur në Konstandinopojë në vitin 599. Fill pas këtij veprimi u vendos një dukë i Bizantit në Durrës, për të ushtruar autoritetin e tij në emër të Perandorisë dhe për më shumë se një shekull ose derisa bullgarët e sfiduan sundimin e saj, Greqia e zotëroi atë pjesë të Shqipërisë plotësisht. Padyshim që sfida e bullgarëve nuk ishte një sfidë me shpatën e shpirtit, pasi edhe ata vetë ishin në fenë e tyre *ortodoksë grekë*. Por, gjithsesi, ata luftuan me

dhunë në pjesën më të mirë të dy shekujve.

Këtu lindi një prej atyre paradokseve ballkanike që ka hutuar botën tonë perëndimore: Si ka mundësi që si bullgarët, si grekët, si serbët e urrejnë kaq shumë njëri-tjetrin dhe, në të njëjtën kohë, i takojnë së njëjtës *Kishe Shtetërore*? Pa dyshim, bullgarët e nxorën veten më vonë nga mëdyshja, duke themeluar *Kishën Autoqefale të Bullgarisë*. Kjo në kthim çoi në një situatë qesharake, ku fëmijët me të njëjtin baba dhe nënë e gjetën veten të ndarë nga ana racore në grekë, bullgarë, madje edhe serbë, pasi ata iu bashkëngjitën njëres ose tjetres prej këtyre tri organizatave kishtarë. Shpeshherë ata i ndërronin emrat e tyre për të korresponduar. Në veri të Shqipërisë janë bërë fare pak përpjekje, ose janë përmbyshur shumë pak prej tyre, për të identifikuar besimin fetar me atë politik, sa të arrijë të identifikojë qoftë edhe dikë virtualisht me dikë tjetër. Prandaj shqiptarët katolikë romakë mbetën gjatë tërë historisë së tyre të lidhur në shkallë të ndryshme me Perandorinë e Shenjtë Romake dhe qeveritë që e shoqëronin atë.

Në pjesën tjetër të Shqipërisë rezultatet ishin shumë të ndryshme. Atje *Kisha Ortodokse Greke* u hodh në sulm ndaj çështjes së racave. Nuk vihej në dyshim fakti që shqiptarët kishin qenë të krishterë përpara se turqit ta pushtonin vendin, por se a duhej apo jo që këta shqiptarë të mbeteshin të tillë, pa marrë parasysh se kush do i sundonte ata. Çështja ishte nëse a duhej tani të bëheshin grekë, pasi kisha greke ishte bërë nëna e tyre shpirtërore, madje pa patur të drejtën për të zgjedhur ose vendosur vetë mbi këtë çështje, apo jo? Zelli me të cilin kjo propagandë u kthye në një skandal dhe në një krim politik, meriton vëmendje të posaçme. Shkollat ishin themeluar anembanë vendit. Funkzioni kryesor, për të mos thënë i vetëm, ishte t'i mësonte të rinjtë e racës shqiptare se ata nuk mund të ishin me fe ortodokse greke dhe kombësi dhe racë shqiptare⁶². Prandaj duhej hequr dorë nga njëra prej tyre. Ata nuk kishin zgjedhje tjetër, nëse dëshironin të ishin të krishterë, por, si të tillë, duhej të ishin grekë ortodoksë, si prindërit ashtu dhe fëmijët e tyre. Ata ishin vënë përpara një mëdyshjeje të tmerrshme. Epiteti i vjetër “barbar” ishte ringjallur edhe

⁶² Shqip në origjinal.

një herë dhe po zbatohet si një goditje kamzhiku për të përkulur këtë popull të pabindur.

Gjuha shqipe, sipas kësaj kishe, ishte një gjuhë barbare, të cilën Zoti i krishterë nuk e kuptonte. Ata duhej të përdornin greqishten si gjuhë zyrtare që çonte në *Gjykimin e Qiellit*, ndryshe ata kurrë nuk do të kuptoheshin. Nuk ka prova që e vërtetojnë këtë, por njeriut mund t'i shkojë lehtësisht ndërmend një lloj rregulli i bazuar në “kokat që fitohen dhe bishtat që humbasin”, i cili zbatohet me kaq rigorozitet ndaj shqiptarëve. Kjo bëri që një pjesë e tyre e madhe të përqafonin islamin, kur zotër të vendit u bënë turqit. Meqë ra fjala, fara e doktrinës së krishterë, e mbjellë me aq durim e përpjekje gjatë shumë shekujve, ka mbjellë një lloj fare të urrejtjes racore, përbuzjeje dhe hakmarrjeje, e cila do të kërkojë ende shumë kohë për t'u zhdukur.

Padyshim, ardhja e turqve paraqiti një faktor të tretë fetar në ujërat tashmë të turbulluara fetare, i cili mendohet se do t'i shërbente shërimit të kombit. Turqit ishin më të zgjuar se sa ç'kishin qenë grekët. Ata nuk u thanë shqiptarëve se e vetmja rrugë për në Parajsë kalonte nëpërmjet *Kuranit*, dhe të mësuarit e *Profetit të Mekës*. Ata thjesht u thanë bijve të pabindur e xanxarë të Shqipeve se, nëse ata donin të ruanin lirinë e tyre, të mbanin integritetin dhe nderin, duhej të betoheshin për aleancë me islamin. Po ta bënin këtë, ata mund të mbanin armët e tyre, madje të mbanin aq sa të donin, të jetonin jetët e tyre siç ishin mësuar ta bënin, duke mbetur njerëz të lirë. Të krishterët, në anën tjetër, nuk do të gëzonin as pozita, as të drejta trashëgimie, as të drejtë për të mbajtur armët dhe pozita e tyre përpara ligjit do të mbetej në mëshirë të gjykatës. Në rrethana të tilla, nuk të habit fakti që kaq shumë prej tyre e pranuan islamin, duke përbërë sot thuajse shtatëdhjetë për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Nuk të habit as fakti që shumë shqiptarë të krishterë nga qendrat e *Kishës Ortodokse Greke* emigruan për në Itali ose në Greqi. Ata që mbetën të krishterë në Shqipëri, humbën nga vetja diçka në karakter, çka kurrë nuk e kanë rimarrë. Shqiptonja e zbutur nuk ka qenë kurrë një shpend tërheqës; në rastin më të mirë, është një mbret në mërgim.

Një fis katolikësh në Mirditë arriti një marrëveshje të veçantë me sulltanatin, i cili i mbronte ata prej këtij poshtërimiti, duke përfituar për vete kushte të njëjta, madje edhe më të mira sesa ato fise që pranuan të shndërroheshin në islam. Kjo pati, natyrisht, ndikimin e vet mbi fiset e tjera të krishtera të veriut dhe u dha atyre një farë imuniteti. Përveç kësaj, *Porta e Lartë* ishte e kënaqur të mbante marrëdhënie miqësore me Perandorinë e Romës së Shenjtë.

Të dhënat për Ali Pashën e Janinës, për intrigat e tij me anglezët, Napoleonin dhe francezët, rusët, turqit, për hakmarrjen e tmerrshme e shkatërimin e suljotëve, himariotëve, pargiotëve, fiseve të krishtera që gati ishin shfarosur, mund të kursehen nga kjo e dhënë e shkurtuar e historisë tragjike të Shqipërisë. Ata që quhen *particeps criminis*⁶³ në këto krime, e sjellin atë shumë afër shtëpisë, tek njerëzit që unë i respektoj dhe i vlerësoj lart.

Nëse fantazmat e të gjitha krimeve që kanë lënë njollat e gjakut në tokën e Shqipërisë do të ktheheshin në jetë përsëri dhe do të vizitonin vendet e tragjedive të tyre, Shqipëria do të ishte një nga vendet më të mallkuara. Me të njëjtën masë, nëse kjo përbën mjaft material për të bërë një ferr, atëherë Shqipëria vetë meriton një nder shumë të veçantë për kontributin që ka dhënë për të populluar parajsën, me njerëzit e saj të ndershëm, të bukur dhe të pafajshëm.

⁶³ Pjesëmarrës në krim.



“AH, MIQTË E MI, NËSE QOFTË EDHE NJË PREJ NESH DO TË SHPËTOJË NGA KJO BETEJË, DUHET TË BËHEMI TË TËRË DHE PËRGJITHMONË ENGJËJ TË PAVDEKSHËM. NE NUK DO TË LUFTONIM MË NË KRYE TË RADHËS, AS DO JU DËRGOJA MË NË LUFTËRA QË I JAPIN BURRAVE EMËR E MIRËNJOHJE. POR TANI, SIGURISHT, DHJETË MIJË JETË TË HUMBURA NA RRETHOJNË DHE NE AS I MARRIM DOT ME VETE, AS I SHPËTOJMË DOT - E PRA, LE TË ECIM PËRPARA!”



XII



PATRIOTIZMI – VIRTYT I MESNATËS

Shqiptarët kanë një proverb të çuditshëm dhe të pazakontë:

“Kush të ndihmon? – armiku!”.

Për ta perifrazuar paradoksin, ai mund të lexohet diçka si kjo: A kemi miq? Jo, nuk kemi asnjë. Po armiq? Sa të duash. Atëherë veç nëse na ndihmojnë ata, se askush tjetër nuk na ndihmon. Nëpërmjet tyre, gabimet tona bëhen “muzikë e përjetshme e këngës së tokës dhe asaj të qiellit”. Në të vërtetë, kjo më ngjet me një epikë të vjetër saksone të një dite kur një veteran, mbajtës i një medaljeje të lartë, u bëri thirrje saksonëve lindorë që të qëndronin kundër vikingëve të Olafit. Edhe Hektori u bëri thirrje shokëve të tij: “Bëhuni zemërfortë, të guximshëm, guximtarë edhe kur forca jonë bie!”. Ndërsa Glauku, në orën e tij më të rëndë, u drejtohet ushtarëve të tij:

“Ah, miqtë e mi, nëse qoftë edhe një prej nesh do të shpëtojë nga kjo betejë, ne duhet të bëhemi të tërë dhe përgjithmonë engjëj të pavdekshëm. Ne nuk do të luftonim më në krye të radhës, as do ju dërgoja më në luftëra që i japin burrave emër e mirënjohje. Por tani, sigurisht, dhjetë mijë jetë të humbura na rrethojnë dhe ne as i marrim dot me vete, as i shpëtojmë dot – e pra, le të ecim përpara!”.

Një ngjarje që e kam jetuar vetë, mund të ngjasë me këtë shpirt të shqiptarëve.

Koha: verë e viti 1909; ora: mesnatë.

Vendi është Tirana, kryeqyteti i sotëm i Shqipërisë, në dhomën e *selamllëkut* të një beu.

Për orë të tëra kishim folur për të metat e shqiptarëve, i kishim bërë ato kopicë, sa na dukej se ishin bërë sa malet. Pastaj, papritmas, miku im u ngrit e duke u siguruar se qepenat ishin mbyllur fort, nxori nga xhepi një varg çelësash, eci drejt murit të brendshëm të dhomës dhe e futi çelësin në një bravë të fshehur.

“Dua të të tregoj diçka”, më tha ai.

Mendja më shkoi menjëherë tek ndonjë armë e fshehur. Një hamendje e tillë ishte e pavend, edhe pse e njihja si udhëheqës të një çete të fuqishme guerrile. Pastaj ai hapi një derë të ngushtë e të ulët dhe pasi mori një llampë, më tha që unë të rrija anash. Aty, për habinë time tronditëse, pashë diçka shumë më serioze, më të rëndësishme dhe më inkriminuese se çfarëdo lloj arme që ai mund të kishte fshehur në atë vend aq të mbyllur. Në dysHEME gjendeshin vandakë me libra, të lidhura, mes të cilave abetare të mësimit të gjuhës shqipe, libra të thjeshtë historie, poema për Skënderbeun, këngë për lirinë dhe dashurinë pasionante për atdheun e tyre. Unë e dija se ky ishte një dinamit politik i cili, nëse zbulohet, sigurisht që do të sillte një gjykim të shpejtë mbi kokën e tij, burgosje ose azil, ose të dyja. Sepse çfarëdo lloj forme e gjuhës së shtypur në libra, edhe sikur të ishin histori ninullash për të vënë fëmijët në gjumë, do të ishte njësoj – *yasak* – e ndaluar! Sikur nuk kishim folur bash atë natë për një vëlla të beut, i cili kishte kaluar thuajse gjysmën

e jetës së tij në arrati. Ai nuk kishte bërë ndonjë krim tjetër, përveçse ishte përzier në shtypjen e këtyre libërthave jashtë Shqipërisë dhe i kishte sjellë në Shqipëri si kontrabandë për t'i qarkulluar midis njerëzve.

Patriotizmi ishte virtyt i mesnatës. Shqipëria si vend, shqiptarët si racë dhe komb i veçantë që e bën patriotizmin pjesë të pandarë të jetës, aq të natyrshme sa vetë frymëmarrjen, aq të shenjtë sa lutjen, nuk kishin vend ose pjesë në skemat turke. Qeveria e tyre pranonte vetëm një ndjenjë, atë të osmanllinjve. Zyrtarisht shqiptarët ishin osmanllinj, me një fije të lidhur me *kaurrët*, e përdorshme ajo kryesisht për të nxitur trazira. Për aq kohë sa qeveria turke do t'i mbante shqiptarët larg prej dashurisë, besimit dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin dhe do t'ia dilte të mbante ndezur urrejten, përbuzjen dhe fyerjen midis tri feve, katolikëve, ortodoksëve grekë dhe muhamedanëve, administrimi i tyre do të bëhej me sukses. Për këtë ishte nxitur propaganda greke. Shkollave greke nuk u ndërhyej kurrë. E përse do t'u ndërhyenin, kur fëmijët mësonin gjeografi, histori dhe fe, pa as më të voglën shenjë që t'u tregonte se kush ishin, nga vinin, çfarë ishin në këtë botë, përveçse grekë!?

Lutjet e tyre duhej të mbaheshin në greqisht, sepse “shqipja ishte gjuhë e pafë, në të cilën Zoti i krishterë nuk kuptohej”. Jo më i vogël ishte zelli i hoxhallarëve myslimanë në mësimin e rinisë myslimane, ku nuk gjendej kurrë, qoftë edhe një shenjë që të tregonte se nxënësit ishin diçka tjetër, përveçse osmanllinj.

Patriotizmi ishte virtyt i mesnatës. Një numër të rinjsh të rritur në Kishën Ortodokse u dërguan në Amerikë prej prindërve të tyre për t'u dhënë atyre një shans për jetën. Me të arritur në portin e Nju-Jorkut, atyre iu tha se duhej të deklaronin kombësinë e tyre si grekë, pasi kishin frikë se po të thonin se ishin shqiptarë, ata do të ktheheshin mbrapsht, si të huaj të padëshirueshëm. Ata kështu bënë dhe e deklaruan përkatësinë e vet si grekë. Autoritetet, duke ditur se kjo nuk ishte e vërtetë, i kthyen mbrapsht për deklarim të rremë të identitetit.

Patriotizmi ishte virtyt i mesnatës. Në qytetin e Elbasanit jetonte një

shqiptar muhamedan i thjeshtë dhe i varfër. Qyteti kontrollohej nga një armatë turke. Treqind burrave që kishin guxuar të nxitnin mësimin e gjuhës shqipe dhe të dërgonin bijtë e tyre në shkollën amerikane që në atë kohë mbahej në shtëpinë time, si i vetmi vend ku këta nxënës dhe mësues ndjeheshin të sigurtë, po u jepej një trajtim i veçantë për këtë sëmundje të patriotizmit. Pronari i shtëpisë-shkollë një ditë po i lëndonte djemtë duke treguar se sa mirë kishin mësuar dhe çfarë do të bënin ata për vendin e tyre kur të bëheshin burra. Pasi e rrahën deri sa i ra të fikët nga dhimbjet, si një ndjesë për ndëshkim të mëtejshëm, torturuesit e tij i kërkuan me urgjencë të rrëfehej se ku i kishte fshehur armët në shtëpinë e tij. Përgjigjja e tij ishte kjo:

“Ju dhe çdokush e di se unë nuk kam armë të fshehura. Ju nuk po më rrihni për armë, por se jam shqiptar dhe se nuk ndjehem i turpëruar kur e pranoj këtë. “Unë kam lindur shqiptar dhe nëse më duhet të vdes për këtë, i tillë do të vdes”.

Ndëshkimi vazhdoi dhe ai burrë u rras në burg pa iu dhënë asnjë ndihmë mjekësore, me duar të thyera, me shenja të vrerosura në kokë e në trup, me fytyrën të larë në gjak prej plagëve të marra nga kondaku i pushkëve.

Patriotizmi ishte virtyt i mesnatës. Edhe ca fjalë në lidhje me fenë. Asgjë nga ato që po trajtojmë këtu, nuk gjendet sot. Ato kanë të bëjnë me atë çka kam parë në vitet kur Shqipëria ishte ende me zgjedhën turke në qafë. Një vëzhgues i zakonshëm i asaj kohe do të kishte menduar se shqiptari nuk është njeri fetar. As xhamia, as kisha nuk mund të pretendojnë se kishin besimtarë të bindur. Arsyeja ishte e thjeshtë, pasi këto institucione nuk arrinin t’i bënin për vete këta besimtarë. Shqiptari e dinte se të ishe besnik ndaj myslimanizmit ose ndaj *Kishës Ortodokse Greke*, do të thoshte të tradhtojë racën dhe gjakun me të cilin vendi i tij ishte shenjtëruar nëpër rrjedhë të mijëra viteve.

Këtu ekzistonte një vuajtje e tmerrshme shpirtërore, për të cilën nuk kishte dhembshuri. Njeriu mund ta kuptojë se si një popull mund të qëndrojë ashtu siç

duket, i patolerueshëm, i pikëlluar ose i shtypur. Zioni⁶⁴ i tij ishte përherë në mes, si një strehë ngushëllimi; dhe feja e tij, besimi i tij, kishin krahë dhe ishin diçka hyjnore dhe e fuqishme sa vetë Zoti; ndaj familja, shtëpia dhe vendi, po edhe vetë jeta, mund të mbështeteshin në besim dhe fe. A ishte ky sekret i qëndresës së Izraelit dhe triumfi i tij përfundimtar? A nuk ishte ky që i mbështeti puritanët në luftën e tyre për lirinë fetare edhe në botën e vjetër, edhe në të renë?

Por Shqipërisë i ishte mohuar ky moral i ruajtur në shpirtin e saj. Feja muhamedane ishte shfrytëzuar prej qeverisë turke për ta shkatërruar dhe zhdukur si diçka blasfemike dhe të turpshme fenë e baballarëve të tyre. Kisha Ortodokse Greke, e mbështetur në propagandën e saj në Shqipëri prej një shoqërie krejtësisht laike dhe politike, me objekt të hapur e të betuar për të përfutur zotërime në gjysmën jugore të Shqipërisë, ndryshonte prej turqve vetëm në format dhe metodat e saj, duke qenë, nëse ishte sadopak e ndryshme, edhe më e paskrupullt dhe e poshtër, që zotëronte shumë më pak virtyt dhe nder, dhe shumë më tepër dredhi, hile, gënjeshtër dhe bestytni.

Në ditët e luftës hebraike për zotërime të *Tokës* së tyre të *zgjedhur* dhe lirinë e adhurimit ndaj Zotit të tyre, patriotizmi arriti formën e tij më të lartë, si shpirti i tyre i fuqishëm, i strehuar në fenë e tyre kombëtare.

“Nëse të harroj ty, o Jeruzalem, m’u thaftë dora e djathtë! Nëse nuk e mbaj mend këtë, m’u thaftë gjuha! Nëse nuk e zgjedh Jeruzalemin mbi çdo gëzim tjetër në këtë botë, mos qofsha!”

Në Shqipëri, kodra e Zionit ishte shkërmoqur në pluhur. Patriotizmi ishte virtyt i mesnatës. Gjithmonë ka përjashtime ndaj rregullave të tilla të vëna për të karakterizuar një komb ose përvijuar një periudhë... Në Elbasan ishte një prift me zgjuarsia dhe sqimë të pazakontë dhe me zemër prej patrioti. Ai kishte një djalë të shkëlqyer dhe premtues, për të cilin unë fillova të shfaqja shumë interes

⁶⁴ Termi Zion (*Tzion*) u përdor fillimisht për të përcaktuar zonën e kështjellës në Jeruzalem dhe më pas u përdor për Tempullin e Solomonit dhe, në përgjithësi, Tokën e Premtuar. Sipas *Biblës hebraike*, Zoti ndodhet mes njerëzve të tij në Izrael. (Shënimi im)

dhe i sigurova një bursë në *Kolegjin Robert* në Stamboll. I ati ishte mirënjohës për mundësinë e dhënë dhe e dërgoi të birin menjëherë. Pastaj erdhi peshkopi, tmerrsisht i zemëruar, e zbriti atë nga kadetra e kishës duke i kërkuar publikisht që ta hiqte djalin menjëherë nga kolegji protesant ose atij do t'i hiqej veladoni i priftit dhe do të largohej nga kisha. Djali vazhdoi studimet. Fill pas kësaj, peshkopi nisi ta vinte në jetë kërcënimin e tij. Në këtë kohë, një grup besimtarësh ortodoksë me ndikim shkuan dhe i thanë peshkopit se nëse do të tentonte ta largonte priftin, i tërë qyteti do ta përzente vetë atë me gurë. Djali vazhdoi studimet dhe sot ai mban një pozicion shumë të rëndësishëm dhe të përgjegjshëm në qeverinë shqiptare.

Elementi i tretë që po hynte në jetën fetare të Shqipërisë në atë kohë, ishte feja katolike. Kjo fe ishte pakrahasimisht më e mirë se feja ortodokse greke, ose ajo myslimane përse i takon patriotizmit. Ajo ende përmbante shumë elemente që preknin zemrën e shqiptarëve besnikë. Sipas *Traktatit të Berlinit*, Austrisë i ishte dhënë protektorat mbi fiset katolike të veriut. Këtë nuk e duroi dot Italia dhe kjo fyerje shpesh e bëri atë të përfshihej në intriga me muhamedanët, të cilët vetëm sa e bënin situatën edhe më të ngatërruar. Rivaliteti midis dy qeverive me kohë u bë qesharak, veçanërisht në qendra katolike siç ishte Shkodra. Nëse austriakët ndërtonin një katedrale, italianët do të ndërtonin një spital, pastaj Austria një dispenseri dhe Italia një shkollë bujqësore, pastaj Austria një shkollë industriale, Italia diçka tjetër. Kështu vazhdonte kjo dramë komike me seri.

Priftërinjtë dhe njerëzia u lodhën nga ky rivalitet. Në fakt, nuk mund të ishte ndryshe. Por po t'i krahasojmë me të tjerët, priftërinjtë katolikë ishin të një karakteri të mirë. Ata ishin të sinqertë, të ndershëm, intelegjentë, të zgjuar dhe të përkushtuar ndaj besimtarëve të grigjës së tyre dhe shumë prej tyre ishin patriotë të vërtetë dhe të zjarrtë.

Duhet përmendur në kalim edhe sektin e bektashinjve, të cilët janë shumë të fuqishëm në Shqipëri. Ky është një sekt i fshehtë, ritualet e të cilit janë pak të njohura. Origjina i vishet në mënyra të ndryshme një imami, pasardhës i Muhametit

dhe njërit prej apostujve të krishterë. Ai sekt njeh mësimet e Jezuit, përfshirë faljen, bamirësinë, dashurinë vëllazërore, thjeshtësinë, jetën e varfër, të dlihtë e të përunjur. Këta besimtarë predikojnë barazinë e grave dhe të drejtën e tyre për arsim dhe për të jetuar jetën e tyre në këtë botë. Sekti u ndalua prej qeverisë turke po aq shumë, në mos edhe më tepër se të krishterët, sepse ata ishin mbështetës të fuqishëm të lëvizjes kombëtare shqiptare. Shumë prej tyre janë midis dëshmorëve që ranë për lirinë e Shqipërisë. Këta ishin gjithashtu bijtë e *patriotizmit të mesnatës*.

Disa javë pas takimit të mesnatës me beun e Tiranës arrita të mësoj pikërisht për peshën e “dorës” që po përpiqej të shkërmoqte jetën e shqiptarëve. Një ditë, një trokitje e fortë goditi në derën e oborrit të shtëpisë sonë të rrethuar me mur në *Rrugën e Dibrës*. Një tellall i bashkisë më tha të paraqitesha tek zyra e prefektit menjëherë. U solla rreth e rrotull për të shmangur rrugët ku mund të bija në sy. Dhashë një intervistë të shkurtër përpara kryetarit të bashkisë që ishte shqiptar. Me pak fjalë, ai më tregoi jozyrtarisht se *Komiteti i Fshehtë i Turqve të Rinj* kishte nxitur disa fshatarë myslimanë që të vinin në Tiranë dhe t’i jepnin fund punës sime. Sipas tyre, unë nuk isha amerikan, por spiun austriak. Unë po shtroja udhën që Austria të merrte zotërimin e vendit dhe, kur kjo të ndodhte, çdo muhamedan të pagëzohej si katolik me forcë. Këta burra, rreth dyqind vetë, ishin në shtabin e *Komitetit të Bashkëm Përparimit*, secili me mauzerin gati, çka do të thoshte shumë.

Kryetari vetë ishte i pafuqishëm. Siguria ime e vetme ishte të zhdukesh, të shkoja në Durrës, ku do të më siguronin mbrojtje. Po familja ime? Në fund të fundit, këta burra ishin shqiptarë dhe do të garantonin që gruaja dhe fëmijët e mi nuk do të cënoheshin. Kështu, përsëri në mesnatë, ndërkohë që ata duhej të ishin ekzekutorët e mi, u bënë mbrojtësit e mi. Kështu, i shoqëruar nga një roje, me kuajt e tyre që m’i kishin dhënë vetë ata, u nisa drejt Durrësit, pasi i kisha thënë “mirupafshim” gruas sime, nënë e një bebeje dyjavësh, dhe tre fëmijëve tanë të vegjël. Kështu e mësova edhe unë leksionin tim të *patriotizmit si virtyt i mesnatës*.

Më pas malet u mbushën plot me guerrilas të drejtuar prej parisë së tyre të

kombit dhe ditët dhe netët u bënë edhe më të vështira, ndërkohë që javët kalonin. Shqipëria po u dilte nga dora. Autoritetet ushtarake morën urdhra të shkonin tek shtëpitë e këtyre udhëheqësve për t'u kërkuar grave se ku i kishin burrat. Justifikimit të tyre se ata kishin ikur që andej, iu përgjigjën me një goditje shpate:

“Ata duhet të paraqiten në shtabin tonë brenda tri ditësh, ose ne do të djegim shtëpitë dhe çdo gjë brenda tyre!” A u paraqitën burrat?

Ata as që nuk i njoftoi njeri për atë kërcënim. Po të bëhej kjo, ata do të detyroheshin të bënin diçka të pamatur, të dëshpëruar, që do t'u binte si goditje traumatike, ndoshta e papërballueshme mbi kokat e tyre. Me fëmijët, gratë dhe shtëpitë e djegura? Cilën do të zgjidhnin? Jo, ata nuk u njoftuan dhe kështu dy palët iu nënshtruan fatit të tyre dhe shpresave për diçka më të mirë.

Patriotizmi lulëzoi si virtyt i mesnatës. Dhe kështu vijoi goditja e vitit 1910, kur turqit mësuan për planet për një kryengritje të përgjithshme në tërë Shqipërinë Veriore e Qendrore. Në qendrat kryesore të populluara, në Dibër, Krujë, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe tërë qytetet midis tyre, ushtria e Turgut Pashës ndërmoi një fushatë të pamëshirshme për çarmatimin e popullatës, shkatërrimin e çdo libri në gjuhën shqipe dhe ndëshkoi në çdo qytet, fshat dhe qendër banimi, çdo njeri që gjeti, deri në atë masë sa ta mbanin mend sa kohë të jetonin.

Deri në atë kohë unë i kisha mbushur mendjen vetes se mjaftonte flamuri amerikan që valëvitej në dritaren e shtëpisë sonë për sigurinë e familjes sime. Kjo nuk pinte ujë më. Një skuadër e ushtrisë turke, e prirë nga një flamur turk dhe një oficer, erdhën e hynë drejt e në shtëpinë time për të na bastisur për armë. Në vend të tyre, ata gjetën gjënë më kompromentuese, më inkriminuese. Ishin librat shkollorë në gjuhën shqipe që po i përdorja për djemtë e shkollës. Ata i rrëmbyen të gjitha dhe u larguan bashkë me to në gjendje triumfi.

Brenda një ore ishte kondaku i pushkës që shpërtheu derën me forcë. Ishte

i njëjti oficer që erdhi me skuadrën e tij, këtë herë me bajoneta të hapura dhe, nëpërmjet një përkthyesi shqiptar, u njoftuam se duhej të largoheshim nga Shqipëria menjëherë. Kështu, të hipur nëpër kafshë të ngarkuara ashtu siç mundëm në atë çast, brenda një ore u bëmë udhëtarë dhe morëm rrugën në drejtim të lindjes, nëpër male e lugina në drejtim të Manastirit. Për të arritur atje na u deshën pesë ditë. Kështu e tërë familja, Kerri, Earli, Luisi, Pauli, Kristeli dhe bebja jonë në krahë, të tërë bëmë gjithçka që mundëm për të mbajtur nderin e kombit dhe patriotizmin si virtyt të mesnatës.

Kështu, vetëm nën yjet si fenerë të largët mbi krye, nëpër malet e bardha, larg syve të botës, kombi i vogël ishte edhe një herë nën goditje. Tonelata abetaresh u gjetën të fshehura nëpër shtëpitë dhe dyqanet e popullit dhe përfunduan në flakë. Trena të ngarkuar me armë, të mbledhura nga e tërë Shqipëria, u dërguan në Manastir. Qindra e mijëra prej këtyre armëve ishin antika të vlefshme, të zbukuruara me argjend dhe të mbushura me gur gjysmë të çmuar, tani të vërvitura në kuti që ngjanin si të mbushura me mbeturina hekuri që prisnin të shkriheshin. Ishte e tëra një gjë e neveritshme dhe po aq e marrëzishme, sa edhe raprezaljet që shoqëronin konfiskimin e tyre. E vetmja gjë e mirë e tërë kësaj ishte rritja shkallë-shkallë, por e shpejtë e energjisë së popullatës dhe përcaktimit të saj për të hequr qafe njëherë e përgjithmonë këtë tmerr dhe ankth. Ishte koha e përpjekjeve për jetë a vdekje.

Gjatë verës së vitit 1912 gjithçka u vërtit rreth çështjeve kryesore që ishin kryengritjet spontane dhe të palidhura me njëra-tjetrën në tërë tokën e shqipeve, të cilat u njësuan në një ushtri të mrekullueshme që u mbledh në Fushën e Kosovës. Aty ishin zhvilluar aq shumë beteja historike, kishin luftuar stërgjyshërit e tyre në përpjekje për të hequr qafe armiqtë. *Porta e Lartë*, duke ndier se kjo kishte vënë në pikëpyetje bash jetën e perandorisë, dërgoi ushtritë e veta në atë fushë-betejë. Në këtë kohë, edhe ato dështuan. Besnikët e vjetër, të cilët i kishin mundësuar sulltanit dërgimin e regjimenteve të tij shqiptare dhe komandantët e tyre kundër vëllezërve të një gjaku, tani nuk vlenin më. Ata nuk hezituan të thoshnin:

“Ne nuk i kemi lënë shtëpitë dhe fushat tona në Azinë e Vogël për të ardhur që të luftojmë kundër vëllezërve tanë muhamedanë në Shqipëri”.

Në këtë kohë Portës së Lartë iu dërgua telegrafisht ky ultimatum:

“Ose pranoni kushtet tona brenda njëzet e katër orëve, ose ne do të marshojmë drejt Stambollit”. Menjëherë pas këtij ultimatum u organizua një komision që kërkonte të arrinte një marrëveshje me “arnautët” me nxitimin më të madh dhe me çdo kusht.

Shqiptarët e dinin se çfarë donin dhe kërkesat e tyre ishin gati:

1. Riorganizim i sistemit të taksave në atë mënyrë që të kemi pjesën tonë për përdorim po në vendin tonë.
2. Riorganizim të administratës së Shqipërisë me zyrtarët që janë kompetentë, të ndershëm dhe që flasin gjuhën shqipe.
3. Shqiptarët të lirohen nga detyrimi ushtarak jashtë Rumelisë, me përjashtim të rasteve të luftërave të tashme me fuqi të huaja.
4. Të themelohet një shkollë kombëtare bujqësore.
5. Të hapen shkolla normale për përgatitjen e mësuesve .
6. Të hapen shkolla kombëtare anembanë Shqipërisë, sapo të sigurohen mësuesit e nevojshëm për këtë, si dhe të lejohet mësimi i gjuhëve europiane.
7. Të hapen rrugë kombëtare dhe të zhvillohet tregtia me vendet e huaja.
8. Tërë Shqipëria, përfshirë këtu katër vilajetet, Shkodra, Kosova, Manastiri dhe Janina, të bashkohen nën një qeveri autonome, me një guvernator shqiptar në krye dhe të përdoret gjuha shqipe si gjuhë zyrtare.

Pikat e kërkuara ishin trembëdhjetë, nga të cilat vetëm një u hoq, pasi nuk u pa aq e nevojshme. Për të riparuar dëmët e shkaktuara dhe për të filluar reformat, u dhanë një gjysmë milioni lira turke.

A duhej të zgjaste më kalimi i Shqipërisë nga vasaliteti në liri? A duhej që

patriotizmi shqiptar, i cili ishte mbajtur prej sunduesve otomanë gjatë një periudhe prej 434 vjetësh në hijen vdekjeprurëse të natës, të kalonte si virtyt i panjohur kombëtar?

Fatkeqësisht, përgjigjja kërkon më shumë se një shembull, diçka më të plotë, fjalë më gazmore sesa ato që do të gjenden në kapitujt që vijojnë. Në pritje, le të kujtoj atë që Hall Caine⁶⁵ e ka bërë karakterin kryesor të veprës së tij kur thotë:

“Është Gori i braktisur, apo jo?

“Edhe mund të jetë zotëri, – por këtë e tha qyqja, pasi hëngri vezët nga foleja e mëllenjës dhe la pas një rrëmujë të paparë në të”.

⁶⁵ *Sir Thomas Henry Hall Caine* (14 maj 1853 – 31 gusht 1931), i njohur si Hall Caine, ishte shkrimtar dhe dramaturg i fundit të epokës viktoriane dhe të asaj eduardiane. Disa nga romanet e tij janë bërë filma. Ato ishin kryesisht romanca me lidhje dashurie mes tre personazheve, por ai trajtoi edhe disa nga çështjet më të mprehta politike dhe sociale të kohës. (Shënimi im – MB)



SHPESH NJË FJALË PËR TRAGJEDINË, NJË PYETJE, NJË
VËSHTRIM, NJË SHTRËNGIM DORE PËRBËJNË GJUHËN
UNIVERSALE TË ZEMRAVE TË TYRE DHE JANË MË TË ËMBLA SE
ÇDO GJË TJETËR NJERËZORE.



XIII



GJUHA UNIVERSALE E NDJENJAVE SHQIPTARE

*Oh, ne ende besojmë disi, se e mira
Do vijë një ditë dhe do mposhtë të keqen,
Ndërgjegjen e brejtur, mëkatet që mbjell dëshira,
Të metat e dyshimit dhe njollat e gjakut.*

*Kur asgjë nuk ecën më në këmbë, kuturu,
Dhe asnjë jetë nuk duhet shkatërruar,
As hedhur si mbeturinë krejt ashtu,
Kur zoti çdo gjë të plotë e ka mbaruar.*

In memoriam: Alfred Tennyson⁶⁶

⁶⁶ *Alfred Tennyson (Alfred Tennyson), baroni i parë Tennyson (6 gusht 1809 – 6 tetor 1892) ishte poet, laureat i Mbretërisë së Bashkuar në pjesën më të madhe të sundimit të mbretëreshës Viktoria; mbetet ndër poetët më të parapëlqyer në gjuhën angleze. (Shënimi im – MB)*

Përpara se të kthehesha në Shqipëri, bëra një pelegrinazh në Zvicrën gjermane, aty ku Earli kishte vijuar shkollën. Gjithashtu në Frajburg ku ai pat kaluar katër muaj të pushimeve verore. Unë u qetësova me atë që më tha zonja Froelich për djalin tim, pasi e dija se sa të larta ishin standardet e saj. Ajo i bëri atij këtë nderim:

“Ai ishte absolutisht i singertë, nuk e fshihte kurrë të vërtetën për të mbrojtur veten. Ai ishte i pastër në mendim, fjalë dhe veprime. Gjithashtu, ai ishte shumë nervoz (siç ishte nëna e tij), tejet i gjallë, i alarmuar dhe i mprehtë. Në disa aspekte, më i pjekur se vitet që kishte mbi vete, në raste tjera, si një fëmijë”.

Kjo më bëri të ndjehesha mirë. Me këto copëza prej *Portofolit të kohës*, unë u ktheva në Shqipëri, duke lënë Loisin në një shkollë vajzash të quajtur *La Chattaniere*, afër Kopesë (Coppe), disa milje larg Gjenevës. Drejtori i shkollës, zoti Shuartz, dhe gruaja e tij shumë e dashur, një familje e re, e morën vajzën menjëherë për zemër, sikur ta kishin fëmijën e vet. Oh, sa i lehtësuar u ndieva! Veçanërisht po të kem parasysh faktin se as e ardhmja jonë dhe as ajo e misionit nuk mund të parashikoheshin. Çfarëdo që të ndodhte, të paktën ne do të ishim të qetë se ajo ishte në duar të sigurta. Sapo arrita në Durrës, pas një mungese prej gjashtë javësh, u vura nën arrest, më dërguan në burg dhe u mbylla pas hekurave. M'u mbajtën edhe vetë bagazhet. Nuk kishte as dyshek, as ushqim, asgjë për të pirë. Aty u mbajta pa asnjë mundësi komunikimi.

Nga dritarja e qelisë shikoja vetëm këmbët e njerëzve që shkonin e vinin anës murit të burgut. Në një çast arrita t'i tërhiqja vëmendjen një djali të vogël që lozte aty pari. I hodha atij përmes hekurave një letër që ta dërgonte tek konsulli austriak dhe një monedhë për atë vetë. Nuk kisha asnjë dyshim se ai do ta bënte këtë. Dhe e bëri. Konsulli austriak ndërhyri dhe unë u paraqita pranë një gjykate.

Oficeri që merrej me mua, ishte i ri në atë detyrë dhe i dobët si një mi i kapur në çark. Unë ia dola të merrja disa informata në lidhje me ngjarjet që kishin ndodhur gjatë kohës që kisha munguar në Shqipëri. Lufta Ballkanike po shpërthente në të tëra anët. E pamëshirshme, mizore, shkatërruese. Shpalljet e

pavarësive të popujve të Ballkanit, thënë me plot gojën, ishin çlirim prej zinxhirëve të turqve. Ata po çliroheshin nga zgjedha katërqind e pesëdhjetë vjeçare e robërisë. Ëndrra shqiptare për të qenë shtet autonom nën turqit kishte shkaktuar një ankth të tmerrshëm. Shqipëria po rrënohej, sikundër nuk ishte rrënuar kurrë më parë, as edhe gjatë pushtimit disashekullor otoman.

Ndihmësi im shqiptar, Grigor Cilka, ishte arrestuar dhe larguar që andej dhe thuhej se ishte dënuar me vdekje. Serbët dhe grekët ishin vënë në garë se kush do ta arrinte portin e Durrësit më parë se tjetri, siç bënë më vonë edhe për atë të Selanikut. Në rastin e parë fituan serbët, në të dytin, grekët. Gjithmonë një vend si Shqipërinë, që ishte e dobët, e pambrojtur dhe pa miq, me zotërit e saj turq që i shkaktonin asaj më shumë trazira se sa të tjerëve, kishte një numër të caktuar që donin ta gllabëronin.

Lufta Ballkanike solli kaq shumë tmerre dhe shkaktoi një rrëmujë të tillë sa që dalja prej saj e popujve që u përfshinë në të mund të marrë shumë kohë. Por le të kthehem te burgimi im. Pas një jave paraburgimi, falë atij djali dhe mikut tim austriak, konsullit, ja tek isha në gjyq përpara një majori serb. Tani do të dëgjoja edhe aktakuzën:

Unë paskësja qenë armik i Serbisë, paskësja bërë propagandë aktive kundër saj në tërë Shqipërinë.

Në përgjigjen time unë i thashë se kisha qenë burgosur në Manastir një vit dhe kisha ndejtur në arrati, pasi isha nën hetim prej turqve. Ndërsa tani po kthehesha pas gjashtë javësh nga Zvicra, pasi kisha pasur një fëmijë të sëmurë, të cilin e kisha varrosur atje. Iu tregova se isha rrugës në kthim për tek familja ime në Elbasan, dhe as që kisha dëgjuar për pushtimin e Shqipërisë deri sa kisha arritur aty. E tërë kjo duket se nuk bëri asnjë përshtypje tek ai. Kështu m'u desh të prisja vendimin.

Në vendim thuhej se unë duhej të zhdukesh që me barkën e parë që nisej atë mbasdite. Unë protestova se nuk mund ta lija familjen time të pambrojtur dhe të

pa siguruar. Ai u tregua “bujar”; më la të shkoja në Elbasan të kaloja njëzet e katër orë duke u përgatitur, t’i ktheja ata në Durrës dhe të kapja barkën e parë që nisej sapo të arrija.

Atë natë u nisa për në Elbasan dhe, duke ecur me tërë forcat, arrita në mbrëmje një ditë më pas. Arritja ime ishte marrë vesh dhe kur iu afrova pazarit, aty më prisnin një numër njerëzish që u mbledhën rreth meje duke më thënë:

“Si je, mirë? Si është çuni, mirë?”.

Iu përgjigja duke iu dhënë përherë përgjigje që nuk u tregonte të vërtetën siç ishte. Më në fund, njëri prej tyre e kapi kalin tim nga yzengjitë dhe më tha:

“Ju nuk po na tregoni të vërtetën. Ju po e mbani të vërtetën brenda. Ne duam ta dimë, ne duhet ta dimë, si është çuni?”.

Iu dhashë përgjigje me një fjalë të vetme:

“Vdiq”, dhe bëra një shenjë poshtë me gishtin e madh të dorës.

Papritmas kjo shkaktoi një rrëmujë dhe një reaksion, sikur i kisha lëshuar në shok elektrik. O Zot, po ata ishin të mësuar me tragjeditë në tërë format e saj, ndërkohë që ishin pikëlluar kaq shumë për fëmijën tim. Kishin mbetur pa gojë e në dhimbje të tmerrshme. Më në fund, Xhafa, pronari i restorantit theu heshtjen:

“Për atë Zot, nuk është e vërtetë ! ⁶⁷ Për atë Zot, kjo nuk mund të jetë e vërtetë!”.

Pastaj pasoi një heshtje varri. Më pas, të tërë hapën rrugën dhe ulën kokat ndërkohë që e ngava kalin drejt shtëpisë dhe familjes sime.

Ime shoqe, nëna e djalit, e cila kishte marrë një kartolinë nga i biri ku i thoshte se ndjehej më mirë, ishte tërësisht e papërgatitur për lajmin e kobshëm.

⁶⁷ Shqip në original.

Ajo u lëshua krejt dhe për njëzet e katër orët që pasuan ishte e tëra në një delir të tmerrshëm tragjik. Gjithsesi, gjatë tërë asaj mbrëmjeje, gjatë natës, si dhe në ditët që vijuan, grupe pas grupesh, elbasanasit, si të krishterët ashtu edhe myslimanët, erdhën për të shprehur ngushëllime. Shpesh një fjalë për tragjedinë, një pyetje, një vështrim, një shtrëngim dore përbëjnë gjuhën universale të zemrave të tyre dhe janë më të ëmbla se çdo gjë tjetër njerëzore.

Ditën tjetër u paraqita tek shtabi serb, tek oficeri në detyrë. Ai më pyeti se sa kohë kisha në atë qytet. I tregova. Ai u xhindos dhe shpërtheu me kërcënime të ulëta. Pse nuk isha paraqitur tek ai me të arritur në qytet? I shpjegova aq sa munda me gjermanishten time të çalë për atë që kishte ndodhur. Ai as që deshi të dëgjonte dhe urdhëroi që të mbyllesha në qeli. Pas disa orësh, më thirrën përsëri dhe ai lëshoi këtë urdhër:

“Shko menjëherë në shtëpinë tënde, mos fol me askënd gjatë udhës, kyçe derën dhe mbaje atë të mbyllur. Nesër në mëngjes në orën tetë të jeni gati për t’u nisur bashkë me familjen tuaj për Durrës. Një roje e armatosur do të jetë i ngarkuar për të vëzhguar zbatimin e këtij urdhri”.

Duke punuar tërë natën, pjesërisht me paketimin e gjërave dhe pjesërisht duke u marrë me gruan, u bëmë gati për t’u nisur në orën që na u tha. Bëmë gati gjithçka, por nuk kishim asnjë kalë. Në fakt na nevojiteshin të paktën pesë. Kavasi⁶⁸ kishte kërkuar gjithandej, por nuk kishte gjetur qoftë edhe një, pasi gjithkush që kishte kalë, e kishte larguar që andej nga frika se i konfiskohej prej serbëve. Në orën e caktuar u shfaq tek dera një njeri i armatosur me një pushkë me kondak. Kavasi e hapi derën dhe brenda oborrit u fut ai dhe skuadra e tij me pushkë me bajoneta të hapura. Ai më lexoi një manifest me terma të tmerrshëm, duke deklaruar se gjërat e mia do të kontrolloheshin një për një, pasi dyshohej për dokumente inkriminuese, armë të fshehura, libra shqip, etj, etj.

⁶⁸ Kavas, shërbëtor, zakonisht i pajtuar për t’u kujdesur për përfaqësitë diplomatike, një shërbëtor që bën shumë punëra njëherit, si postën, rojën e objektit, etj.

Sirtarët u përplasën përtokë, librat u hoqën nga raftet dhe, po ashtu, u përplasën përtokë. Disa letra të mbledhura si shporta, të marra për t'u përdorur për studime speciale dhe të sjella në konak u hapërdanë sa andej këndeje. Bagazheve tona që kisha përgatitur për udhë, iu dha i njëjti trajtim, duke i përplasar dhe shpërndarë anembanë dyshemesë. Pastaj ikën me plaçkën e tyre (ndoshta dyshimet e tyre shkronin tek shumë paketa psallmesh të shkruara, të cilat duhej të kishin shkuar në zjarr shumë kohë më përpara).

Porta u kyç përsëri, roja ishte vënë në post dhe ne mbetëm përsëri aty ku ishim, në tërë atë ciklon që ata kishin lënë pas. Avullorja e së enjtes tani ishte e pamundur të arrihej, por ishte edhe një të dielën. Kështu ne nuk kishim asnjë mundësi t'i arrinim ato. Aliu, kavasi, kishte pikasur disa kuaj që u takonin jevgjitëve, që ishin aq të rrënuar sa jevgjitët ishin të sigurtë se ushtria pushtuese nuk do t'i bezdiste, pasi nuk i duheshin askujt.

Ditën tjetër, në orën tetë u dëgjua e njëjta krrakëllimë te porta. Kavasi e hapi dhe ata hynë brenda, bashkë me dy hamej që i kishin sjellë me vete, që mbanin koshat e letrave dhe të dokumenteve, psallmet dhe të gjitha gjërat që kishin marrë. Neve na u dha urdhër të iknim menjëherë për Durrës dhe madje të iknim në këmbë. Atë kalvar e filluam me dy fëmijë të vegjël, njëri foshnje disa muajsh, një djalë nëntë vjeç dhe një nënë gjysmë invalide. Kerry, e ëma e fëmijëve, e cila mbante Kristelin trevjeçar në krahë, unë që mbaja bebin, Pauli ecte vetë, rojet me bajonetat e tyre të tmerrshme, kërcënuese që na rrethonin, përbënin karvanin tonë.

Pastaj na detyruan të kalonim si në një paradë mes për mes pazarit, në një vend të hapur ku edhe na ndaluan. Pasi pritëm një çerek ore, kërkova leje për familjen që të ulej në buzë të trotuarit. Kështu bëmë dhe pritëm se çdo të bëhej me ne. Kjo zgjati ndoshta një orë. Gjatë kësaj kohe, një numër i madh elbasanllinjsh u mblodhën rreth nesh. Kjo bëri që roja të frikësohej, ndaj na urdhëroi të ecnim më tutje.

Turma qëndroi e heshtur, por e gatshme, duke na vështruar ndërsa ne po

kalonim. Ndërkohë Aliu e kishte marrë porosinë që të sillte kuajt e jevgjve, t'i ngarkonte me bagazhet dhe të na shoqëronte në një largësi deri sa të shihte çfarë do të ndodhte. Ne ecëm për më shumë se një orë, deri sa na zuri mesdita. Ishte frikshëm e vështirë për nënën. Pesha e saj ishte e rënduar. Këmbët dhe kyçet i kishte të enjtura. Rruga e vështirë. Kjo ishte sigurisht patetike për mos të thënë, tragjike. Pastaj na ndaluan edhe një herë në mes të një fushe ku kishte shkurre, hedhurina, kërçabla, gurë dhe driza që i kishte sjellë lumi në vërshimin e vet. Pa han, pa strehë, nën një qiell të mbuluar me re dhe kërcënues nga vetëtimat dhe bubullimat. Pastaj na u dha urdhër të vazhdonim rrugën për në Durrës. Në këmbë. Po ushqimi? Po natën si do e kalonim? Edhe harabelat kanë krahë. Ne nuk kishim asgjë. "Shoqëruesit" tanë na kthyen shpinën dhe morën rrugën për në qytet, pasi kishin bërë punën e tyre të ndyrë.

Asnjëherë nuk e mora vesh se si i lanë duart e tyre si Pons Pilati. Madje as që çava kokën për këtë. Nuk mbajta mëri ndaj tyre. Në kohëra të tjera, sikur të kisha qenë në udhëtim të gjatë dhe të vija vonë në shtëpinë e tyre, ata do më kishin mirëpritur bujarisht me duart hapur dhe në largim e sipër, mëngjesin tjetër do më kishin shoqëruar urimet e panumërta. Kjo do të ishte e vërtetë për çdo popull ballkanik. Psikologjikisht lufta kishte punuar në mendjen dhe shpirtin e tyre për t'i kthyer ata në bisha dhe ia kishte arritur. Këta njerëz të Egjeut e trajtonin luftën si lodër, loznin me rregullat e saj të ngurta të nderit, si dëshmitarë të betejës së shpatave midis Hektorit dhe Ajaksit. Sapo ata morën rrugën dhe u kthyen, arriti Aliu me kuajt, kështu që tani do ta kishim më të lehtë.

Prapë mirë përderisa e gjeta veten pranë një pele ngjyrë gri, pullalie, struktura anatomike e së cilës nga veshi te bishti, nga kurrizi te thundra ishte një karikaturë, gërdallë që ia kalonte për nga shëmtia një mijë herë Rosinantit. Me beben që e mbajta në krahë, i hipa kafshës butësisht, në mënyrë që të mos shembej tërësisht dhe të shtrihej përtokë. Kjo nuk vonoi shumë, pasi sapo arritëm te një moçal, ajo u rrëzua dhe mbeti aty petë në baltë. Ndaj vendosa të eci më mirë në këmbë. Ecëm edhe ca, deri sa arritëm tek një burim uji ku ndaluan. U lamë, u freskuam dhe

hëngrëm drekën që e kishim me vete. Pushuam pak.

Ndërsa po pushonim, në largësi vura re një kalorës që po vraponte me të katra. Ai kishte edhe një kalë tjetër të lidhur me litar nga prapa, të cilin e tërhiqte me një lak pas kalit të tij. Nuk vonoi dhe ai erdhi tek ne, zbriti me shpejtësi, u qas pranë meje dhe më përshëndeti duke më thënë:

“Zotëria im i pa kuajt që kavasi juaj ju kishte siguruar dhe duke e ditur se ata nuk ju çojnë dot në Durrës, më dërgoi në mal që të merrja kuajt që ishin të fshehur nga frika e serbëve. Ai më porositi që t’i sillja dy prej tyre këtu te ju. Ai më porositi gjithashtu t’ju përcjell dhe t’u jap tërë ndihmën e mundshme zonjës dhe fëmijëve tuaj”. Ky ishte një veprim samaritan, do të thoja, siç e meriton vetëm një vend në Shkrimin e Shenjtë. Dhe ky vend ishte Shqipëria.

Zonja ime dhe unë u hipëm kuajve të sapoardhur. Aliu hipi në një kalë, e po ashtu edhe fëmijët secili në nga një kalë. Pauli ishte në të vetin. Kristeli në një tjetër, e kështu me radhë. Nuk ka të numëruar se sa herë jemi rrëzuar, kemi mbetur në baltë, jemi bllokuar dhe kemi rinisur udhëtimin përsëri. Gjithsesi, ia dolëm.

Marshallah!⁶⁹

⁶⁹ Turqisht në original.



AJO QË MË KA FRYMËZUAR MË SHUMË PËR TË SHKRUAR KËTË
LIBËR, ËSHTË PIKËRISHT GJURMIMI I RRJEDHËS SË GJAKUT TË
RACËS SHQIPTARE QË NGA FILLIMET E HISTORISË SË SAJ DERI
NË KOHËN E SOTME, KUR PERANDORIA TURKE U SHKATËRRUA
DHE I LËSHOI ZOTËRIMET E SAJ EUROPIANE.



XIV



XHUNGLA BALLKANIKE

Nëse ngjarjet e këtij kapitulli do të vendoseshin një mijë vjet mbrapa, kjo do të ishte pakrahasimisht më e thjeshtë të shkruhej. Ky do të ishte pikërisht një tjetër episod xhungle në historinë e racës shqiptare, kur tërë pasionet primitive ishin ndërsyer mbi të për të zbrazur gjakderdhje dhe poshtërsi, kur qytetërimet dhe vetë fetë zvetënohen e zhvleftësohen. Fatkeqësisht këto ngjarje nuk zhvillohen para një mijë vjetësh, por rreth vitit një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë.

Kemi parë se si Shqipëria ishte shndërruar thuajse në një vend mysliman dhe se si ky fakt i kishte kthyer kombet e tjera, veçanërisht fqinjët, kundër saj. Ajo që nuk kemi përmendur, është se dita e dhënies llogari për këtë “mëkat” të saj ishte e sigurtë se do të vinte. Kombet e Ballkanit kanë kujtime ende të freskëta për çdo vepër që kanë kryer shqiptarët ndaj fqinjëve, qoftë e bërë vetë, qoftë e bërë me imponim nën urdhërat e sulltanit. Kjo ishte shkruar në mënyrë të pashlyeshme në zemrën dhe shpirtin e fqinjët, për t’u përdorur dhe nxitur për hakmarrje.

Këtu kishte diçka prej dramës që karakterizon gjakmarrjen. Kjo ishte përcjellë prej babait tek djali brez pas brezi, si të ishte një mallkim i lëshuar mbi ta, një njollë mbi nderin e tyre, e cila nuk ishte fshirë. Për pesë shekuj nën turqit, kjo traditë ishte stërgrumbulluar. Madje edhe aty ku shqiptarët nuk ishin të implikuar drejtpërdrejt, për shkak të identifikimit të tyre aq të afërt me Perandorinë Osmane, fitonte ndjesia se çfarëdo shpagimi që t'i bëhej Shqipërisë, ishte një shpagim ndaj vetë Turqisë.

Përveç këtyre, kishte edhe shkaqe të tjera zemërimi. Serbia ishte një komb i izoluar nga ujërat. Austria kishte zotëruar vetë bregdetin, deri në kufirin me Malin e Zi dhe shanset e saj për të siguruar një ose më shumë prej këtyre porteve për vete dukeshin tmerrësisht të largëta. Pikërisht Shqipëria me katër porte të zbrazëta, praktikisht të papërdorura, pa hekurudha për t'i lidhur ato me pjesën e brendshme të vendit, mbante peshën e fajsisë së një krimi kundër tërë shteteve të tjera të Ballkanit. Ishte vetë dora e përgjakur e turkut.

Hidhërimi i grekëve ishte një tjetër gjë, por gjithsesi, shumë i fortë. Fjala *barbar*, të cilën Herodoti e përdor aq shpesh në përshkrimin e stërgjyshërve të shqiptarëve, kishte edhe ajo peshën e vet.

Duke u kthyer në ditët e Aleksandrit, ata nuk duruan lojën e tij barbare me ushtritë e tyre. Ndoshta prej asaj kohe deri më tani, ata nuk kanë duruar përbuzjen shqiptare, për shkak të mungesës së cilësive të veta luftarake. Historia ka lidhje edhe me luftën greko-turke. Zotërimet e grekëve në Epir ishin shqetësimi i tyre kryesor.

Padyshim, Greqia ndante me Serbinë një urrejtje të thellë për myslimanët, qofshin ata turq apo shqiptarë. Kjo nuk kishte rëndësi fare.

Kishte deklarata zyrtare edhe nga Serbia, edhe nga Greqia, të cilat konfirmonin qëndrimet e tyre: Pashiqi, kryeministri i serbëve, deklaronte se nuk kishte asnjë arsye që Shqipëria të ekzistonte dhe ai fliste për të drejtën e serbëve për dalje në Adriatik.

Ndërkohë gjenerali grek Dangle shprehte pozicionin e vendit të tij kur deklaronte: “Ne kemi qëllim që Shqipëria të ndahet midis grekëve dhe serbëve, duke gjykuar që ëndrra shqiptare e autonomisë është absolutisht e perealizueshme”.

Autonomia së cilës i referohej gjenerali, kërkonte interpretim të mëtejshëm. Shqipërisë dhe Maqedonisë u ishin premtuar reforma në Kongresin e Berlinit në vitin 1878. Pikërisht pas njëzet e tetë vjetësh, Rusia dhe Austria ranë dakord për një sistem reformash që duhej të zbatoheshin. Në vend të kësaj, sulltani dinak Abdyl Hamidi sugjeroi që Hilmi Pasha, i trajnuar si european dhe rastësisht një prej zyrtarëve të tij më të zgjuar dhe më pa të skrupullt, të emërohej për të ndërmarrë këto reforma si administrator i përgjithshëm i territorit. Kjo u pranua dhe reformat u mbyllën në të njëjtin morg ku shumë gjëra të tjera ishin vënë në ngrirje të plotë.

Atëherë Eduardi VII dhe car Nikolla u takuan në Reval dhe vendosën t'i ndërmerrnin së bashku këto reforma. Kjo ndërmarrje shënoi edhe fundin e karrierës së sulltanit. Për tridhjetë e tre vjet ai e kishte mbajtur pushtetin, kryesisht për shkak të mbështetjes së fshehtë që i kishte dhënë Britania e Madhe, pasi ishte kundër Rusisë dhe ëndrrave të saj për Konstandinopojën dhe Dardanelet. Ardhja e tyre deri tek një marrëveshje e kërcënoi tani Perandorinë me humbjen jo vetëm të provincave europiane, por edhe të vetë Konstandinopojës. Për të parandaluar një lëvizje të tillë, një grup zyrtarësh turq, të drejtuar prej Esat Pashës, vendosën të sakrifikonin sulltanin dhe të merrnin qeverinë. Kjo u bë e njohur si *Lëvizja e Turqve të Rinj*.

Si u përmbush grushti i shtetit? Nevojiteshin disa gjeste spektakolare që do t'i kërkonte ushtria dhe populli. Këtë do ta gjenin tek Shqipëria. Shqiptarët kishin frikë njësoj sa nga nga Konstandinopoja, po aq edhe nga Athina. Në Resnjë, afër Liqenit të Ohrit, ishte një garnizon i vogël i përbërë prej shqiptarësh, i drejtuar nga Njazi beu, një prijës shqiptar në komandë. Iu kërkua atij ta drejtonte lëvizjen me shqiptarët e tij. Ai ra dakord dhe u nis në marshim drejt Manastirit, ku kishte shtabin *Korpusi i Tretë i Ushtrisë Turke*. Lajmi për revolucionin u shpërnda si zjarri në pyll. Me mijëra shqiptarë u grumbulluan tek flamuri. Në kohën kur arritën në Manastir, Njazi beu kishte një ushtri të tërë prapa vetes. Ushtria turke, në vend që t'i rezistonte atij, u bashkua rebelimit. Më pas, forcat e bashkuara filluan marshimin drejt Konstandinopojës, duke i dërguar telegrame sulltanit ku i shkruhej:

“Ne kërkojmë kushtetutë!”.

Ata shkuan më tej duke kërkuar edhe sigurinë se ajo jo vetëm do të garantohej, por edhe do të zbatohej. Me të arritur, ata morën qytetin në zotërim dhe Esat Pasha u ngarkua që të njoftonte sulltanin se sundimi i tij kishte marrë fund, çka ishte i vetmi që guxoi ta bënte. Duke parë se e përmbushën qëllimin, shqiptarët u kthyen në shtëpitë e tyre, ndërsa kushtetuta që do t’u garantonte atyre liritë, ra në duart e një grupi aventurierësh politikë dhe sharlatanësh. Skena ishte planifikuar të ishte e madhe për të luajtur në të, por për ta bërë këtë nuk kishte as kapacitete, as qëllime të qarta. Shqipëria u bë edhe një herë fushë beteje. Për të, u trazua edhe një herë toka dhe qielli. Për të shmangur një tjetër lëvizje të “kapuçave të bardhë”, Shefqet Turgut Pasha, tipi i të cilit si gjeneral do ta kishte kënaqur Mehmetin II, u dërgua me një ushtri prej dhjetë mijë vetësh në Shqipëri për ta gjuhëzuar atë. Ishte një shakullimë terrori që përfshiu tërë vendin. Listat e tërë prijësve që mbështesnin reformat, tashmë ishin bërë që më parë dhe ata ishin të parët që e provuan kamzhikun.

Unë, duke qenë midis të dënuarve, u dërgova në azil bashkë me qindra të tjerë. Shumë prej tyre u vunë para vdekjes, të tjerë u rrahën, u ekspozuan të zhveshur në sheshet publike, u dërguan në burgje për periudha të gjata. Shkollat u mbyllën, shtëpitë botuese u shkatërruan, abetaret, librat, mijërat e gjërave të shkruara në copa letrash të vogla, të cilat kishin marrë kuptim të thellë jo vetëm për fëmijët, por edhe për burrat e çdo moshe që mësonin gjuhën e vet, tani u shkatërruan, u dogjën dhe u shuan së ekzistuari. Pas disa muajsh heshtjeje, Shqipëria e ktheu goditjen mbrapsht. Gjatë pranverës dhe verës së vitit 1912 kryengritjet spontane nëpër tërë vendin u bashkuan në një ushtri të dyzet mijë burrave në Fushë Kosovë. Turqit e dërguar nga Anadoli për të luftuar kundër tyre nuk pranuan të luftonin kundër vëllezërve të tyre muhamedanë dhe në vend të kësaj iu bashkuan atyre. *Porta e Lartë* e dinte se në këto kohë, të kishe punë me arnautët, do të thoshte të ishte në telashe të mëdha. Prej këtyre telasheve mund të gjendej shpëtim vetëm nëse kërkesat e tyre plotësoheshin menjëherë. Por plotësimi i këtyre sillte në mënyrë të menjëherëshme edhe fundin e regjimit të sulltanit mbi shqiptarët.

Kështu, një komision i kryesuar prej dy anëtarësh të kabinetit u dërgua menjëherë tek shtabet e tyre, me autoritet të plotë për të bërë paqe me ta me çfarëdo lloj çmimi, përveç pavarësisë së plotë. Ndërkohë prijësit shqiptarë kishin përvijuar një listë ku kërkonin autonomi të plotë për katër vilajetet e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës. Të tërë duhej të viheshin nën një guvernator shqiptar. Qeveria lokale të riorganizohej plotësisht dhe të përbëhej prej zyrtarësh që dinin shqip dhe njihnin nevojat e popullit. Të përjashtoheshin shqiptarët nga shërbimi ushtarak jashtë Rumelisë, me përjashtim të rasteve kur luftohej ndaj një fuqie tjetër. Financimin e shkollave kombëtare të bujqësisë dhe shkollat normale kombëtare ta bënte shteti. Taksat të përdroreshin brenda vendit për zhvillim, ndërtim rrugësh, burimesh materiale, përmirësim të kushteve të jetesës. Të kishte liri absolute në zhvillimin e sistemit kombëtar të shkollave. Këto ishin kërkesat bazë që iu dhanë atyre brenda dyzet e tetë orësh.

Ajo që nuk iu plotësua atyre, ishte dhënia e një gjysmë milioni lirash turke për të riparuar disa prej dëmtimeve të bëra prej Shefqet Turgut Pashës dhe ushtrisë së tij, megjithëse edhe ajo ishte pranuar. Në këtë mënyrë, pas një kohe aq të gjatë pushtimi, Shqipëria do të bëhej shtet autonom, i krahasueshëm në madhësi, popullatë dhe burime me fqinjët e saj si Greqia, Serbia dhe Bullgaria. Më e vogël vërtet, por e afërt me to, ajo mund të shpresonte ta mbante veten si një shtet simotër. Çfarë ëndrrash ishin zgjuar, çfarë gëzimi ishte përhapur pas një burgimi të gjatë! Çfarë shpresash të shtypura kaq keqas dhe pamëshirshëm nëpër shekuj vuajtjesh po merrnin jetë përsëri!

*Dita agon në pranverë,
Pranvera shndrit në mëngjes,
Mëngjesi zbardh në shtatë përherë,
Bari prarohet me vesë,
Lauresha fluturon në krah t'vet,
Kërmilli zvarritet në ferrë,*

*Zoti është në qiell,
Gjithçka në botë është në rend të vet.*⁷⁰

Mbushi këta rreshta të *Tenisonit* me shekujt e pritjes së mërzitshme dhe të zymta, dhe kjo do të shërbejë për këngën kombëtare të Shqipërisë në orën e daljes së saj në jetë.

Dhe pastaj ndodhi një gjë shumë e habitshme, diçka që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në tërë historinë e Ballkanit. Dy burra u vunë kokë më kokë me njëri-tjetrin. Dy burra që deri në atë kohë e kishin urryer njëri-tjetrin me ndjenja aq të hidhura dhe të fuqishme. Në fakt, ata kishin qenë armiq të betuar, aq armiq sa gjithçka që ishte e mirë për njërin, ishte helm për tjetrin. Dhe prapëseprapë, ata ishin bashkë që të dy me njëri-tjetrin në një konferencë thuajse shumë miqësore, të fshehtë dhe intime. Pastaj një i tretë u bashkohet atyre, dhe të tre kokat mblidhen së bashku në një mënyrë krejt intime. Nuk vonon dhe për të na habitur edhe më shumë, u bashkohet i katërti. I katërti që ishte njeriu më i urryer për tre të parët. Dhe i shohim tani katër koka të mbledhura së bashku, njerëz që kurrë më parë nuk ishin takuar në atë mënyrë.

Është vërtet krejt një gjë ogurzezë që ka edhe një mister rreth vetes. Është krejt si një orë përpara lindjes...ose para vdekjes. Cilado të jetë! Pasi i shoh ata katër krerë kaq afër, tek prekin shpatullat e njëri-tjetrit, me armë të kryqëzuara, të gatshme për të dhënë sinjalin për sulmin tjetër, mendoj se mos është thjesht imagjinatë. Shoh edhe kokën e pestë, bash prapa tyre! Dhe a po shkruan diçka ai në mur në pantomimë, të cilën ata nuk mund ta shohin, as lexojnë? Diçka si kjo:

*Për para, urrejtje dhe frikë,
Shteti me shtetin ndeshen çdo ditë,
Me floririn, zilinë dhe egon e hidhur,
Gjithçka mes tyre kështu ishte lidhur.*⁷¹

⁷⁰ *Alfred Tenison (Alfred Tennyson)* i cituar edhe më sipër.

⁷¹ Rudyard Kipling, *The Peace Of Dives*, 1903.

Në vitin 1919, ndërkohë që isha në një mision të veçantë në Shtetet e Bashkuara nga Konferenca e Paqes në Paris, në emër të Shqipërisë pata nderin të merrja në intervistë një farë senatori nga pjesa qendrore. Me një hartë të Ballkanit në dorën e tij rreth njëzet centimetër të gjerë, ai filloi menjëherë të më tregonte mua rreth situatës në Ballkan.

“Ata, njerëzit e Ballkanit, duhet të mblidhen së bashku. Kështu i thashë presidentit. I thashë se nuk kanë më kuptim tek ata njerëz zënkat dhe grindjet e tyre tërë kohën. Pasi të gjithë sllavë janë ata. Serbë, bullgarë, shqiptarë, korintianë, kroatë dhe tërë të tjerët; presidenti donte t’i bënte të tërë bashkë, që ata të kishin një qeveri. Kjo do të kontribuonte më shumë për paqen, sesa Lidhja e Kombeve”.

Unë e mëshirova për sugjerimet e mbrapshta dhe ika duke kujtuar ato që kishte thënë Mark Tueni:

“Është më mirë të dish pak e sak, se shumë e për lumë”.

“Po, ashtu është, i nderuar senator, katër prej tyre janë bashkuar me njëri-tjetrin dhe ne do shohim se si do të shkojë puna e paqes në Ballkan”, i thashë në të ikur.

Pasi disa plane ishin zbatuar nën tutelën e Fuqive të Mëdha, sekreti i madh i ishte fshehur botës: Bullgaria, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia kishin formuar një aleancë dhe shpejt do të ndërmerrnin një tjetër Kryqëzatë të Shenjtë kundër të “pafeve”, me qëllim që “të lironin” vëllezërit e tyre të krishterë, shqiptarët dhe maqedonët nga zgjedha shtypëse e Turqisë. Kështu nisi Lufta e Parë Ballkanike e vitit 1912 kundër turqve. Përpara se të fillonte lufta, tërë kalorësit e vjetër me flamujt e tyre u bekuan prej *Kishës së Shenjtë*. Është krejt e besueshme që këta bujq fshatarë dhe barinj nga Ballkani i Veriut dhe ata nga korijet e ullinjve dhe vreshtave të tokave të Platonit dhe Sokratit, të besonin vërtet në misionet e tyre kalorsiake. Ata i përkulën duart për temjanin dhe ujët e bekuar. Por me ata katër krerë që ishin vënë kaq afër njëri-tjetrit, aty luhej një dramë tjetër. Forca e vërtetë motivuese

dhe lajtmotivi i asaj drame ishte që Shqipëria të mos bëhej shtet autonom. Ata i frikësoheshin kësaj më shumë se çdo gjëje tjetër. Shqipëria nuk duhej të bëhej shtet, sepse ishte myslimane, sepse duhej t'i merreshin burimet e saj të pashfrytëzuara, pasuritë natyrore, pyjet, mineralet, tokat bujqësore, si dhe për shkak të pozicionit gjeostrategjik në Adriatik. Ndaj “me paranë, urrejtjen dhe frikën e hidhur, gjithçka mes tyre kështu ishte lidhur”.

Javët e para të luftës filluan me nxitim. Përplasja ishte midis Greqisë dhe Serbisë, se kush do të merrte më shumë toka shqiptare në zotërim, në mënyrë që kur të vinte koha e shkëmbimit të zhvasnin sa më shumë të ishte e mundur secila për veten e saj.

LUFTËRAT BALLKANIKE – GJAK I HUMBUR

Akti përfundimtar i kësaj drame u lajti në vitin 1912-1913, atëherë kur plasën dy *Luftërat Ballkanike* dhe Turqia nënshkroi *Traktatin e Londrës*. Pozita e Shqipërisë në këtë luftë është keqparaqitur dhe keqkuptuar, aq sa kërkon të rishikohet e tëra, në mos për tjetër arsye, të paktën për hatër të drejtësisë.

Çështja e parë që duhet të sqarohet është përse *Katërshja (Quadruplice)* që e nisi luftën kundër Turqisë, nuk e përfshiu Shqipërinë? A e nënvlehtësuan ata forcën e Shqipërisë dhe ndihmën që ajo ishte në gjendje të jepte? Mendja të shkon sa tek fitorja që kishin korrur shqiptarët në Kosovë një vit më parë, aq edhe tek historia e tyre si komb gjatë tërë shekujve të pushtimit otoman. A do të kundërshtonte Shqipëria t'i bashkohej Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë në një aleancë të tillë, po të ishin këshilluar me të për këtë çështje? Këto janë pyetje të qenësishme, nga përgjigjja e të cilave mund të kuptojmë dhe vlerësojmë vendin e Shqipërisë në *Luftën e Parë Ballkanike* dhe pasojat që la kjo luftë në lidhje me të.

Le të shqyrtojmë në fillim pozicionin e saj ndaj Turqisë dhe shteteve të tjera të Ballkanit në kohën e bisedimeve. Shqipëria kishte përfituar ca lëshime nga Turqia, po t'i referohemi kapitullit të fundit. Qeveria e Turqve të Rinj bashkë me parlamentin u detyrua të dorëhiqej. Kjo situatë do të kishte krijuar virtualisht një

shtet të pestë ballkanik, me një status shumë të ngjashëm me atë të Bullgarisë, pra, duke e mbajtur atë, Shqipërinë, në autonomi të plotë nën sovranitetin turk.

Ky program do të shkonte tërësisht kundër lakmive serbe dhe greke. Përsa i takon Serbisë, kjo gjë do të frenonte ambiciet e saj për të rimarrë zotërimet e lashta të Dushanit të Madh, me një port në Adriatik. Po të realizohej kjo, do të kishte ndikim të jashtëzakonshëm mbi tre prej katër vilajeteve shqiptare, Shkodrës, Kosovës dhe Manastirit. Greqia ishte po aq e etur dhe e vendosur të zotëronte Epirin, ku ajo kishte shpenzuar miliona duke propaganduar nëpërmjet *Kishës Ortodokse Greke*. Bullgaria ishte po ashtu e pakënaqur për shkak të interesave të saj në Manastir, të cilat nuk ishin, gjithsesi, një pjesë jetike për të.

Përveç këtyre, Bullgaria kishte treguar gjithmonë një lloj qëndrimi racial miqësor ndaj shqiptarëve, çka nuk shihej tek asnjë shtet tjetër në Ballkan. Shpesh aty kishte pasur biseda jozyrtare midis udhëheqësve bullgarë dhe atyre shqiptarë, të cilët kërkonin të bashkonin veprimet për çlirimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë. Edhe guerrilet e tyre shpesh e kishin ndihmuar njëri-tjetrin. Interesat e tyre të ndërsjellta ishin forcuar edhe më shumë, bazuar në urrejtjen racore të Serbisë dhe Greqisë kundër Bullgarisë, për shkak të ambicieve të saj ndaj Maqedonisë.

Për ata që janë të njohur me këtë rrjedhë të kryqëzuar të politikës dhe fesë ballkanike, del e qartë edhe përbuzja me të cilën greku përçmohej prej sllavëve, edhe antipatitë dhe urrejtjet raciale të hidhura e të rrënjosura thellë që i mbajnë këta popuj të ndarë prej një humnere të ngjashme e të pakalueshme. Aleanca ballkanike ishte një sprovë e lehtë besimi, përkundër çdo gjëje që kishte dalë sheshit në Ballkan në një gjeneratë të tërë. Ndikimet e fuqishme politike nga jashtë luanin në vazhdimësi një rol tejet të fuqishëm në gadishull. Ato vinin që nga Shën Petërburgu, Berlini, Parisi, Londra, Roma dhe Vjena, duke mos lënë pa prekur asgjë. Këto ndërhyrje e bënin shumë më të vështirë situatën. Ministra, qeveritarë, konsuj, atashe ushtarakë e tregtarë, agjentë të fshehtë, mësues, gazetarë, prelatë, priftërinj, spiunë, komitete të fshehta, banditë, komitë, të tërë luanin lojën e tyre.

Të tërë shpenzonin gjithçka për të arritur qëllimet e veta në kurriz të të tjerëve. E tillë ishte situata në Ballkan. Në fund, ajo mund të përmblihet në dy vlerësimet e mëposhtme:

Njëri ishte rreziku i përbashkët, brenda të cilit kërcënonin të shpërthenin territoret që gjendeshin ende në dorë të turqve në Ballkan, duke rezultuar në ndarje tokash në dëm të vendeve më të vogla; ndërsa tjetri ishte trysnia e fortë që ushtronte Rusia për t'i mbajtur pas vetes Serbinë, Bullgarinë dhe Maqedoninë.

Në rastin e parë tentohej të bashkoheshin këto tri shtete sllave në një aleancë me Turqinë, pasi Turqit e Rinj i mashtruan ata fillimisht me Kushtetutën e tyre të re. Por aleanca ballkanike nuk ishte as spontane dhe as lëvizje e vërtetë nga brenda – ajo ishte, si të themi, në një rën anë si zëri i Jakobit, por në anën tjetër, krahu ishte ai i rusit Esau⁷². Po të citojmë nga raporti i *Komisionit Ballkanik*,⁷³ do të gjejmë këtë pasazh:

“Nuk ishte ëndrra entuziaste rinore sllave e një federate të lirë të demokracive ballkanike. Nuk ishin as nacionalistët dhe filozofia pansllave e një hegjemonie morale ruse me Konstandinopojën si qendrën e vet politike. E para e këtyre ëndrrave ishte vrarë prej rivalitetit të shteteve të Ballkanit. E dyta, prej dashurisë së tyre për pavarësi”.

Aleanca ballkanike, e drejtuar prej diplomacisë imperialiste ruse, ishte ose kundër pretendimeve gjermane, ose kundër pushtimit otoman dhe ambicies shqiptare për autonomi. Detajet e marrëveshjes ose, thënë më mirë, mosmarrëveshjeve mbi

⁷² Esau është djali i madh i Isakut. Për herë të parë ai përmendet në *Librin e Gjenezës* dhe më pas nga profetët më të vegjël, *Obadiah* dhe *Malachi*. *Dhjata e Re* i referohet atij në *Librin e Romakëve* dhe *Librin e Hebrejve*. Esau është paraardhës i edomitëve dhe vëllai binjak i Jakobit, patriarkut të izraelitëve. Esau dhe Jakobi ishin djemtë e Isakut dhe Rebekës dhe nipat e Abrahamit dhe Sarës. I pari nga binjakët lindi Esau, pas tij lindi Jakobi. Isaku ishte 60 vjeç dhe mendohet se Rebeka ishte shumë më e re kur lindi binjakët. Në atë kohë thuhet se gjyshi Abraham, rreth 160 vjeç, ishte ende gjallë. Esau, 'bir i shkretëtirës' u bë gjuetar i zoti dhe kishte një "ashpërsi" që e dallonte nga vëllai binjak. Jakobi ishte 'i thjeshtë' ose 'i turpshëm' (varësisht nga përkthimi i fjalës hebraike "Tam", që do të thotë edhe 'burrë relativisht i përsosur'. Gjatë gjithë *Librit të Gjenezës*, Esau shfaqet shpesh në plan të dytë në krahasim me vëllain e tij më të vogël binjak, Jakobin. (Shënimi im – MB)

⁷³ Raporti i *Komisionit për Ballkanin (Balkan Commission Report)* f. 40–41.

ndarjen e plaçkës i ka shkruar historia. Në fakt, e vetmja marrëveshje e vërtetë ishte që Shqipëria të ndahej midis Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, duke e vënë vijën ndarëse në lumin e Shkumbinit. A ishte e drejtë kjo?

Kryeministri serb, Pashiqi, e shprehu shkurtimisht pikëpamjen e qeverisë së tij me këto fjalë:

“Shqipëria nuk ka arsye të ekzistojë. Shqiptarët nuk janë të aftë të përparojnë, aq më pak të qeverisen. Themelimi i shtetit shqiptar do të jetë një mollë sherri pafund, si dhe do të pengojë të drejtën e serbëve për të dalë në Adriatik”.

Gjenerali Danglis⁷⁴, që përfaqësonte grekët, deklaroi pozicionin e tyre si më poshtë:

“Ne synojmë që Shqipëria të ndahet midis grekëve dhe serbëve, duke gjykuar se ëndrra shqiptare për autonomi është absolutisht e perealizueshme”.

A duhen fajtuar shqiptarët për ndjenjën e dyzuar që kishin lidhur me zgjedhjen midis dy gjërave, secila më e keqe se tjetra? A ishte më mirë të vuanin së bashku nën tiraninë turke apo të ndaheshin, përthitheshin, sllavizoheshin, helenizoheshin dhe shkatërroheshin tërësisht si komb prej fqinjëve të tyre? Kjo ishte dilema e tyre. Si duhej t'i përgjigjeshin ata asaj shpalljeje të “aleatëve” e cila e thellonte edhe më shumë këtë dilemë, kur shihej se si veprohej në praktikë:

“Vëllezër, vuajtjet që keni hequr, kanë prekur zemrat e miqve tuaj. Të nisur nga detyra e shenjtë e dhimbjes vëllazërore, ata erdhën t’ju ndihmojnë për t’ju çliruar nga zgjedha turke. Si shpërblim për sakrificat e bëra, ata nuk meritonin asgjë më pak sesa të rivendosnin paqen dhe rendin në tokat e vendlindjes së tyre. Ejani, takohuni me kalorës të guximshëm të lirisë, mbajtës të kurorave triumfale. Mbulojuani rrugën

⁷⁴ Panagiotis Danglis (1853-1924) ishte gjeneral grek në ushtrinë helene dhe politikan. Lindi në Agrinio më 1853, u diplomua në Akademinë Ushtrake *Scholi Evelpidon* më 1878 me gradën lejtant I dytë në forcën e artillerisë dhe më pas i vazhdoi studimet edhe një vit në Belgjikë. Pas kthimit me gradën kapiten, u caktua adjutant pranë misionit ushtarak francez (1884-1887), i cili ishte ngarkuar me modernizimin e ushtrisë greke. Ai ishte ekspert i njohur artilerie, dha mësim në Akademinë Ushtrake dhe shpiku topin Shnajder-Dangli në vitin 1893. Gjatë Luftës Greko-Turke në vitin 1897, ai mbajti postin e shefit të shtabit të një brigade në sektorin e Epirit. Pas marrjes së gradës kolonel-lejtnant, ai u transferua në Shtabin e Korpunit të Përgjithshëm në vitin 1904. (Shënimi im – MB)

përpara këmbëve të tyre me lulet e lavdisë. Dhe jini shpirtmëdhenj ndaj atyre që deri dje ishin sunduesit tuaj. Si të krishterë të vërtetë, mos e shpërbleni të keqen me të keqe. Rroftë Lirija! Rrofshin ushtritë e guximshme të çlirimit!”.

Me këtë shpirt mirëbesimi u takuan këto ushtri në Shqipëri, njësoj, si të krishterët edhe muhamedanët njësoj. Në fakt, nuk pati kundërshtime ndaj ushtrive serbe dhe greke, përveçse në Shkodër, Kosovë dhe Janinë. Kur barrierat e ushtrisë turke në Kosovë dhe Manastir u shkatërruan, jo me shumë vështirësi, dhe trupat u hapërdanë dhe u gjymtuan, Shqipëria deri në Adriatik dhe në veri të lumit Shkumbin, përveç Shkodrës, gjendej përpara serbëve. Ata nuk vonuan aspak që ta pushtonin atë.

Nuk dua të më bëni mua me faj, pasi ky kapitull prej këtu merr një karakter tërë ankth e tmerr. Ne kemi parë mjaft prej këtyre gjërave tashmë. Kemi parë çnatyrimin a sjelljen çnjerëzore të “njeriut” ndaj “njeriut” gjatë errësirës së gjatë të shekujve të trishtueshëm, kur hordhitë pagane kënaqeshin në epshin dhe pasionin e pashuar që kishte përfshirë tërë Ballkanin si baticë vdekjeprurëse, torturuese, e trazuar.

Në vijim dua të jap disa fragmente nga raportet e dhëna prej korrespondentëve dhe të pranishmëve në terren, dëshmitarë të drejtpërdrejtë të asaj çka ndodhte, dhe shënime që vinin drejtpërdrejt nga terreni. Profesori Shiman (Schiemann) në *Kreuz Zeitung* thotë:

“Letrat personale që kam marrë e që vijnë nga fusha e luftës, përshkruajnë atë që bëjnë serbët dhe grekët; ato paraqesin herë pas here pamjet e një tmerrri të jashtëzakonshëm. Serbët kanë nisur luftën për shfarosjen e shqiptarëve”.

Një korrespondent danez, simpatitë e të cilit anonin tërësisht nga serbët, shkruan:

“Praktika e luftës së serbëve ka marrë natyrën e masakrave të tmerrshme ndaj popullatës shqiptare. Sipas dëshmisë së vetë ushtarëve dhe oficerëve, midis Shkupit

dhe Kumanovës u masakruan 3000 shqiptarë. Në rrethinën e Prishtinës edhe 5000 të tjerë. Fshatrat shqiptare janë rrethuar dhe u është vënë flaka. Banorët e kapur në shtëpitë e tyre janë vënë përpara kasaphanës. Ushtarakët serbë i tregojnë këto bëma famëkeqe me mburrje”.⁷⁵

Një tjetër person që mbante pozicion të lartë zyrtar në Shkup në atë kohë, paraqiti raportin që vijon tek *Reichpost*:

“Qyteti regjistron e ruan dëshmi të përditshme të veprimeve çnjerëzore të kryera prej serbëve kundër banorëve shqiptarë. Për shumë ditë unë kam vështruar gjuetinë e zhurmslime ndaj shqiptarëve prej bandave të armatosura serbe dhe trupave të tyre të rregullta. Për tri netë rresht unë kam parë flakët e fshatrave të djegura që skuqnin qiellin. Popullata shqiptare ishte zhdukur gati e tëra. Ata u bënë viktimë dhe humbën territoret e tyre. Prapa kështjellës së Shkupit është një liqen malor në të cilin u gjetën trupat e mbi njëqind shqiptarëve. Në liqenin Vistola Voda u gjetën tetëdhjetë trupa. Çdo ditë nga tridhjetë deri në dyzet të plagosur ose të vdekur hidhen në lumin Vardar. Në Kalkandelend,⁷⁶ tridhjetë e pesë vetë u masakruan. Vendi është kthyer në një skenë të tmerrshme krimi edhe ndaj grave dhe vajzave nga mosha dymbëdhjetë vjeçare e lart. E tëra kjo është e vështirë të përshkruhet. Kulmi i monstrozitetit të tyre arriti atëherë kur ata me revole te koka, i detyronin prindërit të shihnin me sytë e tyre krimet që kryheshin kundër vajzave të tyre. Në masakrën e bërë në Ferizaj shpëtuan vetëm tre shqiptarë myslimanë, nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

Pas Prishtinës, Prizreni ishte qyteti që përjetoi të keqen më të madhe midis tërë qyteteve të Shqipërisë që ranë në duart e tyre. Ngado mbretëronte vdekja. Serbët hynin me dhunë nëpër shtëpi dhe masakronin këdo që binte në duart e tyre. Të vrarët hidheshin në rrugë dhe liheshin pa u varrosur. Masakrat vazhdonin ditë e natë, pa ndërprerje. Ditën e parë morën fund katërqind. Gjenerali Jankoviç, me revolver në dorë i detyroi autoritetet e qytetit dhe parinë e vendit që njëri pas tjetrit të

⁷⁵ Mobilizimi për luftë, propaganda, opinioni publik dhe gazetat në Luftën e Madhe (Call to Arms, Propoganda, Public Opinion and Newspapers in the Great Ear) nga Troy R.E. Paddock. (Shënimi im – MB)

⁷⁶ Emërtim në gjuhën turke për qytetin e Tetovës.

nënshkruanin një deklaratë ku njihet sundimi i krahut Pjetrit dhe ushtrisë së tij mbi ta. Në fakt, kjo u praktikua kudo ku shkeli ushtria. Prej fisit të Lumës, njëzet e shtatë fshatra u shkatërruan, shtëpitë u dogjën, shumë prej tyre me njerëz brenda. Grave u nxirreshin zorrët dhe foshnjat ende të palindura viheshin në majë të bajonetave të ushtarëve serbë. Në vilajetin e Kosovës, prej një vlerësimi të kursyer, u masakruan mbi 25.000 shqiptarë”.

Korrespondenti special i gazetës *Daily Telegraph* nga Londra shkruante:

“Çdo lloj persekutimi që mund të të shkojë ndërmend, i kryer gjatë historisë, është kryer këtu nga trupat serbe nën komandën e gjeneralit Jankoviç, në marshimin e tij nëpër tërë Shqipërinë. Ata vrasin pabesisht dhe ekzekutojnë jo vetëm shqiptarë të armatosur, por edhe të paarmatosur, pleq e plaka, gra, madje edhe fëmijë të sapolindur apo që janë ende në mitrën e nënës. Zyrtarët serbë kanë shpallur se mënyra më e suksesshme për të paqtuar Shqipërinë është t’i zhdukësh tërë shqiptarët. Ata kanë shpikur metoda të reja masakrash për të shuar etjen e tyre për gjak”.

Z.Tomoc, ish-sekretar i kryeministrit serb, Nikolla Pashiq, tregon atë që pa gjatë udhëtimit të tij nga Prizreni në Pejë, ku në të dyja anët e rrugës, tërë fshtrat ishin të djegur ose të rrënuara deri në themel:

“Rrugës ishin ngritur trekëndësha ku qenë varur trupat e shqiptarëve. Nga Gjakova rruga kishte pamjen e Bulevardit të Trekëndëshave”.

Letra e mëposhtme e publikuar prej një gazete socialiste serbe, *Radnicki Novine*, dhe e përfshirë në raportin e Komisionit Ballkanik, dërguar prej Carnegie Endowment për *International Peace* flet vetë:

“I dashur mik!

Nuk kam kohë t’ju shkruaj gjatë, por mund t’ju tregoj se këtu po bëhen gjëra të llahtarshme. Jam i tmerruar prej atyre që shoh dhe vazhdimisht pyes veten:

Si mund të jetë njeriu kaq barbar sa të kryejë mizori të tilla!? Është e pabesueshme!

Unë nuk guxoj (edhe sikur të kisha kohë të të shkruaja, çka nuk e kam) t'ju tregoj më shumë, por mund të them se Luma nuk ekziston më. Nuk ka asgjë tjetër përveç pluhurit, kufomave dhe hirit. Ka fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë deri në dyqind shtëpi ku nuk ekziston më asnjë njeri. Thjesht asnjë! Plaçkitja vazhdon gjithandej.

Oficerët u kërkojnë ushtarëve të shkojnë në Prizren dhe të shesin ato gjëra që kanë vjedhur”.

Gazeta vazhdon:

“Një miku im më tha se po ndodhin gjëra edhe më të tmerrshme se kjo, por ato janë aq të lemerishme dhe aq shumë të prekin në zemër, sa më mirë parapëlqej të mos i publikoj fare.

Kam patur rastin të kaloja shumë orë bashkë me një djalë të ri, i cili me familjen e tij kishte shpëtuar nga kasaphana e përgjithshme me një veprim të jashtëzakonshëm. Ai ishte pak më shumë se një djalë i ri, dhe për shkak se më të moshuarit e tij ishin vvarë, atij i kishte mbetur drejtimi i familjes. Ai në fakt vinte nga një familje shumë e fuqishme, shumë e pasur dhe me shumë ndikim.

Ata kishin shumë tokë, mijëra kokë dele, qe e lopë, kuaj dhe kafshë tjera, magazina të mëdha gruri, një magazinë ku mbanin sheqer, oriz, vaj ulliri, vajguri, etj. Me to ata furnizonin veten dhe fqinjët e tyre rreth e rreth shtëpisë në një largësi prej disa kilometrash. Shtëpia e tyre ishte e mbushur me mobilje europiane dhe gratë visheshin me tekstile delikate që gjendeshin vetëm në shtëpitë e të pasurve. Një natë serbët erdhën pa paralajmërim, e rrethuan shtëpinë dhe i kërcënuan banorët e saj se ditën tjetër të gjithë do të viheshin para vdekjes. Shtëpitë, megjithatë, ishin siguruar me një kalim të fshehtë për raste të tilla. Ndërkohë që po agonte dhe rojet i kishte zënë gjumi, e tërë familja shpëtoi dhe iku nëpër male me ato ushqime dhe veshje që mund të merrte me vete. Nëntë muaj jetuan ata në bjeshkë, duke u fshehur nëpër shpella, ndërkohë që tërë kohën gjuheshin prej serbëve. Një pjesë e kohës ishte dimër dhe një

prej pjesëtarëve të kësaj familje vdiq prej urisë dhe mungesës së rrobave. Shpesh ata kishin shkuar deri në atë gjendje sa të jetonin me gjërat e natyrës, gjethe, barishte të egra dhe çdo gjë që mund ta gjenin dhe ta përtypnin. Se çfarë vuajtjesh të llahtarshme përjetuan ato gra dhe fëmijë që cilët ishin mësuar tërë jetën e tyre të jetonin në bollëk, nuk mund të përshkruhet kursesi me fjalë. Qëndresa e tyre kërkon vëllime të tëra që të tregojnë fatkeqësinë e tyre, por edhe guximin dhe dëshirat e tyre spartane”.

Pjesa që të çudit më shumë në këtë *Holokaust* është se as katolikët shqiptarë nuk u kursyen prej vëllezërve të tyre të krishterë, por u vranë njësoj si edhe muhamedanët. Kjo tregonte qartë se nga foleja e pushkës së tyre fisheku zbrazej jo thjesht kundër muhamedanëve, por ndaj tërë racës shqiptare.

Thesaret e kishave të tyre u vodhën.

Në gazetën *Neue Freise Presse* të datës 29 mars 1913 u publikua ky artikull:

“Në datën shtatëmbëdhjetë të këtij muaji serbët mblodhën në rrethinat e Gjakovës rreth treqind vetë të fesë katolike, së bashku me priftin e tyre, P. Luigi Paliç, të cilin e lidhën me litar dhe e kërcënuan me vdekje nëse populli nuk hiqte dorë menjëherë nga feja e tyre dhe të pranonte të pagëzohej. Një prift ortodoks e përsëriti ofertën e bërë nga oficeri, ndërsa ushtarët me armë në pozicionin gati për zjarr, thanë: “Hiqni dorë nga feja juaj dhe përqafoji tonën menjëherë, ose këta ushtarë që bëjnë luftën e Zotit do të qëllojnë mbi ju, duke i dërguar shpirtërat tuaj në thellësinë ferrit”. Atëherë grupi pranoi të pagëzohej në masë. Priftit nuk i mbeti rrugë tjetër veçse të rezistonte deri në fund. Tri herë e kërcënuan dhe tri herë ai kundërshtoi. Pastaj, me një shenjë të bërë nga prifti ortodoks, e zhveshën, e rrahën me kondakët e pushkëve deri sa ra përtokë me eshtrat dhe brinjët e thyera. Ushtarët u urdhëruan të ndërprisnin torturën, ndërsa priftit iu kërkua edhe një herë të hiqte dorë nga feja e tij, por ai përsëri dha të njëjtën përgjigje:

“Jo, unë nuk e braktis fenë time, unë nuk e shkel betimin”.

Pas kësaj ushtarët morën urdhër ta therrnin priftin Paliç me bajoneta, për t’ua shtuar

emrin e tij radhëve të martirëve”.

Por le të shohim se çfarë bënin grekët në jug të Shqipërisë?

Ndryshimi qëndron vetëm tek emrat. Zëvendëso Prizrenin, Gjakovën, Pejën, Prishtinën me Tepelenën, Kolonjën dhe Korçën dhe kjo do të mjaftonte. Qindra fshatra u shkatërruan, u dogjën... mijëra shqiptarë u masakruan dhe u përdorën tërë metodat e përshkruara më sipër, shto këtu edhe diçka të veçantë:

Djegje për së gjalli. Mbi 200.000 njerëz u lanë pa strehë dhe u përvodhën e ikën në panik në drejtime të ndryshme anembanë Shqipërisë. Vetë paria e qyteteve detyrohej të nënshkruante me dhunë peticione ku kërkonin të përfshiheshin brenda Greqisë, me qëllim që të shpëtonin prej “barbarizmave të shqiptarëve”.

Mijëra njerëz dërgoheshin me zor drejt qyteteve qendrore për të bërë demonstrata në favor të Greqisë. Grupe të mëdha grash rreshtoheshin nën kërcënimin e armëve për t’u fotografuar për shtypin evropian si Amazona “që luftonin për kauzën e Greqisë deri në vdekje”. Grekofilë në qytete të ndryshme, të cilët njiheshin dhe përçmoheshin si tradhtarë të paguar prej grekëve, u ngritën tani në pozita të pushtetit dhe autoritetit, të zotët të bënin hatanë me një të lëvizur të gishtit, për të dërguar fisnikërinë shqiptare dhe heronjtë kombëtarë drejt vdekjes së sigurtë. Ashtu si serbët, edhe grekët në mënyrë të vazhdueshme u thonin veglave të tyre:

“Na tregoni kush është ai ose ajo që ju zë rrugën dhe ne e heqim qafe menjëherë”.

Shpesh popullsisë ortodokse i kërkohesh të tregonte emrat e armiqtve muhamedanë, me qëllim që ata të hakmerreshin për ta. Por shqiptarët ortodoksë duhen lëvdur se në asnjë qytet apo fshat, qoftë edhe një shqiptar i krishterë, përveç ndonjë përndjekësi të paguar shtrenjtë, nuk u gjend që të binte aq poshtë sa të merrte në qafë vëllezërit e vet myslimanë. Për shembull, kur kjo popullatë e marrë peng prej serbëve u dorëzua në Elbasan para të krishterëve, këta të fundit u përgjigjën:

“Ne nuk kemi armiq midis myslimanëve. Jemi të gjithë të dashur me njëri-tjetrin”.

Në gazetën *Manchester Guardian* na del një letër e shkruar nga korrespondenti i saj, ku përshkruhen ngjarje që ai i kishte parë vetë në Epir:

“Në sytë e tërë Europës një popull po shkatërrohet. Kur u vra një figurë mbretërore, tërë Europa u shpreh me tmerr. Por kur fshat pas fshati shqiptarët masakrohen, digjen me zjarr e me hekur, vdesin nga uria dhe të ftohtët, Europa luan golf e tenis dhe vë baste nëpër gara kuajsh. Dje në mëngjes bankina e vogël e Vlorës ishte mbushur me refugjatë të rrsakapitur, myslimanë që iknin nga tmerret që ushtron mbi ta ushtria greke, e cila ua ka pushtuar vendin, territorin shqiptar, me bekimin e vetë Europës... Greqia po zbaton planin e vet të paramenduar të shkatërrimit dhe përzënies së popullsisë shqiptare, me qëllim që më pas ta aneksojë atë”.

Në të vërtetë ajo i ka shpalosur tërë pretendimet. Madje, edhe konsulli grek në Durrës, M. Baratasi, pohon sinqerisht:

“Asnjë kriminel nuk ka mbetur më në Kretë. Ata të gjithë po bëjnë maskaradë si ‘epirotë’ në jug të Shqipërisë”.

Më 8 prill 1913, sër Eduard Grej deklaroi përpara parlamentit:

“Lufta Ballkanike ka kohë që ka pushuar së qeni luftë për liri. Veprimet e Malit të Zi kundër Shkodrës janë veprime luftarake pushtuese. Unë nuk shoh ndonjë arsye përse simpatia që kemi treguar për Malin e Zi dhe vende të tjera që luftojnë për lirinë dhe ekzistencën e tyre kombëtare, të mos shprehet edhe ndaj popullsisë shqiptare të Shkodrës dhe pjesëve të tjera të vendit, si për ato katolike, edhe ato myslimane, të cilat luftojnë për ekzistencën e tyre, për territorin e tyre, për fenë e tyre”.

Situata në Shqipëri në atë kohë është shprehur shumë mirë prej një udhëheqësi shqiptar si më poshtë:

“Rrethuar prej maleve tona ku nuk ka konsuj të huaj, as shtyp europian, serbët bëjnë me ne çfarë të duan. Ndërsa nën qeverisjen turke ndaj nesh kishte një farë çlirësie, tani ne nuk guxojmë të na shpëtojë asnjë fjalë nga dhëmbët, ndërkohë që për gjëra të tjera vihemi ose para kamzhikut, ose para plumbit e litarit”.⁷⁷

Çfarë mund t’i shkonte më shumë këtij kapitulli se sa të kujtoja një ngjarje që tronditi zemrat e botës dhe shkrehu në vaj e i bëri serbët heronjtë e famshëm të Luftës Botërore? Të mundur dhe të tronditur prej austriakëve, me vendin e tyre të pushtuar në çdo pëllëmbë, të mbeturit e dërrmuar të ushtrisë serbe u hapërderdhën drejt maleve të Shqipërisë, në një kohë kur ato ishin të mbuluara me dëborë. Të gjitha luftimet u kishin shkuar kot. Krenaria e tyre kishte marrë fund, shpirti i tyre ishte shkërmoqur. Për më tepër, ata kishin edhe një numër të madh të burgosurish austriakë me vete, të cilët nuk mund t’i linin prapa. Dhe ja momenti!

Këta *malësorë* shqiptarë me ushqime aq të pakta, me atë pak drithë që kishin, aq sa duhej të llogaritinin thujse çdo ditë se sa kallinj misri kishin në hambar për veten e tyre, papritmas u ballafaquan me një ushtri të dëshpëruar, jetët e të cilëve ishin tërësisht në duart e tyre.

Çfarë bënë ata?

Ata nuk bënë çfarë do të bënte pala që shpëtuan. Jo. Bënë të kundërtën! Ndanë racionet e ushqimeve me ta, edhe muhamedanët, edhe të krishterët, duke patur parasysh fjalën e zotit:

“Në qoftë se armiku yt është i uritur, jepi të hajë, në qoftë se është i etur, jepi të pijë!”.

Gjatë kësaj odiseje nëpër Shqipëri, deri në Durrës, asnjë serb nuk u dëmtua, madje as edhe një fije floku nuk iu prek atyre.

Në shoqëri të kësaj ushtrie fundërrinë ishte një doktor francez dhe e bija,

⁷⁷ E.Vaina, *Shqipëria lind (Albania che Nasce)*, f.88.

Suzana Suzeri, që kujdeseshin për spitalet e tyre në lëvizje, për të plagosurit dhe të sëmurët. Më vonë ajo dhe i ati u bënë aq të afërt me shqiptarët, sa ata kurrë nuk mënuan të shprehnin mirënjohjen dhe habinë për kortezinë dhe mirësinë e shqiptarëve, në duart e të cilëve ata kishin rënë. Mrekullimi i tyre bëhej edhe më i madh për shkak të shpifjeve që kishin dëgjuar në Serbi, për “barbarizmat e tmerrshme” që mbizotëronin në malet e Shqipërisë. E veshur lehtë, vetëm me këpucët e spitalit, Suzana u mbajt ngrohtë në një gunë shqiptare dhe këmbët të mbështjella në lesh. Shqiptarët e mbajtën në shpatulla me një vig drejt Shkodrës, gjatë dhjetë ditëve të tmerrshme dhe të rrezikshme. Të dy, babë e bijë, u liruan pa u hyrë gjemb në këmbë. Shqiptarët nuk pranuan kurrsesi as dhuratë, as shpërblim për një shërbim të tillë. Këta francezë do të ishin kthyer aty, tek ata, pa as më të voglën ndrojtje, nëse do t’u ishte dhënë mundësia.

Shqiptarët kishin bërë vetëm atë që ndjenin. Ndërsa mua s’më mbetet gjë tjetër veçse të them:

Tungjatjeta! Rrofshin sa malet njerëz të tillë!



NUK KA TRAZIRA NË BALLKAN QË TË KENË ORIGINË OSE NATYRË THJESHT LOKALE. PËRHERË NJË OSE MË SHUMË PREJ FUQIVE TË MËDHA TË EUROPËS E KANË PATUR NJË DORË ATY, MADJE DERI NË ATË PIKË SA TA KENË KRIJUAR VETË TRAZIRËN, DUKE E ZHVILLUAR, DREJTUAR, FINANCUAR DERI NË ÇASTIN KUR AJO SHPËRTHEN. ATËHERË BOTA NGA JASHTË DETYROHET TË PLANDOSË DUART PËR TË SHUAR TMERRIN QË DEL NGA KAZANI I PËRGJAKUR I BALLKANIT SI REZULTAT I ATYRE NDËRHRYJEVE NGA JASHTË.



XV



BALLKAN - VULLKAN

Është e lehtë të merret me mend se ky kapitull do të merret me Ballkanin. A e di ndokush se nga vjen emri *Ballkan*? Në fakt u ka mbetur turqve që përdorin të njëjtin emër për *malet*. Ndoshta mund të mos ketë lidhje, por a nuk ekziston gjithsesi një emër më i vjetër antik me origjinë nga *Vullkani*, farkëtari i armëve për zotat e Olimpiti? Që aty është vetëm një hap prej *volkano*, një mal i veçantë ku vullkani mban zjarrin dhe farkën. Dhe kjo e identifikon atë përfundimisht me gjuhën e lashtë të shqiptarëve.

Vullkan është veta e tretë në shumës e foljes *me vjellë*. *Malet vjellkan* – *malet kanë vjellë*. Që ka patur vullkane aktive në rajonin e Ballkanit, kjo as që diskutohet. Shtoji këtu edhe tërmetet që kanë qenë përherë të përhapura dhe që kanë lidhje në një pjesë të madhe me topografinë. Fjalori *Uebster* përdor shembullin “një vullkan vjell llavë” për të ilustruar kuptimin e termit. Me përjashtim të disa fushave të gjera, e gjithë topografia e Ballkanit i jep njeriut përshtypjen e natyrës së egër. Malet e tij nuk janë të lartësuar si vargmalet e Alpeve, brenda një simfonie të

intonuar me natyrën, sikur krijuesi t'i kishte punuar ato aq të ndërlikuara dhe me dizenjaturë aq të bukur në sipërfaqen e planetit. Ato janë të gremisura, të hedhura dhe të shpërndara në një mënyrë aq të parregullt, sikur të ishin thjesht grumbuj hedhurinash. Atëherë vjen shpërthimi i ujërave, i cili shihet ngado të lëvizësh. Lumenjtë e nisin shtratin prej burimeve në male dhe e vjellin ujin nga përrrenjtë që mbliidhen nëpër lugina dhe fusha bregdetare. Ndërkohë detet nuk janë treguar asgjë tjetër përveçse bisha primitive që *kanë çarë dhe bërë stroullat, vorbullat, në rrugën e tyre të thellë në sipërfaqen e tokës deri sa ajo është çarë, bërë brazdë dhe shqyer në çdo drejtim. Kjo nuk mund të mos linte vrragën e vet në jetën dhe karakteret e njerëzve që jetonin në mes të një bote të tillë. Dhe vetë racat janë të tilla. Ato përbëhen prej fisesh, klanesh e feshë të ndryshme, hungarezë dhe kroatë, bullgarë e serbë, rumunë dhe kutzo-vllahë, shqiptarë dhe grekë, jahudinj dhe turq, armenë e levantinas, më të shumtët ose të tërë kundërshtarë e ndërluftues. Shto këtu edhe antagonizmin fetar ku ortodoksia greke urren katolikët romakë, të dyja këto urrejnë myslimanët, judaizmi që rri larg edhe ndaj të krishterëve, edhe ndaj myslimanëve dhe do shohim se si plotësohet kjo tablo e zymtë. E tërë kjo njihet kaq mirë prej qeverive të fuqive europiane, sa ato mund të gjejnë përherë në to, kur iu del nevoja për qëllimet e tyre të pasinqerta e makiaveliste, bazë për veprimtarinë e vet.*

Nuk ka trazira në Ballkan që të kenë origjinë ose natyrë thjesht lokale. Përherë një ose më shumë prej fuqive të mëdha të Europës e kanë patur një dorë aty, madje deri në atë pikë sa ta kenë krijuar vetë trazirën, duke e zhvilluar, drejtuar, financuar deri në çastin kur ajo shpërthen. Atëherë bota nga jashtë detyrohet të plandosë duart për të shuar tmerrin që del nga kazani i përgjakur i Ballkanit si rezultat i tyre ndërhyrjeve nga jashtë.

Sarajeva dhe vrasja e arkidukës Franc Ferdinand i Austrisë që solli Luftën Botërore, është një çështje për t'u parë. Beogradi nuk ishte i vetmi kryeqytet që e kurdisi dhe e zbatoi atë komplot të përgjakshëm, siç e di sot bota fare mirë. E njëjta gjë është e vërtetë për Luftën e Parë Ballkanike të vitit 1912. Historia e brendshme se si është formuar aleanca e Ballkanit nuk përbën një lexim të këndshëm për

ata që janë aq të guximshëm sa ta mbartin idealizmin e tyre në fushën e politikës ndërkombëtare.

Përballë kësaj nuk ka patur as arsye, as ndjesë për luftën vetë. Ajo ishte e paprovokuar, siç ishte edhe ajo që ndodhi midis Italisë dhe Turqisë dy vjet para saj. Nuk ka patur qoftë edhe një çështje midis ndonjërit prej shteteve të përfshira – Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Turqisë që mund të konsiderohet në ndonjë aspekt jetike ose e mprehtë. Siç i shohim, deri tani këto katër mbretëri të vogla ishin të lidhura me njëra-tjetrën në një mënyrë të veçantë. Ato e urrenin njëra-tjetrën, nuk i besonin njëri-tjetrit, e mallkonin njëra-tjetrën në mënyrën më skandaloze. Serbët dhe bullgarët ishin si dy “bulldogë” në dy anët e të njëjtit kufi, që të dy të gatshëm për t’i çarë fytin njëri-tjetrit. Malazezët, për të gjitha lidhjet e përbashkëta të racës dhe fesë që kishin me serbët, ishin aq të terrorizuar prej të qenit të përthithur dhe të përfshirë brenda tyre, sa kultivuan marrëdhënie më të ngushta me shqiptarët, edhe pse ata ishin më të huaj për ta si nga feja, si nga raca. Ndodhte shpesh që ata luftonin. Kishte shumë raste gjakmarrjeje që kërkonin kapërcimin e kufirit midis dy anëve. Dhe përsëri ata e njihnin mirë njëri-tjetrin, prandaj grindjet e tyre nuk kishin asnjëherë aq shumë helm sa ç’kishin ato midis serbëve dhe bullgarëve.

Pas shekujsh të një letargjie flegmatike, mpirëse, fatale, prej së cilës bijtë e shqipes qenë të zotët t’i qëndronin vasalitetit të tyre nën turqit, pati një zgjim të menjëhershëm të kombit. Kjo filloi në vitin 1908, që ishte viti i arritjes sime në Shqipëri, kur lëvizja e *Turqve të Rinj* përfshiu perandorinë. Kjo lëvizje e pati zanafillën në qytetin shqiptar të Resnjës (sot në Maqedoni, afër Liqenit të Prespës) dhe kontigjenti i parë që u lëshua në revoltë kundër sulltanatit, përbëhej prej shqiptarëve të drejtuar nga Riza bej Resnjasi, i cili solli shfronësimin e sulltan Abdyl Hamidit, shpërndarjen e parlamentit dhe daljen e një Kushtetutë të re.

Shqiptari Esat Pasha ishte deleguar që të njoftonte sulltanin e vjetër të dekretonte aktin që e shfronësonte atë dhe e dërgonte në mërgim. Kur revolucioni

xhonturk nuk tregoi asgjë më të mirë në administratën e tij sesa ç'kishte treguar sulltani, shqiptarët, të zemëruar keqas për tradhtinë që u ishte bërë, u lëshuan në një revolucion tjetër, këtë herë kundër xhonturqve. Kjo lëvizje u pri prej Isa Boletinit. Ajo zgjati nga maji deri në tetor të vitit 1909, dhe e njëjta gjë u përsërit në vitin 1910. Kur një vit më pas, shqiptarët e Kosovës grumbulluan dyzet mijë trupa të përgatitur jo vetëm për t'i qëndruar ushtrisë turke të dërguar kundër tyre, por edhe për të marshuar drejt Stambollit e për ta qëruar atë fare, revolucionin mori përmasa më të mëdha. Toskëve të jugut iu bashkuan edhe katolikët e veriut të Shqipërisë, Malësia e Madhe, Mati dhe Mirdita, duke përbërë së bashku një forcë përtej fuqisë së xhonturqve për t'u marrë me ta. Për më tepër, fuqitë europiane po tërhiqeshin ngadalë drejt kësaj çështjeje. Rusia, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Austro-Hungaria dhe Italia ishin të gjitha në *qui vive*, të gjitha duke ndier se Ballkani po shkonte përsëri drejt një shpërthimi për t'i dhënë fund të qenit pjesa europiane e Perandorisë Otomane. Secili shqetësohej për atë që bënte tjetri. Austria dhe Italia ishin të zëna me marrëveshjet, së pari në Salzburg, në vjeshtën e vitit 1908, më pas edhe me dy të tjera, atë të Torinos dhe Rakonjit (Racogni Agreement).

Rusia po përpiqej t'i bashkonte shtetet e Ballkanit në një lidhje kundër Turqisë. Ndërkohë, pesëdhjetë shqiptarë gegë, pjesëtarë të parisë së veriut, paraqitën një memorandum para Fuqive të Mëdha, nëpërmjet konsullatave të tyre në Shkodër. Ata protestonin në lidhje me dështimin e turqve për të përmbushur premtimet e tyre të bëra ndaj shqiptarëve. Në anën tjetër, turqit po mundoheshin të shtypnin baticën në rritje të rebelimit. Shefqet Turgut Pasha me një ushtri të përbërë prej pesëdhjetë mijë anadollakësh fshiu çdo gjë që gjeti përpara, dhjetëra e qindra fshatra, duke arrestuar nacionalistët, bejlerët dhe pasuesit e tyre. Paria e fiseve të mëdha e të fuqishme, e cila ishte mësuar me homazhet e princërve dhe sunduesve, ishte shitur në treg përpara popullit – një poshtërim dhe çnderim që nuk mund të harrohej. Mjetet për të njoftuar Fuqitë e Mëdha për barbarizmat që po kryheshin kundër shqiptarëve u gjetën, por përsëri asgjë nuk u ndërмор për t'i ndërprerë ato.

Duke qenë se shqiptarët janë akuzuar prej fqinjëve të tyre si njerëz që nuk

kanë shpirt patriotik, nuk kanë shije për pajisjet e jetës moderne të qytetëruar, le të hedhim një shikim në disa prej kërkesave që ata bënë në atë kohë për ta hedhur poshtë këtë shpifje ndaj tyre:

1. Amnisti për të gjithë të burgosurit politikë.
2. Një komision për të përlogaritur dëmet e shkaktuara Shqipërisë nga Shefqet Turgut Pasha dhe ushtria e tij. (Më vonë, kjo shumë u caktua një gjysmë milioni lira turke, që nuk u paguan kurrë.)
3. Njohje zyrtare e kombit shqiptar dhe e gjuhës shqipe, së bashku me alfabetin kombëtar latin.
4. Mësimet në të ardhmen të bëheshin në shkollat fillore në gjuhën shqipe dhe turke, pa dallim. (Ishin shqiptarët myslimanë që i paraqitën këto kërkesa.)
5. Të gjithë punonjësit e administratës duhet të dinin gjuhën shqipe.
6. Tërë agjentët e policisë duhej të ishin shqiptarë.
7. Trupat shqiptare në ushtrinë otomane, do të shërbenin vetëm në Europë, jo në Azinë e Vogël.
8. Një pjesë e taksave të mbledhura prej shqiptarëve duhet të përdorreshin për zhvillimin e vendit – rrugë, ura, shkolla, spitale, etj.

Përveç këtyre u paraqit edhe një kërkesë që parlamenti të shpërndahej dhe të ndërtohej një qeveri që do t'i ngarkonte vetes detyrën që t'i përmbushte tërë këto kërkesa. Nëse nuk bëheshin këto, çfarë do të ndodhte?

Ushtria e tyre do të marshonte drejt Stambollit dhe do të merrte kontrollin mbi qeverinë turke. A ishte ky një bllof? Shqiptarët nuk ishin aq ekspertë për këtë sa ç'janë ata që shohim në çdo kryeqytet europian në kohët e sotme. Ata e

kishin me gjithë mend atë që thoshin, ndërsa dihej se ata e kishin edhe forcën, edhe guximin për ta zbatuar planin e tyre të mirëmenduar. Turqit ranë dakord me kërkesat e shqiptarëve, pa humbur madje as një ditë.

Më në fund duket se karremi shqiptar dha rezultat, dhe kjo ishte diçka që në mendjen e qeverive të shteteve të tjera ballkanike do të ishte një katastrofë e një përmase të paparë. Prandaj nxitonin krerët e qeverive nga një kryeqytet në tjetrin. Shqipëria nuk duhej të lejohej të bëhej një vend autonom ose shtet nën sovranitetin e Turqisë, cilado të ishte kostoja që kërkohej për ta ndaluar atë. Po përse fqinjët ballkanikë të Shqipërisë do t'i kapte një panik kaq i madh, kaq i trazuar për një perspektivë të tillë?

Kjo situatë kuptohet më mirë kur vëren se si ushtria serbe ishte shenjtëruar me ritet më solemne të kishës për “misionin e shenjtë” që ajo kishte marrë përsipër të kryente, saktësisht: “Të çlironin vëllezërit e tyre të krishterë prej prangave mizore dhe poshtëruese të turqve islamë”. Disa muaj më vonë, kur këta të krishterë të njëjtë dhe myslimanë gjithashtu gjetën kohë për të llogaritur koston e çlirimit të tyre prej duarve të turqve, për të rënë në kthetrat e serbëve, shumica e tyre po qanin dhe i luteshin zotit që t'i kthente tek shteti i mëparshëm, pasi tani dukej sikur ai të kishte qenë një parajsë. Pas tërë këtij kamuflazhi, e vërteta lakuriq ishte se tokat shqiptare lakmoheshin prej Greqisë dhe Serbisë për të shtuar zotërimet e tyre territoriale pa shqiptarët, të cilët përbënin popullsinë vendase. Kushdo që dëshiron të përjetojë emocionin tronditës të tmerrit të vërtetë, jo si diçka që është sajuar dhe vënë në skenë nga aktorët e Hollivudit, mund ta gjejë atë në faktet autentike të fushatave kriminale të ndërmarra anembanë Shqipërisë, sa prej Greqisë aq edhe prej Serbisë.

Përse nuk luftuan shqiptarët? Më së pari, ata ishin mashtruar si edhe shumë herë të tjera më parë prej premtimeve pompoze të bëra ndaj tyre dhe prej besimit si prej fëmije që patën te mbrojtja që do u ofronin Fuqitë e Mëdha europiane. Në fillim të luftës, ato u kishin bërë tërë llojet e paralajmërimeve solemne shteteve

ballkanike të favorizuara, që asnjë metër katror e ndonjë territori nuk do t'u jepej atyre shtesë si rezultat i luftës. Lexoni këtë proklamatë drejtuar popullit shqiptar:

“Vëllezër, vuajtjet tuaja kanë prekur zemrat e njerëzve tuaj të afërt. Të prekur prej detyrës së shenjtë të mëshirës vëllazërore, ata erdhën tek ju për t'ju ndihmuar, për t'ju çliruar nga zgjedha turke. Si shpërblim për sakrificat e tyre, ata nuk dëshirojnë asgjë më shumë sesa të rivendosin paqe dhe rregull në tokën ku ju keni lindur, prandaj ejani dhe takoni këta kalorës të guximshëm të lirisë me kurora triumfale. Mbulojuani rrugën përpara këmbëve të tyre me lule dhe lavdi! Dhe jini shpirtmëdhenj ndaj atyre që deri dje ishin shtypësit tuaj! Si të krishterë, mos ia nxirni sytë njëri-tjetrit!

Rroftë Liria! Rrofshin ushtritë e guximshme çlirimtare!”.



PËRCAKTIMI PËRFUNDIMTAR I KUFIJVE ISHTE NJË KOMPROMIS. VILAJETET E KOSOVËS DHE MANASTIRIT, ME NJË POPULLSI SHQIPTARE PREJ TREÇEREK MILIONI, IU DHANË SERBISË. E TËRA KJO TOKË ISHTE SHQIPTARE. ISHTE NJË PLLAJË E GJERË DHE E BEGATSHME BUJQËSORE QË ZOTËRONTE SHQIPËRIA. DHE SHQIPTARËT JO VETËM I SHPRONËSUAN DHE I VENDOSËN NËN NJË QEVERISJE QË TASHMË KISHTE KRYER KRIMIN E SHFAROSJES NDAJ TYRE, POR LANË MIJËRA TË TJERË, NË ANËN E SHQIPTARËVE TË SHQIPËRISË SË CUNGUAR TASHMË, KREJT SI TË BURGOSUR NË KËSHTJELLAT E TYRE MALORE, PA LIVADHE PËR BAGËTINË, PA FUSHA PËR DRITHIN E TYRE AQ TË NEVOJSHËM DHE PA QENDRAT E BANUARA OSE QYTETET KU ATA DO TË QARKULLONIN DHE TREGTONIN PRODUKTET E TYRE.



XVI



LIRIA BASTARDE

Ishte prilli i vitit 1913 kur sër Eduard Grej, ministër i Jashtëm, deklaroi në *Dhomën e Komuneve*:

“Marrëveshja midis Fuqive në lidhje me kufijtë e Shqipërisë u arrit pas një përpjekjeje të gjatë dhe të mundimshme diplomatike”.

Edhe një herë u kujtua proverbi i vjetër: *“U mbars mali, polli një mi”*. Gjashtë Fuqi të Mëdha europiane dhe botërore, me përvojën dhe mençurinë e njëzet e pesë shekujve qytetërim, duke gjetur të pamundur procesin normal dhe natyror, kishin bërë një *operacion cezarian* me qëllim që të sillnin në jetë një shtet foshnjor. Gjashtë muaj më parë, më 8 tetor 1912, gjashtë Fuqitë e Mëdha, Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia u kishin dërguar një ultimatum Aleatëve Ballkanikë, në prag të fillimit të *Kryqëzatës së tyre të Krishterë* kundër turqve, për çlirimin e vëllezërve të tyre të Ballkanit, duke i paralajmëruar ata se, nëse shkonin në luftë, nuk do t’u lejohej të piqnin ndonjë *“fryt të fitores”*.

Më vonë u lëshuan paralajmërime veç e veç nga Austro-Hungaria për Serbinë, në lidhje me pretendimet e saj ndaj Shqipërisë dhe prej së njëjtës perandori dhe prej Italisë, në lidhje me Shqipërinë e Jugut. Në rrethana të tilla njeriu mund të mendojë se krijimi i një shteti të tillë duhet të ketë qenë një punë e thjeshtë. Ajo ishte një çështje e përcaktimit të vlefshmërisë së pretendimeve shqiptare ndaj vilajeteve të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, ndaj të cilave ata kishin paraqitur kërkesat e tyre tek qeveria turke disa muaj më parë.

Edhe qeveritë e shteteve të fuqishme u gjetën në pozita që duhej të hanin fjalën që kishin dhënë. Pa humbur kohë, u mbledh edhe *Konferenca e Paqes* në Londër. Dhe për shkak të pretendimeve të paraqitura ndaj territoreve të lëshuara prej “Turqisë Europiane”, ata u gjetën përpara një situatë jonormale. Mali i Zi paraqiti pretendime për Shkodrën, sipas tij, për shkak të nevojave ekonomike. Të njëjtën gjë bënë edhe ndaj Pejës, për shkak se, sipas tyre, Stefan Dushani, i cili në vitin 1346 e kishte shpallur veten car të serbëve, shqiptarëve dhe bullgarëve e bëri atë qendër për vendqëndrimin e patriarkut serb. Serbët paraqitën pretendime për të shkëputur pjesë nga veriu dhe t’i linin Shqipërisë një rrip toke të vetëm që shtrihej nga Vlora deri në Lezhë.

Austriakët dhe italianët e kundërshtuan me forcë këtë pretendim, ndërsa kishin hallin e vet për të bërë që kufiri të vihej jo më poshtë se dhjetë milje në jug të Vlorës, duke lënë një rrip shtesë tek ajo gjerësi që përbëhej thuajse tërësisht prej malesh, pa qytete të rëndësishme të shtetit shqiptar.

Shqiptarët i kishin paraqitur kërkesat e tyre bazuar në katër vilajetet e tyre të mëparshme, çka dukej se ishte shumë e arsyeshme për ta. Së pari, sepse e tërë popullsia ishte shqiptare dhe, së dyti, sepse ishte e domosdoshme që të ndërtohej një shtet që të kishte mundësi për t’u zhvilluar. Austria dhe Italia i mbështetën këto kërkesa, jo për hatër të Shqipërisë, siç mund të nënkuptohet, por për qëllime të dyfishta, njëri ndër të cilët ishte ta mbanin Serbinë sa më larg që të ishte e mundur nga deti Adriatik. Kështu mbahej ndezur edhe konflikti midis vendeve të Ballkanit,

suksesi i të cilëve kërcënonte t'i nxirrte ato jashtë prej statusit të shteteve kukulla; nëse ato do mund të mbanin së bashku *Aleancën Ballkanike*, atëherë do të pengonin përpjekjet e Austrisë për në Selanik. Rusia i mbështeste fuqishëm kërkesat e Serbisë dhe Malit të Zi. Kishte vende që donin ta fshinin Shqipërinë fare nga harta, duke e ndarë atë me Greqinë në vijën ndarëse të lumit Shkumbin

Përcaktimi përfundimtar i kufijve ishte një kompromis. Vilajetet e Kosovës dhe Manastirit, me një popullsi shqiptare prej treçerek milioni, iu dhanë Serbisë. E tëra kjo tokë ishte shqiptare. Ishte një pllajë e gjerë dhe e begatshme bujqësore që zotëronte Shqipëria. Dhe shqiptarët jo vetëm i shpronësuan dhe i vendosën nën një qeverisje që tashmë kishte kryer krimin e shfarosjes ndaj tyre, por lanë mijëra të tjerë, në anën e shqiptarëve të Shqipërisë së cunguar tashmë, krejt si të burgosur në këshjtjellat e tyre malore, pa livadhe për bagëtinë, pa fusha për drithin e tyre aq të nevojshëm dhe pa qendrat e banuara ose qytetet ku ata do të qarkullonin dhe tregtonin produktet e tyre. Midis tërë mizorive që kam parë në Ballkan dhe që ilustrjnë “çnjerëzinë e njeriut ndaj njeriut”, kjo e fundit është më e keqja. Shqipëria “meqë nuk mori atë që i takonte” në territor, popullatë, burime dhe në fqinjësi, të paktën të kishte përfituar ndonjë garantues europian. Çfarë rreshtimi ishte ky: Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia! Njeriu mendon se qoftë edhe vetëm njëra prej tyre po t'i dilte garant Shqipërisë, asaj do t'i mjaftonte për të siguruar suksesin e së ardhmes së shtetit të saj të sapolindur.

Mjerisht në rastin e saj u desh shumë pak kohë për të parë se sa qesharake ishte e tërë kjo që ishte ndërmarrë. Në plan të parë, ishte e pamundur të vendosej ndonjë bashkëpunim i vërtetë midis fuqive. Rusia e urrente, dhe thjesht priste rastin për ta fundosur tërë planin dhe të shkërmoqte tërësisht çdo ide për ekzistencë të një shteti shqiptar, territoret e të cilit bashkë me popullsinë, sipas saj, duhej t'i jepeshin Malit të Zi e Serbisë, duke kënaqur edhe aleatin e vet, Francën, me një pjesë dhënë Greqisë.

Kundër këtyre qëllimeve ishin pozicionuar dy fuqi, Austro–Hungaria dhe Italia, të cilat për arsye që dihen tashmë, prireshin kundër këtij plani. Gjermania dhe Britania e Madhe ishin më të përmbajtura, por çfarëdo vendimi mbi këtë çështje, për ta do të thoshte se ishte ose në favor të Francës dhe Ruisë, ose në favor të Austro–Hungarisë dhe Italisë. Pas përpjekjesh të gjata dhe të mundimshme, më në fund u ra dakord prej të gjitha fuqive që Shqipëria do të ishte një principatë e pavarur, sovraane, me një varg të drejtash nën garancitë e përbashkëta të gjashtë Fuqive të Mëdha. Për më tepër, shtatëdhjetë e pesë milion franga ari do të jepeshin prej këtyre fuqive për të plotësuar nevojat financiare të shtetit që do të drejtohej nga një princ i vendosur aty. Nga kjo shumë, dhjetë milion i dhanë Austro–Hungaria dhe Italia, fonde që do të përdorreshin për t’ia filluar. Kur kjo shumë u hodh në erë, e tërë skema doli të ishte një fiasko krejt qesharake.

Siç e di tërë bota, i zgjedhuri për princ të Shqipërisë ishte princ Vidi, kushëri i mbretëreshës Maria të Rumanisë dhe i rekomanduar prej saj për këtë kurorë. Ndërkohë, pikërisht për t’u siguruar se vendi nuk do të mbetej pa qeverisje, fuqitë ftuan Holandën që të dërgonte një komision në Shqipëri dhe të organizonte xhandarmërinë. Një prej veprimeve të para të komisionerit të lartë holandez ishte t’u ofronte grekëve në jug të Shqipërisë autonominë lokale, duke kërkuar në kthim njohjen formale të princ Vidit si kreu zyrtar i shtetit. Grekët në jug të Shqipërisë, të mbështetur fuqishëm prej qeverisë greke, po përpiqeshin me të gjitha mjetet të parandalonin përfshirjen e tyre brenda këtij shteti të ri. Nuk duhet aq shumë mendjemprehtësi për të kuptuar politikën ballkanike, e cila nuk ishte gjë tjetër veçse një barrë intrigash kundrejt një shteti të sapolindur. Ajo çfarë e bën edhe më trullosëse situatën për vëzhguesin, është se ku e mori komisioneri i lartë holandez atë autoritet? Apo po vepronte thjesht në të tijën? Në Vlorë gjendej qeveria e Ismail Qemalit, që ishte formuar si qeveri kombëtare, por që në fakt nuk e shtrinte dot autoritetin e saj as deri në Durrës. Më pak se gjashtëdhjetë milje larg ishte porti më i afërt në veri të saj. Atje Esat Pasha kishte vendosur qeverinë e tij që shtrihej deri në Tiranë. Drejt veriut dhe lindjes jetonin fiset e fuqishme malësore, që nuk

tregonin kurrfarë interesi ndaj asnjërës prej këtyre dy qeverive apo për procesin e vendosjes së qeverisë së princ Vidit. Në Shkodër kishte një trupë qeveritare të pavarur, e njohur si *Kontrolli Ushtarak Ndërkombëtar*. Dy njësi të tjera ndërkombëtare po vepronin në strukturat qeveritare, *Komisioni i Kontrollit Financiar* dhe *Komisioni Ndërkombëtar Konsullor*, i cili supozohej të ishte autoriteti më i lartë.

Kjo ishte situata kur Esat Pasha, i shoqëruar prej një delegacioni të rëndësishëm shqiptar që e kishte zgjedhur vetë, shkoi tek *Neuied* për t'i ofruar kurorën princ Vilhelm Vidit, të cilën ai e priti me shumë gëzim, zell dhe entuziazëm. Kjo ndodhi më 21 shkurt 1914 ose nëntë muaj pas nënshkrimit të *Traktatit të Londrës*, i cili i dha Shqipërisë të drejtën e pavarësisë. Më 7 mars, princ Vidi arriti në Durrës, qytet i zgjedhur për kryeqytet. Le të shohim pamjen e vendit ku do të rrinte princi. Tipari i parë që të bën përshtypje, është mosha e vjetër e vetë qytetit. Ai ishte i pluhurosur dhe gjithandej i mbushur me gjëra antike. Ajo çfarë shihej në atë vend, përbëhej nga një rrëmujë që dukej aq e vjetër sa dhe ata. Në qoftë se dikush do të ishte aq i guximshëm sa të kërkonte për bukuri në një vend të tillë, ai ose ajo do ta gjenin atë jo në diçka moderne, të gjallë, por në disa kolona mermeri të thyera, të sjella ndoshta nga Akropoli për të zbukuruar portikun e vilës së disa senatorëve romakë. Njëra prej rrugëve gjarpëruese që do të përshkonte mes përmes qytetin, ishte ndërtuar për qerret romake. Njëherë e njëkohë, thundrat e kuajve kishin shkelur, goditur, ciflosur dhe thyer ata gurë kalldrëmi nën trokëllimën e tyre. Këtu ka pasur shkëlqim të rrallë, por tani ajo duhet të jetë vetëm diçka që i përket një imagjinate që shkon prapa në historinë e mijëvjeçarëve. Në qytetin ku hyri princi, pasi ai kaloi muret antike, pa se nuk kishte asgjë tjetër përveç pamjes së një varri mumjesh, të lënë pas dore. Disa dhjetëra metra më tutje gjendej një kënetë që rrethonte qytetin.

Dikush pyet, përse ishte zgjedhur ky qytet prej princit për principatën e tij? E vetmja arsye e mundshme që unë hamendësoj, është që të largohej papritmas në rast nevoje, dhe për këtë Durrësi ofronte përparësi të pakrahasueshme. Në qoftë se do të rrethohej, ai e dinte se nuk kishte flotë të gatshme për ta bllokuar atë nga deti. Kështu erdhën princi i ri dhe princesha, dy fëmijët e tyre, një marshall, një

doktor, një sekretar, një mazhordom, zonjat e nderit, një kujdestar i dy zagarëve aristokratë, dhjetë milion franga ari në portofolin e tij dhe të gjitha gjërat për të kaluar sa më mirë.

Ishte një shfaqje e guximshme, e vënë në skenë shumë bukur: anije luftarake të huaja, diplomatë të huaj, aristokraci, dukë e dukeshë, flori i shndritshëm dhe i vezullueshëm, mëndafshe dhe stoli që rrisnin guximin dhe bukurinë e atyre që kishin si funksion të siguronin besnikëri përmes mbështetjes dinjitoze e të ndershme. Por, në tërë këtë katrahurë, faktori më i rëndësishëm që mungonte, ishte vetë kombi shqiptar. Hollivudi, me përvojën e tij edhe më të gjerë në vënien në skenë të pushtetit mbretëror dhe kurorëzimit të tyre, nuk do të kishte bërë një gabim kaq trashanik dhe fatal. Një regjisor filmi i Hollivudit do ta kishte përdorur këtë si një mundësi të pashoqe për ta “futur Shqipërinë në hartë”. Ai do të kishte pasur agjentët e tij që informonin nga një cep i vendit në tjetrin, duke zgjedhur njerëzit më të njohur midis shumë fisesh, krahinash dhe rrethesh të ndryshme, me veçantitë e tyre të të tëra llojeve, të kostumeve, të qethjes së flokëve, zbukurimeve, armëve, stolive dhe gjithçkaje tjetër. Burra e gra prej Matit e Mirditës, Dibërës e Oroshit, Lumës, Hotit dhe Grudës, Shkrelit dhe Kastratit, edhe pse shumë prej tokave të tyre kishin humbur tashmë dhe ishin marrë nga Mali i Zi. Prej Shkodrës dhe Lezhës, Krujës dhe Trebishtës, prej çdo pjese të Gegërisë së Shqipërisë, paria e tyre, bajraktarët, priftërinjtë dhe hoxhallarët, gratë dhe fëmijët do të shfaqeshin të gjithë me atë bukuri të rrallë, sado parake të ishte. Po ashtu nga Toskëria, ku kostumet janë në një kontrast të habitshëm me ato të veriut, me fustanellat e tyre, dollakët e bardhë të leshtë të ngjeshur pas trupit, xhaketat e tyre, jelekët e qëndisur deri në detajet më të vogla; këta së bashku me njerëzit nga qytetet më moderne dhe të përparuara si Korça, Gjirokastra, Janina, Beratit, do të përfitonin nga një rast kaq i veçantë si ky. Por sa i ndryshëm me këtë që përshkruam më lart ishte rezultati i tërë kësaj aventure! Nëqoftëse princi, duke marrë rolin e babait të një kombi, do t’u ofronte mikpritje disa prej prijësve të vendit dhe të shpenzonte disa milion franga, atëherë rezultati i punës së tij do të ishte krejt i ndryshëm.

Thyerja e një cope buke me princin e tyre, diçka që prej kohëve shumë të lashta vlerësohej si më e rëndësishme edhe se vetë lidhja e gjakut apo betimi, nuk u bë. Në vend të kësaj u gjet Esat Pasha, që ndodhej përherë tek bërryli i princit, nga ku i bënte shenjë se nga duhej t'i hidhte sytë, tek intrigonte herë me një fuqi europiane, herë me një tjetër. Të gjitha në kurriz të princit, të cilit i ishte betuar t'i shërbente besnikërisht. Po ç'gjendje ishte për njerëzit anembanë vendit? Ky ishte viti më i tmerrshëm ku numri i të vdekurve, jo-luftëtarë, viktima të ushtrive pushtuese, e i të plagosurve, ishte dyfish më i madh se humbjet më të mëdha të pësuar në beteja prej çdo vendi ballkanik në luftë. Kishte kaluar një vit ose edhe më shumë që kur kishte mbaruar lufta. Në më të shumtën e kësaj kohe, ushtria serbe dhe trupat e parregullta mbanin të pushtuar veriun e Shqipërisë, duke ndjekur të njëjtat metoda që kishin përdorur me sukses në Kosovë, duke shpresuar se shqiptarëve do u soste durimi dhe do të pranonin të përfshiheshin në shtetin serb. Në jug të Shqipërisë kushtet ishin edhe më të mjerueshme. Në pjesën më të madhe të kohës atje vazhdonin luftimet. Ushtria greke, para se të tërhiqej, i kishte ndërsyer bandat e armatosura të trupave të rregullta, guerrillasve, banditëve, aventurierëve, madje edhe kriminelëve që të hidheshin mbi banorët shqiptarë.

Ata do të merrnin aty tokë dhe mjete me format e tyre më të mbrapshta. Më shumë se 200.000 banorë në tokat e tyre të ligjshme stërgjyshore, siç theksohet në *Komisionin e raportimit të barbarizmave*, u nxorën prej shtëpive të tyre pa asgjë tjetër, veç shpirtit. Një numër i madh i tyre u la të vdisnin nga uria. Këta ishin myslimanë shqiptarë që u përzunë për t'u hapur rrugën grekëve, me qëllim që të zmadhohej popullsia që mbante fenë ortodokse greke, deri sa të bëhej ajo një shumicë mbizotëruese. Tridhjetë mijë syresh i pashë vetë në Vlorë dhe rreth saj, ku kalova disa ditë bashkë me ta. Ajo që pashë me sy dhe dëgjova me veshët e mi dhe që dëshmon vuajtjet dhe martirizimin e tyre, më bën ta besoj më lehtësisht atë që flitet për më të keqen që ka ndodhur në këtë vend. E tillë ishte varrosja për së gjalli e njëqind e pesëdhjetë burrave, grave dhe fëmijëve të strehuar në një kishë ortodokse, duke pandehur se aty të paktën do të gjenin strehë të sigurtë. Përveç

atyre jetëve të shkatërruara tërësisht, vlerësohej se edhe 200.000 000 franga ari në pasuri ose ishin shkatërruar tërësisht, ose ishin rrëmbyer prej pushtuesve.

Prej tetë “qeverive” të pavarura (dhjetë nëse përfshijmë edhe grekët dhe serbët, njëmbëdhjetë nëse përfshijmë edhe Turqit e Rinj që ishin ende aktivë) që sundonin në një territor prej dhjetë mijë miljesh katrore, ndoshta më e dobëta, më pak efektive dhe më e pashpresa ishte ajo e drejtuar prej princ Vedit. Pothuajse të vetmit njerëz që e rrethonin princin dhe që duhej t’i bindeshin ose i bindeshin, ishin marshalli, doktori, sekretarët, shërbëtorët dhe, me raste, edhe mazhordomi i tij. Gjashtë javë pasi ishte formuar kabineti, Esat Pasha, ministër i Brendshëm dhe i Luftës, i vetmi anëtar jo thjesht kukull i kabinetit, u arrestua për nxitjen e një komploti që kishte si qëllim ta nxirte princin jashtë loje dhe të merrte kontrollin për vete. Dyshimi për organizimin e komplotit shkonte shumë tek italianët, sidomos prej austriakëve. Besohej se princi ishte tejet pro-austriak, sidomos po të kihej parasysh, për shembull, fakti që ai e porosiste ushqimin për zagarët e tij që nga Vjena.

Sido që të jetë, italianët e morën përgjegjësinë për pashain, e dërguan atë në Itali si njeri të luftës, e mbajtën si mik nderi për disa muaj, ndërkohë që përkrahësit e Esatit dhe Turqit e Rinj së bashku, nxitën një revolucion, i cili bëri që brenda një muaji princ Vidi të detyrohej t’u kërkonte në mënyrë të menjëhershme ndihmë ushtarake Fuqive për të shtypur rebelimin. Me ardhjen e gushtit, Fuqitë e panë veten të zënë më shumë me gjëra të tjera që i kishin më afër shtëpisë së tyre, me ruajtjen e jetës dhe qytetërimit të tyre nga vorbullat e madhe e *Luftës së Madhe* që kërcënonte t’u zinte frymën të gjithëve, sesa me princin dhe Shqipërinë.

Më në fund princ Vidi hoqi dorë nga lufta dhe ia hipi një varke italiane, i lumtur që arriti të paktën të mbronte kokën e vet. Kaq i befte ishte nxitimi i tij, sa ai e la portofolin e tij ku kishte ca para të holla prej dhjetë milion frangash ari, prapa, në varkën që e dërgoi drejt avullores. Esat Pasha u kthye mbrapsht në Shqipëri menjëherë prej zotërve të tij italianë dhe u vendos në një pallat të lënë

bosh prej princit. Aty ai gjeti pjesën më të madhe të garderobës së princit dhe të princeshës, të mbetur aty në dollapet e tyre, si dhe mobiljet, qilimat, pikturat dhe tërë zbukurimet e pallatit, me depozitat e verës, pijeve, cigareve, duhanit, etj., gjëra që ai i përdori thujse gjatë tërë kohës së luftës. Dr. E.J. Dilloni,⁷⁸ korrespondenti i Ballkanit për gazetën *London Daily Telegraph*, në librin e tij *Nga Treshja te Katërshtja*, na ka dhënë përmbledhjen e një fiaskoje fatale si kjo:

“Skema e një Shqipërie të pavarur lindi nga xhelozia reciproke e dy aleatëve, të cilët paraqiteshin përpara botës si miq të ngushtë të saj. Realizimi i kësaj ideje që do të shkatërrohej para se ata vetë ta braktisnin, solli frikën e shfaqur prej këtyre dy fuqive se mos dështonte eksperimenti dhe përpjekjet që kishin bërë nga jashtë. Për të penguar këtë arritje lindi një konferencë tjetër, ajo e Londrës, që u soll ndaj Shqipërisë si ndaj një fëmije që sapo kishte lindur si produkt i xhelozisë dhe urrejtjes. Personalisht jam i prirur të mendoj se Shqipëria mund të ishte modeluar si një shtet aq i shëndetshëm dhe i dobishëm ose aq pengues dhe i vështirë sa edhe çdo shtet tjetër i mbretërive të Ballkanit. Por në këtë rast, burimet e bollshme financiare, një skemë koherente, një zgjidhje e vendosur dhe zbatimi i metodave të zgjuara ishin kushte të domosdoshme. Por asnjë prej këtyre nuk u zbatua”.

“Udhëheqësi ishte një princ gjerman, i komunikueshëm, por të cilit i mungonte ambicia dhe nxitja për të pranuar një kurorë mbretërore me gjemba. Xhandarmëria ishte holandeze dhe shefat e saj, duke dashur të provonin se ishin po aq të aftë në politikë sa ç’ishin trima në betejë, u bashkuan me një pjesë të nacionalistëve të pandershëm kundër dy kombeve që i kishin ftuar ata për të mbajtur rendin”.

Dhe kaq të devotshëm ishin ata ndaj idealit të tyre për Shqipërinë, sa komplotuan me princin kundër dy burrave të fuqishëm shqiptarë, dhe me Austrinë, kundër parisë së fuqishme myslimane që përfaqësonte 68 % të tërë popullsisë.

⁷⁸ *Emil Zhozef Diloni (Emile Joseph Dillon)* (lindi në Dublin më 21 mars 1854 – vdiq në Barcelonë më 9 qershor 1933), ishte shkrimtar, gazetar dhe gjuhëtar. Babai ishte irlandez, ndërsa nëna angleze. Diloni studioi fillimisht për t’u bërë prift, por hoqi dorë nga karriera e kishës në moshën 21 vjeç dhe u zhyt në studimin e gjuhëve orientale në *Collège de France* në Paris. Më pas mori gradën Doktor i Filozofisë në Universitetin e Laipcigut, si dhe mbrojtëti doktoratura të tjera; në gjuhët dhe letërsinë orientale në Universitetin Katolik të *Leuvenit*, dhe në filologjinë krahasuese në Universitetin e *Kharkivit*.

Mbreti (princi) pengohej prej një këshilltari italian dhe një tjetri austriak, çdonjëri prej të cilëve i jepte atij këshilla që ishin zhvleftësuar prej të tjerëve. Ministrat, të ndarë mes tyre, herë ndikoheshin prej Italisë, herë prej Austrisë. Një *Komision Ndërkombëtar i Kufijve*, i përbërë kryesisht prej komisionerëve që ishin të bindur se i tërë eksperimenti ishte i dënuar të dështonte, e intensifikoi kaosin që mbretëronte dhe mungesa e parave goditi përpjekjet e çrregullta të dy ministrave, për t'i bërë këto përpjekje edhe më shterpë se ç'ishin.

Më shumë se një vit pasi princi dhe princesha kishin ikur, krejt papritmas hasa *mazhordomin* e tyre, ndërkohë që po hipnim në varkën e vogël që do të na çonte deri tek avullorja. E bëmë udhëtimin bashkë deri në Bari dhe dëgjova shumë prej tij për jetën prapa skenës që zhvillohej në ato muaj të turbullt. Shumicën e gjërave m'i tregoi me një besim që njeriu duhet ta respektojë. Por, megjithatë, më duhet ta lidh atë tregim me shpërthimin e tij në lotë kur foli për humbjen e garderobës mbretërore. Thujse asgjë nga të brendshmet e zgjedhura me shije aq të hollë të mbretëreshës nuk kishte mbetur. Të njëqind e shtatëdhjetë palët që ajo i kishte kaq të bukura, të tëra të blera në dyqanet *channel* më të bukura të Parisit, ia kishin marrë që të gjitha.



LUFTËRAT BALLKANIKE E KISHIN GJYMTUAR TRUPIN E KOMBIT, NDËRSA PLAGËT IA KISHIN HOLLUAR GJAKUN. MUHAXHIRËT PREJ PJESËVE TË NDARA TË KOMBIT, TË PASTREHË DHE TË URITUR, KISHIN ARDHUR ATY. NË SYTË E TYRE SHQUHEJ TERRORI QË KISHIN PROVUAR NDËRSA ME GOJËN E ATYRE MIJËRA VETËVE TREGOHEJ TMERRI QË KISHIN PËRJETUAR. PËR MË TEPËR, PLAGA E KUFIRIT PO GRRITHEJ DHE KRIPEJ ÇDO DITË ME MIZORI TË REJA. NË VERI, NË LINDJE DHE NË JUG. NDËRKOHË, MUAJT KALONIN. GJATË PRANVERËS, FUSHAT E TYRE ISHIN PLUGUAR ME PUSHKËT DHE BAJONETAT E USHTRIVE PUSHTUESE DHE FARA E DRITHIT ISHTE MARRË PËR TË USHQYER KAFSHËT E USHTRIVE PUSHTUESE.



XVII



GUR PËR BUKË

...Dhe secilit prej jush që është baba, i biri do t'i kërkojë një copë bukë, dhe ai i jep atij një gur.

Shën Luka

Subjekti i këtij kapitulli është një prej atyre që ndoshta sa më pak të flitet, aq më mirë është. Prandaj do të jetë i shkurtër. Gjashtë muajt e mbretërimit të princ Vidit në Shqipëri mund të trajtohen qoftë si komedi, po aq edhe si tragjedi. Është tepër serioze kur e sheh nga një kënd i caktuar, dhe tepër komike kur e sheh nga një kënd tjetër. Është një parodi, një opera komike e mbushur me skena tragjike. Por kjo ka kaluar tashmë. Aktorët, çfarëdo lloj rolesh të kenë luajtur, princ apo shejtan, kanë ikur. Disa prej tyre nuk u kthyen kurrë. Nuk është bërë asgjë tjetër, përveç një episodi të mbetur në kujtesën e dikujt, me kohëra kaq të mjegullta sa njeriu ka frikë se mos i ngatërron gjërat me ndonjë novelë të Antoni Hopit. Por episodi ishte mjaft i vërtetë në kohë dhe i endur prish e shprish, në historinë

tragjike të kombit shqiptar. Një kredhje në të shkuarën.

Në vitin 1913, së bashku me zonjën Edit Durham e zotin Henri W. Nevinson ndërmorëm një tur me kuaj nëpër tërë Shqipërinë, nga Shkodra deri në Vlorë. Një prej ndalesave tona ishte Kruja, kryeqyteti i Skënderbeut dhe një prej qyteteve më piktoreske në tërë vendin. Ne u vendosëm në konak ose në ndërtesën e qeverisë, brenda mureve rrethuese që i kishin qëndruar me aq sukses rrethimeve të njëpasnjëshme të Muratit II dhe Mehmetit II në shekullin e pesëmbëdhjetë.

Pasi u pritëm prej zyrtarëve dhe na shërbyen kafe dhe cigare, na lanë vetëm në dreqë dhe mbasdite. Përpara se të bëheshim gati për të ikur, zyrtarët na vizituan edhe një herë. Atyre u printe kajmekami.⁷⁹ Ai ishte një hoxhë i vjetër, ose një mësues i Kuranit, një burrë dashamirës dhe patriarkal, me një feste të kuqe në kokë dhe shall të bardhë rreth qafës. Ai ishte zëri i asaj mbremjeje të vogël. Pasi kundërshtoi të ulej në divan në anën tonë, ai kërkoi leje të ulej në dysHEME tek këmbët tona, në shenjë respekti ndaj Anglisë dhe Amerikës. Pastaj filloi të fliste me zë të ulët, me një ton të butë. Ai fliste një shqipe të bukur, që është e pamundur të përkthet ashtu siç e fliste ai, pasi përdori shumë frazeologjizma gjuhësore për ta veshur sa më mirë mendimin. Dhe ja çfarë ai na tha:

“Ne jemi të nderuar dhe mirënjohës për ardhjen tuaj në qytetin tonë të vogël. E morëm vesh se ju vini prej kombeve të mëdha dhe të pasura të Anglisë dhe Amerikës. Ne kemi udhëtuar aq pak, sa kemi shumë pak dijeni rreth botës së madhe. Por kemi dëgjuar dhe besojmë se vendet tuaja janë më të pasurat, siç janë kombet tuaja më të përparuarat dhe më të zhvilluarat në botë. Kemi dëgjuar për lirinë që gëzojnë popujt tuaj, për mundësitë që kanë për arsim dhe rehati familjare në shtëpitë e tyre, për kujdesin që tregojnë për fëmijët, për të sëmurët, për të varfërit dhe të moshuarit. Kemi dëgjuar për veprat bamirëse në drejtim të njerëzve të vendeve të tjera që janë me më pak fat, për përpjekjet për t’u siguruar atyre disa prej bekimeve që ju vetë i gëzoni. Kushtet tona, si komb, janë të dhimbshme.

⁷⁹ Kryebashkiaku.

Ne jemi të dobët, të varfër, të pashkollë dhe të shtypur. Ne jemi si një tufë delesh, të braktisura prej bariut dhe të rrethuara prej ujqërve të uritur që kërkojnë të na shqyejnë. Ne kemi vuajtur aq shumë nga luftërat dhe nuk kemi përfituar asgjë. Neve na janë grabitur tufat dhe bagëtitë, drithi, madje edhe të mbjellat dhe farërat. Shumë prej fshatrave tona janë shkatërruar. Shumë pasuri janë konfiskuar dhe janë marrë. Populli ynë është keqtrajtuar dhe shpërndarë. Ne menduam se Europa ishte gati të na mbronte në të drejtat tona të lashta, prandaj nuk bëmë qëndresë. Nuk e dinim se do na linte të vuanim në këtë mënyrë, pasi nuk kemi bërë as krime, as gabime.

Për shembull, kur serbët u vunë në zotërim të qytetit tonë, një shqiptar që jetonte gjashtë orë larg në male, vrau një serb për mizoritë e bëra ndaj gruas së tij. Për t'u hakmarrë, serbët shkatërruan disa fshatra rreth e rreth, kapën pesëdhjetë vetë të pafajshëm ndërsa po shkonin në pazar, dy prej të cilëve ishin gra dhe i vunë para vdekjes. Tërë këta ishin krejtësisht të pafajshëm dhe të palidhur me çfarëdo krimi për të cilin ata ishin vënë përpara akuzave. Qëkur serbët ikën, ne kemi qeverisur veten, të krishterë dhe myslimanë së bashku, dhe jetojmë në paqe e në qetësi, duke pritur Europën që të na dërgojë një qeveri”.

Pasi na bëri disa pyetje se çfarë forme qeverisjeje do të ishte më e mira për ta, dhe ne i shprehëm mendimin tonë, ai vazhdoi:

“Baba Dovleti ishte askushi për ne. Ai nuk ishte i mirë ndaj nesh, edhe pse ishim fëmijët e tij. Ai na harroi sapo ne u kthyem drejt jush. Nuk besojmë se edhe ju do na merrni për të na kalbur dhe zhvatur për interesat tuaja. Besojmë se do përpiqeni të na ndihmoni. Ne kërkojmë prej jush mësues që të na tregojnë mënyrën se si të jetojmë. Kërkojmë guvernatorë që dinë të na udhëheqin. Ne duam të jemi fëmijët tuaj të adoptuar dhe do t’ju bindemi juve. Ne nuk jemi të paqeverisshëm, por na lipsen udhëheqës që t’u besojmë, që nuk na tradhetojnë. Jemi të paditur, por jo njerëz të këqij. Thjesht na duhen ata që na prijnë në rrugë të mbarë”.

Unë e citova të tërë thelbin e kësaj thirrjeje prekëse dhe të drejtpërdrejtë, të bërë prej një njeriu të moshuar, një shqiptari muhamedan që na hapi zemrën. Ai na interpretoi çfarë ka në zemrën e këtij kombi. Dhe unë besoj se është një karakterizim i vërtetë i shpirtit me të cilin shqiptarët ishin përgatitur të praninin qeverinë që Europa u premtonte t'u jepte.

PO PËRSE DËSHTOI QEVERIA E VIDIT?

Cilat ishin, atëherë, arsyet e dështimit të mjerueshëm të regjimit të princ Vedit? Cila ishte natyra e vllgut që duket se shkatërroi çdo degë, çdo departament, çdo sipërmarrje të kësaj qeverisjeje? A bie faji për këtë mbi vetë shqiptarët, duke i treguar ata si të paaftë për t'iu përgjigjur kërkesave të një shteti të organizuar? A bie arsyeja e dështimit mbi princin që ishte dërguar për t'i sunduar ata? Këto arsye janë hamendësuar, por njeriut i duhet të shqyrtojë situatën në mënyrë të paanshme, përpara se ta pranojë njërin ose tjetrin variant. A mund të fajsohet një popull që del prej errësirës së pesë shekujsh shtypjeje, robërie e tiranie racore, gjatë së cilës ka mësuar shumë prej së keqes e pak prej së mirës në çdo aspekt, përfshirë edhe atë të qeverisjes? Për çështjet legjislative as që dinin ndonjë gjë. Ata dërgonin përfaqësues në parlamentin turk, por zgjedhja e tyre ishte aq e manipuluar prej turqve, sa që mezi mund të shihet qoftë edhe si një formalitet elektoral. Aq pak kuptim i jipnin ata kësaj çështjeje, sa kjo nuk kishte asnjë lidhje me kombin e tyre.

Me degën ekzekutive të qeverisjes ata njiheshin pak a shumë. Një mytesarif i ri, ose një kaimekam (prefekti dhe nënprefekti) dërgoheshin shpesh tek ta dhe ndryshimet ishin shumë të shpeshta në sistemin turk. Ata ishin përgjithësisht turq aziatikë, që nuk dinin asnjë fjalë në gjuhën shqipe, që nuk çanin kokën dhe as që interesoheshin për jetën e njerëzve. Ata jetonin si të huaj midis tyre, duke mos bërë miq, duke mos i hulumtuar nevojat e tyre dhe, padyshim, duke mos punuar për asnjë përmirësim të kushteve të tyre të jetesës. Pas gjashtë muajsh ose një viti, ata iknin duke i lënë vendin një tjetri. Përsa u takon gjykatave turke, mjafton të themi se shumë shqiptarë kanë kaluar nëpërmjet tërë procedurës së ligjit, arrestit, gjykimit

dhe burgosjes, ose çfarëdo dënimi tjetër, pa ditur madje as natyrën e krimit për të cilin gjykoheshin ose pikat për të cilat burgoseshin.

E tillë ishte përvoja e mëparshme e kombit shqiptar me atë që ne e quajmë qeveri. Efekti i natyrshëm i një qeverisjeje të tillë, ndaj të cilës një popull bëhet indiferent ose antagonist, është sa ta quajë atë si diçka që duhet duruar, si një e keqe e domosdoshme, por duke ushqyer ndaj saj një përbuzje të fshehtë në shpirt. Gjatë luftërave të fundit në Ballkan, populli ishte gjetur midis dy zjarreve dhe digjej prej të dyve, duke mos ditur se cilin drejtim të merrte. Pastaj fuqitë e mëdha të Europës u kishin thënë shqiptarëve të rrinin të qetë, dhe për këtë do të shpërbleheshin. Atyre u ishte premtuar pavarësia, e cila për disa prej tyre kishte pak kuptim si fjalë, ndërsa për shumë të tjerë ishte gjithçka. Për këta të fundit që kishin punuar, luftuar dhe vuajtur, pavarësia ishte bërë një gjë e shenjtë, një parrullë, një *shoboleh*, çelës që hapte një derë të parajsës tokësore.

Mbi të gjitha, shqiptarët janë popull krenar dhe spiritual. Ata nuk mund të përziheshin me forcë. Ata mbanin plagë të dhimbshme në trupin e vet dhe të kombit. Nëse fjalët e Shekspirit në tragjedinë *Makbeth* kanë qenë ndonjëherë të vërteta në Skoci, ato, me siguri, kanë dy herë më shumë kuptim në tokën e shqiptarëve:

E shoh se vendit tonë, qafën zgjedha ia shtrëngon,

Qan, gjaku i kullon dhe plagët përditë ia shton.

Atëherë, ushtritë ikën duke e lënë popullin të vuante tërësisht pa ndihmë dhe në mizerje. Disa prej bejlerëve ia kishin dalë të ruanin pjesë të magazinave të drithit të tyre, dhe kjo pjesë e mbetur iu shpërnda fshatarëve për farë, për t'u mundësuar atyre një fillim. Por mjerisht, në shumë raste kaluan në uri të zgjatur. Pas muajsh të tërë pritjeje të lodhshme erdhi koha e korrjeve. Por ato ishin korrje aq të varfëra, sa nuk i plotësonin nevojat e kombit. Përsëri fuqitë nuk ua dërguan *princin* atyre.

Por dr. Diloni, në librin e tij *From Triple to the Quadruple Alliance*⁸⁰ ka theksuar:

“Në tërë atë çka u vendos dhe u bë aty, ruheshin interesat e gjithkujt, përveç atyre të popullit shqiptar”.

ARRITJA E PRINCIT, HAPET PERDJA

“Më 7 mars 1914, princi dhe princesha Vidi arritën në Durrës. Aty pat shumë brohoritje, u rezervua një mirëseardhje bujare dhe e vërtetë, dhe një turmë e madhe e shoqëroi çiftin mbretëror për tek pallati i tyre. Sigurisht jo si ai i Bakingamit⁸¹ ose ai i Potsdamit,⁸² por mjaft i mirë për një fillim. Nga ballkoni i tij ata shumë shpesh merrnin përshëndetje dhe brohoritje të shumëfishta që andej poshtë”.

Vetëm disa javë më vonë, dr. Diloni, duke i shkruar gazetave londineze nga kryeqyteti shqiptar, thoshte:

“Shqipëria është bërë arenë e ndikimeve heterogjene që vijnë nga drejtime të ndryshme. Aty nuk ka qëllim, as program, as autoritet të njohur në vend. Propaganda, intrigat, fjalët e njerëzve e fshelin thelbin e çështjes”.

Qaq e shpejtë dhe precipituese ishte rruga drejt kaosit. Për t’u kthyer përsëri tek çështja e fillimit të kapitullit: Përse dështoi princ Vilhelm Vidi? Le të provojmë të përgjigjemi tani. Fillimisht, unë besoj se përgjegjësia duhet të kërkohet tek *Konferenca e Ambasadorëve* e Londrës, e cila ndërtoi kornizën e qeverisë së re. Midis të tjerash, u vendosën dispozitat e mëposhtme:

Së pari, Shqipëria duhet të jetë një principatë sovraane, autonome, e trashëgueshme, nën garancitë e gjashtë Fuqive. Një dispozitë e tillë, sapo të zgjidhej kreu i shtetit, do të dukej se e vendoste përgjegjësinë në duart e tij, i garantuar ndaj çdo ndërhyrjeje të jashtme. Por një gjë e tillë ishte larg nga ajo çfarë bëhej në

⁸⁰ Nga Aleanca Treshe në atë Katërshe (*From Triple to the Quadruple Alliance*) f.59.

⁸¹ Buckingham Palace – Pallati Mbretëror i Anglisë në Londër.

⁸² Pallati kaizerëve gjermanë në Potsdam, afër Berlinit.

terren.

Një dispozitë tjetër përcaktonte se aty do të konstituohej një *Komision i Kontrollit*, i përbërë nga një delegat prej secilës prej gjashtë Fuqive, si dhe shqiptarëve, i cili do të mbante kontrollin mbi financat, administratën civile, dhe, mundësisht, policinë. Po ky komision do të organizonte qeverinë e përhershme.

Një klauzolë në lidhje me detyrat shtetërore të *Komisionit* ishte që “në pritje të emërimit të princit dhe formimit të një qeverie kombëtare, funksionet e autoriteteve ekzistuese, ashtu si edhe policia, duhej të ishin nën një *Kontroll Ndërkombëtar*”. Në të njëjtën kohë, një dispozitë tjetër në marrëveshje thotë: “Siguria publike dhe kufiri do të garantohen prej *Organizatës Ndërkombëtare të Policisë*, organizatë që do t’i besohet oficerëve të huaj, që do të kenë komandën më të lartë dhe të plotë mbi policinë”.

Siç është theksuar në artikujt e ish-ministrit të nderuar,⁸³ financat, administrata dhe policia u morën të gjitha prej duarve të princit dhe kabinetit të tij. Për më tepër, autoritetet civile që e kishin mbajtur rendin dhe qetësinë në vend deri më tani, ishin zhveshur nga të tëra funksionet, nga i pari tek i fundit, dhe të tëra funksionet ishin marrë prej *Komisionit të Kontrollit*. Këtij populli nuk i ishte dhënë as kushtetutë, prej së cilës ata do të gëzonin qeverisjen në tërë degët e saj. Madje ata nuk dinin se kush ishte qeveria e tyre dhe në duar të kujt qëndronte autoriteti, as se si mbroheshin të drejtat dhe liritë e tyre. Në të vërtetë, pjesa shqiptare e qeverisjes përfaqësohej prej një anëtari në *Komisionin* shtatë anëtarësh të një kabineti kukull, të drejtuar po prej një princi kukull. Z. Williams thekson gjithashtu, se asnjë pushtet juridik që të përcaktonte dhe kufizonte funksionet në degë të ndryshme të pushtetit, nuk ishte vendosur qartë. Del qartë se aty kishte tre krerë të pavarur të qeverisjes, një princ me kabinetin e tij, një *Komision Kontrolli* dhe një *Kontroll Policor të Huaj*. Asnjëri prej tyre nuk i jipte llogari tjetrit, ndërkohë që dy prej tyre nuk i jipnin llogari askujt. Komisionerët e huaj jipnin llogari vetëm tek qeveritë e

⁸³ George Fred Williams *Harpers Weekley*, 24 prill 1915.

veta që i kishin dërguar aty. Për më tepër, Fuqitë e Mëdha që kishin vendosur dhe garantuar integritetin e shtetit, nuk siguronin qoftë dhe një ushtar të vetëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e tij dhe më keq akoma refuzonin ta bënë një gjë të tillë, bash në atë kohë Epiri ishte kthyer në një burim çrregullimesh, intrigash, rebelimi të armatosur, siç është përshkruar tashmë.

Më pas, vetë organizimi i *Komisionit të Kontrollit* nuk pati ndonjë fund fatlum. Asnjë anëtar i tij nuk e kalonte rangun e konsullit dhe njëri ishte vetëm zëvendëskonsull. Çfarëdo ekspertësh të kenë qenë ata në administrimin e punëve të tyre konsullore, prapë nuk zotëronin përvojën që kërkonin detyra të tilla delikate dhe të vështira të drejtuarit të kësaj pune kaq të brishtë e në kohëra kaq të turbullta.

Përfytyroni përpikmërinë dhe kujdesin me të cilin mendjet më të pjekura të kolonive amerikane, juristët më të aftë, burrështetasit më të zgjuar, historianët më të ditur treguan së bashku për formimin e qeverisë së kombit të tyre dhe hartimin e kushtetutës së tij. Shihni punën e jashtëzakonshme në të cilën ata u përfshinë përpara se instrumenti i lirisë së kombit të paraqitej përpara tyre. Vendoseni këtë në kontrast me këtë trajtim thuajse shpërfillës të problemit shqiptar. Nuk kishte asgjë, as në veprim, as në përbërje të këtij *Komisioni* që të jepte shpresë për sukses të tij në fund të misionit të vet. Jo-zyrtarisht, mësojmë se dikush që përfaqësonte *Foreign Office*-in, ndërsa pritej të bënte punën që i ishte caktuar, e kalonte kohën duke i raportuar qendrës së vet. Ishte kjo arsyeja që ai zinte kohën e tij gjatë diskutimeve me argumente të kota dhe shpesh foshnjore, ose me një shëtitje duke pirë duhan nëpër korridore.

ITALIA DHE AUSTRIA

Një tjetër shkak i madh që çoi në dështimin e sipërmarrjes, ishte xhelozia e dyanshme e Italisë dhe Austrisë, dhe frika e tyre se njëra do të merrte përparësi ndaj tjetrës prej pazareve që bëheshin. Ato ishin dy fuqitë që në *Konferencën e Londrës* kishin qenë për një Shqipëri të plotë dhe të pavaruar. A do të kishin sukses

ato në kërkesat e tyre, të cilat kishin si qëllim ta ndanin shtetin midis tyre në dy zona ndikimi, me të cilat më vonë mund të shkonin më larg, aq sa do ta lejonin rrethanat? I vockël dhe i dobët siç ishte fëmija që kishin bërë, në pamje të parë ishte e pamundur që ky qëndrim të sillte fundin e trazirave midis këtyre dy shteteve. Megjithëse Italia e pranoi emërimin e princ Vidit në *Konferencën e Ambasadorëve*, në mënyrë krejt të qartë ajo u bind që herët se rivali i saj mori përfitime më shumë se ajo vetë dhe politika e saj e pranimit të heshtur u shndërrua në armiqësi aktive ndaj tjetrës. Shkruesit e saj e kanë fshehur faktin se ajo furnizonte me armë rebelët e Tiranës, Shijakut dhe Kavajës kundër qeverisë, në dobi të ardhjes së një princi muhamedan, nëse rebelimi kishte sukses. Kryeministri i Italisë, markezi di Xhuliano, nuk kishte interesa dashamirëse ose shqetësime ndaj shqiptarëve. Ai deklaroi hapur se “interesat e Italisë në këtë vend ishin negative”.

Ai nuk do të duronte kapjen e bregdetit në anën e Adriatikut prej ndonjë fuqie tjetër ose, të paktën, jo nga Austria. Kjo ishte palca e politikës së saj.⁸⁴

MBRETËRESHA VIDI

Është e sigurtë se princi asnjëherë nuk e pati fatin me vete. Tërë kartat u luajtën kundër tij, çfarëdo lëvizje që ai të bënte. Ai ishte në gjendjen më të vështirë dhe më të keqe të mundshme. Atij i duhej të ballafaqohej me katër mënyra, secila e kundërt me tjetrën.

Kënaqe njërën, që të bësh tri të tjerat të pakënaqura! Përpiqu t'i kënaqësh të gjitha dhe pastaj shih se asnjëra nuk kënaqet! Mendo të veprosh i pavarur, dhe të gjithë fyhen! Më në fund, më mirë mos bëj asgjë! Nga zotërimi i tij rrëshqiti çdo gjurmë autoriteti, dhe ai u kthye në një të burgosur virtual. I vetmi ngushëllim ishte zagari dhe kitara e tij.

⁸⁴ *Triple to Quadruple*, f.57.

SIKUR, SIKUR, SIKUR...

Ka kaç shumë spekulime se çfarë do të ndodhte sikur...?

Sikur ai të mbështetej më pak tek Austria dhe më shumë tek Italia? Po sikur ta kishte mbajtur Esat Pashën jashtë kabinetit të tij, dhe të mos fyente thuajse tërë krerët e Shqipërisë? Po sikur të tregonte më shumë vlerësim për dallimet fetare të popullit dhe të mos i vendoste katolikët në atë pozitë sa të shtypnin një kryengritje muhamedane...?

Po sikur ta kishte kapur “demin nga brirët” dhe të merrte pranë vetes këshilltarë të mençur, veçmas nga njëri-tjetri, dhe të mos merrte ata që ishin të pabesueshëm dhe të vegjël? Po sikur mos ta kishte pranuar kurorën me gjemba në duart e Fuqive, derisa ato ta kishin siguruar me një forcë ushtarake të përshtatshme zbatimin e politikës së tij? Po sikur ai, në vend që të qëndronte pa lëvizur në kryeqytetin e tij malarik të vogël, të infektuar, të dilte në terren dhe të thërriste shqiptarët besnikë që ta ndiqnin atë?

Eh, fjala *sikur*... është lojë e humbur fjalësh, tashmë!

Përmbledhja e dr. Dilonit mbi situatën zbulon saktësisht thelbin e çështjes.⁸⁵ Skema e një Shqipërie të pavarur kishte lindur prej xhelozisë së dyanshme të dy aleatëve, të cilët po tregoheshin përpara botës si miq të ngushtë të saj. Por ajo çfarë bënë ata, do të dilte se ishte më shkatërrimtare se sa një braktisje e papritur e saj prej tyre.

Sunduesi ishte një princ gjerman, që i merrte gjërat me qetësi, pa ndonjë ambicie. Atij i duhej të pranonte kurorën me gjemba... Xhandarmëria ishte holandeze dhe shefat e saj duhej të provonin se ishin aq mjeshtër në politikë, sa ishin të guximshëm në betejë. Ata intrigoheshin nga nacionalizmi i vrazhdë i dy kombeve që i kishin ftuar ata për të ruajtur rendin. Ndërkohë, ata nuk kishin

⁸⁵ *Triple to Quadruple*, f. 58-61.

asnjë ndjesi dhe nuk i lidhte asnjë ideal me Shqipërinë dhe, po ashtu, as ndaj faktit që vërenin se të dyja ato shtete bënë konspiracion kundër princit, çdonjëri për llogari të vet. Dhe mungesa e parave godiste në mënyrë të çrregullt përpjekjet e konsolidimit me zbrazëtinë e vet në arkë”.

Historia dëshmon se ka vetëm dy forma për ta qeverisur popullin: Njëra mund të quhet *adezive* (ngjitëse) dhe tjetra *kohezive*. E para, përfaqësohet prej monarkisë absolute, diktaturës ushtarake, autokracisë dhe despotizmit. Aty duhet të ketë ushtri të fuqishme, si krah i djathtë i fronit; të jetë e tmerrshme në ekzekutime, vdekjeprurëse në etjen e saj kurdo që godet. Kjo ka qenë metoda me të cilën Turqia e qeverisi Shqipërinë por, për shkak të dobësisë, ajo dështoi në mënyrë mizerabël. Në metodën e dytë, pushteti krijon të tjera lidhje me popullin dhe varet tek shkalla e bashkimit, bashkëpunimit dhe inteligjencës, patriotizmit dhe fuqisë së karakterit kombëtar, të vëna të gjitha në dispozicion të shtetit. Aty zotëron ekzistenca e një trupi të vërtetë të shëndetshëm dhe aktiv kombëtar, që siguron funksionimin e jetës së racës.

Në rastin tonë, raca shqiptare ndryshon nga racat tjera, madje edhe me fqinjët më të afërt. Ajo ka fuqi dhe kohezion të një shkalle të jashtëzakonshme dhe çdo qeveri e ndërtuar në mënyrë solide e që gëzon simpatinë e saj, do të gjente tek ajo diçka jetësore dhe të qëndrueshme. Personalisht e kam kundërshtuar zgjedhjen e një princi europian si sundues i Shqipërisë. Shpresat e popullit tek një princ i tillë, i mbështetur prej Fuqive të Mëdha, ishin varur tek diçka tepër ekstravagante, tepër e papraktikueshme. Kjo i ngjante ndërtimit të një shteti në formën e një piramide me kokë poshtë. Kur marrëveshja që doli nga *Konferenca e Ambasadorëve* u publikua, duke zbuluar se si ishte propozuar të stolisej koka e këtij populli malor, fshatar, të thjeshtë, i ngecur në të gjitha kurthnajat e mbretërisë, u pa se ishte aq e papajtueshme me situatën në terren, sa bëri që shumë prej nesh të shqydheshim prej gazit dhe prej lotëve. Edhe pse mund të duket si qëndrim shumë mendjemadh nga ana ime, unë, prapëseprapë, do të guxoj të shfaq mendimin tim rreth vendosjes së një qeverie të përhershme në Shqipëri.

Së pari, ambasadorët, duke ditur fare mirë dallimet e papajtueshme që lidheshin me interesa të veçanta të çdo shteti ndaj Shqipërisë, duhej të kishin vepruar siç është vepruar në krijimin e Republikës Zvicerane, dhe krejt për të njëjtat arsye, ata duhej të kishin deklaruar asnjësinë e tyre ndaj shtetit shqiptar. Madje, ata duhej të betoheshin për ta ruajtur këtë asnjësi. Pasi të arrihej kjo, ndërhyrja e pamoralshme e Greqisë në punët e Fuqive dhe çështjeve të një shteti të pavarur siç ishte Shqipëria, do të bëhej e pamundur. Një fjalë e tillë, e vënë në një deklaratë si kjo nga Anglia dhe Franca, do t'i kujtonte zyrtarisht Venizellosit se ai kishte një shenjë ndalimi në tërë sipërmarrjen e tij. Kjo nuk do të linte shteg për kurrfarë spontaneiteti. E tërë lëvizja ishte vënë në skenë, financuar dhe kontrolluar nga Athina. Ato fjalë, të thëna me autoritet, do të kishin shpëtuar jetët e mijëra shqiptarëve të pafajshëm dhe do të kishte parandaluar vuajtjet e patregueshme që hoqën mijëra të tjerë, madje edhe më shumë.

Një thirrje për asnjësi midis fuqive do të kishte parandaluar grindjet midis Italisë dhe Austrisë mbi Shqipërinë, lidhur me qeverinë e Vidit, ashtu si në rastin e Austrisë dhe Francës, lidhur me Zvicrën. Kjo do të kishte ndaluar intrigat e Turqve të Rinj me popullatën muhamedane, me premtimin e një princi mysliman. Kështu, me një të rënë të lapsit, do të ishin hequr tri pengesat e mëdha nga kursi i anijes së vogël të shtetit të sapolindur. Hapi tjetër, me mirëkuptim, do të ishte të këshilloheshin me udhëheqësit kombëtarë të Shqipërisë se deri ku kishin vendosur të shkonin ata vetë. Aty ekzistonte një qeveri e përkohshme, e dalë nga një konventë kombëtare e mbledhur me shpejtësi dhe që shprehte dëshirën e vetë popullit.

Që nga kohëra që nuk mbahen mend, shqiptarët janë përshtatur me bashkësinë, me këshillat, me pleqësinë, dhe duket se ato kanë hedhur baza natyrore tek ata për qeverisje. Një *Komision Qendror Kontrolli* i zgjedhur nga disa shtete asnjëse si Zvicra ose Amerika, do të kishte ndihmuar për ta vënë këtë traditë në lëvizje, për mirëfunktionimin e shtetit të ri. Ky komision do të kërkonte të kishte në krye një burrë të fortë, me aftësi ekzekutive dhe organizative, që zotëronte përvojë dhe ishte marrë me njerëzit e mbetur prapa për shkak të natës. Anëtarët e tjerë të komisionit

do të përbëheshin prej një eksperti financiar, aftësia dhe integriteti i të cilit do të ndikonte në besueshmërinë e qendrave monetare të botës. Pastaj një jurist që do të rishikonte sistemin e lashtë të jurisprudencës turke, duke konfirmuar atë më të mirin, të cilin e ka zhvilluar bota moderne. Një ekspert të arsimit, një ekspert në ndërtimin e një sistemi arsimor për njerëz të tillë me një vlerësim të mprehtë, të thjeshtë dhe praktik, i cili do të vendoste një sistem të përshtatshëm që do mund t'i shndërronte menjëherë burimet natyrore të kombit në mjete përfitimi publik në përgjithësi. Një ekspert për bujqësinë, i cili të mund të mobilizonte burimet e kombit, një njeri që dinte se si të kthente pamjen dhe shpirtin, diellin dhe shiun, lumenjtë që rrjedhin ashpër përmes fushave pjellore, në magjinë e korrjeve për kombin. Sigurisht që nevojitej një tjetër ekspert në komision, që të ishte ekspert i shëndetit publik, që të merrej me një situatë të rrezikshme dhe të ngutshme. Pa dyshim aty do të kishte një ekspert ushtarak për të organizuar xhandarmërinë.

Ky *Komision* do të zbatonte parimet e duhura, të gjera për qeverinë e qyteteve të ndryshme dhe komunat e kombit, duke lënë një pjesë të madhe të lirisë së popullit në vetë duart e tij dhe në ushtrimin e të drejtave të tij qytetare. Kështu do të kishte edhe një konventë kombëtare konstitucionale ku të shkruhej edhe *Magna Karta*⁸⁶ shqiptare. Pas kësaj kohe do të kishte qenë e mundur që të përftohej një konsensus inteligjent i opinionit publik mbi çështjen e kreut të shtetit, qoftë ky princ i huaj, ose një prej të vetëve, ose një president, si në rastin e Zvicrës. Por, cilado të ishte zgjidhja, terreni duhej të përgatitej, në shtëpinë e kombit do të vendosej rregull dhe të ardhurat e tij do mirëpriteshin me diçka si një gëzim i sjellur prej Davidit.

Pas tërë këtyre ngjarjeve të këtij seriali tragjiko-komik që ishte shfaqur gjatë gjashtë muajve, mbretëria u zhbë papritur si një fluskë sapuni. Ajo që mbeti është

⁸⁶ Magna Carta, e quajtur edhe Magna Carta Libertatum ose Karta e Madhe e Lirive të Anglisë, u shkrua fillimisht në gjuhën latine në vitin 1215 dhe më pas u përkthye në gjuhën frënge në fillim të vitit 1219. Ajo u ribotua në shekullin e 13 – të në një variant të modifikuar që i reduktonte autoritetin monarkut. Karta ende gjendet në librat e dekreteve të Anglisë dhe të Uellsit. Karta vendoste të drejtat e barabarta të individëve, pavarësisht nëse ishin feudalë apo bujq. Ky dokument është gurmtheli i dokumenteve të të drejtave të njeriut që vazhdon të përsoset edhe sot. (Shënimi im – MB)

kujtimi i një figure të vogël patetike, një fëmije, një pinjoll mbretëror, të ardhur në Durrës për t'u bërë sunduesi i ardhshëm i popullit shqiptarë. Çuditërisht prindërit e tij krenarë e kishin studiuar, por nuk e kishin mësuar historinë e Shqipërisë dhe emri që i kishin vënë princit, Vilhelm Vidi (*Wilhelm Widi*) ishte tejet ambicioz për të.



TË DASHUR ZOTËRINJ !

Ë KAM TË VËSHTIRË QË NË MES TË NJË DITE KAQ TË NGARKUAR
ME PUNË, T'JU TREGOJ SI DUHET SE SA SHUMË JAM GËZUAR
KUR MORA LETRËN TUAJ TË DATËS NJËZET E KATËR PRILL,
DHE SE SA THELLËSISHT I INTERESUAR JAM TË SHOH PARIMET
E PAQES SË VËRTETË TË ZBATUARA ME BESNIKËRINË MË TË
MADHE.

ME NXITIMIN MË TË PASHMANGSHËM,

SINQERISHT I JUAJI,
WOODROW WILSON⁸⁷



⁸⁷ Shënim: Ky kapitull gjëndet edhe në volumnin e parë të këtij botimi, por është lënë me qëllim që të sigurojë vijueshmërinë e shkrimeve të Ericksonit në veprën e tij të plotë.

XVIII



KONFERENCA E PAQËS, PARIS 1919

Ajo që më duhej të bëja, ishte të gjeja ku ishte delegacioni shqiptar. Çfarë kishte ndodhur me *Katërbëdhjetë pikat* e Presidentit Uillon, që ishin tërësisht në kundërshtim me *Traktatin e Fshehtë të Londrës*? Ku qëndronin ata në lidhje me kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut? Kështu unë u paraqita para zyrës së delegacionit në *Hotel Crillon*. Ishte gjenerali Blis që më priti. Ai ishte babaxhan dhe zemërbardhë, por shihej qartë se dinte shumë pak ose aspak rreth çështjeve që kisha unë ndërmend. Ai më paraqiti tek kreu i divizionit të Ballkanit, dr. W.L. Westermanni, dhe z. Clive Dej. Në fakt, biseda që bëmë, ishte tejet e bezdishme për ne të tre, por jashtëzakonisht e dhimbshme për mua. Unë prisja, të paktën, që të ma dinin për nder që kisha aq shumë dijeni për Shqipërinë dhe shpresoja të më jepej një mundësi për t'i bindur me dijenitë që kisha për të dhe kërkesat e mia për njohjen e saj.

Në vend të kësaj, ata më thanë si më poshtë:

Fillimisht, për sa i takonte *Traktatit të Fshehtë*, ata nuk ishin të interesuar, pasi ai kishte dalë tërësisht jashtë duarve të tyre. Përsa i takon Shqipërisë së Jugut, ata më informuan se pretendimet shqiptare nuk ishin të bazuara sa duhet, pasi shumica e popullsisë, sipas tyre, ishin grekë dhe se ata ishin të gatshëm të luftonin me çdo mjet që të mos përfshiheshin në një shtet shqiptar. Më në fund, sipas tyre, myslimanët nuk kishin ndonjë rëndësi, pasi ata ishin pothuajse tërësisht turq. Faktet që doja t'u jepja, as që u interesonin fare, pasi ata kishin faktet e tyre. Ata dukej se ishin hipnotizuar prej z. Venizellos, kryeministër i Greqisë dhe e citonin vend e pa vend si autoritetin që duhej të thoshte fjalën e fundit. Më në fund unë e humba durimin. U thashë se prisja një qëndrim tjetër prej tyre si amerikanë.

Po atëherë, çfarë u mbetet “*Katërbëdhjetë pikave të presidentit Uillon*” dhe të drejtës për vetëvendosje të kombeve të vegjël, të paraqitura prej shefit të tyre? Njësoj si shën Pali, thashë me vete:

“*Do t'i bëj zë Cezarit*”,⁸⁸ dhe dola jashtë.

Tani problemi ishte si të arrinim deri tek presidenti Uillon! Tashmë *Katër të Fortët* e kishin izoluar dhe e kishin veçuar veten aq shumë nga tufa që gëlonte rreth qendrës së konferencës e që ishin me mijëra. Secili prej tyre dukej aq i fuqishëm, sa vetë Zotat e Olimpmit. Duke lënë mënjanë si të paefektshme të gjitha metodat ortodokse, unë vendosa të ndërmerija një goditje të fortë, duke shkruar një deklaratë të shkurtër rreth situatës sonë, të cilën ia adresova jo vetë presidentit, por edhe zonjës Uillon, bashkë me një letër shoqëruese, ku i shpjegova qëllimin tim.

Pastaj u luta që fati të jetë me mua dhe qëndrova në pritje.

Disa ditë më vonë më erdhi një mesazh prej sekretarit të presidentit. Ai kërkonte një deklaram të pretendimeve të Shqipërisë, siç e kishte konceptuar delegacioni ynë. Nuk dukej se fjalët vinin drejtpërdrejt nga presidenti. Ne pritëm

⁸⁸ Aktet 25:1-27, paragrafi 25:11 “Nëse jam fajtor se kam bërë diçka që meritoj të vdes, nuk refuzoj të vdes. Por, nëse akuzat që këta hebregj kanë ngritur ndaj meje janë të pavërteta, atëherë askush nuk ka të drejtë të më dorëzojë tek ata. I bëj thirrje Cezarit”.

e pritëm tërësisht në dëshpërim. Por, më në fund, tërthorazi, morëm një përgjigje që ishte më e paparashikueshmja e mundshme. Ishte një deklaratë e lëshuar nga presidenti dhe publikuar në *Paris Press*. Ajo fillimisht paraqiste shqetësimet për pretendimet e Italisë ndaj Fiumes, dhe i hidhte poshtë si të bazuara thjesht në interesa dhe jo në parime.

“Nuk janë në pikëpyetje interesat”, thuhej aty, “por të drejtat e popujve, sundimtarët e të cilëve kurrë nuk i kanë llogaritur të drejtat e tyre si të vlefshme”. Pastaj vijonte me këto fjalë:

“Kufijtë tuaj do të zgjerohen në kurriz të saj (Austrië), por jo në kurriz të shteteve të reja që kanë dalë nga rrënojat e saj... Jo vetëm që ju nuk do të keni tërë territoret shtesë që ju lakmoni, por unë kundërshtoj që t’ju jap edhe atë që ju është garantuar prej traktateve tuaja të fshehta.

Unë refuzoj të pranoj që, meqë qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka qenë palë në këtë traktat, të ketë qenë, në fakt, edhe tërësisht e panjohur me ato çka janë vendosur aty. Rrethanat e reja e kanë transformuar atë në një copë letër pa vlerë”.

Kur e lexuam këtë deklaratë befasuese, pyetëm veten nëse ishte letra ime që i kishte dhënë presidentit njohjen e parë të ekzistencës së atij *Traktati të Fshehtë* me Italinë. Sidoqoftë, ne kishim tashmë yllin tonë polar dhe nuk humbëm kohë që ta ndiqnim atë.

Mëngjesin tjetër, presidentin e priste në tavolinë teksti i letrës së mëposhtme:

*Shkëlqesisë së tij Woodrow Wilson,
President i Shteteve të Bashkuara,*

Zotëri,

A do të na lejoje ne, përfaqësuesit e një kombi të vogël, që gjithmonë i ka vlerësuar nderin, drejtësinë dhe guximin si virtytet më të larta, që t’ju shprehim Juve mirënjohjen

më të thellë për ndjesitë tuaja fisnike, të cilave ju i keni dhënë shprehje të tilla kaq të fuqishme? Në to ne shohim Shpalljen e Lirisë, njësoj si raca e zezë e vendit Tuaj i sheh të vetat në Shpalljen e paraardhësit Tuaj të nderuar, Abraham Linkoln.

Duke ditur, ndoshta më mirë se ju, se sa të thella janë rënjtë e imperializmit në Europë, se sa i paepur është egoizmi, ne frikësoheshim pa masë se mos Ju dhe kolegët tuaj do të detyroheshit, përkundër tërë asaj që mund të bënit, të dorëzoheshit ose, më në fund, të bënit kompromis në dëm të parimeve për të cilat Amerika i hyri kësaj lufte. Kështu Shqipëria do të bëhej edhe një herë mish për top, siç është bërë kaq shpesh në të kaluarën. Deklarata juaj, e publikuar këtë mëngjes, zhduk edhe gjurmën e fundit të asaj frike.

Tani ne e dimë se kauza jonë humb vetëm nëse humbet kauza juaj, sepse të dyja janë një, dhe ajo do të ndodhë vetëm nëse vetë Zoti dështon, që do të thotë, KURRË.

Z. President, Ju treguat këtë mëngjes se jeni udhëheqësi i denjë i një populli të madh e fisnik, të cilin e përfaqësoni kaq denjësisht. Në deklaratën tuaj populli amerikan do të gjejë një mesazh edhe për vete, një thirrje të një detyre të lartë e të shenjtë dhe, nëse nevojitet, vetë guximim që do të përlligjë të drejtën morale të Amerikës për të udhëhequr në këtë orë të rëndë e kritike për botën.

Pranoni, z. President, mirënjohjen tonë më të thellë dhe respektin më të madh, si Shërbëtorët Tuaj më të bindur dhe plot nderim,

Mehmet Konica,

Mihal Turtulli,

C. Telford Erickson.

Nënshkruar:

Gëzimi ynë nuk mund të përshkruhet kur morëm letrën e mëposhtme nga vetë presidenti Uillson:

Të dashur zotërinj,

E kam të vështirë që në mes të një ditë kaq të ngarkuar me punë, t'ju tregoj si duhet se sa shumë jam gëzuar kur mora letrën tuaj të datës njëzet e katër prill, dhe se sa thellësisht i interesuar jam të shoh parimet e paqes së vërtetë të zbatuara me besnikërinë më të madhe.

Me nxitimin më të pashmangshëm,

Sinqerisht i Juaji,

Woodrow Wilson

Por, vetëm katër ditë pas marrjes së kësaj letre kaq miqësore prej presidentit Uillson, delegacioni italian publikoi një memorandum që i ishte dërguar senjor Orlandos, shef i delegacionit, po nga presidenti Uillson. Memorandumi ishte dërguar disa kohë para se të publikohej në Paris *Memorandumi për shtyp* i presidentit Uillson, i datës 23 prill 1919. Në të gjendej edhe kjo frazë befasuese që na shtangu të gjithëve:

“Unë besoj se do të ketë një marrëveshje të përbashkët që Ishulli i Sazanit⁸⁹ t’u jepet italianëve dhe Italia të mbajë edhe Portin e Vlorës”.

Ne u stepëm prej daljes në publik të kësaj letre personale të presidentit drejtuar senjor Orlandos. Nëse ajo zbatohet, do ta kthente *Memorandumin* e vet *mbi Adriatikun*, i cili dukej se premtonte kaq shumë për ne, në një letër pa vlerë. Çfarë tragjedie ishte që presidenti Uillson nuk kishte patur një këshilltar personal europian në të kaluarën e tij, i cili të kishte përvojë diplomatike dhe politike dhe të njihnte filozofinë e tyre makiaveliste, e pashfaqur ndonjëherë në formë të tillë me

⁸⁹ *Lissas* në original.

kaq qëllime të mbrapshta sa tani në *Konferencën e Paqes* në Paris. Përshtypja e parë që patëm, ishte se kjo ndoshta ishte një përpjekje për të zvogëluar efektin e ashpër të *Memorandumit*, të cilin presidenti e kishte publikuar dhe fliste mbi *Problemin e Adriatikut* dhe që italianët nuk e kishin gëlltitur dot.

Ky mund të ishte njëfarë shpërblimi i tij ndaj Italisë, nëse ata do të hiqnin dorë nga pretendimet e tyre në Fiume. Do të ishte Vlora, pra, “Porta për në Ballkan”, me një popullsi prej afro njëqind për qind shqiptarë, që do t’i dorëzohej asaj si kompensim. Këtu është edhe çelësi i tërë kësaj. Ishte çështja Fiume ajo që mbante peng punën e tërë konferencës. Sa më shumë të shtyhej zgjidhja e çështjes së saj, aq më e rrezikshme bëhej situata. Ajo mund të shpinte krejt lehtë në një luftë tjetër. Sazani i duhej dhënë Italisë, gjithsesi, për shkak të rëndësisë strategjike që kishte për të. Ballë për ballë me të shtrihej porti primitiv i Vlorës, i cili po të pushtohej nga fuqitë e huaja, Jugosllavia për shembull, do t’i vinte të dyja ato vende të pasura përballë njëri-tjetrit, në një largësi prej nga plumbat e pushkëve të secilit e arrinin njëri-tjetrin. Shqipëria vetë nuk do të ishte e zonja ta mbronte atë.

Po të marrim parasysh faktin se për të “ruajtur fytyrën”, Italisë i duhej të merrte kontrollin mbi *Ngushticën e Otrantos*, atëherë e tërë çështja e Adriatikut, e cila ishte si një gjemb në këmbën e konferencës, duhej zgjidhur me një të rënë të lapsit. E zgjuar, djallëzisht e zgjuar! Kjo zgjuarsi e gjarpërit ishte brenda saj, madje bashkë me helmin. Nuk kishim në këtë rast asgjë tjetër përveçse një komplot të hartuar në një mënyrë dhelpërake, për ta futur në shtëpi nëpërmjet derës së pasme të njëjtin *Traktat të Fshehtë* të cilin presidenti Uillon e kishte deklaruar “letër pa vlerë”.

I ripunuar, i trajtuar pak ndryshe, i pastruar, i lustruar, tani ky propozim na paraqitet si pajtues, si zgjidhja më e mirë. Presidenti Uillon nuk kishte kohë të merrej me çdo gjë. Prandaj ata besonin se hilja e tyre do të fitonte. Po të bëhej kështu, Italia sigurisht që do të futej edhe brenda tokave të vendit. Por, sapo ajo ta bënte këtë, do të ngriheshin Jugosllavia dhe Greqia me pretendimet e veta. Duke

ndier rrezikun e menjëhershëm që u kanosej shpresave dhe planeve tona, ne iu përveshëm punës për të hartuar një përgjigje, duke mos pritur as për të ngrënë mëngjesin. E keqja ishte se propozimi ishte dërguar në emrin e Uilsonit. Prandaj edhe përgjigja duhej adresuar pikërisht për atë vetë. Dhe kjo po ndodhte ende pa u tharë mirë boja që ai kishte hedhur në letrën e tij për ne disa ditë më parë. Në të kishte dinamit.

Nëse atij nuk do t'i pëlqenin ato që do të thoshim, ai edhe mund të kthehej kundër nesh dhe çdo gjë do të merrte fund. Po të humbisnim atë mik, atëherë çdo gjë do të ngecte. Gjithsesi, ne thamë se duhej marrë rreziku në sy. Dhe ashtu bëmë.

Shkëlqesisë së Tij, Woodrow Wilson,

President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Zotëri,

Delegacioni shqiptar ju është shumë mirënjohës për letrën tuaj aq të bukur të datës 25 prill dhe për sigurimet që Ju përsëri dhatë rreth qëllimeve tuaja për të vazhduar me vendosmërinë më të madhe përpjekjet për arritjen e një paqeje të përhershme. Duke njohur sinqeritetin tuaj rreth këtij qëllimi dhe qartësinë me të cilën Ju i shihni kushtet qenësore për arritjen e një paqeje të tillë, ne guxojmë të sjellim në vëmendjen tuaj edhe një herë çështjen e Vlorës. Në Memorandumin e publikuar në gazetën e mëngjesit të datës 30 prill ju deklaroni:

“Unë besoj se do të ketë një marrëveshje të përbashkët që Ishulli i Sazanit t’u jepet italianëve dhe Italia të mbajë edhe Portin e Vlorës”.

Ne habitemi, Z. President, se si mund të jeni tradhtuar kështu kur lëshuat një deklaratë të tillë!

Kjo është kaq në kundërshtim me atë që keni deklaruar më parë, sa ne besojmë plotësisht se po t’ju ishin paraqitur argumente tërësisht të tjera, të kundërta me ato

që ju bënë juve të lëshonit deklaratën e mëparshme, Ju kurrë nuk do të kishit bërë këtë të sotmen. Kjo është në kundërshtim me tërë idealet e larta dhe principet tuaja fisnike ndaj kauzës së drejtësisë njerëzore, të cilën Ju e keni mbrojtur me kaq guxim dhe burrëri përpara botës.

I.- Parimi i nacionalitetit dhe e drejta e çdo kombi për të përcaktuar fatin e vet.

Vlora dhe tokat përreth saj, përfshirë Ishullin e Sazanit të cilin Italia e ka lakmuar sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915, janë të tëra të populluara me shqiptarë dhe aty nuk ka asnjë këmbë të huaji, përveç ushtarëve dhe oficerëve italianë që venë e vijnë. Nën pushtimin italian, ndoshta ka njerëz që thonë të kundërtën, por ato janë po aq të vërteta sa ç'mund të jetë një deklaratë e nënshkruar me pistoletë të drejtuar në ballë.

II – Parimet e moslejimit të kombeve të fuqishme për të shtypur dhe shkelur dëshirën e kombeve të vogla.

Vlora është porti kryesor i Shqipërisë (në fakt, i vetmi port i mirë i Shqipërisë). Prapa saj gjenden dy pasuritë më të mëdha që ka Shqipëria sot, me aq sa dihet: depozitat e vajgurit, një minierë e madhe bitumi dhe një fushë shumë e gjerë dhe aq pjellore sa të ushqejë tërë popullsinë e Shqipërisë dhe, madje, edhe të eksportojë drithëra. Nga ana tjetër, nëse Italia lejohet të kontrollojë doganat e këtij porti, kjo do thoshte shkatërrim i plotë ekonomik i një shteti të vogël e të varfër.

III.- Parimet e mbrojtjes së demokracisë kundër imperializmit. Italia nuk i ka fshehur pretendimet e saj imperialiste në Ballkan. Gjatë pushtimit të saj ushtarak, ajo ka marrë përsipër të luajë atë rol që kanë luajtur Austria dhe Rusia më parë. Ajo është përpjekur ta italianizojë Shqipërinë sipas metodave të mëposhtme:

1.- Ka hapur 200 shkolla italiane dhe ka ndaluar shkollat kombëtare, njësoj siç kishte bërë Turqia, jo shumë kohë më parë.

2.- Ka filluar ndërtimin e një hekurudhe italiane që shkon nga Vlora në drejtim të

lindjes, pa pajtimin e popullatës vendase.

3.- *Është përpjekur të japë me qira ose të shesë tokat publike të Shqipërisë, çfarë përbën një veprim me qëllime tërësisht kolonizuese.*

4.- *Ka ndërtuar një administratë civile italiane anembanë vendit.*

5.- *Nuk ka lejuar ngritjen e një force policore vendase që të stërvitet dhe të sigurojë rendin e qetësinë.*

6.- *Ka përvetësuar pasuritë publike si, për shembull, hekurudhat e ndërtuara prej austriakëve, duke mos dhënë asnjë llogari për to.*

7.- *Ka krijuar shërbimin e vet të Postë Telegrafës Italiane dhe një sistem monetar.*

8.- *Është përpjekur të nxisë trazira midis popullatës së krishterë dhe asaj muhamedane, në atë mënyrë që secila palë të kërkojë mbrojtje prej saj.*

Të gjitha këto kanë shkaktuar zemërim masiv në tërë vendin dhe ne nuk e dimë nëse ju keni konstatime të bazuara nga burime të besueshme apo jo.

Përsa i takon Vlorës, duke ditur etjen e Italisë për t'i zgjeruar kufijtë e saj drejt lindjes, Shkëlqesia Juaj e ka rrëzuar një herë në mënyrën më të adhurueshme kur keni argumentuar çështjen e Fiumes.

Në fakt, kjo e bën dy herë më bindëse çështjen e Vlorës. Fiume ka një popullsi të madhe italiane, ndërsa Vlora nuk ka asnjë. Në Fiume, çfarëdo lloj problemi të paraqesin për Italinë të mbeturit e Perandorisë Austro-Hungareze dhe Jugosllavisë, ata janë më të afërmit e saj dhe gjenden tek dera e saj e pasme, ndërsa Vlora nuk ka asnjë lidhje me ta. Ajo nuk ka absolutisht asnjë arsye që të frikësohet prej Shqipërisë, madje kjo e fundit mund të shërbejë si zonë e largët mbrojtëse ndaj ndonjë rreziku që mund t'i kanoset asaj nga larg. Në anën tjetër, nëse italianët mbeten në Shqipëri, ata menjëherë do të sfidojnë tërë Ballkanin, do nxisin tërë antagonizmat, do të

prishin barazpeshën, si një fuqi e madhe në mes të një kombi të vogël, duke krijuar të njëjtin problem që dikur kishte krijuar Turqia dhe duke sjellë të njëjtin çrregullim dhe mallkim që e ka shoqëruar Ballkanin ndër shekuj.

Për më tepër, problemi që Ju ngrini në lidhje me Fiumen, si nevojë për vendet që mbeten mbrapa, si Hungaria dhe Bosnja, pa dalje në Adriatik dhe Mesdhe, ky problem ngelet edhe më i pazgjidhur nëse Italia e merr Vlorën. Pavarësisht çfarë portesh do t'u jepen këtyre popujve, me Vlorën dhe Ngushticën e Otrantos nën kontrollin e Italisë, deti Adriatik do kthehet menjëherë në një "liqen italian", ashtu sikundër italianët, me dritëshkurtësinë e tyre kërkojnë ta bëjnë atë. Italia bëhet drejtpërsëdrejti një sfiduese e tërë këtyre popujve nga veriu dhe lindja, sikundër edhe ndaj shteteve ballkanike, dhe krijon po atë problem në Adriatik që dikur Konstandinopoja dhe Bosfori kishin krijuar për sllavët. Veprime të tilla nuk garantojnë as paqen më të përkohshme, e lëre pastaj atë të përhershme.

Por, ka edhe një vlerësim tjetër për këtë. Tërë kombi shqiptar njëzëri ka një kërkesë: Traktati i Londrës i vitit 1913 ka lënë më shumë se gjysmën e territorit të tij të ligjshëm, me një popullsi 90 përqind shqiptare, në duart e Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Kështu, afër një milion shqiptarë mbetën jashtë kufijve, në kundërshtim me tërë të drejtat e shenjta dhe vullnetin e kombit të vet. Nëse drejtësia do të vihet ndonjëherë në vend, nëse interesat e kombeve më të vogla "tani e tutje do të ruhen me ndershmëri, si dhe të drejtat e atyre të më të fuqishmëve", atëherë këto territore, dhe popullata që jeton në to, duhet të kthehen aty ku e kanë vendin, sipas dëshirës së vetë popullit.

Por nëse Italia lejohet të qëndrojë në Vlorë, për arsye që Konferenca e Paqes i vlerëson më imperative se të drejtat kombëtare, atëherë këto arsye nuk mund të kërkoohen dhe as të gjenden as në Jugosllavi, as në Greqi, të cilat jo vetëm mbajnë territore që nuk janë të tyre, por kërkojnë edhe më shumë kompensime, siç janë Korça dhe Gjirokastra për Greqinë, dhe Shkodra për Jugosllavinë.

Ju do të gjeni tek këto fakte, Z. President, se sa jetike është Vlora për Shqipërinë dhe

do të kuptoni se shqiptarët janë të vendosur të rezistojnë me çdo kusht për të mos ia dorëzuar Vlorën Italisë.

Në emër të këtij kombi të vogël, i cili ka qëndruar kaq shumë përkundër padrejtësive shekullore që i janë bërë, duke mos patur miq apo mbrojtës midis kombeve të tjera, ne, përfaqësuesit e tij, Ju përgjrohemi Juve që të përdorni personalitetin Tuaj të fuqishëm, jo vetëm për ta mbrojtur atë nga poshtërimi dhe shkatërrimi i mëtejshëm, por ta ndihmoni atë në fillimin e realizimit të së ardhmes së tij fisnike.

Ne jemi, Shkëqesia Juaj,

Shërbëtorët Tuaj të bindur dhe plot nderim.

Nënshkruar:

Mehmet Konica

Mihal Turtulli

C. Telford Erickson

Në këtë kohë vërshyen memorandume nga të tëra anët, duke filluar nga *Federata Pan-Shqiptare VATRA e Amerikës*, kolonitë shqiptare në Zvicër, Rumani, Turqi. Atyre iu bashkua Herbert Adams Giboni,⁹⁰ korrespondenti special i agjensisë së lajmeve AP, i cili i dërgoi presidentit Uillson një telegram shumë të gjatë. Kështu bënë edhe shumë të tjerë. Më në fund, duket se gjiththçka u qetësua dhe nuk u dëgjua më asgjë.

Ndërkohë, duket se po vinte koha e Lidhjes së Kombeve. Kjo solli një

⁹⁰ *Herbert Adams Giboni (Gibbons)* ishte gazetar dhe korrespondent i huaj. Shkrimet e Gibonit janë të periudhës kur ishte korrespondent në Greqi, Spanjë, Turqi dhe vende të tjera të Lindjes së Afërt (1909-1916), kur shërbeu si ushtar në Forcën Amerikane në Francë (1917-1918), si dhe kur ishte korrespondent i disa revistave amerikane në Europë, në vendet e Lindjes dhe në Afrikë (1920-1931). (Shënimi im – MB)

kokëçarje tjetër për shqiptarët dhe delegacionin e tyre. Një prej propozimeve të para që i rekomandua Lidhjes, kishte të bënte me Shqipërinë. Ishte “Këshilli i Lartë” që i propozoi Italisë që ta kthente atë edhe njëherë “në terezi”, si dhe të zbuste ndjenjat e saj “të egërsuara nga shkeljet e vazhdueshme”. Ky propozim ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me tërë pikat e Lidhjes të vendosura në dokumentin e saj themeltar, dhe pikërisht:

Neni XXII: Paragrafi 4. *Bashkësi të caktuara të cilat më parë i takonin Perandorisë Osmane, kanë arritur në një stad të tillë zhvillimi ku ekzistenca e tyre si shtete të pavarura mund të njihet paraprakisht si subjekt i tillë, ku t’u jepen këshilla dhe asistencë administrative prej një mandatarit, deri sa të vijë koha kur ato të qëndrojnë me këmbët e veta. Mandatarit mund të zgjidhet vetëm në bazë të dëshirës së vetë këtyre bashkësive.⁹¹*

Duke parë kontradiktën me nenin e mësipërm, unë iu referova deklaratës së presidentit Uilson e cila kishte tundur botën, dhe prita me shpresën e madhe që ai ta drejtonte edhe një herë botën drejt shtegut të paqes. Ja edhe deklarata e tij:

“Asnjë popull nuk mund të detyrohet të jetojë nën sovranitetin e një populli tjetër me të cilin nuk dëshiron të jetojë. Asnjë territor nuk duhet të ndërrojë dorë, përveç se kur ka për qëllim t’u sigurojë atyre që banojnë aty një mundësi të plotë jete dhe lirie. Nuk ka paqe që zgjat ose që duhet të zgjasë, e cila nuk njeh dhe nuk pranon të njohë parimet se e tërë fuqia e drejtësisë së qeverive rrjedh tek miratimi i saj prej të qeverisurve dhe se nuk ka të drejtë që ekziston në botë që i kalon popujt nga një sovranitet në një tjetër, si të ishin pronat e dikujt. Çfarëdo paqeje që nuk i njeh dhe nuk i pranon këto parime, nuk ka të ardhme”.

Vendosini ato dy deklarata pranë e pranë, bashkë me veprimin e Këshillit të Lidhjes së Kombeve që i ofroi Italisë mandatin mbi Shqipërinë, dhe përpiquni që t’i kuptoni! E vërteta mbi këtë çështje është se *Konferenca e Paqes* kishte hyrë në një rrugë tërësisht pa krye. Të shohim, më së pari, “malin” me delegacione dhe

⁹¹ Traktati i Lidhjes së Kombeve, përfshirë amendamentet e miratuara deri në dhjetor 1924 (*The Covenant of the League of Nations*).

përfaqësues nga më shumë se pesëdhjetë kombe nga tërë anët e botës.

Grupe pa fund kërkuesish, gjeografësh, historianësh, etnografësh, specialistësh në një numër të madh fushash, propagandistë dhe politikanë që fushnin hundët kudo që mundeshin, duke mbushur plot e përplot zyrat, korridoret, të shpërndarë kudo e në çdo rrugë, bulevard, kafene, teatro, kinema, nëpër taksi, tramvaje, trena nëntokësorë... Kudo që të shkoje, ata ishin të pranishëm. Thuhej se një mijë syresh ishin punësuar vetëm në Departamentin e Shteteve të Bashkuara. Një numër i pafund “komisionesh” për të studiuar këtë apo atë ishin krijuar si një laborator i madh ku tavolinat, mikroskopët, mostrat dhe një ushtri njerëzish ishin vënë në punë në një formë të zhurmshme ku secili studionte mostrën e vet. Ata kishin krijuar një pamje të tillë rreth vetes, sa dukej se e tërë bota e kishte ndalur frymën deri sa ata të shqiptonin fjalët magjike që do të përshkonin botën me zbulimin që kishin bërë.

U mbars mali, polli një mi !

Ndërkohë, bash në majë të atij mali të largët sa një objekt astronomik, qëndronte një kullë e fildishtë me katër “të pavdekshmit” olimpike me pamje hijerëndë:

Ja tek hedhin ca dritë nga veriu dhe na del Finlanda; më pas shohin nga Kina dhe Paqësori i Jugut, pastaj Afrika, Palestina, bota arabe... Ja tek është Rusia, si një pullë e madhe e zezë në hartë, që përpiqet të mbulojë, ngrohë, kllloçitë dhe nxjerrë në dritë disa lloje vezësh si republika të reja. Pastaj, sapo t’ia ketë arritur kësaj, e kthen teleskopin drejt Adriatikut dhe një pikë e errët, e vogël vihet re në lente:

E kush është ajo? Pyet njëri prej këtyre të Olimpikut. “Eh, ajo është Shqipëria”, përgjigjet tjetri. Pastaj tjetri që thotë:

Mos dëgjova dikë që tha “Mallkuar”?!

Nganjëherë habitem pse detyrohem t’u kushtoj vëmendje atyre modeleve që

këta “të pavdekshëm” në Kullën e tyre të Fildishtë zhvilluan për një botë të re, të guximshme, ku tërë popujt e vegjël do të kishin vendin e tyre nën një diell ; edhe të ngroheshin nën rrezet e tij, edhe të merrnin dhuratat e tij, ndërkohë që Fuqitë e Mëdha do të uleshin vëllazërisht në botën e tyre të rehatshme të *Lidhjes së Kombeve*, ku do të flisnin dhe këndonin së bashku *Himnin e tyre Ndërkombëtar*:

“Paqe, paqe e përsosur !”.⁹²

Unë habitem nganjëherë se cila fuqi, çfarë autoriteti, çfarë hyjnie i ktheu sytë dhe zgjodhi atë model që pastaj ta thërmonte me duart e veta, ta hidhte poshtë tek këmbët, ta pështynte dhe lehtë e pa dhimbshuri ta shkelte me këmbë ?! A ishte Zoti ai që i ka thënë këto fjalë: “Le ta krijojmë njeriun në imazhin tonë siç na pëlqen neve...”⁹³

Dhe Zoti pa gjithçka që ai kishte krijuar dhe ja që i paska krijuar shumë mirë.

Historia na ka mësuar se Ai është më kërkues sesa sundimtarët e Kullës së Fildishtë që vizatojnë hartat e Botës së Tij, duke zgjedhur për veten e tyre pikat ku vërshimet e lumenjve sjellin thesare të tjera të dhuruara prej Zotit, për të përmbushur kënaqësitë e tërë njerëzve të bekuar prej tij. Ai nuk i pëlqen njerëzit e babëzitur, as njerëzit me vese, as ata që përfitojnë prej privilegjeve të tij dhe që luajnë me zotat në Kullën e tyre të Fildishtë. Kur ai zgjodhi të kishte shoqëri me fëmijët e vet në tokë, unë mendoj se ngjet më shumë t’u thotë lajmëtarëve të vet: “Lëreni poetin Pindar⁹⁴ të shkojë tek Darka e Zotit; lëreni Sokratin në zgjuarsinë e tij të thjeshtë tokësore; lëreni Galileun me thjeshtësirat e tij; lëreni Uendell


⁹² *Eduard H. Bickersteth, Jr*, 1875, i ka vënë fjalët këtij himni i cili është marrë nga *Bibla* dhe përmban ndoshta fjalët e fundit të dëgjuara prej Jezuit para se ai të thërriste “Drejt paqes së përsosur të qiellit.”

⁹³ Marrë nga *Bibla*.


⁹⁴ *Pindari* (522–443 p.e.s.) ishte poet lirik në Greqinë e Lashtë. Nga nëntë poetët lirikë të asaj periudhe, vepra e Pindarit është ruajtur më mirë. Kuintiliani e përshkroi atë si “poetin më të madh lirik ndër të nëntët, me një diferencë të madhe nga të tjerët, falë frymëzimit madhështor, bukurisë së mendimit dhe figurave, gjuhës dhe lëndës së pasur dhe elokuencës së rrjedhshme”. Komediani athinas, Eupolis, citohet të ketë thënë se poemat e Pindarit “janë lënë në harresë për shkak se shumica nuk është e prirur drejt të mësuarit elegant”. (Shënimi im – MB)

Uillkin⁹⁵ të mbështjellë në ëndrrën e tij!”. Po! Unë mendoj se Ai do ta kishte shqyer, grimcuar dhe pastaj pështyrë atë hartë me neverinë më të madhe. Kurrë nuk do ta kisha besuar se Perëndia ka dërguar ca njerëz në këtë botë, të ngr皇甫ur, të gatshëm për të kalëruar dhe për të shkelur sipër miliona njerëzve të tjerë, të gatshëm për t’u shaluar dhe ngarë me romuzin dhe yzengjitë e këtyre shtypësve.

⁹⁵ *Uendell Levis Uillki (Wendell Lewis Willkie)*, (18 shkurt 1892 – 8 tetor 1944), avokat, kandidati i paparashikuar republikan në zgjedhjet presidenciale të 1940-s në SHBA. Duke qenë anëtar i krahut liberal republikan, ai bëri fushatë kundër disa prej politikave të brendshme të *Neë Deal* (Oferta e Re), për të cilat mendonte se ishin të paefektshme dhe dëmtonin biznesin. Mirëpo Uillki u bë i bezdisshëm në debatin për çështjen shumë delikate nëse Amerika duhet të ndërhynte apo të qëndronte jashtë Luftës së Dytë Botërore, duke humbur kështu mbështetës nga të dy krahët. Kundërshtari i tij në garën presidenciale, Franklin D. Rusvelti (Roosevelt), i fitoi zgjedhjet duke marrë 55% të votës popullore dhe 85% të votave të sistemit zgjedhor. Rusevelti e kuptoi se Uillki i përshtatej politikisht planeve të tij, ndaj e ftoi të shërbente si ambasador jozyrtar. Uillki i ra kryq e tërthor globit, duke sjellë pas vizionin e “Një bote” të çliruar nga imperializmi dhe kolonializmi. Liberalizmi i kushtoi humbjen e mbështetjes në Partinë Republikane. Ai hoqi dorë nga gara presidenciale e vitit 1944 dhe vdiq më pas nga një atak në zemër. Uillkei nuk mbajti asnjëherë poste politike. (Shënimi im – MB)



PAS MË SHUMË SE NËNTËMBËDHJETË VJETËSH GJATË TË
CILAVE UNË KAM BËRË TË PAMUNDURËN SI MIK I ATIJ VENDI
AQ TË DASHUR PËR MUA (KUR AI VEND PËR VETE ISHTE
THUAJSE PA ASNJË MIK), UNË ENDE MENDOJ PËR ATO FJALË
TË PRESIDENTIT AMERIKAN, WILSON, TË CILAT NË ATË
KOHË ERDHËN SI FJALËT MË TË ËMBLA QË KAM DËGJUAR
NDONJËHERË.



XIX



VENDIME, TRAKTATE, NDARJE, PËRPPJEKJE TË KOMBIT SHQIPTAR

Le ta kujtojmë edhe një herë ngjarjen e vitit 1830, kur katërqind pjesëtarë të parisë shqiptare, fisnikë e bajraktarë u ftuan prej Reshid Pashës, vezirit të madh, në një *Konferencë* në Manastir dhe përfunduan të tërë të masakruar. Duke e parë njëri-tjetrin në sy, Asllan Beu i pëshpëriti tjetrit: “Kemi hangër bagla !”.

Të paarmatosur, të pambrojtur, të tradhtuar, ata u masakruan deri tek burri i fundit.

Duke u kthyer në Paris, në tavolinën e *Konferencës së Paqes*, ku bota e tërë po mbante sytë, le të shohim se çfarë do të na ofrojnë. Aty do të kishte një tavolinë të pasur, të shtruar prej fitimtarëve të Luftës Botërore, tri Perandori të Mëdha. Mjerisht ne nuk kemi vend të rezervuar në tavolinën e banketit. Edhe më keq se kjo, nuk kemi qoftë edhe një ftesë. Prandaj duhet të jemi të kënaqur nëse do të ndodhte që të merrnim ca thërrime të rëna pa dashje nga ajo tavolinë e tejmbushur.

Duke lënë mënjanë të folurit e figurshëm, le të përqijemi të rindërtojmë pamjen e Shqipërisë në kohën kur u hap *Konferenca e Paqes* në Paris. Ne e kemi parë se sa shumë ishte demoralizuar Shqipëria pas gushtit të vitit 1914, kur filloi *Lufta Botërore*. Në fillim atë e goditën shkatërrimet e tmerrshme të dy luftërave ballkanike. Pas kësaj erdhi ndarja e territoreve të saj prej *Konferencës së Ambasadorëve* në Londër. Më pas erdhi fiaskoja e vajtueshme e regjimit të Vidit dhe dështimi i plotë i Fuqive të Mëdha për të krijuar një shtet të shëndetshëm shqiptar. Më pas erdhi shkatërrimi i shpresave të shqiptarëve për ruajtjen e territorit të tyre prej *Konferencës së Fshehtë të Londrës*.

Të tëra këto patën si rrjedhojë një kaos të vërtetë dhe anarki, pa autoritet qendror që të provonte besnikërinë e vërtetë të kombit. Me Serbinë në verilindje, Malin e Zi në veri, Greqinë në jug dhe Italinë e Austrinë nga jashtë, secila palë brenda vendit përpiquej të mbronte interesat e veta në emër të nacionalizmit. Prej administratës vendore, që s'mund të quhej as qeveri, kishte një njësi të pavarur në Shkodër, një tjetër në Mirditë, edhe një të malësorëve myslimanë, një të Esat Pashës në Durrës dhe Tiranë. Vlora me rrethinat e saj ishin nën kontrollin e *Komisionit Ndërkombëtar*. Jashtë këtyre njësisë administrative, e lënë thuajse tërësisht jashtë rrethojave ishte një e treta e popullsisë shqiptare. Ajo ishte pre e kujtdo që dilte më parë për ta marrë, keqtrajtuar ose përpirë për vete. Prej kësaj mizerijeje, këtyre nevojave, sëmundjeve, urisë dhe tërë privimeve të jetës me të cilën ndesheshin të zhvendosurit myslimanë të jugut të Shqipërisë, duket se u bë e domosdoshme që sër Eduard Grej t'i dërgonte qeverisë italiane një apel në emër të tyre.

E vetmja gjë që mund të thuhet për atë situatë dhe që mund të jepte njëfarë shprese prej ngado që të vinte, ishte se Shqipëria ishte bërë pa asnjë dyshim një problem europian. Lufta sapo kishte hyrë në muajin e katërt. Në nëntor 1914 u mësua se Fuqitë e Antantës, Britania e Madhe, Franca dhe Rusia po i ofronin Greqisë jugun e Shqipërisë, si çmim për hyrjen e saj në luftë në ndihmë të Serbisë, ndërkohë që ajo autorizohet të dërgonte një ushtri të armatosur pushtuese, e cila nuk humbi kohë ta bënte këtë.

Në janar të vitit 1915, Italia dhe Austria ishin të zëna me diskutimin rreth pretendimeve të tyre të papajtueshme në Shqipëri, të cilat ishin të lidhura edhe me Tirolin dhe Trentinon. Si çmim të asnjësisë së vet Italia i kërkoi Austrisë njohjen e sovranitetit të saj mbi Vlorën dhe rrethinat e saj, si dhe ishullin e Sazanit. Kjo sigurisht që do ta kthente detin Adriatik në një liqen italian, çka bëri që Austria ta kthente ofertën mbrapsht.

Meqë Italia ishte në treg thjesht për përfitime, ajo i ktheu sytë drejt Fuqive të Antantës, me shpresë se do të gjente mbështetje. Ambasadori i saj, Marquis Imperiali, i dorëzoi propozimin në dorë sër Eduard Grejt, M. Paul Kambonit dhe kontit Beckendorf, prej nga rrodhi *Traktati i Fshehtë i Londrës*, i quajtur me të drejtë “zullumqar” prej Edit Pierpont Stickenit, në librin e saj “*Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet europiane ndërkombëtare, 1912 - 1923*”⁹⁶.

Për të pasur një ide më të qartë për përmbajtjen e këtij traktati për fatzezën Shqipëri, po radhitim disa prej pikave të tij:

Pasi kishte përfituar Trentinon dhe Istrian prej nenit 4, Dalmacinë dhe Ishujt e Adriatikut prej nenit 5, dhe po ashtu Gjirin e Vlorës, Italia premtonte që në rast të formimit të një shteti të vogël autonom dhe të paanshëm shqiptar, të mos kundërshtonte dëshirat e Francës, Britanisë së Madhe dhe Ruisë për rindarjen e rajoneve veriore dhe jugore të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Brigjet detare jugore prej kufirit të juridiksionit italian mbi Vlorën deri në Kepin e Stillos do të ishin asnjësisë.

Italisë do t’i jepej e drejta të mbulonte marrëdhëniet e Shqipërisë me botën. Sido që të ishte, Italia detyrohej t’i siguronte Shqipërisë një territor të shtrirë që nga kufijtë e saj me Greqinë e Serbinë, deri në përfundim të Liqenit të Ohrit.

Ky traktat u nënshkrua më 26 prill 1915, ndërsa më 23 maj të po atij viti Italia

⁹⁶ *Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet europiane ndërkombëtare, 1912 – 1923*, Botim i Shtëpisë Botuese “KOHA”, Tiranë 2000. Përkthyer në shqip nga Mal Berisha.

hyri në luftë me ish-aleatët e saj, Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë.

Sapo e sanksionoi zyrtarisht praninë e saj, Italia filloi të ndihej si në shtëpinë e vet. Kështu Vlorës i ndërroi adresa brenda natës. Ajo tani ishte “Vlora – Italia”. Për të treguar fuqinë e vet dhe mospërfilljen ndaj grekëve, ajo pushtoi Sarandën dhe Janinën dhe u turr drejt lindjes në kufijtë me Maqedoninë dhe në Gjirokastër. Gjenerali Ferrero, komandanti i ushtrisë italiane, lëshoi një shpallje për Shqipërinë. Kjo ngriti një furtunë por, megjithatë, ishte një strategji e zgjuar. Po sikur Italia të mos e kishte “paktin e saj të fshehtë zullumqar” i cili përcaktonte një “shtet të vogël autonom dhe asnjans” në *Shqipëri*?

Duke shpallur pavarësinë e tyre në këtë kohë, shqiptarët e Shqipërisë së Jugut, të bezdisur prej grekëve, do t’i ktheheshin Italisë, duke parë tek ajo shpëtimtaren e tyre. Në një rol të tillë ajo jo vetëm që do të qëndronte në Shqipëri për aq kohë sa të zgjaste lufta, por do të ishte edhe shumë më e pranueshme dhe më e lehtë për t’u paraqitur para *Konferencës së Paqes* si kampion i guximshëm, duke patur edhe përparësi të jashtëzakonshme. Ç’është e vërteta, ajo iu afrua kaq shumë kësaj ideje, sa anëtarët e delegacionit shqiptar ishin thujse gati t’i bashkoheshin hapur Italisë në konferencë.

Ishim Mehmet Konica dhe unë të vetmit që nuk pranuan qoftë edhe t’u vinim veshin argumenteve të tyre. Kur pikat e plota të “paktit zullumqar” erdhën në dorën e delegacionit shqiptar, nuk kishte më asnjë dyshim se bashkimi me delegacionin italian ishte gjëja më e paduhur që mund të bëhej në emër të pavarësisë së Shqipërisë.

Një tjetër marrëveshje e fshehtë që kishte të bënte me Shqipërinë e Jugut, ose Epirin e Veriut, siç kishin zgjedhur ta quanin grekët, ishte rregulluar të bëhej midis ministrit italian të Punëve të Jashtme, kontit Titoni dhe M.Venizellosit, e nënshkruar më 29 korrik 1919.⁹⁷ Me këtë marrëveshje, Italia pranonte të mbështeste

⁹⁷ M.Frangolis, Kujtime nga Shqipëria dhe Epiri i Veriut (*Memoire sur l’Albanie et Epire du Nord*).

pretendimet e Greqisë në jug të Shqipërisë, ndërsa Greqia do të mbështeste Italinë si fuqi mandatore mbi Shqipërinë dhe do të njihte sovranitetin e saj mbi Vlorën dhe rrethinat në brendësi të vendit. Që unë mos të lë përshtypjen se Italia ishte më shumë e prirur se të tjerët për vënien në jetë të “paktit zullumqar”, më lejoni të them se që të gjithë po bënin të njëjtën gjë.

Rusia, e përfshirë që herët në luftë, kishte një marrëveshje me Britaninë e Madhe dhe Francën që ato t’i njihnin asaj sovranitetin mbi Dardanelet dhe Stambollin. Një tjetër marrëveshje do ta ndante Turqinë midis katër fuqive, Britanisë së Madhe, Francës, Ruisë dhe Italisë. Pastaj vinte marrëveshja e fshehtë midis Gjermanisë dhe Rumanisë, prej së cilës kjo e fundit do të mbante Besarabinë, nëse rrinte asnjënjë. Ndërkohë Rusia i premtojte Rumanisë Transilvaninë, nëse ajo futej në anën e Fuqive Aleate. Më vonë kjo hartë ishte zgjeruar, duke përfshirë territore shumë të gjera që i takonin Hungarisë, si Banati, Bukovina dhe e tërë Transilvania. Britania kopsiti një traktat të fshehtë me mbretin Hysein për koncensionet e vajgurit me një tubsjellës prej Mesopotamisë deri në Mesdhe. Ky ishte aq i fshehtë, sa as aleatja e saj më e afërt, Franca, nuk dinte asgjë për të. Dhe, padyshim, ishte edhe Japonia, së cilës për ndihmën që i kishte premtuar Britanisë në Mesdhe kundër *U Boats*,⁹⁸ i ishte dhënë provinca e Shantungut, Kina dhe tërë territori në veri të ekuatorit. Këto dhe traktate e marrëveshje të tjera të fshehta nuk ishin zbardhur për popujt e vet, aty ku kishin efektin më të madh, as për aleatët më të vegjël dhe as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë përpara, qoftë pasi ato hynë në luftë, në emër të tyre. Disa prej tyre ndoshta ishin thjesht “memorandume të shkurtra”. Por të tjerat, si ajo që Italia kishte nënshkruar me Fuqitë Aleate, ishin të një vlere dokumentare të tillë sa gati sa nuk e prishën vetë *Konferencën*, kur ajo këmbënguli për zbatimin e pikave të marrëveshjes.

⁹⁸ *U-boat* është version anglisht i fjalës gjermane *U-Boot* (shkurtim i *Unterseeboot*). Ky term përdoret për nëndetëset ushtarake gjermane, veçanërisht në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore. Megjithëse teorikisht këto nëndetëse do të kishin qenë një armë e fortë kundër anijeve luftarake armike, në praktikë u përdorën më shumë në situata ‘luftë ekonomike’, për plaçkitje tregtare apo për ruajtjen e bllokadës detare, për të mos lejuar furnizimin e armikut. Shënjestra kryesore ishin anijet tregtare që transportonin drejt Ishujve Britanikë mallra nga vendet e Perandorisë Britanike dhe nga Shtetet e Bashkuara. Edhe nëndetëset austriake në Luftën e Parë Botërore quheshin *U-boats*. (Shënimi im – MB)

Shqipëria e varfër u ndodh përballë një muri të madh si ky, sa një mal, pasi Italia e kishte paguar çmimin e saj me vdekjet dhe plagët e shkaktuara nga *Kaporetto*⁹⁹ dhe beteja të tjera, të cilat i kishin marrë asaj një gjysmë milioni njerëz. Pas Italisë vinte Serbia, e nderuar si heroinë e shquar e luftës, pasi kishte publikuar dhe popullarizuar në një mënyrë aq të efektshme tërheqjen e saj nga Shqipëria dhe Adriatiku. Më në fund ishte Venizellosi që përfaqësonte Greqinë, i cili, në kohën më të shkurtër, jo vetëm që kishte fituar mbështetjen e plotë të delegacionit të fuqishëm britanik, por, po ashtu, kishte hipnotizuar edhe delegacionin amerikan. Me qëllim që të sqarohet çështja midis Shqipërisë dhe Greqisë, u emërua një komision ekspertësh, me përfaqësues prej çdonjëres prej katër fuqive, SHBA, Britania e Madhe, Franca dhe Italia, që ta studionin çështjen dhe “të zvogëlonin numrin e çështjeve për vendim brenda limiteve më të vogla të mundshme, dhe të jepnin rekomandimet për një vendim dhe zgjidhje të përbashkët”.

Anëtarët amerikanë të delegacionit ishin dr. W.L. Uestermani dhe prof. Kliv Deji (Clive Day). Kur shkova tek ata për të paraqitur situatën, siç e kisha njohur atë gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të mia të banimit deri atëherë në Shqipëri, përmes udhëtimeve dhe marrëdhënieve të mia tejet të ngushta e miqësore me shqiptarët, të mirëkuptimit dhe mirëbesimit me udhëheqësit e ndryshëm shqiptarë, këta zotërinj as që deshën të më jepnin të drejtën për t’u shpjeguar. Ata kishin marrë dijeni, në mënyrën e tyre, për përbërjen e popullsisë përkatëse, shqiptarë apo grekë që jetonin atje, edhe deri në fshatin dhe qytetin më të fundit në fjalë. Nuk është nevoja të them këtu se burimet e tyre të informacionit, ashtu siç ishin, i vlerësonin grekët sikur të ishin në shumicë në çdo vend. Kjo u bë tërësisht qesharake në rastin e Korçës, ku ne kishim një ose dy misione. Duke mos gjetur udhë tjetër, i shkëputa marrëdhëniet me ata të dy dhe vendosa ta dërgoja çështjen drejtpërdrejt te presidenti Uilson. “Sepse budallai nxiton drejt atij vendi ku engjëjt kanë frikë të

⁹⁹ Beteja e Kaporetos (*The Battle of Caporetto*) – (gjithashtu, *Twelfth Battle of the Isonzo* *Battle of Karfreit*; slovenisht, *udež pri Kobaridu*), u zhvillua nga 24 tetori deri më 19 nëntor 1917, në afërsi të qytetit Kobarid (tani pjesë e Sllovenisë) në frontin austro-italian në Luftën e Parë Botërore. Beteja u pagëzua me emrin italisht të qytetit Kobarid (i njohur me emrin Karfreit në gjermanisht). (Shënimi im – MB)

shkelin”. Lumturisht, udha për tek presidenti Uillson dukej se ishte e hapur, pasi u vu re se interesi i tij personal ishte ngritur. Ai kërkoi t’i viheshin në dispozicion dhe t’i paraqiteshin atij vetë për t’i studiuar të gjitha informacionet faktike. Kur, ku, ose si e gjeti ai kohën, qoftë edhe për t’u hedhur një sy atyre dokumenteve, mbetet një gjë e paqartë për të gjithë. Por ajo që është e rëndësishme është se, më në fund, ai na dha fjalën se do na mbështeste dhe e mbajti premtimin, çka ishte më shumë se çfarëdo tjetër e mirë që kishin premtuar të tjerët. Ata që më parë nuk i jepnin rëndësi qëndrimit që do të merrnin “ekspertët” në çështjen shqiptaro-greke, tani u bënë shumë miqësorë dhe simpatizues dhe kauza shqiptare u përligj, përsa kishte të bënte me kërkesat greke.

Përsa i takon Italisë, çështja ishte shumë më e vështirë dhe zoti Uillson, për një farë kohe, kishte prirjen t’i jepte Italisë *Portin e Vlorës* dhe tokat rreth saj, por u pengua nga pikat e “paktit zullumqar”, i cili do t’i jepte asaj një mandat thuajse të plotë mbi territorin e pjesëve të tjera. Për fatin tonë të mirë, serbët erdhën për të na shpëtuar, duke i parë interesat e tyre të rrezikuara prej një plani të tillë, i cili do ta vendoste Italinë edhe në veri, edhe në jug të tyre, në Adriatik. Kështu ata i vunë një bombë verbale skemës dhe e çorrën dhe e bënë copë-copë.

Plani im ishte t’i jepej Amerikës një mandat¹⁰⁰ mbi Shqipërinë. Ky dokument ishte lëshuar në fillim nëpërmjet delegacionit shqiptar, dhe më pas nëpërmjet një thirrjeje të veçantë që ia drejtova publikut amerikan në shtypin e kohës. Unë edhe sot besoj se ajo ishte zgjidhja më e mirë që u vu para një çështjeje kaq të ndërlikuar dhe thellësisht të ngatërruar. Si një fuqi asnjëse, duke mos patur interesa ose ambicie të vetat në Shqipëri ose në Ballkan, Shtetet e Bashkuara nuk mund të kundërshtoheshin aq fort as nga Greqia, as nga Italia, as nga Serbia, tri shtete më drejtpërdrejt të interesuara. Në të vërtetë, edhe Greqia, edhe Serbia dhanë miratimin e tyre të pakufizuar. Përsa i takon Italisë, ajo filloi t’i ngrinte kaq shumë pretendimet ndaj Fiumes dhe lëshimet e premtuara në Azinë e Vogël, ku

¹⁰⁰ C.T.Erickson – Gjashtë arsye përse Amerika duhet të jetë e vendosur për Shqipërinë, Arkivat e Departamentit të Shtetit (“Six reasons why America should become mandatory for Albania”, State Department Decimal Files).

përfshihej Smirna (Izmiri), sa nuk i mbetej kohë të merrej aq shumë me çështjen e Shqipërisë.

Ishte e lehtë të shihnim se sa shumë do të ishte mirëpritur një zgjidhje prej Britanisë së Madhe dhe Francës, delegatët e së cilës nuk ngurruan të na thoshin më shumë se një herë:

“Çfarë mund të bënim ne? Ne e dinim se këtu ishim zënë ngushtë, duke pasur parasysh edhe normat morale, edhe ato juridike; por edhe ne luftonim për jetët tona. Prandaj me Italinë në anën tonë, ne mund të shpresonim të fitonim luftën, dhe pa të, nuk do të kishte asnjë shpresë. Ky ishte çmimi që na vuri ajo, dhe neve na u desh ta paguanim atë”.

Unë u dërgova në Uashington për t’u përpjekur që të fitoja interesin dhe mbështetjen e *Senatit* ndaj planit, por në atë kohë *Komiteti i Marrëdhënieve me Jashtë* i *Senatit* sillej hapur armiqësisht ndaj çdo gjëje, çdo nisme që vinte nga presidenti Uillson. Idealizmi i tij ishte anatemuar. Në këtë situatë nuk arrita të bëja përpara me ta.

Kështu çështja u zvarrit muaj pas muaji, deri sa u duk se ajo po zbehej e tëra. Kjo po ndodhte atëherë kur detyra kolosale e vendosjes së fatit të qindra milion njerëzve, popujve, racave, perandorive, mbretërive, principatave, fuqive të mëdha dhe të vogla, të shpërndara në të gjitha kontinentet e planetit ishte marrë në dorë prej katër burrave: M. Klemansosë (Klemencau), Lloid Zhorzhit (Lloyd George), presidentit Uillson dhe M. Titonit.

I pari prej këtyre ishte një ateist, një materialist, një moralist që e shihte të drejtën dhe të shtrembrën universale vetëm me syzet e Francës dhe të Gjermanisë. Kësaj çështjeje ai iu dha me mish e me shpirt me pasionin e një evangjelisti dhe brutalitetin e një Atile.¹⁰¹ Nëse do të bëhej ajo çfarë mendonte ai, Gjermania dhe

¹⁰¹ *Atila (Attila)*, (406–453), i njohur edhe si Atila huni (*Attila the Hun*) ishte sundimtar i hunëve nga viti 434 deri sa vdiq më 453. Ai ishte udhëheqës i Perandorisë së Hunëve, që shtrihej nga Gjermania në Lumin Ural, nga Danubi deri në detin Balltik. Gjatë sundimit të tij, ai ishte një ndër armiqtë më të rrezikshëm të Perandorisë

Austro-Hungaria do të ishin rrafshuar dhe do të kishin përfunduar në pluhur e hi, prej nga më pas do të bleronin livadhet franceze. Urrejta e tij ndaj armiqve ishte aq e ftohtë, ogurzezë, e llogaritur dhe vrastare. I vetmi idealizëm i tij ishte Franca, ndërsa Zoti i tij ishte Nemesis.

Lloid Zhorzhi, i quajtur nga kritikët “Z. Timbreling”¹⁰², ishte një oportunist pa parime të qëndrueshme, madje edhe pa vetëdije perandorake dhe ndjenjë korresponduese të detyrave dhe përgjegjësisive të tij. Fakti që gjysma e botës ishte kapur pas mëngës së xhakëtës së tij për t’u mbrojtur, falë premtimeve për mbrojtje politike ndaj minoriteteve të shtypura kudo që të ishin, të paraqitura aq shpesh prej krerëve të qeverisë së Britanisë, e bënte atë edhe më arrogant. “Ta varim kaizerin dhe ta detyrojmë Gjermaninë të paguajë tërë koston e luftës”, ky ishte slogani me të cilin ai i fitoi zgjedhjet që e dërguan atë në Paris, në krye të delegacionit britanik. Njohuritë e tij të kufizuara për gjeografinë europiane bënë që ai të pyeste një kolegj se ku ishte Transilvania, për të cilën Rumania luftonte me aq përkushtim.

Presidenti Uillson ishte vetë-përkushtuar dhe paracaktuar të luante rolin e tij “mesianik” në këtë skenë botërore me këta dy burra të shquar. Ata e vendosën ariun e madh rus në tavolinën e operacionit dhe morën rolin e kirurgut. Finlanda ishte e para që u hoq, më pas Letonia, Estonia, Lituania, Gjeorgjia. Të tëra kërkonin të drejtat e tyre, thjesht për vetëvendosje dhe asnjëra me plebishit. E gjitha kjo ishte e lehtë, sepse Rusia ishte vetë e dobët fill pas Revolucionit të Tetorit. Gjermania dhe Austro-Hungaria u trajtuan po me të njëjtën mënyrë. Rumania, bazuar në pozicionin e saj gjeografik dhe kontributin që i kishte dhënë kauzës së aleatëve, ishte në pozitë më strategjike për të përfutur. Austro-Hungaria duhej të reduktohej në Hungari, të shkatërrohej. Greqia ishte e pafat në pozitën e saj. Italia ishte kundër saj në jug të Shqipërisë. Përherë duke dashur të kënaqte miqtë e vet, Lloid Zhorzhe

Romake të Lindjes dhe Perëndimit. Ai e pushtoi Ballkanin dy herë dhe marshoi nëpër Gali/Gaule (Franca e sotme) deri në Orléan, përpara se të pësonte disfatë në Betejën e Shalonit (*Châlons*). Më pas iu përmbajt tundimit për të sulmuar Konstandinopojën apo Romën. (Shënimi im – MB)

¹⁰² *Timbreling*: një truk shpejtësie ku një zar apo bizele kalohet me shpejtësi disa herë poshtë tri gotave të vogla plastike, për ta hutuar spektatorin që duhet ta gjejë se nën cilën gotë ndodhet. (Shënimi im – MB)

i nxiti ata të shkonin në Azinë e Vogël dhe të merrnin çfarë të mundnin atje. Tani që *Konferenca e Paqes* ishte në proces, dhe gjendja në këtë proces shfaqej tepër e rrezikshme, merret me mend kur ajo të mbyllet plotësisht dhe bota të qetësohej, sa shqetësime do të sillnin këto çështje. A ndihmonte Britania e Madhe në këtë pikë? Sigurisht që po. Por edhe këtu mungonin specififikimet a veçantitë. Megjithatë, flota do të ishte e gatshme për të goditur mbi Stamboll. Rezultati do të ishte ky: Bota do të shihte se si një milion refugjatë do të vdisnin nga uria duke u zvarrisur drejt Greqisë.

Shqipëria ende priste përmbushjen muaj pas muaji të profecisë apokaliptike të “një qielli dhe toke të re”. Më pas vijnë të tjerat. Më 9 dhjetor 1919 përfaqësuesit britanikë, francezë dhe amerikanë në *Këshillin Suprem*, Zhorzhe, Klemansoja, Z. Ejre Krou dhe Frank Folku i bënë të njohur botës zgjidhjen që kishin rezervuar për problemin shqiptar:

“Shqipëria njihet si shtet i pavarur brenda kufijve që shihen në dokumentin bazë të memorandumit”.

Kjo i jepte Italisë një *mandat* mbi Shqipërinë me sovranitet të plotë mbi Vlorën. Pretendimet e Z.Venizellos mbi Shqipërinë e Jugut mbeteshin për t’u parë përsëri. Ndërkohë, në Shqipërinë Veriore, Serbisë i jepej “e drejta të ndërtonte dhe të përdorte hekurudha nëpër Shqipërinë e Veriut, përmbi paralelin 41.15, duke gëzuar kështu privilegje të plota të transportit ndërkombëtar”. Dallimet midis këtij propozimi dhe pikave të *Paktit të Fshehtë zullumqar* ishin shumë të vogla. Atëherë kryeministrat britanik dhe francez, Zhorzhe dhe Klemanso, iu kthyen *Traktatit të Londrës* dhe e ofruan atë të pamodifikuar si një propozim të tyre. Këtë e kundërshtoi Serbia, për të njëjtat arsye që e kishte kundërshtuar edhe më herët – sepse ai e vendoste Italinë edhe në veri, edhe në jug të saj në Adriatik, duke pasqyruar pozicionin e saj të pasigurtë, nëse jo edhe të pamundur. Vërtet ato ishin aleatë, por kur erdhi puna për të ndarë plaçkën, u vu në veprim diçka më e fortë se traktatet e paqes, aleancat apo fqinjësia e mirë, një faktor i hershëm i natyrës njerëzore, i shprehur kaq me vend nga Uordsuorthi:

*“ Sepse rregulli i vjetër dhe i mirë,
Atyre iu mjafton – edhe plan i nxirë.
Mjafton të marrë kush është më i forti,
Thërrimet që mbeten, t’i marrë i dobëti”.*

Kështu edhe një herë, ky dokument aq keq i ndotur dhe i zhubrosur u hodh në kosh të mbeturinave. Presidenti Uillson, megjithëse në Uashington, nuk e konsideroi veten jashtë lojës. Ja memorandum i tij mbi dy propozimet e fundit:

“Memorandumi i nëntë dhjetorit përmban në masë të madhe ruajtjen e unitetit të shtetit shqiptar. Ai i katërmbëdhjetë janarit 1920 (Memorandumi Lloid George - Klemanso), e ndan popullin shqiptar, përkundër protestës së tij të furishme, midis tri fuqive të huaja. Këto dhe dispozita të tjera të *Memorandumit të 14 janarit*, të negociuara pa dijeninë apo miratimin e qeverisë së Shqipërisë, ndryshuan tërë pamjen e zgjidhjes për Adriatikun dhe në sytë e kësaj qeverie del të jetë e pazbatueshme, e zhveshur prej asaj mase të drejtësisë që është e qenësishme, nëqoftëse duhet që edhe kjo qeveri të jetë pjesë e zbatimit të pikave të kësaj marrëveshjeje”.

Z. Klemanso u pasua nga Milerand si kryeministër i Francës. Tri ditë pas marrjes së notës së presidentit Uillson, më 17 shkurt, kryeministri i ri, bashkë me Lloid Zhorzhin iu përgjigjën atij.

Në atë përgjigje ata theksuan se propozimi për të ndarë Shqipërinë midis tri fuqive ishte bërë në interes të jugosllavëve, që ata të kishin dalje në det nëpërmjet Shqipërisë Veriore dhe e justifikuan propozimin e tyre me deklaratën e pavërtetë dhe zhgënjyese se:

“Populli shqiptar nuk ka qenë kurrë i aftë të vendosë një qeveri të qëndrueshme për vetveten dhe, meqenëse pjesa veriore e popullsisë është në masë të madhe e krishterë dhe ata të jugut, në të njëjtën masë muhamedanë, menduam se më e mira ishte t’u besonte përgjegjësinë për qeverisjen dhe zhvillimin e atyre dy pjesëve, respektivisht

Jugosllavisë dhe Italisë”.

Është e habitshme të mendosh se ku ishte Z.Venizellos kur ishte hartuar ky dokument që deklaronte se jugu i Shqipërisë ishte në masë dërrmuese i populluar nga muhamedanë. Propozimit të mësipërm presidenti Uillson iu përgjigj si vijon:

“Qeveria amerikane e kupton shumë mirë se ndarja e trefishtë e Shqipërisë sipas Marrëveshjes franko-britanike mund të jetë më e pranueshme për qeverinë jugosllave, por ajo e kundërshton po aq energjikisht dëmtimin e popullit shqiptar në favor të Jugosllavisë, sikundër që kundërshton të dëmtojë popullin jugosllav në favor të Italisë”.

Pas më shumë se nëntëmbëdhjetë vjetësh gjatë të cilave unë kam bërë të pamundurën si mik i atij vendi aq të dashur për mua (por ai vetë ishte thujse pa asnjë mik), unë ende mendoj për ato fjalë të presidentit amerikan, Uillson, të cilat në atë kohë erdhën si fjalët më të ëmbla që kam dëgjuar ndonjëherë.

Ato fjalë tingëlluan si meloditë më të bukura në zemrat e delegacionit tonë të dëshpëruar, si një *himn shprese*, për të cilat ashtu si shën Pali,


*“Ne e falenderuam Zotin dhe morëm zemër për më tej”.*¹⁰³

Më në fund, në dëshpërim, *Këshilli Suprem* i propozoi delegacionit jugosllav dhe atij italian të mblidheshin bashkë dhe të shoshitnin çështjet që kishin midis tyre. Pas kësaj, *Këshilli* do të mblidhej në San Remo, për të gjetur një zgjidhje përfundimtare. Delegacioni italian u paraqit, ndërsa ai jugosllav jo. Ata do ta linin Shqipërinë, këtë jetime trazavaçe, te pragu i derës së *Lidhjes së Kombeve* të sapokrijuar, dhe kështu t’i lanin duart me tërë këtë rrëmuje që vetë e kishin krijuar. Meqë e gjeti derën e saj hapur, kjo jetime e humbur, e çrregullt, e braktisur, hyri brenda dhe zuri një karrige. Të paktën ky ishte një hap, pasi kishte ndenjtur për më shumë se një vit në oborrin e jetimëve. Por kjo ishte një provë e vënë para *Lidhjes së Kombeve*, që nuk kishte juridiksion mbi çështje të tilla dhe që e ktheu atë


¹⁰³ *Bibla* – Akti 28-15 shën Pali: Vëllezërit kishin dëgjuar për ardhjen tonë dhe shkuan deri te Forumi i Apusit dhe Tri Tavernat për të na pritur. Kur i pa burrat, (shën) Pali falenderoi Zotin dhe mori zemër.

mbrapsht te *Konferenca e Ambasadorëve* që ishte themeluar prej *Këshillit Suprem*, që të kujdesej për mosmarrëveshje të tilla të lëna prapa pa u zgjidhur plotësisht.

Kështu, pasi ra perdja e kësaj konference, gjithkush mori rrugën për në vendin e vet. *Salla e Pasqyrave* të Versajës u pastrua dhe u rinovua edhe një herë, dyert dhe dritaret u mbyllën dhe një fjalë e shkruar me germa të mëdha “*Fund*” u vu mbi atë traktat monstruoz, të habitshëm, inkoherent të Versajës. Shqipëria e vogël përsëri mbeti jashtë portës dhe pa një vend të sigurtë se ku të shkonte. Le ta lëmë lexuesin t’i përgjigjet pyetjes se çfarë kishim bërë ne në të vërtetë?



MALËSORËT E SHKATHËT SHQIPTARË U SULËN SI NGA
JASHTË, ASHTU EDHE NGA BRENDA RRETHIMIT, ME KLITHMAT
DHE KËNGËT E TYRE TË BETEJAVE, DUKE I BËRË ARMIQTË
E TYRE T'IA MERRNIN VRAPIT, SIÇ KISHIN BËRË ME MIJËRA
HERË TË UDHËHEQUR NGA BIJTË E VET TË SHQUAR, TË
TILLË SI SKËNDERBEU, PIRRO, ALEKSANDRI I MADH, FILIPI I
MAQEDONISË, PËR TË MOS PËRMENDUR ATA TË LUFTËS SË
TROJËS.



XX



PASOJAT E “PAQES”

Më 28 qershor të vitit 1919, *Traktati i Versajës* u nënshkrua në *Sallën* e famshme të *Pasqyrave* në Versajë, duke shënuar kështu fundin e Luftës Botërore. Heshtja ogurzezë me të cilën kjo ngjarje historike u përmyll në njëzetvjetorin e saj këtë qershor që kaloi,¹⁰⁴ është një prej gjërave më të rëndësishme për t’u shënuar në këtë vit përkujtimor. Për të gjitha kombet, popujt, gjuhët, fati i të cilëve ishte i lidhur me atë traktat, njeriu zor se mund të gjejë qoftë edhe një vendim të vetëm që të ketë mbetur i pandryshuar. *Traktati i Versajës* u ndërtua rreth *Lidhjes së Kombeve*. Po guri themelor i Lidhjes, cili ishte? Vetëvendosja.

Vetëvendosje në Ballkan, në Transilvani, në Bukovinë, në Kroaci, në Maqedoni, në Shqipëri dhe provincat e saj të humbura. Vetëvendosje në provincën e Silezisë dhe Ruthenisë që kishin të bënin me Poloninë. Në Fiume, kur ishte fjala për Italinë; në Austri, në Saar, në Dannig, në një rradhë territorësh të tjera të njëjta. A

¹⁰⁴ Duket se Eriksoni e ka shkruar këtë pjesë të librit në qershorin e vitit 1939, pra në 20-vjetorin e mbylljes së *Konferencës së Paqes* në Paris, 1919. (shën. i perk.)

u plotësua ndonjë prej këtyre premtimeve?

Kur Austria kërkoi plebishit në çështjen e bashkimit me Gjermaninë, ajo jo vetëm që u kthye mbrapsht, por u penalizua përgjithmonë, thjesht pse kishte paturpësinë qoftë edhe të ëndërronte një zgjidhje të tillë për fatin e saj. Ndërkohë, mijërat e grave dhe fëmijëve të tyre po vdisnin nga uria dhe sëmundjet rrugëve të Vjenës. Italia ishte anëtare e Fuqive Aleate si në fushën e betejës, ashtu edhe në *Konferencën e Paqes*, por brohoritjet e kombeve për *Traktatin e Paqes* dhe *Lidhjen e Kombeve* pothuajse ishin shuar përpara se shtypi i saj ta përshkruante politikën e Antantës si:

“Një tretëse të strukturës sociale, konstruktive në fjalë, gërryese në vepra”.¹⁰⁵

Duke cituar nga *La Stampa*, dr. Diloni thotë:

“Me fjalë: luftë për lirinë e kombeve, për barazinë e popujve dhe klasave, për mirëqenien e të gjithëve”. “Me vepra: shtypje e lirive më elementare dhe konstitucionale, mbisundim i kombeve të caktuara, bazuar në poshtërimin e të tjerëve, ndarjen e popujve midis shfrytëzuesish dhe të shfrytëzuarish, thellim i dallimeve sociale, shkatërrim i pasurisë kolektive dhe përqëndrim i saj në pak duar të njollosura me gjak, mizerje universale dhe uri”.

Politika e Francës njihej si një politikë e hegjemonisë së saj mbi kontinentin europian. Gjermania ishte e rraskapitur. Austria ishte e detyruar të pranonte lëmshën, me qëllim që tek e fundit, të mbahej gjallë. Çekoslovakia ishte çelnikosur dhe ngulur si bajonetë në shpinën e Gjermanisë, me një dyzinë kombesh të tjera të vogla të mbira e të shtrira nga Rrethi Arktik deri në Detin e Zi dhe në Mesdhe. Qymyri dhe hekuri gjerman duheshin vënë nën kontroll, kundrejt një dëmshpërblimi të llogaritur me terma astronomikë, aq sa të thante edhe pikën e fundit të gjakut të racës gjermane për brezat që do të vinin. Marrëveshja e *Lidhjes*

¹⁰⁵ E.J. Dillon: *Histori nga brenda Konferencës së Paqes (Inside story of the Peace Conference)*, botuar nga Harper & Brothers, në shkurt 1920.

së *Kombeve* ishte shkruar në atë mënyrë, që i gjithë “morali i riarmatimit” të ishte në shërbim të saj. Kjo tregon se Italia ishte thellësisht e bezdisur nga e tërë kjo gjë.

*“Është e pamundur që Franca të bëhet despoti absolut i Europës, aq më pak kundër Italisë. Paqja - po të citojmë E.J. Dillonin - ishte përshkruar si zotërimi franko-sllav, me shtabin e tij në Pragë dhe një degë-zyre në Agram”.*¹⁰⁶ E bllokuar në çdo drejtim tjetër në të cilin ajo kërkonte kompensime për investimin e bërë prej gjakut, floririt dhe argjendit në luftën e aleatëve, Italia këmbënguli edhe më shumë në kërkesat e saj ndaj Adriatikut dhe Shqipërisë ».

Erdhi një kohë kur ajo u përgatit t’i lëshonte veriun e Shqipërisë Serbisë, ndërsa jugun Greqisë, me qëllim që të përfitonte për vete Fiumen. Ajo madje arriti deri tek një marrëveshje me Greqinë për ndërtimin e një hekurudhe që kalonte nga Vlora, e cila përshkonte tërë Shqipërinë Jugore deri në Follorinë, duke vepruar sikur Shqipëria të mos ekzistonte fare. Megjithatë, kjo kapardisje ngjiste me raportin e vdekjes së Mark Tuenit, e ekzagjeruar tej çdo mase.

Të stërlodhur nga shkatërrimet, vonesat e pafundme në vendosjen e statusit të shtetit të vet, shqiptarët i hynë punës për të bërë ç’të mundnin për të ngritur edhe një herë strukturat e shtetit të tyre të vogël, pas atyre cikloneve të luftës dhe vetë luftërave politike, që kishin bërë më të keqen e mundshme për të shembur të kaluarën dhe rrënuar tërë shpresat për ndonjë farë restaurimi të së ardhmes.

Në janar të vitit 1920 u mblodh një Asamble Kombëtare në Lushnjë, me qëllim që të formohej një qeveri e përkohshme. Ushtria italiane i rrethoi pjesëmarrësit dhe ata i provuan armët e tyre në qytetin e vogël që shtrihej në mes të një fushe, pa asnjë ndihmë. Kështu u zgjodh një këshill regjentësh që të luante rolin e kreut të qeverisë, secila fe me nga një anëtar, një për katolikët, një për ortodoksët, një për myslimanët dhe një për bektashinjët. Po ashtu u votua që qeveria ta kishte selinë në Tiranë. Në shkurt, nacionalistët shqiptarë vendosën që ta pastronin vendin nga trupat e huaja, që po e rripnin atë që prej pesë vjetësh, ashtu si mëtonjësit e

¹⁰⁶ *Agram*, emri historik në gjermanisht me të cilin austriakët e njihnin Zagrebin.

Penelopës që i kishin lejuar vetes ta përdornin shtëpinë e mikpritësit si shtëpinë e vet.

Italia ishte e para që u njoftua se vendi ku ata qëndronin, ishte më i rëndësishëm se shoqëria e tyre aty. Kështu më datën 3 qershor 1920, një grup udhëheqësish shqiptarë, të mbledhur në fshehtësi, lëshuan deklaratën e mëposhtme:

I nderuar, gjeneral Piaçentini!

Komandant i trupave italiane në Vlorë,

“Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, i zgjedhur nga populli i Vlorës, i mbledhur në Barçellë më njëzet e nëntë maj 1920, në përgjigje të thirrjes së drejtuar prej të nënshkruarit/nënshkruarve, ka nderin t’i drejtojë Shkelqësisë Suaj deklaratën e mëposhtme:

Kur ushtria italiane zbarkoi në Vlorë në vitin 1914, komandanti italian, në cilësinë e tij zyrtare, dhe me siguri në emër të nderit dhe të kombit italian, deklaroi se Italia e lirë nuk kishte qëllim të pushtonte Vlorën dhe se arsyeja e zbarkimit të trupave ishte të siguronte për ta një bazë strategjike ushtarake, në rast të ndonjë lufte të mundshme me Austrinë. Populli shqiptar, i mbetur pa ndihmë, në vështirësi të mëdha dhe duke besuar në fjalën e nderit të dhënë në mënyrë të përsëritur prej qeverisë italiane, iu dorëzua pushtimit italian. Për pesë vjet me radhë ata e vuajtën këtë mashtrim të cilin ua imponoi qeveria italiane dhe ende vazhdon ta bëjë këtë me Vlorën, që është djepi i pavarësisë së Shqipërisë. Tani ne po qeverisemi si të ishim kolonia më e përbuzur.

Gjuha jonë, administrata jonë dhe flamuri ynë janë të kufizuar prej kushteve edhe më mizore sesa ato të qeverisë turke, të imponuara kur turqit dominonin vendin. Por ajo e ashtuqajtura qeveri lirisdashëse italiane, pa asnjë turp, e ka gjymtuar Shqipërinë nëpërmjet Traktatit të Fshehtë të Londrës, më datën 26 prill 1915, të cilin ajo e ka nënshkruar. Ne nuk jemi aq të shkujdesur ndaj faktit se a është e mundur të përkulet një popull i vogël si shqiptarët me forcën e armëve, qoftë edhe kur kjo ushtrohet prej një fuqie të madhe si Italia! Por qeveria italiane, sado e fuqishme që të jetë, nuk mund

të ndalojë një popull të vogël si shqiptarët që të japin jetën për idealin e tyre të lirisë. Kjo është arsyeja përse populli shqiptar kurrë nuk do t'i nënshtrohet gjymtimit sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës, thjesht për shkak të programit imperialist të Italisë që të mbajë Vlorën nën tiraninë e saj. Populli shqiptar, i bashkuar sot më shumë se kurrë, nuk do t'i lejojë vetes të shitet si bagëti në tregun europian të Italisë, Serbisë dhe Greqisë. Tani ne jemi të vendosur të marrim armët në dorë dhe t'u kërkojmë italianëve vendosjen tonë nën administrimin e Qeverisë së Tiranës, të Vlorës, Tepelenës dhe Himarës. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, me kërkesë të popullit të Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë të mbledhur këtu, i kërkon shkelqësisë suaj të na japë një përgjigje deri nësër në orën shtatë të mbrëmjes. Komiteti nuk do të mbajë përgjegjësi për atë që do të ndodhë në rast se nuk jepet brenda këtij afati një përgjigje e favorshme”.

Nënshkruar nga Osman Nuri

Përgjigjja e gjeneral Piaçentinit u dha me bombardim të disa kasolleve me baltë në rrethinën e Vlorës. Dy zogj gomari u gjetën në linjën e zjarrit të vrarë dhe disa kasolle të zhdukura. Megjithatë përgjigjja u kuptua mirë dhe kjo do të thoshte se gjuha e armëve ishte përdorur shpesh për t'iu hequr shqiptarëve nga mendja çfarëdo lloj dyshimi se kishte zgjidhje tjetër. Kështu, në këtë orë të rëndë, këta burra që nuk ishin as prej Konkordit, as prej Leksingtonit, por prej Vlore, Tepelene dhe Himare, u betuan se do të sakrifikonin jetët e tyre deri tek i fundit, nëse kjo nevojitej, që t'i përzinin italianët dhe të gjithë trupat e huaj jashtë Shqipërisë. Ata me zgjuarsi filluan të mblidhnin njësi të ndara, të vendosura në pjesë të ndryshme të Shqipërisë Jugore dhe asaj Qendrore. Ata hasën në pak ose aspak qëndresë.

Kur menduan se e kishin plotësuar detyrën e tyre, ata panë se kishin kapur dy kolonelë, tridhjetë e dy oficerë të rangjeve më të ulëta dhe një mijë e pesëqind ushtarë. Përveç kësaj, kishin kapur edhe një numër të mirë mjetesh të artillerisë malore, mitralozë, pushkë dhe pajisje të tjera luftarake. Më në fund, ata iu vërsulën edhe vetë Vlorës, të cilën italianët e kishin fortifikuar rreth e rreth me tela me gjemba të përdredhur. Pas tyre ishin muret e ulëta, të ndërtruara në kreshtat e

maleve prapa qytetit, ku ishte vendosur artileria e një force të jashtëzakonshme, në shtatë anët e saj. Shqiptarët numëronin një mijë burra të armatosur, të mbuluar me gunat¹⁰⁷ e tyre. Këto të fundit ishin coha të bëra me lesh deleje dhe dhie, që i përdornin çobanët shqiptarë, të padepërtueshme nga shiu në të tëra stinët. Por, për çfarë do të përdroreshin ato në këtë sulm? Në fakt, ato do të ishin shumë të rëndësishme, gati jetësore, pasi ato u vunë përmbi telat me gjemba të përdredhur.

Këta malësorë të shkathët shqiptarë u sulën si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda rrethimit, me klithmat dhe këngët e tyre të betejave, duke i bërë armiqtë e tyre t'ia merrnin vrapit, siç kishin bërë me mijëra herë të udhëhequr nga bijtë e vet të shquar, të tillë si Skënderbeu, Pirroja, Aleksandri i Madh, Filipi i Maqedonisë, për të mos përmendur ata të Luftës së Trojës.

Ata iu turrën furishëm shtatë fortesave. Tri fortesa u kapën bashkë me mbrojtësit e tyre; atje poshtë, në qytet, ata iu turrën shtabit ushtarak të gjeneral Piaçentinit, por vënia në përdorim e mitralozëve provoi sa vdekjeprurës ishte ky aksion. Kështu shqiptarët përshkuan rrugë të tërthorta drejt municioneve të ruajtura, i shpërthyen ato dhe i përdorën për të arritur qëllimin e tyre. Luftimet vazhduan disa ditë dhe, përkundër topave të flotës italiane që bombardonin pa ndërprerë, shqiptarët përparuan dukshëm duke marrë e mbledhur sasi të mëdha materialesh luftarake, pajisjesh dhe çdo gjë tjetër që i jepte qytetit pamjen e një qyteti italian.

Më vonë u mësua se Shkëlqesia e Tij i kishte djegur telegramet me mesazhet që i përshkruanin qeverisë italiane pozicionin e tyre të dëshpëruar. Kabineti qeveritar italian ra. Në krye u vu Xhilioti i vjetër. Ai nuk kishte stomak për këtë aventurë perandorake në Shqipëri. Megjithatë, ai urdhëroi të dërgoheshin përforcime nga Ankona. Po çfarë bënë këto trupa, përveç gjullurdisë dhe kundërshtimit për të mos shkuar? Asgjë tjetër! Kur oficerët e tyre u përpoqën të përdornin forcën, ushtria nuk u bind. As ata nuk kishin stomak për aventurën shqiptare. Më në fund u bënë përpjekje për të përcjellë municione nëpërmjet porteve. Pas kësaj, edhe trenistat

¹⁰⁷ Shqip në original.

nuk pranuan t'i ngarkonin trenat me municione.

Italia ishte vetë-kurthuar.

Ajo mund të poshtërohej përsëri pas asaj që i kishte ndodhur në Korporeto (Corporetos). Pilula shqiptare ishte po aq e helmët. Qeveria dërgoi ambasadorin e vet që të vendoste paqen. Ky ishte baroni Alioti,¹⁰⁸ të cilin asnjë shqiptar nuk e besonte. Ai kishte qenë ministër italian gjatë regjimit të princ Vilhelm Vidit dhe intrigat e tij, kryesisht me Esat Pashën, njiheshin mirë dhe kishin një famë shumë të keqe. Ai u kthye tek shefi i tij më i diskretituar se kurrë. Atje u dërgua konti Manzoni, një burrë me karakter krejt të ndryshëm, që shqiptarët e njihnin dhe e besonin, i cili e kishte treguar veten në më shumë se një rast si një mik që i kuptonte. Brenda pak ditësh u arrit një marrëveshje e plotë.

Tani Vlora e ndryshoi përsëri adresën. Nuk ishte më “*Vlora-Italia*”, por *Vlora-Shqipëria*. Të gjithë italianët ikën nga Vlora dhe u grumbulluan në Ishullin e Sazanit, të cilin e kishin fortifikuar që më parë.

Një koment italian, i cituar prej zonjushës Stickeni¹⁰⁹ të prek me patosin e tij kur thotë:

“Është vërtet shumë trishtuese të shohësh këtë shpartallim pas kaq gjaku fisnik e bujar italian të derdhur, dhe pasi janë shpenzuar kaq shumë miliona për një punë të madhe të qytetërimit dhe për sigurimin e kufijve tanë”.

Rrjedhjet tjetër e kësaj marrëveshjeje dhe e tërheqjes së italianëve prej Shqipërisë ishte prishja e marrëveshjes *Titoni-Venizellos* dhe të tjerat që mezi prisnin dorëzimin e Shqipërisë së Jugut Greqisë, për t'i bërë kompensime të ndryshme

¹⁰⁸ *Baronin Karlo Aliotin* e dërgoi qeveria italiane për të negociuar me qeverinë shqiptare të Tiranës, menjëherë pasi filloi Kryengritja e Qershorit. Fakti që pushteti i laburistëve dhe socialistëve nuk e lejoi qeverinë e Xhilotit të dërgonte përf forcime, e la Aliotin pa argumente në Tiranë; kështu në mes të gushtit ai u zëvendësua nga konti Manzoni, i cili i solli negociatat në një përfundim të suksesshëm. (Shënimi im – MB)

¹⁰⁹ Edith Pierpont Stickney: *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në çështjet europiane ndërkombëtare 1912-1923*, Shtëpia botuese KOHA, Tiranë, 1997. (Shënimi im – MB)

Italisë. Nga ana tjetër, grekët ishin të gatshëm të merrnin territore me propagandë e dhunë. Ndërsa Jugosllavia ende shpresonte t'i zotëronte rajonet veriore, me qëllim që të ndërtonte një hekurudhë që shkonte drejt Adriatikut për të përfituar një dalje tjetër në det, bazuar në të njëjtat kushte. Në fakt, në gushtin e vitit 1920, Jugosllavia dërgoi një ushtri të konsiderueshme brenda territorit, për ta marrë atë në zotërim ushtarak në emër të shtetit.

Pastaj, në shtator, ndodhi një gjë shumë e rëndësishme. Shqipëria u pranua në *Lidhjen e Kombeve*. Shqiptarët e maleve të egra të Shqipërisë,¹¹⁰ pasi ishin gjuajtur për kaq e kaq vite, më në fund zunë vend pranë Pëllumbit të Paqes, në kafazin e pëllumbave në Gjenezë, me një degë ulliri përmbi kokën e çarë dhe të përgjakur. Në të vërtetë, ajo ishte një arritje që të ngazëllonte dhe që vërtet duhej festuar.

Vërtet që kishin mbetur gjëra të tjera më të rëndësishme me të cilat duhej të merreshin. P.sh., kufijtë. Po statusi i saj përfundimtar si komb? A do të ishte vërtet e pavarur dhe e lirë? A do ta ndihmonte *Lidhja e Kombeve*? A do t'i riktheheshin asaj ato fonde që dikur ishin votuar prej gjashtë Fuqive të Mëdha për t'u përdorur për refugjatët e saj që po vdisnin nga uria, për të riparuar dëmet që kishin shkaktuar nëntë vjet të luftës së pandërprerë ndaj ekonomisë së saj dhe burimeve natyrore kombëtare? Po për shkollat, rrugët, furnizimet me farëra për bujqësinë, makineritë, bagëtitë, lopët, delet dhe kafshët e tjera të fermave, të cilat kishin shkuar dëm duke ushqyer disa ushtri dhe që kishin jetuar në sajë të pasurive të këtij vendi? Ajo ishte bërë viktimë e luftës, po a ishte zhdamtuar ajo? I shkreti shpend i shqiptonjës duhet të jetë ndjerë i dëshpëruar midis madhështisë, shkëlqimit mbretëror, ekstravagancës, pasurisë dhe pushtetit që ajo mbante në çdo dorë! A mundet që shqiptonja e vogël e Maleve Akrokeraune (Acroceraunian),¹¹¹ të mësonte të këndonte *Rule Britannia!*¹¹² dhe *Marsejzen*? Zot, ndihmoje atë, nëse ajo vetë nuk mundet! E vetmja shpresë

¹¹⁰ Shqip në origjinal

¹¹¹ Vargmalet Akrokeraune (Acroceraunian Mountains), në Epir mbarojnë në një gjërësi malore përtej Orikumit. Emri ndoshta rrjedh prej ekspozimit të kreshtave të larta të këtyre maleve ndaj vetëtimave. (Shënimi im – MB)

¹¹² “*Rule (Sundo), Britannia!*” është një këngë britanike patriotike, e bazuar në tekstin e poemës “*Rule, Britannia*”

për të ardhmen e saj gjendet tek ajo vetë!

Unë e gjej interesante listën kronologjike të ngjarjeve që pasuan pranimin e Shqipërisë në *Organizatën e Lidhjes së Kombeve*.

- 20 dhjetor 1920, njohja zyrtare e Shqipërisë si anëtare e Lidhjes së Kombeve;
- 29 prill 1921, Mithat Frashëri, kryetar i delegacionit shqiptar, raportoi në Lidhjen e Kombeve se serbët ende mbanin të pushtuar me ushtrinë e tyre një pjesë të madhe të veriut të Shqipërisë, ndërkohë që grekët, po ashtu, mbanin të pushtuar një tjetër rajon afër Korçës, në jug të Shqipërisë;
- shtator 1921, Lidhja e Kombeve dërgoi një Komision në veri të Shqipërisë për të hetuar mbi konfliktin serbo-shqiptar;
- 9 nëntor 1921, përcaktohen kufijtë e Shqipërisë së Veriut sipas *Protokollit të Firences* të 17 shtatorit të vitit 1913, përveç disa ratifikimeve në favor të Jugosllavisë. Për rrjedhojë, fuqitë nënshkruese Britania e Madhe, Franca, Italia, dhe Japonia e njohën qeverinë e Shqipërisë si një shtet sovran dhe të pavarur;
- 16 nëntor 1921, qeveria shqiptare e pranoi këtë vendim nga katër fuqitë.

Në këtë pikë është interesante të vëmë re se më 9 nëntor 1921, kur u mor vendimi i mësipërm, u arrit edhe një tjetër marrëveshje e fshehtë që kishte të bënte me Italinë, si më poshtë:

“Kufijtë e Shqipërisë janë të një rëndësie ndërkombëtare. Nëse ato shkelen, ose rrezikohen, Shqipërisë duhet t’i mundësohet paraqitja e kërkesës tek *Këshilli* i Lidhjes së Kombeve për asistencë të huaj. Në një rast të tillë, *Këshilli* vendosi që restaurimi i kufijve territorialë të Shqipërisë t’i besohet Italisë”.

Një marrëveshje e katërt dhe përfundimtare u shpall si më poshtë:

“Nëqoftëse Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendos me shumicë që ndërhyrja nuk është

të Xhejms (James) Tomsonit, me muzikë të Tomas Arnesit në vitin 1740. Kjo konsiderohet si kënga e Flotës Mbretërore, por ajo përdoret edhe nga forcat e tjera të ushtrisë britanike. (Shënimi im – MB)

e volitshme, qeveritë e sipërpërmendura do ta rikonsiderojnë çështjen në pajtueshmëri me parimet e shpallura në preambulën e kësaj Deklarate dhe, konkretisht, çfarëdo modifikimi i kufijve të Shqipërisë përbën një rrezik për sigurinë e Italisë”.

Kjo deklaratë, së bashku me preambulën e sipërshkruar, autorizonte Italinë që të ndërhynte me forcë, në rast të një kërcënimi ndaj pavarësisë së Shqipërisë ose shkeljes së territorit të saj. Kjo ishte e rëndësishme për t’i siguruar Italisë një justifikim për atë që do të bënte në të *Premten e Mirë të 7 prillit 1939*, kur ajo hyri forcërisht në Shqipëri dhe e pushtoi atë dhe që i shkojnë kaq mirë këto vargje:

*“Oh, si u end ky lëmsh kaq i ngatërruar,
Që kur së pari nisëm për të mashtruar!”.*

Ndërkohë, një komision tjetër vepronte në kufijtë jugorë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Një prej çudive të zbuluara nga ky komision ishte “mungesa e plotë e grekëve” në territorin e diskutueshëm. Gjithashtu, minoriteti grekofil përbënte më pak se një të tretën e popullsisë dhe ata e bazonin përzgjedhjen e tyre në frikën e krijimit të një *Kishe Autoqefale Shqiptare*, e cila mund të shkaktonte një çarje të hapur me *Patriarkanën e Stambollit*.¹¹³ Komisioni konstatoi se propaganda greke, sikur gjoja shqiptarët nuk përbënin një komb, sikur ata nuk do të ishin kurrë në gjendje të ekzistonin si një shtet i pavarur dhe modern, dhe se herët ose vonë ishte e sigurtë se vendi do të ndahej nga fqinjët e tij”, ishte e pabazë. Vendimi përfundimtar i komisionit, i konfirmuar prej Fuqive ishte që: “Ekzistenca e një Shqipërie të pavarur është një domosdoshmëri për paqen në atë pjesë të Europës dhe që një Shqipëri e pavarur është e mundur vetëm nëse krahinat jugore të saj mbahen brenda territorit të vendit”.

Deri tani punët venë mirë. Tek e fundit, Shqipëria është njohur zyrtarisht si shtet i pavarur, si domosdoshmëri për paqen në Europë. Më në fund, në dhjetor të

¹¹³ Edith Pierpont Stickney: *Shqipëria Jugore ose Epiri i Vëriut në çështjet europiane ndërkomëbtare 1912-1923*, Shtëpia botuese KOHA, Tiranë 2000, 1997.

vitit 1923 u përcaktuan kufijtë jugorë dhe Shqipëria ishte tani në mëvehtësinë e saj. Që nga nënshkrimi i *Traktatit të Versajës* kishin kaluar tashmë katër vjet e gjashtë muaj.

Ndërkohë, për shqiptarët nuk ishte e lehtë të mësonin leksionin e vetëqeverisjes. Ata dukej se ende mendonin se e vetmja mënyrë për të rrënuar një qeveri që atyre nuk u pëlqente, ishte të fillonin një revolucion, në vend që të shkonin tek kutitë e votimit. Kështu, gjatë katër vjetëve kur sallonet e Parisit dhe të Gjenevës po përpiqeshin të vendosnin mbi çështjen nëse duhej të kishte një Shqipëri apo jo, shqiptarët vetë kishin vënë dhe rrëzuar nëntë kabinete qeveritare. As vetë Franca nuk mund të tregonte një përvojë më të përditësuar sesa kjo. Ata kishin inskenuar disa revolucione dhe kryengritje me të cilat do mund të konkurronin me shtete të ndryshme të Europës, mund të thotë dikush. Më seriozet prej këtyre ndodhin pas këtij kapitulli, kur të flasim për kryepeshkopin dhe kreun e *Kishës Ortodokse*, Fan Nolin, kundër qeverisë së Ahmet Zogut. Kjo zgjati prej qershorit deri në dhjetor të vitit 1924. Ndoshta ngjarja më e madhe e kësaj qeverie ishte mënyra se si anëtarët e kabinetit ikën nga zyrat. Ata jo vetëm që ikën, por edhe u arratisën në Itali, duke marrë me vete fondet e thesarit, si dhe fondet e mbledhura nga doganat në portin detar. Të tërë së bashku ishin rreth dyqind vetë, anëtarë të kabinetit, anëtarë të parlamentit, udhëheqës partish, revolucionarë, të gjithë që kishin arsye të besonin se Ahmet Zogu dhe matjanët e tij që po futeshin në qytet, do të kërkonin që ata të rrëfeheshin mirë e mirë, nëse kapeshin prej tyre.

Shumë prej tyre nuk u kthyen në Shqipëri derisa italianët e pushtuan vendin atë të *Premte të Mirë*. Kjo ndihmon për të shpjeguar shumë gjëra që lidhen me atë ngjarje në kapitujt që vijnë.



MË NË FUND, PËR NJË SHTET TË VOGËL DHE TË PANDIHMË SI SHQIPËRIA, UNË DO TË KËRKOJA TË SHMANGIA ME ÇDO ÇMIM ÇDO PENGESË POLITIKE, KOMERCIALE, FINANCIARE OSE EKONOMIKE QË KËRCËNON TË KOMPROMENTOJË JETËN E LIRË DHE TË PAVARUR, SI DHE FUNKSIONET E SHTETIT. PËR MË TEPËR, UNË DO TË KULTIVOJA ME KËMBËNGULJE MIQËSINË ME FUQITË E MËDHA, DUKE MOS PATUR ASNJË INTERES VETJAK DHE EGOIST PËR TË NXJERRË NË PAH VETVETEN. KËTO JANË PËR MUA DISA PREJ DETYRAVE MË TË RËNDËSISHME DHE KËRKESAT MË TË QARTA ME TË CILAT BALLAFAQOHET QEVERIA E SHQIPËRISË SË RE.



XXI



SHQIPONJA DHE MALET E SAJ

“Varka e peshkatarit ka me vete shpresën, liqeni ka mjelmat, malet kanë shqiponjat”.

Kur ndalem e vështroj këta muajt e parë të Shqipërisë së Re, më krijohet përshtypja se ajo që mungon më së shumti këtu është vizioni dhe përgjegjësia që kanë për jetën dhe rritjen e këtij shteti të ri. Nëse ka patur një person të vetëm midis shumë të tjerëve, dhe unë i njoh ata të tërë në intimitet, ku kishte një ide të përgjithshme ose konceptim të tërë asaj që po ndodhte, ai person ia doli në mënyrë të jashtëzakonshme ta mbante atë brenda vetes, si një të fshehtë personale.

Nëse njeriu vendos të ndërtojë një shtëpi, sipas përvojës, ai duhet të ketë idenë se për çfarë do ta përdorë atë shtëpi. Ndoshta ai e merr këtë ide dhe shkon te dikush tjetër dhe e diskuton atë gjerë e gjatë për të shmangur gjërat që janë jo praktike, vendos për materialet më të mira që duhet të përdorë, formën më të bukur të ndërtesës për qëllimet e tij, bën një vlerësim të kujdesshëm të kostos dhe e përshtat

atë me mundësitë e tij. Këto janë vetëm disa prej gjërave të njohura që duhet t'i llogarisë çdokush që do të bëjë një shtëpi për familjen e tij. Prandaj, kur ndërtohet një shtëpi për një komb, njeriu ka të drejtë të mendojë se përgjegjësinë më të madhe e ka ai që ka autoritetin në vendin e vet. Por ku qëndron kjo përgjegjësi?

Ashtu siç i mendoj unë gjërat, një shtet modern duhet të jetë i vetëdisiplinuar, i ndershëm, i drejtë, patriotik, mbajtës i rendit, që administron mirë drejtësinë në mënyrë të paanshme për të gjithë, që respekton të drejtat e njeriut, kujdeset për mirëqenien publike, për të moshuarit, të dobët, të pafuqishmit, të sëmurët, nënat me fëmijë të vegjël. Ai shtet bën kujdes për publikun, shkollimin falas, duke siguruar të gjitha mjetet, ato për ndër-komunikim rrugor, hekurudha; zhvillon aeroportet, postat, telegrafën, duke sjellë dhe mbajtur tërë popullsinë në kontakt me njëri-tjetrin dhe me qeverinë e tyre. Artet e bukura dhe feja duhet të shërbejnë për pasurimin e jetës shpirtërore. Të ndërtuarit e një race brenda një shoqërie të njësuar, në të cilën çdo individ të jetë një pjesë e vlefshme dhe e bekuar e saj, pa marrë parasysh a është i varfër, i dobët, i përulur apo i pasur, në qeverisje apo jashtë saj, është po ashtu detyrë e rëndësishme.

Unë do të prisja që një qeveri e tillë të tregonte zgjuarsin në konservimin e burimeve bazë, të pasurive të kombit, në zhvillimin e këtyre burimeve për të mirë të popullit, në vendosjen e lidhjeve tregtare dhe komerciale me pjesën tjetër të botës, jo për të mirën e përfituesve të huaj, por për mirëqenien dhe përparimin që kërkon populli. Më në fund, për një shtet të vogël dhe të pandihmë si Shqipëria, unë do të kërkoja të shmangia me çdo çmim çdo pengesë politike, komerciale, financiare ose ekonomike që kërcënonte të kompromentonte jetën e lirë dhe të pavarur, si dhe funksionet e shtetit. Për më tepër, unë do të kultivoja me këmbëngulje miqësinë me Fuqitë e Mëdha, duke mos patur asnjë interes vetjak dhe egoist për të nxjerrë në pah vetveten. Këto janë për mua disa prej detyrave më të rëndësishme dhe kërkesat më të qarta me të cilat ballafaqohet qeveria e Shqipërisë së Re.

Kjo qeveri përbëhej prej një regjence prej tre anëtarësh, një *Premier* me

një kabinet prej tetë departamentesh: Ato përbëheshin nga presidenti/kryetari i Këshillit, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Brendshëm, ministri i Financave, ministri i Punëve Publike, ministri i Ndërtimit dhe ministri i Luftës. Ishte po ashtu një Dhomë e Deputetëve me 93 anëtarë. Për regjentët, e tëra çfarë mund të thuhet për ta është se ishin burra me karakter të lartë dhe patriotë. Përveç nismës, ata bënë përpjekje të gjalla dhe krijuese për të kapur mundësinë strategjike që t'i provonin Lidhjes së Kombeve, simpatinë e së cilës ata e kishin, dhe tërë botës se Shqipëria nuk ishte ajo çfarë shkatërrimtarët e saj kishin thënë për të, por një komb i zoti për t'u bashkuar, për përparim, për ndërtimin e vetes brenda dhe jashtë, si një shtet i vyer, i vetëqëndrueshëm dhe i vetërespektueshëm.

Por, nga ana tjetër, tre regjentët ishin gati aq të pazotët për atë punë aq të rëndësishme, sa ç'mund të ishin tre gjyshe shqiptare të ardhura nga malet. Ata kishin përfituar shumë më tepër se ç'duhej nga politika turke, sipas motos 'asgjë mos bëj, dhe nëse bën diçka, bëje sa më keq, dhe mundësisht çdo gjë lëre për nesër'. Ata ishin të pashpresë për shkak të mangësive të tyre në kualifikimet më elementare që kërkonte detyra që kishin marrë në ato zyra. Metodrat, shpirti, ritmi i regjimit të vjetër turk me të cilin njësoj si muhamedanët, si të krishterët ishin mësuar nëpër zyra, pushonin si dorë e vdekur përmbi çdo departament të qeverisë. Pas zyrtarëve, aty ishte një forcë udhëheqëse e padukshme, pa forcën dhe miratimin e së cilës nuk arrihej asgjë.

Në qoftë se një i ri shqiptar donte të zinte një vend në administratën e shtetit shqiptar dhe familja e tij mund të grumbullonte pesëdhjetë napolona dhe t'ia jepte dikujt, ndoshta dikujt që nuk jetonte në Tiranë fare, por që dinte kombinacionin për të arritur deri aty ku duhej, atëherë ai ose ajo edhe mund ta merrte emërimin. Në rastin tim, m'u kërkua nga qeveria që të ndërtoja një kolegji bujqësor kombëtar. Në rastin më të mirë, ky ishte një pranim mirënjohjeje pa fund, pa asnjë lloj përfitimi për vete. Me shumë mirëkuptim qeveria tha se ajo nuk do të vinte para në këtë sipërmarrje për disa vite dhe kështu më duhej që të mblidhja para për tërë buxhetin e saj jashtë vendit, sigurisht që në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E ku

tjetër? E tëra që mund të na jepte qeveria, ishte toka.

Pasi kjo u la e tëra në duart e mia, u zgjodh toka, u premtua titulli i pasurisë, u përpilua kontrata dhe u miratua prej departamenteve sipas detyrave të tyre. Kaluan nëntë muaj derisa parlamenti dhe regjenca e miratuan, dhe kontrata përfundimtare m'u dha në dorë. Unë e dija për muaj të tërë se, po të vija pesëdhjetë deri në njëqind napolona tek një palë e caktuar, do ta kryeja atë punë në kohë. Një prej departamenteve më të rëndësishme të qeverisë (por jo ai i Ahmet Zogut) do të më jepte kontratën në dorë, thuajse menjëherë. Dhe ky ka qenë mallkimi i qeverisë shqiptare tërë kohën. Triumvirati i fuqishëm që fshihej pas qeverisë, ishte i mirënjohur nga çdo shqiptar. Vit pas viti dukej kjo tek dilte nga errësira dhe varfëria, për të zmadhuar pasurinë dhe pushtetin, dhe asgjë nuk bëhej për t'i shpëtuar kësaj të keqeje.

Njërit prej këtyre, ndërkohë që ishte ministër i Brendshëm, iu dha një shumë që ishte më shumë se pesë milion franga për ndërtimin e një hekurudhe nga Tirana në Durrës. Projekti u shty disa vite. Bëhej aq punë sa të mjaftonte për të përfituar shumën e duhur. Pasi kjo arriti përmasat e një skandali kombëtar që mbante erë të keqe aq sa të mund të shkaktonte revolucion, i tërë projekti u braktis. As një traversë nuk u shtrua, për të mos folur për shina. Aty-këtu mbetën shenjat e dheut të rrafshuar, punë të cilën një brigadë punëtorësh me një mjet automatik do ta kishte kryer brenda gjashtë muajsh.

Ndërtimi i rrugëve të Shqipërisë ishte një ilustrim i habitshëm i mënyrës së keqvlersuar rastësore me të cilën ishin bërë punët. Në qeveri kishte një grup të vogël të përbërë prej më të rinjve, të cilët ishin mësuar të takoheshin jozyrtarisht në njërën prej zyrave për të diskutuar problemet e tyre. Edhe mua më kërkohesh shpesh të merrja pjesë në ato takime.

Një mbrëmje po diskutonim problemin e rrugëve. Si mund të ndërtojmë 2000 kilometra rrugë, praktikisht pa patur as para, as makinë, as pajisje? Unë hodha një ide brilante për marrjen e disa inxhinierëve të huaj, të mirë, të kualifikuar

dhe disa ndërtues rrugësh për të inspektuar punimet. Ndërkohë që inxhinierët do të shqyrtonin shtrirjen e rrugëve, qeveria mund të bënte një regjistrim të forcës punëtore të vendit, burra, gra dhe kafshë pune nëpër fshatra. Me një aritmetikë të thjeshtë, inxhinierët do të llogaritin numrin e ditëve të nevojshme, sipas kilometrave që do të ndërtoheshin. Pasi të bëhej kjo, secilit fshat do t'i caktohej pjesa e vet e rrugës që do të bënte, të transportonin gurët, t'i thyenin ata, t'i shtronin dhe të përmbyllnin kryerjen e tyre nën mbikëqyrjen e inxhinierëve dhe inspektorëve të huaj. Kjo punë do të ishte kontribut i popullit pa pagesë, kundrejt përfitimit të pallogaritshëm që do të rridhte prej rrugëve. Plani u mirëprit në parim, pa shumë diskutime, por ajo që më habiti tmerrësisht, ishte se disa ditë më vonë, ministri i Punëve Publike kishte shkuar me nxitim në Itali dhe Austri për të mbledhur një numër inxhinierësh dhe inspektorësh për ndërtim. Afërsisht brenda dy javëve, tridhjetë prej tyre arritën në Shqipëri dhe për gjashtë muaj ata u bënë mysafirët e qeverisë, që u paguante rregullisht rrogat. Ata silleshin kot dhe, duke mos patur çfarë të bënin tjetër, e kalonin kohën nëpër kafene duke pirë birrë *Pilsen* dhe *Munih*, dhe duke luajtur tavëll. Shumica e tyre u kthyen në shtëpitë e veta me kohë, pa i zhytur asnjë ditë duart në dheun e Shqipërisë. E, megjithatë, rrugët u ndërtuan sipas atij plani dhe një prej kënaqësive të veçanta të jetës sime ishte kur i shihja fshatarët tek i ngarkonin vagonët e dekovilëve që i kishin braktisur italianët dhe austriakët gjatë Luftës Botërore, tek i shtynin me milje të tëra për tek vendi që u duhej atyre e që po ndërtonin. Urat ishin një çështje tjetër dhe kërkonin hekur, çimento dhe lëndë druri. Të tëra këto ishin materiale importi dhe të kushtueshme, në një kohë kur qeveria nuk kishte as para vendase, as kredi që vinin nga jashtë. Kështu që këta duhej të prisnin për materiale të tilla. Për disa prej këtyre, më të shtrenjtat ndoshta, pritej me vite të tëra. Kalimi nga një anë lumi në një tjetër mbetej përherë në varësi të lartësisë së ujit në vaun e tyre.

Më i madh se çdo problem tjetër, madje edhe i kombinuar së bashku me probleme të tjera, ishte problemi a çështja e financave. Në fund të fundit, ishte kjo që e çoi Shqipërinë të binte në krahët e Italisë. Çelësi për atje gjendet në

kronologjinë e ngjarjeve që pasuan nënshkrimin e *Traktatit të Vërsajës*, që mban datën e 9 dhjetorit 1920. Aty ka edhe këtë nen:

“Anglia, Franca dhe Shtetet e Bashkuara e ratifikuan mandatin e dhënë Italisë në lidhje me Shqipërinë”.

Në qoftë se dikush habitet me pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara në një rregullim të tillë, le ta japim këtu deklaratën e bërë prej sekretarit të Shtetit, Robert Lansingut:

“Me dëshirën tonë të mirë për të vepruar bujarisht, madje edhe më shumë se bujarisht, ne u hapëm udhë kërkesave të Italisë për një mandat të saj mbi Shqipërinë”.

Ndryshimet në formën e kësaj marrëveshjeje ishin bërë herë pas here për të konfirmuar hapat e ndryshëm nëpërmjet të cilave kalonte vetë problemi. Por, gjithmonë e pranishme ishte njohja e pozicionit dhe interesit të veçantë të Italisë, kryesisht kur fjala ishte për kontrollin prej saj të brigjeve të Adriatikut. Nëse kishte trazira të tilla që qeveria shqiptare nuk i kontrollonte dot, atëherë ajo mund t’i drejtohej Italisë për ndihmë. Nëse kufijtë e saj do të kërcënoheshin, përsëri do të ishte Italia që do të ndërhynte.

Lidhja e Kombeve u tregua aq e mirë, sa të emëronte një komision për të studiuar kushtet e Shqipërisë dhe për t’i raportuar ato. Për këtë u paraqit një raport shumë i mirë mbi gjendjen ekonomike, i cili iu paraqit Lidhjes. Por një borxh i kërkuar, bazuar në rekomandimet e saj, nuk u pranua. Kërkesa që iu paraqit Britanisë së Madhe, hasi në të njëjtën përgjigje dhe po njësoj edhe ajo ndaj Shteteve të Bashkuara. Parë në tërësi, del se një borxh i tillë ishte parashikuar prej kësaj marrëveshjeje të fshehtë t’i ngarkohej Italisë, në mënyrë që të justifikohesh një mandat moral mbi Shqipërinë, në mënyrë që asnjëra prej fuqive, dhe as vetë Lidhja, të mos arrinte të ndërhynte ndaj pozicionit të favorizuar të Italisë.

Në rrethana të tilla, ajo çfarë duhej të bënte Shqipëria ishte të qëndronte e shtrënguar në pozicionin e vet, dhe me kohë të vdiste nga uria; ose të pranonte

alternativën tjetër që ishte: për të shmangur kolapsin ekonomik dhe vdekjen nga uria, siç del qartë, t'i binte në gjunjë Italisë duke i kërkuar borxhe.

Për të kuptuar se sa shpejt dhe sa perceptueshëm Shqipëria ishte tërhequr në këtë rol poshtërues, le të shohim eksport-importin për tri vitet 1921, 1922, 1923:

| | | | |
|-----------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Importe: | 18 235 791 fr.ari | 12 099 516 fr.ari | 23 418 035 fr.ari |
| Eksporte: | 2 189 791 fr.ari | 2 961 995 fr.ari | 8 037 917 fr.ari |
| Deficiti: | 16 046.000 fr.ari | 9 137 520 fr.ari | 15 280 118 fr.ari |

Shuma e përgjithshme për të tri vitet ishte 40 463 038 franga ari. Kuptimi i thjeshtë i kësaj është që shuma e mësipërme ishte dërguar jashtë vendit në para të thata, në vend të kreditit për furnizimin me ushqimet e domosdoshme si grurë, pajisje të përgjithshme për të zëvendësuar ato që dy Luftërat Ballkanike dhe një Botërore kishin shkatëruar. Qeveria bëri përpjekje për të ruajtur bilancin import-eksport, duke vënë kufizime në çdo gjë, përveç gjërave më të domosdoshme. Në fakt, ajo që po ndodhte, po shkatërronte kombin m'u përpara syve. Qeveria nuk po arrinte të bënte diçka më të mirë. Më poshtë është bilanci i viteve 1922-1923:

| | Viti 1922 | Viti: 1923 |
|------------|------------|------------|
| Marrje: | 15 164.000 | 20 644 078 |
| Shpenzime: | 25 917 364 | 21 664 178 |
| Deficiti: | 753 364 | 1 020 100 |

Kjo shumë shtesë në deficitin tjetër prej 11 773 464 franga ari e çoi deficitin e përgjithshëm në 52 237102 franga ari. Përpjekje të dëshpëruara u bënë prej qeverisë për të balancuar buxhetin në mënyrë që t'i shpëtonin vasalitetit ekonomik nga Italia. Kjo gjë dukej pa rrugëdalje. Eksportet shkuan deri në atë pikë sa të hiqej nga goja buka, drithi, gruri, thekra, kafshët, pulat dhe vezët, djathi, vaji i ullirit dhe prodhimet e tjera aq të nevojshme për të ushqyer kombin, bashkë me eksportet e tjera si lëndë druri, lëkurë, lesh, etj.

Zyrtarëve qeveritarë iu zvogëluan rrogat, ndërkohë që doganat për çdo mall

të sjellë nga jashtë u rritën jashtë mase. Sikur nuk mjaftonin këto, vendin e përfshiu edhe një thatësi, e cila nuk la prodhim të piqej, duke e dobësuar edhe më shumë gjendjen financiare të kombit. Kështu, më në fund, si një domosdoshmëri e egër ndërsa vendi po ballafaqohej me urinë, erdhi ajo gjendje e paraparë që t'i kërkohet ndihmë Italisë.

Se sa e etur ishte ajo për të hyrë dhe për të marrë përgjegjësi, tregohet në ngjarjet që pasuan me shpejtësi pas kësaj. Kështu u negociua një borxh prej pesëdhjetë milion frangash ari, u themelua një *Bankë Shteti*, një *Shoqëri për Zhvillimin Ekonomik*, e institucionalizuar. Të gjitha këto u vunë tërësisht nën kontrollin italian, si për shembull, aksionet e bankës mbaheshin prej italianëve që llogaritnin 320.000 kundrejt 5 950 që mbaheshin prej shqiptarëve. Zyra e tyre ishte në Romë, drejtorët dhe menaxherët ishin pa dyshim italianë. Monedha metalike shqiptare e tërë parave që kishte, mblidhej dhe dërgohej në Romë. Një tjetër kompani zhvillimi u organizua nën drejtimin e hekurudhave shtetërore italiane.

Për kërkimin dhe shfrytëzimin e fushave të vajgurit dhe një territori prej pesë mijë hektarësh që u ishte dhënë atyre, ministri shqiptar që përfaqësonte qeverinë në këto transaksione, për shërbimin e bërë ndaj Italisë, thuhet se ishte rikompensuar me një pasuri të majme prej saj. Gjithsesi, ai e gjeti më të rehatshme për vete të hiqte dorë nga shtëpia e tij në Shqipëri, dhe shkoi të jetonte në Itali që prej asaj kohe e në vazhdim. Ky ishte fillimi i demoralizimit të Shqipërisë, i cili, në fund të fundit, i kushtoi asaj pavarësinë. Tek e fundit, shqiponja ende i kishte malet e saj. Të paktën, kjo ishte diçka.



KËTU VËRTET ISHTE NJË VEND I SHENJTË PËR KOMBIN, PËR KATOLIKËT, ORTODOKSËT, MYSLIMANËT, PROTESTANTËT. KJO VËRTET KISHTE RËNDËSI. PRANË VARRIT TË SË NDJERËS, BESIMET E NDRYSHME E GJEJNË VETEN TË BASHKUAR NË NJË FE TË VETME, NË NJË SHPRESË, NË NJË ZOT. “ZOTI DHE ATI I NE TË GJITHËVE, I CILI ËSHTË MBI TË GJITHË DHE BRENDA NESH, TË GJITHËVE!”. ¹¹⁴



¹¹⁴ Fragmente të këtij kapitulli janë botuar në vëllimin e parë të kësaj serie. Kjo pjesë po ashtu është lënë edhe në këtë vëllim për të dëshmuar vazhdimësinë e kërkimeve dhe studimeve të Ericksonit si dëshmitar i gjallë i asaj që ndodhte në Shqipëri.

XXII



AHMET ZOGU

“Zog”, siç dihet tashmë nga të gjithë, është fjala që ka kuptimin e shpendit. Për t’i dhënë kuptim edhe më të qartë shqiponjës, ky emër duhej të ishte *shqiponjë*.¹¹⁵ Megjithatë, është një emër malor dhe shpendi i maleve shqiptare është shqiponja. Dhe Ahmet Zogu është në çdo centimetër që ka lëvizur në jetën e tij, burrë i maleve. Kryelartësia e tyre, rreptësia, veçimi, mëvetësia, qetësia e kanë bërë një pjesë të qenies së tij më të vrazhdë. Ai është kryelartë si malet ku u rrit, përballë çfarëdo gjëje që fati mundi t’i ofrojë. Vetëm një herë e kam parë atë kokë burri të ulej, të ligështohet. Kjo ndodhi kur e ëma e tij, Sadije Zogu, ishte e shtrirë në varrin e saj në kodrat që vështrojnë Tiranën nga lart.

Ai lindi në fshatin Burgajet, lart mbi lumin Mat. Ishte data 8 tetor 1895. Dhjetë vjet më vonë i vdiq i ati, duke e lënë Sadijen me tetë fëmijë, gjashtë vajza e dy djem. Ahmeti ishte më i riu i të gjithëve. Xhelali ishte një njeri i thjeshtë, që kurrë nuk luajti ndonjë rol të rëndësishëm as në jetën e familjes, as në atë

¹¹⁵ Shqip në original.

të kombit. Sadija kishte lindur në një familje të lartë nga dera e Toptanëve të Tiranës. Tani, si kreu i shtëpisë, ajo bëhet edhe kreu i fisit të Matit. Kështu edhe pa kurorën e mbretëreshës, pa salltanetet e madhëstninë, pa pasuri a diçka prej cohavë të kostumeve solemne që tregojnë forcën e autoritetit, ajo i bëri ata burra gjysmë të egër të maleve të përkuleshin përpara fisnikërisë së dukshme të karakterit të saj. Proverbi që shërbeu si çelës ndaj skamjes krenare të shtëpisë së tyre malore, të kullës apo të kështjellës, sepse e tillë qe ajo, ishte:

Nëse ju pyet nëna “çfarë kishit për shtroje?” – përgjigjuni: “Dheu është shtroja ime, guri është nënkresa”.

Nuk ka nevojë ta komentojmë këtë figurë. Me një rrogoz prej hasre dhe një velenxë prej leshi me thekë dhie përsipër, këta njerëz të maleve flinin thuajse me rrobat e ditës, me armët gjithmonë pranë vetes. Për një shtëpi begu, duhej të kishte roje nate në detyrë, jeta e të cilëve ishte pengu i besnikërisë. Muret ishin prej guri një metër të gjera dhe tejet të larta, të ngjitura në kënde të tilla që parandalonin çdo qasje ndaj ndërtesës ku ishin pushkët. Furnizimi i përshtatshëm për ta nuk mungonte kurrë. Mauzeri shqiptar dhe mjeshtëria e përdorimit ishte siguria më e madhe për jetën e tyre dhe të familjes. Pastaj vinte racioni i ushqimeve të ushtarit, i cili ishte po aq i rëndësishëm sa edhe ushqimi i familjes. Buka e ashpër e misrit që ishte bluar në mullinjtë e malësisë, i përzier me ujë, por pa kripë, ose me mungesë tharmi, ishte pjekur në çerapë të mëdhenj dhe saçe të mbuluara me prush. Për një ditë të madhe feste, ata do të piqnin një qingj ose dele.

Nëse do kishte perime dhe “mish me kos”,¹¹⁶ me qumësht të thartë dhe vezë, do të shërbehej në të njëjtën mënyrë. Një sofër e madhe vetëm një këmbë mbi tokë vihet në mes të odës, ndërsa e tërë familja ulet këmbëkryq, me ushqimet të vëna në qendër, ku secili merr pjesën e vet. Kosi hahej të paktën një herë në ditë, ndonëse në malësi kjo nuk ishte krejt e mundur. Mëngjesi përbëhej nga një kafe turke dhe një cigare të dredhur me duhan të vendit.

¹¹⁶ Shqip në original.

Në shtëpinë e një parie siç ishte ajo e Ahmet Zogut, udhëheqësit e fiseve shkonin e vinin. Po ashtu pleqësia e fshatrave të ndryshme, shërbyes, zyrtarë të qeverisë. Selamllëku në të cilin mbaheshin këto takime, ngjante me sallat e mëdha mesjetare të baronëve dhe kalorësve. Këtu mund të gjendej një grup bejlerësh të ulur në një divan të zgjatur sa vetë gjerësia e dhomës. Secili prej tyre sillte lajme të reja nga zona e vet, me rëndësi kombëtare apo edhe nga bota. Sepse aty kishte njerëz që udhëtonin dhe që lexonin lajmet e botës në disa gjuhë. Ditën e pazarit, kur fshatarët nga të gjitha pjesët e rajonit bashkoheshin, mund të shiheshin qindra syresh të ulur në tokë, duke përpirë çdo fjalë të asaj që thoshin bejlerët, që pastaj t'i merrnin me vete në fshatrat e tyre malore e të largëta. Mikpritësi duhej ta priste secilin prej parisë në këmbë, duke i takuar faqe më faqe dhe duke i përcjellë njëherazi ritualin e përshëndetjeve:

Mirë se vini, si jeni, si e keni familjen, si ju shkoi udhëtimi, a u lodhe, etj., etj.? Përgjigjet mund të ktheheshin me fjalë të tilla si, *mirë*, por këto përshëndetje të para mbartnin sigurimin e qetësisë që çdo gjë ishte në rregull. Vetëm tërthorazi mund të mësohej më vonë se çfarë peshe të dyfishtë apo trefishtë mbartte miku. Përgjatë çdo dite, me këto takime jozyrtare dhe me sistemet e mrekullueshme të “përhapjes së lajmit gojë më gojë”, çka mbulonte zona të tëra të vetmuara të maleve, këta pjesëtarë të parisë dinin jo vetëm për ngjarjet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare që ndodhnin aty pari ose nëpër botë, por edhe çdo rast sëmundjeje njerëzore në shtëpitë dhe bashkësitë mbi të cilat ata ushtronin zotërimet e tyre. Kur këta bejlerë shkonin diku, ata kurrë nuk shkonin vetëm, por gjithmonë me një gardë të armatosur rëndë, ose ndoshta një dyzinë burrash. Zakonisht ata kishin objektiva politike në mendjet e tyre. Kjo kurrë nuk ishte thjesht për shlodhje apo kënaqësi, veç nëse ishte rast fejeje, martesë ose festë e të krishterëve ose muhamedanëve.

Ajo që binte në sy ishte se vizitorët ishin të feve të ndryshme. Po ashtu, ata shkëmbenin vizita tek njëri-tjetri në çdo rast feste fetare për të dyja palët. Të krishterët vizitojnë miqtë e tyre muhamedanë për festën e Bajramit dhe këta të fundit i vizitojnë shokët, miqtë e tyre për festat e Krishtlindjeve dhe Pashkëve. Në

të tilla raste çdo gjakmarrje ndërpritej, dhe dy burra që mund të ishin në gjak, nëse ndodhte të takoheshin, e trajtonin njëri-tjetrin si miq.

Disa herë një rast i tillë do të shfrytëzohej prej një ndërmjetësi për t'i dhënë fund një gjakmarrjeje që qëndronte gjatë pa u kryer, ndoshta edhe duke ndërmjetësuar një fejesë të një djali apo vajze nga ana tjetër, për t'i miqësuar palët, ndërsa prisnin të vrisnin njëri-tjetrin.

Djalëria e Ahmet Zogut kaloi në një mjedis si ky që u përshkrua më lart. Krejt i vetmuar, pa një kuptim social dhe pa nxitje politike, veç të tjerash edhe për arsye se i ati nuk jetonte. Në moshën katërmëdhjetë vjeçare ai u dërgua në Stamboll për të studiuar. Aty kaloi katër vjet. Vite përshtypjelëse, gjatë të cilave djali që po rritej bëri të vetat jo vetëm idealet, doktrinën, parimet, mësimet e dhëna nëpër xhami, por përtej tërë këtyre dhe me rëndësi më të madhe, tërë panoramën shumëngjyrëshe të botës myslimane. Ajo çka ishte Jeruzalemi për hebrejtë, ishte Stambolli për myslimanët. Një qytet i shenjtë, vend i fuqisë së jashtëzakonshme dhe të gjithanshme shpirtërore.

Gjithsesi, ishte gjithmonë dikush që e ruante atë të mos i dorëzohej kësaj ideologjie dhe të mos hiqte dorë nga nacionalizmi dhe forca e karakterit të tij shqiptar, siç kishin bërë shumë bashkatdhetarë të tjerë. Kjo ishte nëna e tij. Ajo ishte mishërimi i një grupi tjetër idealesh, më të vjetra, madje shumë më të vjetra se ato muhamedane ; ajo kishte ushtruar autoritet dhe kontroll mbi jetët, mendimet, zakonet, idealet e këtyre fiseve malësore, shumë më reale dhe më imponuese se çdo fe tjetër apo forcë e jashtme.

Edhe pse aq e gjatë dhe e pamëshirshme, nata e errët osmane e kishte mbajtur shqiptarin, në përpjekjet e tij për t'u mbrojtur, të ngjitur pas idealeve të tij racore, pas normave të veta, ndërkohë që shtete të fuqishme, perandori, qytetërime, fe, ishin zhdukur sikur i kishte rrëmbyer batica e oqeanit. Për ata burra të maleve, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, disa herë i quajtur thjesht *Kanuni i Maleve*, i kishte shërbyer të njëjtit qëllim, ashtu siç kishte bërë *Ligji i Moisiut* për hebrejtë. Për këtë kishte nene

të cilat kurrë nuk mund të shkeleshin ose të harroheshin.

Neni i parë ishte: Nëse dikush fyente ose vriste një malësor që ishte marrë në besë, atëherë ai që e kishte marrë në besë ishte i detyruar me kanun të merrte hak për shkeljen e nderit të mikut. Nëse ai që e ka marrë në besë vritet, atëherë është familja e tij që e bën këtë, ose nëqoftëse ata nuk janë të zotët ta bëjnë këtë, është fisi që e merr një detyrë të tillë. Pikërisht këtu gjendet përgjigjja se përse shqiptari e çmon betimin e tij, fjalën e tij të nderit, besën e tij, më shumë se sa jetën e vet, duke përfshirë jo vetëm veten, por edhe familjen dhe fisin e tij.

Përsëri, se sa larg shkonin këto ligje, e gjejmë në nenin tre, i cili thotë: Një personi që shkon në një udhëtim malor, i duhet vetëm të hapë zjarr në ajër me armën e vet dhe me zë të lartë të shqiptojë emrin e mbrojtësit të tij që e ka marrë në besë, që pakti i tij të bëhet i vlefshëm për tërë udhëtimin e tij. Kushdo që mund ta dëmtojë atë me qëllim, ose ta vrasë, prej atij akti bie në gjak me mbrojtësin e këtij njeriu.

Një ligj tjetër e bën mbrojtjen e fisit dhe të shtëpisë të detyrueshme për çdokënd. Askush nuk përjashtohet pa arsye të forta nga kjo dhe, nëse dikush përpiket të fshihet ose të arratiset, jo vetëm që do të gjobitet me 30.000 piastra që duhen paguar nga familja e tij, por e tërë familja, duke përfshirë prindërit, janë të detyruar ta zëvendësojnë atë në shërbimin ushtarak për aq kohë sa zgjat lufta.

Një tjetër ligj i çuditshëm është ai i katërmbëdhjeti: Kushdo që godet një grua, e rreh ose e plagos atë, duhet trajtuar si vrasës. Ajo që të habit me një ligj të tillë të detyrueshëm prej dëshirës dhe vetëdijes së kombit, është se gruaja shqiptare është më e sigurtë në nderin dhe personin e saj në malet e egra dhe të ashpra të Shqipërisë, sesa është graria thuajse në çdo vend tjetër të botës. Jo vetëm ajo, por zona e sigurisë që e rrethon një grua është po ashtu e vlefshme edhe për këdo që e shoqëron atë. Një armik me të cilin dikush është në gjak për vdekje, dhe që e takon në ndonjë prej shtigjeve të këtyre maleve të larta, nëse ai do të jetë në shoqërinë e një gruaje, atëherë është i imunizuar dhe as që mund të ceket sado pak ; ndaj tij

personi, në këtë rast, s'mund të marrë hak. Ndodh shpesh që një grua të caktohet si ndërmjetëse midis dy armiqve, për shkak të pacënueshmërisë së saj. Ajo që më ka mrekulluar më shumë me atë që më pat thënë Ahmet Zogu, kur këmbënguli edhe një herë që të punoja për të hapur një shkollë për trajnimin e vajzave shqiptare, ishte kjo shprehje e tij:

“Nuk ka komb që ngrihet më lart sesa graria e vet”.


Dhe unë e mora si një sinjal nderi, kur ai shtoi këto fjalë:

“Nuk ka tjetër njeri që të jetë më i zoti se sa ti për t'i hyrë një pune të tillë si kjo”.


Ajo që më mrekulloi, gjithashtu, ishte se kur nëna e tij vdiq krejt papritmas, ai, mbreti i Shqipërisë, pësoi një panik, zemërthyerje, dëshpërim të tmerrshëm prej djali që ka parë dritën, lavdinë dhe krenarinë e jetës së vet nëpërmjet saj, dhe pastaj e gjen veten të tronditur në natën më të errët të vetmisë.

Ka edhe një ligj tjetër të këtyre maleve që duhet të përmendet e që ka të bëjë me *mikpritjen*. Ai ligj mbron jetën dhe sigurinë e çdo personi, madje edhe të një të huaji ose të panjohuri që troket në shtëpinë e shqiptarit. Mjafton kjo, dhe i zoti i shtëpisë menjëherë merr çdo përgjegjësi për mikun. Ai nuk është përgjegjës vetëm për sigurinë e mikut, por ai nuk mundet as ta dorëzojë atë, veç nëse ka shkelur ligjin.

Një prej këtyre ligjeve mund të gjurmohet thellë në ditët e Homerit, kur Penelopa, bashkëshortja e Odisesë, mbretëresha e Itakës, nuk mund t'i kthente mbrapsht shumë mëtonjës, të cilët kishin kaluar vite në pallat si mysafirët e saj, duke i ngrënë asaj gjithçka që kishte, duke korrptuar mbajtësit e shtëpisë dhe duke dhënë urdhëra, sikur të ishin ata, jo ajo, pronarët e pallatit. Meqë jemi këtu, emri i Penelopës, në këtë gjuhë të lashtë do të thotë *pen-e-lype*.



GJATË TRIDHJETË VITEVE TË PUNËS DHE JETËS SIME NË
SHQIPËRI JAM PËRPJEKUR TË RRËNJOS TEK KËTA NJERËZ
KRENARI PËR ATË ÇFARË ATA JANË NË RACËN E TYRE, PËR ATË
QË KANË ARRITUR NË HISTORINË E TYRE.



XXIII



RRUGA DREJT TRANSFORMIMIT

*Kushdo që ngjitet në majat e maleve, kurorë,
Kreshtat do t'i gjejë të mbuluara me re dhe dëborë;
Ai që prej andej njerëzimin fyen, poshtëron,
Urrejtjen e njerëzve atje poshtë, vështron.*

Një e metë e madhe që e karakterizon shqiptarin, është se ai është një njeri vetanak. Ai dëshiron të jetë përherë i pari. Shumë njerëz të kësaj race ia kanë dalë të bëhen udhëheqës të mëdhenj dhe zotër të padiskutueshëm. Aleksandri i Madh, Diokleciani, Konstandini i Madh, Justiniani, Skënderbeu... Historia e kësaj toke të palumtur mund të kishte qenë shumë e ndryshme sikur njerëzit e saj të mos kishin pasur atë të metë në strukturën e tyre racore. Humbja kohët e fundit¹¹⁷ e pavarësisë së vendit mund t'i atribuohet pikërisht kësaj. Si gjithmonë, aty ka pasur pseudo-udhëheqës të cilët, kur vinte puna tek hapja përfundimtare e letrave, ishin

¹¹⁷ Libri është shkruar pas pushtimit fashist italian të Shqipërisë.

të gatshëm të sakrifikonin vendin e tyre për vendet tjera, me qëllim që të rrëzonin kundërshtarin dhe të shijonin ëmbëlsinë e pushtetit dhe të autoritetit për vete.

Ahmet Zogu e dinte se çfarë mendonin dhe çfarë thoshin për të. Sipas disave, ai ishte një turk, një reaksionar, një njeri me mentalitet dhe sjellje mesjetare, i cili nuk kishte asnjë interes për përparimin modern. Ai ishte gegë, verior, dhe toskët e jugut e quanin të tillë, duke shfaqur një armiqësi të thellë, pa pasur ndonjë argument tjetër kundër tij. Shpesh jam përpjekur edhe drejtpërdrejt, edhe nëpërmjet miqve të mi, edhe nëpërmjet kanaleve diplomatike të ndryshoja atë çka ishte aq shumë e rrezikshme bash për ekzistencën e vetë shtetit shqiptar. Këta toskë që e mbështetën revolucionin e peshkopit Noli, ishin burra që, në fund të fundit, besonin se ata vetë ishin modernë, njerëz të shekullit të njëzetë. Mijëra syresh kishin vajtur në Amerikë dhe megjithëse pak prej tyre kishin rënë ndonjëherë në kontakt vetjak me kulturën amerikane, ata kishin përvetësuar diçka prej shpirtit amerikan dhe ishin të etur ta shihnin mëmëdheun e tyre tek merrte rrugën drejt një shteti modern sa më shpejt të ishte e mundur. Idetë, planet, ëndrrat e tyre ishin padyshim shumë të përziera. Ata nuk i kishin vlerësuar të vërtetat prej vargjeve të Bajronit:

*“Një mijë vjet mezi mjaftojnë, një shtet për të formuar,
Por veç një orë ta shtrijë atë për tokë, në dhé të pluhëruar”.*

Ata ndoshta në mënyrë naive besonin se ishte gjë e lehtë shndërrimi i kushteve primitive, fizike a shpirtërore qofshin, në ato moderne, siç ishte zëvendësimi i kalit menjëherë me aeroplanin apo karrocave e qeve që i kishin shërbyer nevojave të tyre për tre mijë vjet, me makinat.

Ata besonin se Ahmet Zogu ishte njeri i rendit të vjetër dhe se asnjë përparim qenësor nuk mund të bëhej nën pushtetin e tij. Kjo është arsyeja përse u organizua revolucionin, i cili e detyroi atë të ikte jashtë vendit. Vitet e mëvonshme treguan se ata ishin gabim, të paktën pjesërisht, sepse vendi ka bërë përparim qenësor nën drejtimin dhe kontrollin e tij. A do të funksiononte një koalicion i gjerë? Kjo është tejet e vështirë të thuhet.

Mund të thuhet vetëm se pikërisht këtu fillon edhe tragjedia. Sepse fara e mbjellë e atij revolucionit dhe çështjet që ai ngriti, e thelluan ndarjen midis veriut dhe jugut, midis progresistëve dhe konservatorëve. Kjo ndarje solli lindjen e atyre frutave që u rritën në formën e humbjes së vendit të tyre në favor të italianëve. Se cili do të jetë fundi, do të shohim. Por le të kthehemi tek një studim i mëtejshëm i figurës së Ahmet Zogut si burrë dhe si mbret.

Për të kuptuar qëndrimet e tij ndaj ndryshimeve dhe progresit, na duhet të bëjmë disa ilustrime. Në një mbrëmje të marsit 1922, Ahmet Zogu, Mehmet Konica, ministër në Britaninë e Madhe, që ishte kthyer me leje në shtëpi dhe unë vetë, po shëtisnim në rrugën kryesore të Tiranës. Arritëm në sheshin ku më vonë u ndërtuan ndërtesat qeveritare.

Mbi një pjesë të gjerë të kësaj hapësire të lirë shtrihej një varrezë myslimane. Jo vetëm fakti që ajo ishte në qendrën e biznesit të kryeqytetit të Shqipërisë, aty ku nuk duhej të ishte, por ajo ishte edhe një pengesë e madhe për sytë e njerëzve në atë vend ku gjendej. Bimët e këqija, të stërzgjatura, të pakorrura që prej më shumë se një viti, të ndërthurura me gurë varri të shpërndarë aty këtu, e bënin atë edhe më të padëshirueshme.

Në një cep të asaj varreze gjendej një pellg i madh me ujë dhe baltë, në të cilin lahashin disa pata. Papritmas, që nga matanë një muri të ulët, në një pus publik, vëmendjen tonë e tërhoqi një grua që po nxirrte ujë për përdorim shtëpiak, si gatim, larje, pirje apo ndonjë gjë tjetër. Aty-këtu kishte plehra të bëra kapicë, të derdhura nga dyqanet aty pari, mbeturina nga tregu publik që fermentoheshin, që kombinoheshin me vetë varrezën. Unë u kërkova shoqëruesve të mi të ndalonin. Pastaj, sapo u ndalëm dhe qëndruam pranë murit të asaj varreze, u dhashë atyre një mendje si më poshtë:

“Ju doni ta shihni Shqipërinë të bëhet shtet modern, apo jo? Çfarë do të bëni me këtë? Ky është një turp për çdo lloj qytetërimi. Dhe e keqja më e madhe në këtë rast, kjo është e dëmshme për shëndetin e njerëzve. E shihni atë grua që po

nxjer ujë nga pusi? Prej nga vjen ai ujë? Prej këtyre varreve që mbajnë mish dhe kocka të vdekurish. Nuk ka dyshim që njerëzit sëmuren prej kësaj. Po ato rosa në pellg? Është vendi më i mirë për të rritur ato mushkonja që mbartin mikrobe vdekjeprurëse në gjithë qytetin. Prej tyre burrat, gratë dhe fëmijët sëmuren dhe humbin gjallërinë e tyre ose mbushin këto varreza”.

Kur e mbarova fjalën, Ahmeti tha përafërsisht këto fjalë:

“Ju keni të drejtë që flisni kështu, por kjo është varrezë myslimane dhe ju, besoj, e dini se çfarë do të thotë kjo. Çdo mysliman në Tiranë do të merrte armët nëse do të ndërhynim mbi këto trupa, të cilët, në besimin e tyre, presin Profetin për ringjalljen e tyre përfundimtare”.

“A mos po më thoni se ju nuk bëni dot asgjë në lidhje me këtë? Ju, kreu i ushtrisë! Ju që keni mposhtur një revolucion? Unë po ju them se ju kurrë nuk do ta bëni Shqipërinë një shtet modern nëse nuk do t’i pastroni këto varreza të vjetra, jo vetëm këtu në Tiranë (më vonë mësova se kishte shtatëmbëdhjetë të tilla), por në tërë Shqipërinë”, i thashë unë.

“Po çfarë do të bënit ju me to?”, më pyeti ai.

“Pastrojani këtë, nivelojani dhe bëjeni treg publik për njerëzit që t’i bëni të rrinë rehat. Atë që është pranë ndërtesës së Parlamentit, kthejeni në një kopsht bashkiak, mbillni lule dhe bëjeni vend shëtitjesh dhe vend ku të luajnë muzikë orkestrat. Silleni grupin muzikor të Korçës për koncerte publike ku të kënaqen njerëzit”.

E kisha fjalën për atë grup muzikor që kishte vajtur deri në Boston, i ftuar dhe i drejtuar prej një shqiptari që luante në orkestrën simfonike atje. Në kohën kur po ndaheshim, u tregova se si ministri amerikan,¹¹⁸ vetëm një javë më parë i kishte dërguar një raport qeverisë amerikane ku shprehej me hidhërim për kushtet e jetesës, të cilat i konsideronte të padurueshme, në kryeqytetin shqiptar. Prandaj

¹¹⁸ Ministër emërtohej kreu i legatës amerikane në Tiranë, i barabartë me postin e ambasadorit të sotëm.

kërkonte leje pa të drejtë rroge.

Pas kësaj ne u shpërndamë. Në ikje, ai më tha:

“Do të mendohem për këtë dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë. Dy ditë më vonë u lëshua një shpallje drejtuar popullit të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, ku urdhërohej që tërë varrezat brenda vijave të qytetit të prisheshin menjëherë. Rregullat e shëndetit nuk lejonin që të vdekurit të jetonin në mes të të gjallëve. Prandaj të gjithë të vdekurit duhej të ishin në një largësi të arsyeshme me kufijtë e qyteteve. Duke mos pritur reagimin e njerëzve, ai nxori dyqind të burgosur nga burgjet e Tiranës, burra të cilët kishin marrë pjesë në rebelimin e fundit dhe i vuri të punojnë në atë varrezë të veçantë. Sugjerimet e mia ishin marrë parasysht dhe vite më vonë, aty mbreti bëri një kopsht shumë të bukur përpara Pallatit të tij. Tregu publik, fillimisht i ndërtuar në truallin e varrezës, më vonë u hoq edhe prej aty. Vendin e tij e zunë ndërtesat qeveritare.

Në të njëjtën shëtitje të paharrueshme, ne vumë re disa gra myslimane me fustane të zeza të shëmtuara, ferexhe që nuk u linin atyre asnjë vend të pambuluar.

“Aty, trupi mbulohet prej djallit dhe ne, nëse do të bëhemi ndonjëherë shtet europian, duhet ta zhdukim menjëherë”, tha Ahmeti.

“Do të nxjer një dekret që i detyron gratë e vendit tim t’i heqin ferexhetë brenda një viti”.

Ndjeva një reagim instinktiv ndaj atij vendimi të menjëhershëm të tij, ndaj i thashë:

“Më mirë jepu atyre pak më shumë kohë që të kuptojnë. Nuk ka asnjë dyshim se një e keqe si kjo nevojitet të hiqet qafe një orë e më parë. Por si ta bëjmë këtë brenda një viti? A nuk është shumë shpejt? A nuk përbënte kjo një rrezik shumë të madh për jetën shoqërore të grave shqiptare? A duhej marrë parasysht fakti se kjo mënyrë veshjeje mbështetej prej shtatëdhjetë për qind të kombit? Pra, si do të

hiqej ferexheja brenda një viti? Më mirë t'i lihet më shumë kohë. Atëherë, më mirë themelo shkolla për vajzat dhe organizata për gratë dhe, shkallë-shkallë, përgatituni për zakonet dhe idetë moderne”.

Pas disa çastesh heshtjeje mendimtare, ai u përgjigj:

“Keni të drejtë, por ne duhet të punojmë menjëherë për t'i përgatitur ato për ndryshime”.

U deshën dhjetë vjet deri sa për këtë doli dekreti, por gjatë kësaj kohe gratë zhvilluan jetën e tyre shoqërore deri tek ajo pikë për të cilën, në fakt, ato nuk ishin të përgatitura, por që e kërkonin në emër të jetës së tyre. Vajzat tani shkonin në shkolla publike, ndërsa koha kur atyre u kërkohej me patjetër të mbulonin fytyrën, kishte kaluar qysh kur. Në vend të kësaj, ato loznin basketboll me kilota, bënin gjimnastikë, mësonin vallëzim me fustanë të shkurtër dhe u kthyen në vajza perëndimore thujse menjëherë. Pikërisht falë kësaj periudhe tranzitore, kur doli dekreti, nuk pati krizë emocionale, siç ndodhi në Turqi, për shembull, ku një dekret i tillë, i lëshuar pa paralajmërim, gati sa nuk solli gjëmën për gratë e vendit. Për ngritjen e nivelit të edukimit të grave bashkë me Ahmet Zogun, paralel me kolegjin bujqësor të Kavajës ngritëm edhe atë të vajzave.¹¹⁹

Po le ta zëmë se Ahmet Zogu kishte patur shumë për të bërë, por që nuk i bëri, sikundër ka shumë gjëra që i bëri, por që nuk duhej t'i kishte bërë. Të tëra këto vetëm sa e bëjnë atë më njerëzor, e vendosin atë në të njëjtin klas të cilit ne të gjithë i takojmë dhe që e gjejmë në fjalët universale të *Kishës Katolike*:

“Ne kemi lënë pa bërë ato gjëra që duhej t'i kishim bërë dhe kemi bërë ato gjëra të cilat nuk duhej t'i kishim bërë”.

Ai mund të kishte kundërshtuar vënien e vendit të tij nën vasalitetin financiar të Italisë. Por, cila do të ishte e kundërta e kësaj? E kundërta do të ishte vuajtja e jashtëzakonshme, varfëria, mungesat e tmerrshme dhe një pengesë, një barrierë që

¹¹⁹ Historia se si u ngritën këto shkolla gjëndet e plotë ne volumn e parë të këtij botimi.

pengonte çfarëdo mundësie drejt progresit. A do të justifikohet kjo? E kush mund ta thotë këtë?

Ai mund t'i kishte prekur pasuritë e patundshme të bejlerëve dhe t'ua jepte njerëzve me familje dhe ngastra të vogla. Por, pa fonde qeveritare për subvencione për ata që nuk kishin asgjë, as edhe një ka apo gomar, as një thes me farën e drithit apo shtëpi me ushqime, a do të ishte kjo gjëja që duhej bërë? A nuk do të ishte uria, kaosi, revolucioni, fundi i një eksperimenti të tillë? Por mund të thuhet se për sa kohë ai i kishte paratë e Italisë, përse nuk i përdori ato për qëllime më të frytshme?”.

Përgjigje: Ato para nuk ishin të tijat, as të qeverisë shqiptare. Kontrolli mbi to ishte përherë, në një mënyrë ose në një tjetër, në duart e Italisë. Prandaj ato shpenzoheshin për ndërtim rrugësh ushtarake deri në kufi, shpenzoheshin miliona për ndërtimin e gjireve detare dhe fushave të aviacionit për aeroplanët italianë. Ai mund të kishte hequr qafe batakçinjtë, ryshfetçinjtë, të pastronte shtëpinë, të vintë vulën e ashpër të integritetit dhe ndershmërisë skrupuloze mbi fondet, sikur ato të ishin nën kontrollin e tij.

Bajroni, i cili citohet në krye të këtij kapitulli, dinte diçka për zemërimin që kthehet në urrejtje dhe kjo e fundit në vuajtje dhe plagë që mundonin mendjen dhe shpirtin. Të mos harrojmë se ai i takonte racës angleze, e cila krenohet për tolerancë dhe njohje të menjëhershme të gjenisë dhe vlerës. Një situatë tërësisht e ndryshme gjendet në Shqipëri, ku instinktet më të fuqishme primitive të krenarisë, xhelozisë, urrejtjes, hakmarrjes janë njësoj si shumë armë të vendosura në duart e tyre për të nxitur krenarinë e familjes dhe fisit.

Ai që lë pas vetes,

Ose e mposht njerëzimin,

Tek urrejtja e atyre poshtë,

Le të hedhë vështrimin.¹²⁰

¹²⁰ Xhorxh Gordon Bajron

Kjo reflekton si një pasqyrë kushtet raciale që ekzistonin dhe kanë ekzistuar përherë midis “*Bijve të Shqipës*”. Konstandini i Madh, i cili luftoi për epërsi pushteti mbi pesë vëllezërit e tij, ku secili luftonte për të kapur kreun më të lartë të Perandorisë Botërore, është përsëritur, ndonëse në një shkallë të zvogëluar, në këto vite të vona në Shqipëri.

Duke i përmbledhur këta dy kapituj për Ahmet Zogun, do të thoja se tri arritje të mëdha të tij duhen nxjerrë në pah patjetër:

Së pari, ai e mbajti Shqipërinë shqiptare. Pas kaq shekujsh robërie, shtypjeje, ngecjeje ekonomike, të mbytur prej *yasakut* të turqve, në tërë përpjekjet e shqiptarëve drejt rritjes, progresit, bashkimit racor, menjëherë sapo ajo fjalë të hiqej nga përdorimi dhe kombi të lihej i lirë të ndiqte rrjedhën e tij, do të lindte shqetësimi se mos rندهj rrëmujshtëm, lesh e li, drejt rrugëve perëndimore, zakoneve, veseve dhe vanitetit. Fakti që nuk ndodhi kështu, i duhet ditur për nder vetë mbretit Zog. Ai qëndroi fuqishëm kundër këtij dorëzimi, kësaj hedhjeje tutje të vlerave racore të kombit të vet, të cilat e kishin bërë *shqiptarin*¹²¹ të famshëm në çfarëdo sfondi apo paraqitjeje në rrjedhën e më shumë se dy mijë vjetëve të historisë.

Me rastin e festimeve të njëzet e pesë vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë që u mbajtën në kryeqytetin shqiptar, karakteristika më e veçantë, më përshtypjëlënëse dhe më kuptimplote mbi të gjitha ishin kostumet kombëtare të veshura me porosinë e mbretit. Njësoj ishin veshur edhe aristokratët, edhe fshatarët gjatë asaj jave festimesh. Unë i kujtoj tërë ato gra të bukura shqiptare, që nga princeshat deri tek fshataret më kokulura, të veshura me kostume kombëtare tek lëviznin midis uniformave magjepsëse të diplomatëve, krahu zburimeve të ndërtesave moderne qeveritare, flamujve, banderolave që i jepnin kësaj skene një pamje të jashtëzakonshme. Bashkë me ta ishin fëmijët e shkollave, djem e vajza, të ardhur prej të gjitha anëve të Shqipërisë, secili i veshur me kostumin e fisit të vet, që e dallonte atë në çfarëdo lloji shoqërie që të gjendej. Kjo ishte pamja më magjepsëse

¹²¹ Shqip në original.

që unë kam parë ndonjëherë në jetën time. Gjatë tridhjetë viteve të punës dhe jetës sime në Shqipëri, jam përpjekur të rrënjos tek këta njerëz krenari për atë çfarë ata janë në racën e tyre, për atë që kanë arritur në historinë e tyre.

Unë i kam paralajmëruar ata që përkrah besimit tek qytetërimi ynë perëndimor, kurrë të mos hedhin tutje traditën e tyre aq të vyer. Unë ngurroj të mendoj se çfarë mund të kishte ndodhur sikur shqiptarët tanë në Boston, Worcester dhe Framingham ta kishin patur mundësinë dhe forcën për të formësuar fatin e kombit të tyre në këto njëzet e pesë vitet e fundit? Siç duket, barrierat e lashta janë ende të ngritura për mbrojtjen e kombit, moralisht, shpirtërisht, por edhe politikisht, madje edhe ashtu siç ishin gjatë katërqind e pesëdhjetë vjetëve nën pushtimin turk. Kjo nuk do të jetë detyrë e lehtë për Zotërit e tyre të rinj, me dëshirat e tyre të çmendura për ta ndryshuar popullin shqiptar nga tradita e tij dhe për ta sjellë tek një natyrë sjelljeje fashiste.

Arritja e dytë e jashtëzakonshme e sundimit të mbretit Zog janë rrugët që ai i ka ndërtuar në të tëra anët e mbretërisë së tij. Le ta zemë se ato i shërbyen qëllimeve ushtarake. Por ato kanë shërbyer shumë më tepër se ç'mund të mendohet. Në kohët e hershme, kur këto rrugë nuk ishin ndërtuar, njerëzit nga veriu dhe nga jugu i Shqipërisë ishin kaq të panjohur me njëri-tjetrin, sa ç'ishin njerëzit që jetojnë në dy kontinente të ndryshme. Janë bërë aq shumë rrugë, sa t'u mundësojnë njerëzve të takohen me njëri-tjetrin, të vijnë në Tiranë dhe aty, në kryeqytetin e tyre, të takojnë njerëzit e racës së vet nga të gjitha anët e vendit.

Kjo e ka bërë më të lehtë shkëmbimin e prodhimeve të tokës, ka ndihmuar rrënjosjen e vetëdijes kombëtare tek tërë populli, një detyrë kjo shumë e rëndësishme dhe e nevojshme për ta përgatitur kombin për sfidat e ardhshme.

Arritja e tretë dhe ndoshta më e madhja gjatë tërë mbretërimit të Zogut, është ajo e arsimimit. Qindra djem të rinj u dërguan për trajnime në universitetet, shkollat teknike dhe profesionale në katër anët e Europës dhe të Amerikës. Anglia, Franca, Austria, Gjermania, Italia, me kulturën e tyre të paanë, shkencën, artin, teknologjinë

dhe pajisjet e jetës, u bënë të disponueshme për këta të rinj. Sot shumë prej tyre kanë pozita të rëndësishme drejtuese në jetën e vendit të tyre. Brenda vendit, atyre iu dhanë trajnime speciale në bujqësi, teknologji, tregti. Një shkollë kombëtare për trajnime të nivelit të mesëm u mbush me disa qindra djem që vijonin studimet për vite me radhë për të plotësuar kërkesat e shkollave kombëtare që u hapën dhe që janë në proces hapjeje në tërë vendin.

Poshtërimi që i ishte bërë këtij kombi për ta mbajtur 99% analfabet në gjuhën e vet, tashmë i takon së kaluarës. Arsimimi i detyrueshëm, sigurisht i bazuar në mjetet më të mira të mundshme, ka përfshirë gradualisht shumicën e rinisë së kombit. Kjo ishte me të vërtetë një arritje e mrekullueshme, po të marrim parasysh se gjithçka kishte filluar nga asgjëja. Kur u hap shkolla e parë, çka e kujtoj shumë mirë, nuk kishte qoftë edhe një shqiptar brenda vendit që të ishte i kualifikuar për të dhënë mësim në atë shkollë. Për të gjetur një drejtor shkollë, bordi dërgoi një misionar në Kairo, në Egjipt. Për një tjetër pjesëtar të këshillit pedagogjik iu drejtuan Bostonit, në SHBA, dhe për një tjetër, Romës, në Itali. Të gjithë këta e kishin mësuar gjuhën shqipe jashtë vendit të tyre, atje ku mësimi i kësaj gjuhe nuk ishte bërë *yasak*.

Ndërkohë që po udhëtoja në malet e larta të verilindjes së Shqipërisë, një herë m'u qas një malësor dhe më tha se kishte diçka që donte të ma tregonte. Ai më çoi tek një shtëpi fare e thjeshtë, e cila ishte ndërtuar në mes të një pylli shumë të bukur, buzë një përroi me ujë të pastër si loti. Shtëpia ishte e bërë me gur, e suvatur brenda me baltë dhe e gëlqerosur, por ende me tavane të pambaruara. Dritaret ishin bërë me lëndë të gdhendur ashpër dhe me kanate të rënda druri. Me një krenari të madhe, ky burrë më tregoi se si ai vetë dhe fshatarët e tij e kishin ndërtuar këtë objekt për shkollë, që fëmijët e tyre të mësonin shkrim e këndim. Ai më tregoi se tani aty kishte afro njëzet fëmijë që mblidheshin që nga grykat e maleve dhe fshatrave malore, nga largësi që kapnin herë dhjetë e herë njëzet kilometra. Të tjerë, edhe më larg, shpresonin të regjistroheshin në shkollë.

“Po mësues, a kanë ata?”, e pyeta.

“Jo!”, më tha. I kishin kërkuar Ministrisë së Arsimit që t’u dërgonte një mësues aty, por nuk kishin marrë ende përgjigje. Për kënaqësinë time të menjëhershme, unë u vura në lëvizje për të gjetur një mësues, të cilin e rregullova të dërgohej në atë fshat sapo të hapej shkolla në vjeshtë.

Sa bukur ishte që kjo lëvizje për një *Jetë të re* e kishte gjetur udhën e vet bash aty, në zemrën e jetës më primitive të kombit, ku një institucion i tillë nuk ishte njohur kurrë më parë, në asnjë prej mijëvjeçarëve të historisë së saj.

Ahmet Zogut, sikundër askujt tjetër, i duhet ditur për nder kjo që ka bërë.

Unë e kam formuar gjykimin tim ndaj këtij burri, bazuar tërësisht në faktet dhe përvojat e mia gjatë njëzet vjetësh shoqërie të ngushtë me të. Kam dëgjuar gjithfarë akuzash dhe denoncimesh ndaj tij dhe kam parë shumë prej atyre që duan ta diskreditojnë para botës, duke mohuar çdo gjë që ai ka bërë. Por unë kam krejt tjetër mendim për të. Gjithsesi, unë do ta lë këtë çështje në dorë të lexuesve të mi dhe t’u kujtoj fjalët e Spinozës që për mua përçon zërin e mençurisë njerëzore kur thotë:

*“Qëllimi ynë nuk duhet të jetë as t’i përqeshim, as t’i qajmë,
as t’i denoncojmë veprimet e njerëzve, por t’i kuptojmë ato”.*



KËTO MALE TË SHQIPËRISË QË RRITIN KËTA MALËSORË, KANË
KRIJUAR NJERIUN MË TË GJATË, BURRIN MË TË PASHËM DHE
MË TË GUXIMSHËM TË EUROPËS, POR QË PËRKOHËSISHT DHE
PAPRITMAS ËSHTË I LËNË KREJT PAS DORE.



XXIV



DHE...DHUNIMI

Ato që u shfaqën atë ditë në Gjirin e magjishëm të Durrësit, nuk ishin mjelma, por anije të fuqishme lufte, të hirta, të rënda, zotëruese, të ngathta, si një flotë gargantuane që zbret nga kozmosi i pafund. Të mëdha e të vogla, kruizerë e destroyerë, varka torpedo dhe nëndetëse zhytëse si rika të shëmtuara përbënin një numër prej njëqind e dyzet e shtatë syresh. Ato frushkulluan dhe u vorbullosën me rrotullimet e tyre shkumbëzuese, deri sa erdhi një çast qetësie. Për mbi to, qindra aeroplanë ngjiteshin e zbrisnin tmerrësisht zhurmshëm si një kor shoqërues bubullimash vdekjeje dhe terrorndjellëse. Madje edhe maleve të ashpra, të njohura për majat e mprehta që në ag të krijimit, të rryera prej furtunave kërcëllitëse, duhet t'u jetë trazuar indiferenca dhe krenaria shekullore prej këtyre njerëzve dhe makinerive. Më pas, prej anijeve hijerënda që pothuaj e kishin ndalur kolovitjen në det, befasisht filluan të dilnin njerëz si mizëri grenxash, secila me thumbin e saj të veçantë, të shpejtë, vdekjeprurës, me një zell të pamatshëm dhe gatishmëri vrastare për ta zgjuar këtë qytet të vogël, të përgjumur, të trullësuar, të lënë pas dore, që më

pas ta pickonin për vdekje...

Pas përhumbjes që kishte kapluar atë qytet, pas disa kohërash të vyera, të mbushura me një farë qetësie për vegjëlinë dhe qytetin, tani kishte mbetur shumë pak forcë për të sfiduar fuqinë e këtyre makinave, për t'u ndeshur edhe me një trazirë tjetër, për ta larë vdekjen me vdekje. Dhe ja! Ata u njohën më në fund. Disa grave dhe fëmijëve iu vunë në duar disa flamuj të vegjël. Ato i shtërnguan dhe i valëvitën për të bërë lajm për *Associated Press*. Pyes veten, a janë vallë ato gra dhe fëmijë romë apo çfarë janë? Unë kurrë nuk mund t'i mendoj gratë shqiptare, në rrugë qofshin apo diku tjetër, në një kohë si kjo, të valëvitin flamujt e pushtuesve të tyre.

Ata u nisën drejt Tiranës, kryeqytetit të vogël, të rrethuar prej kështjellës natyrore të malit të Dajtit, tanimë e papërdorshme, me ato maja të mprehta që shkojnë drejt qiellit e që zbresin thikë teposhtë. Që atje shihet z barkimi i mallrave dhe njerëzve në fushat e fluturimit. Mbresëlënëse, dramatik, ky është një inskenim i interesave të imperializmit italian. Për një rast të tillë duhet të ketë një shfaqje të inskenuar jo thjesht për t'u parë vetëm nga Shqipëria, por nga e gjithë bota. Kjo ishte arsyeja përse këta "skifterë" të Romës Perandorake po zbrisnin në atë fushë, jo vetëm si ushtarë të përditshëm, të rëndomtë, thjesht si mish për top, por si vetë garda perandorake, në uniformat e së cilës gjendeshin xhaketat e kuqe të stolisura, helmetat e argjendta, një dëshmi e largësisë së jashtëzakonshme me vegjëlinë. Këto male të Shqipërisë që rritin këta malësorë, kanë krijuar njeriun më të gjatë, burrin më të pashëm dhe më të guximshëm të Europës, por që, përkohësisht dhe papritmas, është krejt i lënë pas dore.

Po Tirana? Këtu, padyshim, pushtuesit gjetën një prijte tjetër. Floriri i Italisë, intrigat dhe propaganda e saj, mobilizimi prej saj i tërë forcave kundërshtarë ndaj Ahmet Zogut, kundërshtitë e lindura midis fiseve feudale, feja, ambiciet politike, etja për plaçkë dhe armata e lojtarëve të vegjël, të cilët do të krekoseshin dhe brengoseshin, përbënin arsenalin e saj pushtues. Tërë këto forma, mjete dhe

kategori ishin përdorur deri në atë çast, që pastaj të heshtnin e të mos dëgjoreshin më. Të gjithë këta ishin gati të viheshin nën urdhërin e asaj dore për përdorim të menjëhershëm. Shumë prej tyre, duke iu bindur urdhërave të nxitësve të tyre, brohoritnin me zë të lartë për gjoja lumturinë e çlirimit të tokës së tyre të palumtur prej italianëve fisnikë. Po ishte ende dikush i gjallë që i kishte parë të gjitha, që kur serbët erdhën në vitin 1912, me bajonetat e skuqura nga gjaku i vrasjeve masive të dhjetëra mijëra njerëzve të pambrojtur, grave dhe fëmijëve, shumë prej të cilëve ende të palindur.

Aq sa do të deshëm të mendonim mirë për miqtë dhe të afërmit tanë, për këtë racë dhe vend, po aq e dimë se nuk ka kauzë më të shenjtë, nuk ka vend, qoftë edhe i shenjtë, që të shpëtojë nga ndotje të tilla. Shqiptari nuk duhet të lejojë që një kauzë kaq e lartë siç është *Liria* dhe *Pavarësia* e atdheut të vet apo “mëmëdheut”, siç parapëlqejnë ata ta quajnë të dhunohet kështu. Sepse ata janë ende aty. Ata që nuk e kanë shitur veten për asnjë çmim, ata që ende e ndiejnë peshën e padurueshme të zgjedhës së pushtuesit. Shumica e miqve të mi më të vjetër e më të ndershëm shqiptarë i takojnë këtij numri dhe jam aq i sigurtë për ta, sa ç’jam i sigurtë për veten time, se ata nuk e kanë shitur veten për “tridhjetë aspra”, apo për çfarëdo lloj çmimi që t’u kenë ofruar. Ndoshta ata e kanë ndier se duke pranuar një pozicion përgjegjësie nën italianët, do mund të ruanin vlera të vetërespektit dhe krenarisë së racës së tyre dhe, mbi të gjitha, atë vlerë të pamatshme, të pakrahasueshme me asgjë tjetër, të simbolizuar dhe përmbledhur në një fjalë magjike me katër germa, të quajtur BESA,¹²² pa të cilën kjo racë do të kishte humbur tërë atë cilësi që e dallon e, bashkë me të, zërin e saj të brendshëm detyruës që e ka bërë të mbijetojë. Unë vetëm mund dhe dua t’u uroj atyre qartësi në vështrimin e problemeve, guxim dhe besnikëri ndaj idealeve racore dhe asaj vetie të tyre të pathyeshmërisë që shfaqet tek ta në formën e “qëndresës së lindur”. Kjo i ka sjellë kësaj race trashëgiminë e saj fisnike epokë pas epoke, pas pushtimeve të gjata, kundër zotëruesve të huaj të territoreve të tyre.

¹²² Shqip në original.

Efekti i këtij shpirti dhe karakteri të races është një çështje serioze për t'u diskutuar. Gjithmonë midis shqiptarëve dhe italianëve ka patur një mospërshtatje të caktuar të karakterit, një antipati që ka parandaluar çfarëdo lloj marrëdhënieje ose bashkëpunimi të afërt e të besueshëm. Me të drejtë apo pa të drejtë, shqiptari e ka quajtur veten një person që i përket një race të lartë. Dhe kjo shihet jo vetëm tek vlerësimi i tyre për italianët por, gjithashtu, edhe për popujt e tjerë në anën e vet të detit Adriatik. Përbuzja është një fjalë e rëndë për ta përdorur në këtë lidhje, por jo edhe aq, mendoj unë, në rastin e sotëm.

Temperamenti latin, tepër i emocionuar, nervoz, shpërthyes, fjalëshumë, madje me tepricë të madhe, pasojat zhgënjyese të hasura shumë shpesh midis premtimit dhe mosrealizimit të premtimit, janë gjëra që shqiptari nuk i duron dot. Qetësia e tij e jashtme, ngadalësia në veprime merr ndonjëherë forma vdekjeprurëse në kohë të tilla si kjo. Kjo krenari racore, e pajustificueshme sa ç'është sipas standardeve tona perëndimore, është diçka që duhet të studiohet në çdo pikëpamje prej italianëve, nëse ata duan vërtet të vijojnë me mbretërinë e tyre të re, të zgjeruar. Unë do të thoja se besimi tek vetvetja i shqiptarëve është një prej faktorëve më të rëndësishëm që duhen vlerësuar në çdo përpjekje të Italisë për të fituar vërtet besnikërinë dhe mbështetjen e popullatës shqiptare ndaj sundimit të saj. Ideja se po të bërtasësh shumë e me zë të lartë arrin t'i nënshtrosh njerëzit nga frika dhe i bën ata të të binden, nuk shkon aq shumë me malësorët e Shqipërisë.

Një ide tjetër që do të ishte po aq e kotë dhe e dështuar, është ajo që të priresh t'i trembësh shqiptarët me mjete ushtarake, anije luftarake, flotë ajrore, tanke, mitralozë, helmata prej tunxhi të qëndisura me flori dhe të shndritshme, si pjesë të një shfaqjeje të inskenuar bukur përballë tyre, përballë asaj gjendjeje në të cilën ata ndodhen sot, të gremisur plotësisht, të lemerisur, të rënë në krahët e Italisë. Të tentosh t'i trembësh ata, është punë e kotë.

Asgjë nuk mund të ishte më e vërtetë se kjo. Madje, edhe thellë në zemrat e atyre që janë duke i shërbyer Italisë nëpër zyra të ndryshme të shtetit, nëse mund

të shihej, do të gjendej e njëjta fyerje dhe antipati që ka ekzistuar në gjakun e stërgjyshërve të tyre për dy mijë vjet, ose edhe më shumë. Falë shumë e shumë shekujve qëndrese të tyre nën zgjedhën e huaj, dhe jo vetëm në një rast, por në shumë e shumë raste e prej shumë individësh, ata kanë treguar dhe janë mësuar të jenë të durueshëm dhe të qëndrueshëm, dhe nën atë zgjedhë të qëndrojnë të paepur në izolimin e tyre të vetmuar të shpirtit, aq të pandryshueshëm sa edhe vetë malet e vendit të tyre.

Edhe Turqia që e mbajti nën kontroll të plotë Shqipërinë, aq sa mund të mbahet një vend dhe një popull, që nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë e deri në vitin 1912, munda të linte vetëm një shenjë mbi këtë komb, që është feja myslimane. E pranuar në fillim si maskë për të përfutur të drejta civile, siç është mbajtja dhe përdorimi i armëve, që më pas t'i përdornin për luftë guerrile kundër pushtuesve të tyre, shqiptarët muhamedanë në rrjedhë të shekujve nuk përvetësuan qoftë edhe një karakteristikë tjetër të turqve. Ata shquhen për qëndrimin e tyre fatalist ndaj jetës. Durimi i tyre, edhe kur kushtet janë më të këqijat e mundshme, është krejt i veçantë.

Mosrespektimi i rregullave të jetës së zakonshme u bë moto e jetesës së tyre të përditshme. Kjo është një shenjë që ka mbetur, një vragë shumë e thellë që jeton bashkë me ta. Këtu gjendet një pikë tjetër nga ku mund të kuptohet irritimi, çarja dhe revolta e rastit. Që ky popull i çuditshëm, kaq i largët me procesin tonë të menduarit, të të jetuarit, të mund të kuptohet dhe vlerësohet më mirë, na duhet ta shohim atë në një mënyrë më intime dhe jo formale, duke i vlerësuar atij rolin që ka luajtur në historinë e Europës dhe të Lindjes së Afërme.

Për më tepër, nuk duhet të harrojmë se një milion njerëz apo ndoshta edhe dy, të kyçur tashmë në Ballkan, janë thjesht një trashëguese shumë e vogël e një race shumë të lashtë, shumë të populluar dhe shumë të shpërndarë.



“NJERIU MUND TË PESHKOJË ME NJË KRIMB TË FUTUR NË
GREP, I CILI ËSHTË USHQYER NË TRUPIN E NJË MBRETI,
NDËRKOHË QË VETË MBRETI KA PAS NGRËNË DIKUR PESHKUN
QË KISHTE NGRËNË NJË KRIMB”.

HAMLETI



XXV



NJË BURRË-SHTETAS SHKON PËR TË GJUAJTUR PESHK

Duke e zhvendosur skenën në Londër, le të shohim se çfarë përshtypje lanë në kryeqytetin e botës ngjarjet që u zhvilluan në Shqipëri. Gjëja që na habit më shumë, është kur shohim se si kryeministri i Madhërisë së Tij kishte shkuar për të zënë peshk në Skoci. Kur Shqipëria u dhunua atë të *Premte të Mirë*, ai u gjend atje, por nuk u përpoq të kthehej në Londër jo vetëm atë natë kur çdo gjë kishte marrë fund, por as të shtunën. Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, ishte tashmë plotësisht e pushtuar, trupat italiane ishin shpërndarë drejt kufijve të vendit, mbreti Zog me mbretëreshën dhe djalin e tyre pesë ditësh ishin arratisur në Greqi. Zoti Çembërlein nuk u kthye në zyrë deri sa e tëra kjo mori fund. A nuk është e çuditshme? Lexuam se vetë populli italian ishte befasuar prej këtij sulmi të papritur. Radioja dhe shtypi janë tërësisht nën kontrollin e qeverisë, çka nuk përbën ndonjë habi. Po mirë atje, po si mund të ndodhë kjo me qeverinë britanike? Nuk dinin gjë ata për këtë? E kundërta është e vërtetë. Ata kishin dijeni paraprakisht për mobilizimin e trupave

italiane në portin e Barit dhe Ankonës. Ata e dinin se italianët u tërhoqën nga Shqipëria, gjoja se ishin ngacmuar prej shqiptarëve në Shqipëri; ata i dinin kërkesat e pareshtura të Zogut, bërë nëpërmjet diplomatëve të tij, përfshirë edhe atë në Londër, pranë qeverive ku ata ishin akredituar, për atë që do të ndodhte. Ne e dimë se lordi Perth, ambasadori britanik në Romë, ishte në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Jashtme italiane. Jo, qeveria britanike nuk ishte zënë në gjumë në atë orë kritike.

Një gjë tjetër e çuditshme ishte toni, përmbajtja dhe mënyra se si raportoi kryeministri para parlamentit për çështjen shqiptare. Deklarata e tij e parë për shtyp ishte që situata ishte shumë e ngatërruar dhe duhej pritur deri sa ajo të sqarohet. Dihej vetëm që sovraniteti i Shqipërisë ishte nëpërkëmbur dhe shkatërruar i tëri. Raporti nga Londra thoshte:

Duke bërë këtë deklaratë përpara Dhomës së Komuneve, i pikëlluar, shtatëdhjetëvjeçari Çembërlein për njëzet minuta lexoi me mundim të madh një epitaf. Ai sqaroi kohën dhe portet prej nga ishin nisur trupat italiane. Ai tregoi për kohën kur diplomatët kishin shkuar dhe kur kishin ikur nga *Foreign Office*. Ai fërkoj duart kuturu me pamjen e lodhur dhe u largua prej vendit ku ishte. Por, në asnjë çast nuk u duk i nervozuar”.¹²³ Përkundër tërë asaj që kishte ndodhur, kryeministri pati si qëllim të mbronte marrëveshjen anglo–italiane, e cila kishte garantuar të mbronte *status-quo-në* në Mesdhe. Ajo që e shqetësoi, ishte britma e laboristes, zonjushës Uilkinson, kur tha “Lëri lajkat!”. Në “epitafin” e tij për Shqipërinë, ai dha një deklaratë si kjo:

“Të dhënat duket të jenë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe nuk do të ishte mençuri ta varnim gjykimin tonë vetëm në faktet që çuan tek pushtimi. Sipas burimeve të mirinformuara, pushtimi i Shqipërisë u bë i detyrueshëm për qeverinë italiane për shkak të keq-qeverisjes dhe kokëfortësisë së mbretit Zog... Ka patur shumë elementë në Shqipëri që dëshironin ta çlironin Shqipërinë nga sundimi i

¹²³ *Los Angeles Times*, 14 prill 1939.

mbretit Zog”. Kjo është logjika e fakteve, apo jo? “Epitafi” mbyllet me vëzhgimin e mëposhtëm:

“Siç del nga lajmet e fundit, *Këshilli i Përkohshëm Administrativ i Shqipërisë* i ka ofruar Kurorën e Shqipërisë mbretit të Italisë dhe neve na duhet të presim përgjigjen e qeverisë italiane për këtë ofertë”.

Duke e marrë me mend se zoti Çembërlein dhe qeveria e Madhërisë së Tij duhet ta kenë ditur që ky *Këshill Administrativ i Përkohshëm i Shqipërisë* ishte një mashë italiane e vendosur në kryeqytetin shqiptar prej kontit Çiano, që përfaqëson Duçen dhe qeverinë italiane, a ishte pritja e një përgjigjeje të qeverisë italiane kaq e rëndësishme, tek e fundit? Dhe kur përgjigja u dha disa ditë më vonë, a kishte ndonjë shënim tjetër zyrtar të ndërmarrë mbi këtë çështje nga ana qeverisë së Madhërisë së Tij?

Duke e larguar vëmendjen nga çështja shqiptare krejt i trazuar, kryeministri iu kthye problemit të Greqisë dhe Rumanisë. Menjëherë, stili dhe gjuha e tij ndryshuan. Nuk kishte këshilla për pritje, dëshpërim apo ndonjë gjë tjetër. Për rrjedhojë, qeveria e Madhërisë së Tij ka ardhur në përfundimin se në rast të ndonjë veprimi që mund të ndërmerrej për të kërcënuar pavarësinë e Greqisë dhe të Rumanisë, qeveritë e të cilave e vlerësojnë si jetike rezistencën me forcat e tyre kombëtare, qeveria e Madhërisë së Tij do ta ndiejë veten të detyruar t’u japë menjëherë atyre tërë mbështetjen që ka në dorë. Flota britanike dhe ajo franceze ishin grumbulluar në Mesdhe, ndërkohë që *Foreign Office*-i britanik dyfishoi rishtas përpjekjet e tij për të forcuar pozitën e qeverisë së vet në Ballkan dhe në Turqi.

Me qëllim që të kuptohet më mirë qëndrimi indiferent i qeverisë britanike ndaj dhunimit italian të Shqipërisë, lexuesit duhet t’i kujtojmë përsëri *Traktatin e Fshehtë* të Londrës, një marrëveshje sekrete e përpiluar dhe nënshkruar fshehtas midis Britanisë së Madhe, Francës dhe Ruisë, si palë në pjesën e parë, dhe Italisë, si palë e pjesës së dytë, më 26 prill 1915.

Sipas pikave të këtij traktati, Italisë i ishte garantuar pronësi e plotë mbi Shqipërinë, me një kusht që lihej për t'u kuptuar, se ajo mund të bënte mirë ta nën-ndante Shqipërinë në katër pjesë. Kështu veriu do t'i jepej Serbisë, jugu Greqisë, Vlora dhe zona brenda vendit për vete dhe ajo që mbetej, të shndërrohej në një krahinë muhamedane autonome nën sovranitetin italian. E çuditshme sa shumë i shkon për shtat një model i tillë përvijimit të fundit të Çekosllovakisë dhe, madje, edhe Polonisë, nëse e dyta do t'i bindej këtyre dy zotërinjve. Siç e di tashmë e tërë bota, pikat e atij pakti, kur kemi të bëjmë me Shqipërinë, nuk u zbatuan, jo pse nuk deshën Lloid Xhorxhi dhe Klemansoja, që kërkuan me çdo mjet që kishin në dorë t'i ndryshonin mendjen dhe dëshirën presidentit Uilson. Por ishte ky i fundit që e bllokoi vendosmërisht këtë lëvizje.

Tani, ndërkohë që Franca dhe Britania e Madhe shfaqnin veçanërisht padurim për të kënaqur Italinë, me qëllim që të ndërprisnin *aksin Romë-Berlin*, është e lehtë të kuptohet se si dhunimi i Shqipërisë prej Italisë u pranua me kaq gjakftohtësi dhe qetësi prej tyre. Ky akt jo vetëm që ishte shlyerje e një borxhi të vjetër, kryer me kujdes për të ruajtur të dyja qeveritë nga ndonjë akuzë për bashkëpunim me Italinë, por ky akt u dha gjithashtu aleatëve një pikë pazarllëku për ta patur kur të vinte koha për zgjidhjen e çështjes së Tunizisë dhe Xhibutit.

Dhe përsa i takon Shqipërisë, të drejtave të saj, pavarësisë së saj, integritetit të saj territorial, mbretit të saj dhe qeverisë së tij të njohur nga tërë shtetet e Europës, përfshi edhe SHBA-në dhe Turqinë, veç të tjerash, as që u tregua ndonjë merak. Nëse e tërë kjo mund të shuhet si flakë qiriri, çfarë kuptimi merr atëherë ky veprim për Finlandën, Belgjikën, Estoninë, Palestinën dhe një numër shtetesh të vogla, mbrojtja e vetme e të cilave ndaj shteteve të mëdha është ajo morale? Ajo çfarë përvoja e këtyre njëzet e pesë vjetëve të fundit na ka mësuar, është se njeriu e sheh dikë me fat dhe e parandjen si në vargjet e njohura të Wordsworthit¹²⁴:

¹²⁴ William Wordsworth (1770 – 1850), poet i madh romantik anglez, i cili bashkë me Samuel Teilor Coleridge) çelën epokën e romantizmit në letërsinë angleze me botimin e përbashkët *Balada lirike* në vitin 1798. (Shënimi im – MB)

*Edhe sot është si ç'thot' i moçmi,
Një plan i thjeshtë plotësisht mjafton,
Ta marrë të tërën kush është më i forti,
T'dobtëve u mbetet veç çfarë tepron.*

Grindjet e mëparshme midis Gjermanisë dhe fuqive perëndimore, Britanisë së Madhe dhe Francës, përbënin një konflikt të përmasave të mëdha. Është fakt që në çdo rast Austria, Çekosllovakia, Danzig-u¹²⁵ kishin popullsi të madhe gjermane që kërkonte me të drejtë kthimin tek Rajhu. Në rastin e Shqipërisë nuk ka një ngjashmëri të pretendimeve që kanë të bëjnë me territorin. Më e mira e asaj që mund të bëjë Musolini, është të kthehet tek viti 229 p.e.r, kur territore më të gjera, të zëna në atë kohë prej racës ilire, epirote dhe maqedone, së bashku me pjesën tjetër të Ballkanit qenë përfshirë në një seri luftërash e pushtimesh të cilat përfunduan me Betejën e Pidnas¹²⁶ në vitin 168 p.e.r. E vërtetë është se kishte një deng me hilerë që i shërbeu qëllimit për të kamufluar dhe fshehur qëllimin e vërtetë të Italisë, për të pushtuar Shqipërinë dhe për të gjetur një pretekst që do ta bindte botën.

Në listën e preteksteve, i pari ishte: Shqipëria nuk i paguante huatë e marra Italisë. E vërtetë, por a ishte menduar ndonjëherë seriozisht se si do të paguheshin ato hua? Huatë ishin nën kontrollin italian, siç ishin edhe vetë financat kombëtare. Banka Kombëtare e Shqipërisë ishte një institucion italian, me zyrat qendrore në Romë. Aksionet e saj ishin si më poshtë:

*Credita Italiano 115 000
Banka Nazionale 30 000
Banca Comerciale 30 000*

¹²⁵ Danzing është emri në gjermanisht për Gdansk, një qytet polak në bregdetin balltik, porti kryesor i Polonisë dhe qendra e katërt më e madhe e vendit. (Shënimi im – MB)

¹²⁶ Beteja e Pydnës (The Battle of Pydna), e zhvilluar në vitin 168 midis Romës dhe Dinastisë Antigonike të Maqedonisë, i dha fund linjës mbretërore të antigonëve të cilët e kanë rrjedhën prej Aleksandrit të Madh. (Shënimi im – MB)

Banca di Roma 30 000

Banka të tjera italiane 30 000

Gjithsej: 235.000 franga ari

Banka Jugosllave 50 000

Banca Comercial, Bale 50 000

Banka Belge 50 000

Gjithsej: 150.000 franga ari

Të gjitha së bashku: 385.000 franga ari

Shqiptarët kishin 49% të shumës, por vetëm një sasi e pakonsiderueshme ishte nënshkruar. Midis të drejtave dhe privilegjeve të bankave ishin edhe këto:

- Të negocionte huatë qeveritare dhe lokale;
- Të ishte depozituesja e të gjitha fondeve qeveritare;
- Të përjashtoj nga taksat;
- Dhjetë përqind e fitimit t'i kalonte shtetit;
- Vota vendimtare i takonte drejtorisë italiane.

Në lidhje me huanë italiane dhënë Shqipërisë:

Huaja e parë prej 50 milion frangash ari u bë 71 milion, e cila në të vërtetë përbënte borxhin e qeverisë shqiptare prej 76 milion e gjysmë franga ari, pasi norma e interesit ishte 10.5%. Prej 44 milion frangash ari, të dhëna në kohën e huasë, pak më shumë se një milion ishte caktuar për ujitje, bujqësi, bursa studentësh (më të shumtët në Itali). Një milion ishte caktuar për administratën qeveritare dhe të tjerat për rrugë, ura, porte, hekurudha, godina qeveritare, asnjë prej të cilave nuk ishte produktive por, në të kundërt, përfshinte shpenzime mirëmbajtjeje shumë më të shtrenjta se ç'mund ta përballonte qeveria. Për më tepër, këto ishin rrugë ushtarake që zgjatëshin drejt fqinjëve të Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Greqisë, dhe nuk mund t'i shërbenin ndonjë qëllimi tjetër. Për qëllime tregtare e duke përdorur

portet me anijet e veta për Itali, Jugosllavi dhe Greqi, deti Adriatik i shërbente më mirë nevojave shqiptare. Në të vërtetë, ky investim që kapte një të tretën e shumës totale të huasë për rrugë, ura, porte dhe hekurudha, përfaqësonte interesat vetjake politike të Italisë në Shqipëri, si një avanpost strategjik perandorak për mbrojtjen e interesave të saj në Ballkan. Kamuflazhi ishte pikërisht në formën e huasë që e mbështillte këtë qëllim, dhe faktin shtesë që ajo vuri në dorë një hipotekë mbi këtë vend dhe burimet e tij të kufizuara, të cilat mund t'i konfiskonte në çdo çast që t'i duhej.

Përsa i takon hileve të tjera të paketës italiane, ato nuk meritojnë aq shumë komente. Që fondet e huasë ishin keqpërdorur dhe shpenzuar më së keqi, kjo dihej. Zyrtari shqiptar që negocioi termat e huasë në kushte kaq favorizuese për Italinë dhe i përcolli edhe në parlament, ishte shpërblyer me bonuse që kapnin, siç thuhet, një milion franga ari. Që atëherë, ai sa herë donte, jetonte në Itali. Me një fillim të tillë, ajo që del është se fondet ishin keqpërdorur edhe prej zyrtarëve të tjerë. Një pikë tjetër ishte se mbreti Zog po intrigonte me Jugosllavinë. Një tjetër gjë që e nervozonte Italinë, ishte se ai nuk do të lejonte të institucionalizohet fashizmi në Shqipëri; e po ashtu, edhe një tjetër gjë ishte se gjoja italianët që jetonin në Shqipëri, ishin ngacmuar, dhe që *Der Fuhrer* e kishte nxitur Duçen që ta pushtonte Shqipërinë, me qëllim që të shërbente si një *quid pro quo*¹²⁷ për pushtimin e Çekosllovakisë prej tij.

Këto janë tërësisht spekulime. Deri sa guxuan të paraqesin akuza të tilla sikur familjet italiane në Shqipëri nuk ishin të sigurta për shkak të ngacmimeve, një akuzë që unë e kundërshtoj duke u vënë nën betim për atë që them, është vështirë të merret seriozisht cilado nga akuzat e tjera të përmendura më sipër.

Gjithsesi, janë edhe dy arsye të tjera që unë i paraqes këtu, por e treta është edhe më e rëndësishme se të gjitha ato që do të trajtohen në kapitullin që pason.

E para, është lindja e Princit Leka, trashëgimtar i fronit të Shqipërisë. Deri sa

¹²⁷ Kompensim

lindi ai, nuk kishte një trashëgimtar të fronit. Princi i sapolindur vendosi radhën e trashëgimtarit të parë për *Oborin Mbretëror Shqiptar*. Kjo ishte një çështje shumë serioze për Italinë, nëse kishte për qëllim që ndonjëherë t'i jepte fund pretendimeve për mbështetje të sinqertë të një shteti shqiptar të pavarur, të vazhdonte të bënte mbajtjen e huave, të shkruante traktate aleancash, marrëveshje tregtare etj. Përsa i takon mbretit Zog, ishte një çështje krahasimisht e thjeshtë për Italinë që ta hiqte atë nga fronti nëse donte, kurdo që ta vendoste për ta bërë këtë. Kishte disa mënyra për ta bërë këtë: njëra ishin rivalët politikë që ishin në arrati që prej kohës së Revolucionit të peshkopit Fan Noli, në qershor të vitit 1924, dhe varësia nga dhuratat e varfëra që merrnin ata jo vetëm prej Italisë, por edhe prej Greqisë dhe Jugosllavisë. Ata ishin shpërndarë në këto tri vende.

Ka patur gjithmonë një element kryengritës në Shqipëri. Me një drejtim të kujdesshëm, propagandë dhe premtime për shpërblime dhe poste, ata ishin përherë të gatshëm për të vepruar. Por, kur aty ka një trashëgimtar, dhe në këtë rast një fëmijë i lindur nga një mbretëreshë e mrekullueshme siç është Geraldina, që kishte bërë për vete zemrat e tërë Shqipërisë, atëherë kjo bëhet një çështje shumë serioze. Shqiptarët i duan bijtë e tyre të gjithë njësoj, qofshin myslimanë, katolikë a ortodoksë, i quajnë ata forcë përtëritëse, përjetësuese, pjellore, e cila e ka mbajtur racën *shqiptare*¹²⁸ gjallë, të fortë dhe burrërore në rrjedhën e mijëra vjetëve të historisë së saj plot rreziqe.

Sfida që shqiptari të imponon kurdo dhe këdo që të takosh, në qytet apo në fshat, në rrugë malore apo në fushat malarike buzë Adriatikut, është: “*A je burrë?*”¹²⁹ Dhe përgjigjja plot krenari e shqiptarit është: “*Jam burrë, po ti a je?*”¹³⁰ duke bërë dallimin gjinor, çka e bën gruan shqiptare gruan më krenare, të ndjehet bashkudhëtare e një burri të fortë. Lexoje këtë në kuptimin e vet më të gjerë dhe më të thellë të këtij fëmije-burrë në pallatin e mbretit Zog dhe mbretëreshës

¹²⁸ Shqip në original.

¹²⁹ Shqip në original.

¹³⁰ Shqip në original.

Geraldinë, për të kuptuar plotësisht përse Musolini dhe legjionet e tij goditën Mbretërinë e Vogël me një forcë kaq prepotente në mëngjesin e së Premtës së Mirë, 7 prill 1939, kur princi i vogël kishte vetëm dy ditë që kishte ardhur në këtë jetë.

Arsyeja e dytë për etjen e papritur ishte kërcënimi i rrethimit prej Britanisë së Madhe dhe Francës. A luajtën bixhoz këto dy të fundit duke e lënë Italinë të merrte Shqipërinë, të vendoste trupa të mëdha tokësore atje, të zgjeronte kufijtë e saj matanë Adriatikut dhe pastaj ta mbyllte atë brenda Liqenit italian?¹³¹ Kujtoni se sa i plotësuar ishte plani i tyre i rrethimit: Jugosllavia, Hungaria, Rumania, Turqia dhe Greqia. Ndoshta në një komplot si ky, ata mund t'ia arrinin të shkëpusnin Italinë nga *Aksi Romë – Berlin* dhe kështu të ngurtësonin tërë Ballkanin dhe Turqinë në një bllok solid shtetesh me të cilët të përballëshin me Hitlerin në Europën Juglindore dhe ta bënin Gjermaninë që në përpjekjet e saj për një “*Drang nach osten*”¹³² të mburrej kot dhe të mos ishte rrezik as për më të fundit dhe më të dobëtin shtet të Ballkanit. Kjo ngjashmëri mund të ndihmojë të shpjegojmë përse zoti Çembërlein shkoi të gjuante peshk në Skoci, pasi kishte shpërndarë me kaq mjeshtri rrjetat e tij në ujërat ballkanike.

Dua ta mbyll këtë kapitull në nderim të të famshmit Faik Konica, ministër i Shqipërisë në Uashington në kohën e grushtit të shtetit, i cili bëri këtë koment për shtypin:


“Italianët kanë shumë cilësi të admirueshme dhe janë një komb i madh, por Zoti i Plotfuqishëm, me qëllimin e tij të pashpjegueshëm, i ka privuar ata nga çfarëdo lloj ndjesie kalorsiake. Pikërisht kur mbretëresha jonë lindi djalë, italianët i dhanë këtë goditje, dhe mëmës iu desh të linte krevatin e lehonës me fëmijën dy ditësh dhe ta kërkonte sigurinë diku tjetër, jashtë Shqipërisë. Është jashtë natyrës së italianëve të kuptojnë se duhej të kishin pritur të paktën edhe disa javë deri sa të fillonin sulmin e tyre.”

¹³¹ Në të gjitha dokumentet rreth përpjekjeve italiane për pushtime në anën lindore të detit Adriatik, ky i fundit, kur të mbyllet në Otranto prej italianëve, do të konsiderohej Liqen italian. (Shënimi im – MB)


¹³² Gjermanisht: *Depërtuar në lindje.*

E çfarë do t'u sjellë atyre ky agresion i paprovokuar me një shpërpjesëtim kaq të madh, dyzet me një në numër, një mijë me një në pajisje? Asnjë fitim të qëndrueshëm dhe, me sigurinë më të madhe, asnjë lloj nderi. Një boksier profesionist që dëshiron të impresionojë botën me fuqinë e tij, nuk rrëzon përdhe një fëmijë, por sfidon një boksier tjetër si veten. E di që italianët qeshin me një pikëpamje të tillë. Njeriu qesh gjithmonë me gjërat që nuk arrin t'i kuptojë. Por, një burrë tjetër, më i madh se Musolini, e kam fjalën për Bismarkun, i jepte shumë rëndësi atyre gjërave të cilat i quante “të paparashikueshme”. Nuk besoj se ka ndonjë që e admiron Italinë për këtë bëmë.

Unë dhe shumë intelektualë të tjerë kishim ëndërruar për një bashkëpunim të ngushtë kulturor, ekonomik dhe politik me Italinë mbi një bazë të ndershme. Përgjigjja elegante ishte një grusht në kokën tonë”.



“HEDHURINAT PASTROHEN, GJAKUN E PËRTHITH TOKA.
MBETEN VETËM RRUGËT, TË ÇELURA, TË GJERA E TË GJATA QË
RENDIN DREJT AZISË NË NJË RRJETË KTHESASH TË BUKURA SI
VENAT NË GJIRIN E NJË GRUAJE”.¹³³



¹³³ Gamaliel ben Sasra, ndërtues rrugësh i Aleksandrit të Madh.

XXVI



NJË MBRETËRI PËR NJË RRUGË

Për të qenë të drejtë me Italinë, duhet pranuar se ende mbetet një arsye shumë e fortë, madje imponuese, të sqarohet se përse e pushtoi ajo Shqipërinë në atë kohë. Kjo arsye, siç mund ta marrë me mend lexuesi, është një rrugë. Nuk është gjë tjetër, përveçse një rrugë antike romake që zgjatet nga Roma në Brindizi, seksion i cili është njohur me emrin *Via Appia* dhe zgjatimi i saj prej Durrësit nëpër Shqipëri, Maqedoni dhe Trakë, drejt Stambollit dhe Lindjes për tek lumenjtë Tigër dhe Eufrat. Për një libër romance, aventurash të rrugës, nuk besoj se njeriu mund të gjejë në këtë botë diçka të krahasueshme me *Via Egnatian*, emër me të cilin njihet ajo rrugë. Jul Cezari dhe Pompeu, ndjekës dhe të ndjekur, e përshkuan këtë rrugë drejt Farsalit (Pharsalus),¹³⁴ një qytet në Tesali, ku beteja e tyre vendimtare u bë për të zotëruar dhe sunduar Romën Perandorake. Tjetri që e përshkoi *Via Egnatian* me legjionet e shpejta në ndjekje të vrasësve të xhaxhait të tij, ishte Cezari August, nipi

¹³⁴ *Beteja e Farsalit (The Battle of Pharsalus)* ishte betejë vendimtare e Luftës Civile të Cezarit. Më 9 gusht 48 p.e.s. në këtë rajon në Greqinë Qendore, Cezari dhe aleatët e tij u përballën me ushtrinë republikane nën komandën e Pompeut të Madh (Gnaeus Pompeius Magnus). Pompeu kishte mbështetjen e shumicës së senatorëve dhe ushtria e tij ishte shumë më e madhe në numër se legjionet e Cezarit. (Shënimi im – MB)

i Jul Cezarit. Kështu, në rrjedhë të shekujve dhe mijëvjeçarëve, migrimi i popujve prej Lindjes së Afërme, prej rajoneve përmbi dhe matanë detit Kaspik, hordhive plaçkitëse, ushtrive shkatërrimtare nga lindja në perëndim dhe nga perëndimi në lindje, i ngulën thellë gurët e kësaj rruge me rrotat e karrocave të tyre dhe qerret me qe, dhe i lustruan gurët me thundrat e kopeve të kafshëve të tyre. Megjithatë, kurrë në historinë e saj aventurore nuk i shërbeu një qëllimi kaq të lartë e kaq të rëndësishëm sa gjatë kohës kur Peandoria Romake ishte në kulmin e vet.

Perandoria Romake përballej me shtete dhe mbretëri të reja që duhet t'i mposhtte, me rebelime të vazhdueshme që duheshin shtypur me gjak e hekur, me barbarët që i çanin rrethimet për të marrë hak, plaçkë dhe shkatërronin qytetet, qytezat dhe fshatrat romake; e në këtë situatë duhet të ketë qenë tërësisht e pamundur për t'u përballur dhe marrë në sy këto rreziqe të frikshme ndaj perandorisë, pa këtë rrugë kaq të madhe arteriale. Duke ecur drejt Lindjes, legjionet e Romës vërshuan me shpejtësinë e rrufesë nëpër Maqedoni, Trakë, ujëmbledhësin e Danubit, Propont (Propontus), në Bosfor dhe Detin e Zi, të gjitha të përshkuara pa vështirësi prej kësaj rruge.

“*L'histoire est une résurrection*”,¹³⁵ thotë Mishlé (Michelet). A e mendoj Duçja këtë kur gjeti si arsye fisnike për të Premten e Mirë sulmin mbi Shqipërinë, që pretendimet e Italisë ndaj atij vendi t'i çonte thellë në vitin 229 p.e.r.? Sigurisht, ky vështrim në histori i ka dhënë më shumë oreks, shumë më tepër se sa një pushtim i thjeshtë. Si pushtim i thjeshtë nuk ishte dhe aq për t'u mburrur. Por të lëshojë një ekspeditë në Ballkan krah për krah me *Via Egnatian*, me hijet e Filipit të Maqedonisë, Aleksandrit të Madh, Pirros, Jul Cezarit, August Cezarit dhe të gjithë atyre që retë e dëshmime historike i vështrojnë me xheloziziliqare, kjo do të ishte diçka që mund të nxiste edhe një sundues romak me krenari perandorake. Gjithashtu, ekspedita ishte një ringjallje e historisë në një aspekt tjetër. Përtej atij vendi të vogël, Shqipërisë, shtrihet një sfidë ndaj armëve, ndaj fuqisë së perandorisë dhe autoritetit, ashtu si edhe në ditët romake. Nën emra të tjerë dhe rreshtime

¹³⁵ Historia është ringjallje (frëngjisht në original).

të tjera, atje ishte ende Maqedonia e vjetër, Traka, Lugina e Danubit, Proponti, Bosfori, Deti i Zi, me të njëjtën maja tharmi të përplasjes së racave, feve, politikës, qytetërimeve. Aty shiheshin me frikën e dikurshme xhelozitë, urrejtjet, të gjitha emocionet dhe instinktet primitive, të cilat kishin patur një pjesë kaq të madhe në formësimin dhe bërjen e historisë së trazuar e të përgjakshme të Gadishullit të Ballkanit.

Kur shohim se si dy fuqi kaq të mëdha si Britania e Madhe dhe Franca filluan të peshkonin në ato lloj ujërash të turbullta, është më lehtë, duke mos harruar të kaluarën, të kuptojmë se përse Italia e drejtoi këtë pykë hekuri kaq papritmas dhe kaq furishëm tek Shqipëria. Rëndësia e saj strategjike në një rrethanë të tillë është e jashtëzakonshme. Jo vetëm *Via Egnatia*, por të gjitha rrugët ushtarake të ndërtuara drejt kufijve të Shqipërisë me paratë italiane erdhën në jetë përsëri. Menjëherë vendi i vogël u bë fushë shumë e rëndësishme manovrash. Ndaj tij, çdo shtet i vogël ballkanik që kishte filluar të binte në karremin e Aleatëve, kishte ndalur frymën dhe priste të merrte kaparin e plotë të shpërblimit. Prej popujve të tashëm ballkanikë, grekët, rumunët, hungarezët dhe shqiptarët kanë qenë njëherë e një kohë pjesë e Perandorisë Romake. Kujtesa racore, si rregull, nuk është shumë e gjatë dhe, ndoshta, ajo bën shumë pak dallim në qëndrimet e këtyre popujve në drejtim të kësaj Perandorie Romake Moderne, duke u ngritur tani edhe një herë drejt brigjeve të lumit Tigër. Asnjë prej shteteve ballkanike nuk ka ndonjë të kaluar të mirë në lidhje me besnikërinë në fushën ndërkombëtare. Dhe për arsye shumë të njohura – asnjë komb, perandori apo Fuqi e Madhe europiane nuk ka qenë në mënyrë koherente besnike ndaj ndonjë vendi ballkanik, përtej asaj që i kanë shfrytëzuar për interesat e veta. Britania e Madhe, siç e dinë të gjithë, mëton të kontrollojë pjesën më të madhe të Mesdheut, me qëllim që të mbrojë perandorinë e vet në Afrikë dhe në Orient. Në kohën e tashme, ajo ballafaqohet me dy fuqi kërcënuese të rrezikshme, Rusinë dhe Gjermaninë ; që të dyjave u nevojitet Mesdheu dhe vendet e juglindjes së Europës si fusha për zgjerimin e tregtisë. Për Rusinë janë vetëm Deti i Zi dhe Dardanelet, për Gjermaninë janë dy rrugë. Në lindje është Danubi deri

në Detin e Zi, dhe në perëndim deti Adriatik, deti Jon dhe deti Mesdhe. Kjo na jep një arsye tjetër për të menduar përse Britania e Madhe ishte kaq e urtë kur Italia e kaloi Adriatikon dhe doli në bregdetin lindor, për të marrë kontrollin e plotë mbi Ngushticën e Otrantos. Në kohën kur Britania e Madhe po përpiquej të shkëpuste Musolinin prej aksit me Berlinin, ky favor ofronte më pak rrezik për Britaninë e Madhe dhe Francën. Me më shumë se dy mijë milje vijë detare të Italisë, e tëra me dalje të flotave në Mesdhe, edhe Britania e Madhe, edhe Franca llogaritin se një manovër nga ana e Italisë nuk përbënte problem madhor ose rrezik ndaj shumë prej interesave të tyre. Megjithatë, do të ishte sukses i madh përcaktues për to nëse do të arrinin ta ndanin Italinë nga Gjermania. Në rast të një lufte me Gjermaninë, aleanca e tyre me Italinë do ta bënte shumë më të lehtë bllokimin e rrugëve ujore të Gjermanisë – Dardanelet, Danubin dhe Adriatikon. Nga ana tjetër, mbyllja e rrugëve ujore në Balltik dhe në Kanalin anglez, do ta bënte bllokadën e tyre ndaj Gjermanisë thuajse hermetike.

Nëse Gjermania ia del të kapë një post të përparuar nëpërmjet pellgut ujqor të Danubit, drejt lindjes dhe jugut, kjo do të lehtësonte trysninë, të paktën për një kohë të caktuar mbi Adriatik. Siç më rezulton, dhe në fakt jam duke kërkuar me vetëdije një kuptim të paanshëm dhe të shkëputur prej këtyre çështjeve të rëndësishme që e kanë bërë Ballkanin një vorbull të përgjakur të politikës europiane e madje edhe aziatike, grindja e vërtetë që e shkund tani Europën prej njërit cep tek tjetri nuk është midis Gjermanisë, nga njëra anë dhe Britanisë së Madhe dhe Francës, në anën tjetër. Grindja e Gjermanisë është me gjeografinë. Ata që vunë ngulimet e para të popullit gjerman, zgjodhën ta bënin atdheun e tyre në veri të pritës së Alpeve. Ky vargmal ishte një mur i fuqishëm mbrojtjeje dhe sigurie. Në veri ishte Balltiku dhe Deti i Veriut. Nga lindja ishte një botë e panjohur prej së cilës shfaqeshin herë pas here fise migratore të egra, të ashpra, që kërkonin kullota për bagëtinë dhe plaçkë për fitimet e tyre. Shumë beteja të ashpra vdekjeprurëse pasuan midis këtyre popujve të ashpër dhe të fuqishëm. Në kthimin e vet, populli gjerman shpërthyeu nëpërmjet barrierave të tyre malore për të rënë në luginat diellore dhe pllajaj

pjellore të Italisë së Veriut, Ilirisë, Maqedonisë, dhe pjesëve të tjera të Ballkanit. Kundër fuqisë, mjeshtërisë së lartë e të vrazhdë, popujt më të qytetëruar, më të butë, më të sjellshëm të këtyre tokave jugore ishin në një disavantazh të tmerrshëm dhe qëndruan shumë të nëpërkëmbur në duart e tyre. Falë këtyre inkursioneve, Italia veriore është e populluar në pjesën më të madhe me njerëz të origjinës gjermane dhe skandinave. Ndërkohë brenda rrethit të kufijve të saj, pjesërisht të bërë vetë dhe pjesërisht prej kombeve të tjera, siç janë galët në perëndim dhe sllavët në lindje, ata ndërtuan një sistem feudal të fuqishëm, të pakrahasueshëm me më të mirin e Europës. Ata pranuan kristianizmin në shekullin e katërt dhe peshkopi i tyre i parë, Ulfilias, e përktheu *Biblën* në gjuhën e tyre, prej së cilës ende kanë mbetur fragmente që përbëjnë disa prej relikeve më të shkëlqyera të gjuhës që ende ekziston. Por gjithmonë historia e tyre ka qenë shënuar prej trazirash shpërthyes. Kjo ishte sikur numri i popullsisë, vitaliteti, energjia të arrinin periodikisht pikën ku një mizëri e re do të lëshohej si zgjua bletësh.

Ndërkohë kombe të tjera, mbretëri, perandori kishin vendosur gurët e tyre të shenjtë kufitarë nëpër tërë Europën, deri sa asnjë këmbë e territorit të mos mbetej bosh për të zënë vend ndonjë tepricë populsië.

Unë e kam diskutuar këtë çështje gjerë e gjatë jo vetëm pse ajo ka të bëjë me të tashmen dhe të ardhmen e Shqipërisë, por se ajo ka të bëjë shumë, dhe në mënyrë jetike, edhe me tërë skenën europiane. Nuk dua të ndalem tek *Herr Hitleri*, por, duke njohur historinë e popullit të tij, nuk mund të kem të njëjtën pikëpamje për Gjermaninë e sotme me atë që kam për atë të së kaluarës. Unë besoj se aleatët, Britania e Madhe, Franca dhe tërë ata që simpatizojnë qëllimet e tyre luftarake, janë ballafaquar me një dukuri më themelore, me ndikim të gjerë dhe të rëndësishëm për të ardhmen e qytetërimit dhe të çfarëdo lloji ëndrre apo ambicieje njerëzore.

Nuk është kjo një çështje mishi apo gjaku e pasionit të vrazhdë apo epshit për pushtime. Është më tepër një çështje shpirtërore, kozmike. Dikush mund të thotë diçka të ngjashme me baticat, forcën e gravitetit, ligjet e tkurjes dhe bymimit.

Popullata të tejmbushura në lagjet e varfëra, në qytetet e mëdha apo në qendra të pakontrolluara banimi, kanë shtuar milionat e popullsisë së Indisë, duke filluar ngjizjen që, më në fund, mund të shkaktojë një shpërthim.

I vetmi ligj për ta parandaluar këtë është zbutur, ndërsa alternativa tjetër ka vdekur. Shkatërro tepricat dhe kështu bëj vend brenda strukturave kombëtare! Lufta, uria, murtaja, kolera kanë qenë kuajt e Apokalipsit me të cilat vdekja dhe ferri kanë kalëruar në rrjedhë të historisë njerëzore, duke shkatërruar racën e njeriut në qendra të ndryshme të popullimit. Ndërkohë, zona të gjera, madje kontinente të tëra po prisnin pushtimin hyjnor të mendjes dhe të shpirtit të përdorimi i dobishëm i njerëzimit.

Duket se lufta ende mbetet shëruesi i pranueshëm ose parandalues për këtë sëmundje të qytetërimit, siç ishte njëherë e njëkohë shëruese nxjerrja e gjakut për të shëruar sëmundjet e trupit të njeriut.

Me fjalë të tjera: Shkatërro popullsinë e tepërt, në vend që ajo të shtohet! Shqipëria dhe të tëra shtetet e tjera të vogla në Ballkan, mund të përgatiten shumë mirë për një tjetër “gjakosje” në duart e Fuqive të Mëdha. Ndoshta ky pushtim i Shqipërisë është një sinjal për të vënë në lëvizje një tjetër spastrim dhe banjo gjaku, për të kuruar kokëçarjet e mbetura të Versajës. Kjo thjesht do të ishte koherente me historinë, nëse në fillim do të ndodhte diku në Ballkan – dhe ku më mirë se në Shqipëri? Tek e fundit, edhe lufta e vjetër nga Zoti Mars¹³⁶ duhet të ketë patur një rrugë për të arritur aty dhe *Via Egnatia* është ende aty për t’i shërbyer atij qëllimi.

¹³⁶ Marsi, perëndia romake e luftës, ishte një nga perënditë që romakët e lashtë i luteshin dhe e respektonin më shumë. Marsi ishte djali i Jupiterit dhe Junës. Sipas legjendës, ai ishte babai i Romulit (Romulus) dhe Remit (Remus), themeluesve të Romës, nga lidhja me virgjëreshën Rea Silvia. Për shkak të kësaj mitologjie, romakët e konsideronin veten sikur të ishin fëmijët e Marsit, ‘mbrojtësit’ të tyre. Marsi zinte një vend të veçantë në Panteonin Romak, jo vetëm për këtë ndikim, por edhe për shkak të rëndësisë së fushatave ushtarake në Perandorinë Romake dhe pushtimit të Afrikës Veriore, pjesës më të madhe të Europës dhe Lindjes së Mesme. (Shënimi im – MB)



AJO QË MË SHQETËSON ËSHTË SE DERI NË Ç'MASË DO TA DËMTOJË SHPIRTIN E SHQIPTARIT PUSHTIMI I SHQIPËRISË PREJ ITALISË ? ËSHTË KY NJË SHQETËSIM KREJT I NDRYSHËM NGA AI QË KAM PËR ITALINË. DHE KJO NUK ËSHTË PËR T'I ULUR VLERËN NJËRIT APO PËR T'IA NGRITUR TJETRIT.



XXVII



SHPIRTI I RACËS

Një shpirt i mjeruar, i vrarë prej fatkeqësisë.

Shekspir

Ndoshta një diskutim si ky që do të hap në këtë kapitull është jashtë mode në epokën tonë moderne. Asgjë nuk thuhet për shpirtin e kombeve në letërsinë e sotme. Megjithatë, ndodh që kjo racë e njohur me emrin *shqiptare*,¹³⁷ mëton të ketë një shpirt shumë të lashtë, sado të vrarë dhe ndoshta të përçmuar, edhe pse unë kam mendimet e mia për këtë të dytën.

Përsa u takon fatkeqësive, kjo racë sigurisht që ka pasur më shumë se sa duhet. Por, siç e dimë, fatkeqësia i kalit popuj të caktuar, ndërkohë që shkatërron të tjerë,

¹³⁷ Shqip në original.

varësisht prej brumit prej të cilit ata janë bërë. Ajo që më shqetëson mua, është se deri në ç'masë do ta dëmtojë shpirtin e shqiptarit pushtimi i Shqipërisë prej Italisë. Është ky një shqetësim krejt i ndryshëm nga ai që kam për Italinë. Dhe kjo nuk është për t'i ulur vlerën njeriut apo për t'ia ngritur tjetrit. Vitet që kam kaluar edhe si banor në Itali, edhe si fqinj i afërt me italianët, i afërt me jetën e tyre, jo vetëm që më kanë mbushur me adhurim dhe respekt, por i kanë bërë të dashur ata për mua, për shumë arsye. Megjithatë, kjo nuk ma heq dyshimin se çfarë do t'i shkaktojë pushtimi italian shpirtit të popullit shqiptar.

Italia është moderne, Shqipëria është e lashtë, primitive. Italia është shumë krenare për qytetërimin e saj, për kulturën, artin, industrinë, universitetet, katedralet, muzeumet e saj... Aty e bukura gjendet kudo, në shkencë, në mjeshtri. Aty ka njerëz të palodhur të shkencës, të mjeshtrive të mëdha, shfaqet energji dhe disiplinë e një populli të madh që kërkon vendin e vet midis Fuqive të Mëdha të botës. Gjithçka aty është ashtu siç duhet. Nuk ka dyshim se në një botë moderne, shumë kombe të tjera të mëdha i drejtojnë energjitë e veta kah zotërimi i botës në të gjitha fushat e ndryshme të sipërmarrjes njerëzore. Por, a do të jetë kjo gjë e mirë për Shqipërinë? A mund të marrë formë ajo sipas dëshirës së zemrës së pushtuesit? A duhet ta bëjnë këtë ata, edhe në qoftë se ky transformim është i mundur? Këto janë disa prej pyetjeve që i bëj vetes në temën e librit *Mbretëria e vogël – Po më pas?*

Unë them se e kam një ide për problemet që Italia do të hasë në Shqipëri. Çelësin e gjej tek ajo që unë vetë pata gjetur kur u katapultova bashkë me familjen time në zemër të Shqipërisë. Aty nuk pati interval midis jetës sonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe jetës ku papritmas ne e gjetëm veten në Shqipëri. Ne nuk patëm thujasë asnjë mundësi për t'u orientuar. Lamë rrugët e qeta, të bukura e dinjitoze të Bostonit, për të shkelur në rrugët e papastrat dhe të mjeruara të qytetit të lashtë të Durrësit, me më shumë se njëzet e gjashtë shekujt e historisë së tij të ndërlikuar. Kjo ishte një përvojë që s'kishte për t'u harruar kurrë. Më në fund pamë një hotel ose, më mirë të them, një han krejt të thjeshtë, me një krevat dhe një tavolinë dhe me një lloj banjaje dhe një tualet. A mund të kërkonte njeriu më

pak se aq në njërin prej vendeve më të vjetra të Europës?

Ushqimi që shërbehej aty ishte me copëza me mish deleje, tërë dhjamë, me fasule, një kupë pilaf dhe kos turk ose qumësht i thartuar. Kishte edhe një ëmbëlsirë si bakllava. Kjo menu, e njëjtë ose me ndryshime të vockla, do të ishte e tillë për të gjithë Shqipërinë, restorantet, hotelet dhe shtëpitë e njerëzve. Në përgjithësi, gatesa përgatitej në shtëpi me përbërësit e saj, në enë a tava balte, dhe ashtu siç ishte çohëj në furra publike për t'u pjekur. Mizat lëviznin në një hapësirë tripërmasore që i korrespondonte dhomës ku ato ishin mbyllur. Aty pinim ujë të bekuar duke shpresuar për më mirë. Tualetet ishin të patregueshme për higjienën e tyre. Krevetat ishin të shtruar për tokë, me një dyshek kashte, çarçafë të shtruar poshtë, ndërsa sipër një mbulesë e quajtur “jorgan”, me pambuk të kuq. Parazitët, pleshtat, morrat, mushkonjat, çimkat e bënin qëndrimin të pamundur. Nuk ma merr mendja se Dan Sift ka patur rastin të shkelte në atë pjesë të botës në atë kohë, e njohur si ‘Turqia e Europës’, kur shkruajti: “Sikur pleshtat të mirëkuptoheshin”.

Por, ajo për të cilën unë jam shumë i shqetësuar në këtë çështje, është gjendja shpirtërore që pasqyron këtë situatë. Gatishmëria për të pranuar këtë lloj jetese me një qëndrim si ky që: “Zoti është në qiell, gjithçka është në rregull me botën”.

Gjatë vitit tonë të parë në Tiranë (1908-1909), i vura detyrë vetes t'i përmirësoja këto kushte. Tregjet publike të ushqimeve, veçanërisht pazari i mishit, ishin në gjendje të patregueshme për kushtet sanitare. Dyqanet ishin të rrethuara me hekura. Mishi ishte i ekspozuar në natyrë dhe i mbuluar nga miza, të cilat kasapi mundahej t'i largonte me një fshesë në dorë. Unë ndërtova për shtëpinë tonë një dollap të ekspozuar për t'u parë prej të gjithëve se ku ruheshin ushqimet. I ftova kasapët bashkë me të tjerë që të vinin e ta shihnin se si t'i ruanin ato. U shpjegova me gjuhën e popullit, me aq sa munda, se përse e kisha bërë këtë. Unë tërhoqa vëmendjen e një mase të madhe, përfshirë fëmijët dhe të rriturit, ata me ulçera të rënda, atyre që ethet ua bënë jetën të tmerrshme dhe u tregova se si mizat, insektet që pështynin mbi mishin që ata hanin, ua helmonin ushqimet dhe ndikonin në

shëndetin e tyre.

Njerëzve duket se u bëri përshtypje kjo, dhe shumë prej tyre porositen dollapë dhe i vendosën nëpër shtëpitë e tyre. Por çfarë rëndësie kishte kjo, nëse ushqimet e tyre ishin infektuar para se ata t'i çonin në shtëpi? Më në fund, njëri prej kasapëve u bë modern dhe e rregulloi dyqanin e tij siç e kisha udhëzuar. Ai më dërgoi fjalë që të shkoja ta shihja. E kishte rregulluar ashtu siç i kisha thënë, përveç pjesës së sipërme, ku kishte lënë një vrimë hapur me qëllim që të qarkullonte ajri dhe ta freskonte. Gjithashtu, në ditën e madhe të pazarit, kur shitej 90% e mishit, ai e hapi tërësisht derën e dollapit ndaj blerësve, që ata të mos e merrnin për të çuditshëm dhe jomikpritës.


Ngjitur me konviktin e *Shkollës Bujqësore* në Kavajë ishte një fshat, më i pasuri prej të gjithëve, dhe kryeplaku vendosi të ndërtonte vetë një vend për familjen dhe bagëtinë e tij. Disa ditë më vonë, ai u sëmur dhe mua më thirrën që të shkoja ta vizitoja. Për t'u futur në dhomën ku ai shtrihet, më duhej që në fillim të kaloja nëpërmjet një stalle ku ishin strehuar disa bagëti. Aty pashë plehun që ishte i lënë për tokë. Edhe pse kështu, në një farë mënyre dhoma e tyre të paktën ishte e këndshme, krahasuar me atë ku shtrihet i sëmuri ; sepse ajo kishte edhe ajër, edhe dritë, ndërkohë që e tija kishte pak nga e para, dhe aspak nga e dyta. Ishte një dhomë e mbyllur, pa dritare, madje pa oxhak. Dyshemeja e shtruar me dhé, muret prej qerpiçi të së njëjtës ngjyrë, një vrimë në qendër të dhomës, ku një zjarr shkarpash po digjej, ndërkohë që tymi dilte nëpërmjet të çarave të tjegullave. Një kusi e varur mbi zjarr qëndronte në dhomën e tymosur, të errët, me të vetmen dritë, atë të zjarrit. Kur hyra në atë dhomë të errët, pasi vija nga drita e diellit, nuk munda të shoh asgjë. Afër zjarrit ishte një djep me një bebe të vogël të mbështjellë me një brez që të mos dilte prej tij. Përtej djepit ishte i shtrirë i sëmuri, mbi një dyshek prej kashte. Fëmijët e tjerë, e shoqja, një plakë, së bashku me të tjerët, filluan të merrnin formë në sytë e mi pasi u përshtata pak me mungesën e dritës. Ai burrë ishte në fazën e fundit të tuberkulozit. Më pak se një gjysmë miljeje më tej gjendej ndërtesa moderne e shkollës. Kjo shtëpi që sapo ua përshkrova, ishte as më e mirë,

as më e keqe se mesatarja e shtëpive të bujqve anekënd vendit. Dhe ata përbëjnë rreth 80% të popullsisë së atyshme. Një studim për gjendjen e fëmijëve zbuloi faktin tragjik se afër 70% e fëmijëve, të lindur nëpër shtëpi si kjo që përshkrova, vdesin pa mbushur vitin e parë të jetës.


Megjithëse për ne mund të duket e pabesueshme, fakti është se këta njerëz shpesh herë gjatë historisë së tyre janë pajtuar me jetën ashtu siç u ka ardhur. *Ata e kanë pranuar tokën si shtratin e tyre dhe gurët e saj si nënkresë.* Ata e kanë paguar haraçin për fëmijët e tyre, ndoshta me më shumë mirësi se sa disa amerikanë i paguajnë taksat e tyre, sepse është fati ai që përcakton të ardhmen e tyre, është *Kismet*, siç e quajnë ata. Ata e kanë identifikuar veten me një popull të vogël të tokës, duke e ditur shumë mirë se jeta nuk është kurrë një gjë as e lehtë, as e sigurtë. Dhe kjo i bënte ata të mos ishin lakmiqarë ndaj pasurive të mëdha. Ata kurrë nuk i ruajtën plevicat e tyre. Kur njeriu udhëton nëpër Shqipëri, i bën përshtypje fakti se natyra kurrë nuk mbivendoset ndaj njeriut, për të marrë një pozicion të dytë. Shtëpitë e ndërtaura nëpër luginat mes maleve, mbi majat e kodrave apo në faqet e maleve, duken kaq shumë të njësuara me peizazhin, sa natyra dhe bota e njeriut duken të shkrira në një. Ata nuk i tremben ngricës, as akullit, shkëmbinjve të rrëpirtë, lumenjve të rrëmbyer, vërshimeve ose thatësisë. Ata i bëjnë ballë këtyre vështirësive duke i konsideruar ato si pjesë të domosdoshme të jetës, që duhet t'i durojnë aq sa munden me mendje dhe shpirt të patrazuar.

Gjatë tridhjetë viteve të kontakteve të mia intime dhe njohjeve me këta njerëz, unë kurrë nuk arrita të njihja një shqiptar që të ishte viktimë e ngacmimit, depresionit mendor, sëmundjeve nervore apo ndonjë gjëje tjetër të kësaj natyre. Shën Francis i Asisit¹³⁸ do të kishte gjetur shumë gjëra tek ky popull që i shkojnë zemrës së tij. Baballarët e bektashinjve, një sekt muhamedan, veshin rripa të hollë në sandallet e tyre kur ecin mbi bar, për t'i paralajmëruar tërë insektet që t'i shpëtojnë rrezikut se mos i shkelin.

¹³⁸ *Shën Francis i Asisit (Saint Francis of Assisi - Giovanni Francesco di Bernardone)*, (1181/82 – 3 tetor 1226), prift dhe predikues katolik. Shën Francis themeloi Urdhrin Franceskan, Urdhrin Shën Kler (Clare) të Gruas, si dhe Urdhrin e Tretë të Shën Francisit. Ai është një ndër figurat fetare më të respektuara në histori.



POR PËRSA I TAKON VILAJETIT TË KOSOVËS, PARË EDHE
NGA ANA RACIALE, EDHE NGA ANA HISTORIKE, NUK MUND
TË KETË ASNJË DYSHIM NË MENDJEN E NJË STUDIUESI TË
PAANSHËM SE PRETENDIMET SHQIPTARE KANË MBËSHTETJE
TË JASHTËZAKONSHME. AI VILAJET, PO T'I BASHKËNGJITEJ
TERRITORIT TË VET SHQIPTAR, THUAJSE DO TA DYFISHONTE
TOKËN E SAJ TË PUNUESHME DHE DO T'I SHTONTE
SHTATËDHJETË E PESË PËRQIND POPULLSISË SË VET.



XXVIII



ÇFARË MBETI PAS MBRETËRISË SË VOGËL?

“Ndodh shpesh që shpirtrat e ngjarjeve të mëdha ta bëjnë hapin para se ato të ndodhin. Prandaj ndodh që në të sotmen, të ecë, tashmë, e ardhmja....”.

Coleridge

Tani që po filloj të shkruaj këtë kapitull (7 shtator 1939), një hijë e rëndë, e zezë endet përmbi Europën e zymtuar. Të tëra ngjarjet janë mbërthyer me të. Hija e errët e së djeshmes është përflakur sot në zjarrin e qyteteve që digjen me gjuhët e flakëve të betejave nëpër dete, në ajër dhe në tokë.

Kështu përgjigja e pyetjes “Po më tej, çfarë u bë me *Mbretërinë e vogël?*”, që më shërbeu si titull në këtë libër, tani është edhe më e vështirë, edhe më e paqartë, edhe më e pasigurtë se kur fillova të shkruaja, fill pas ngjarjes së *të Premtes së Mirë*, pikërisht ditën kur ndodhi dhunimi i Shqipërisë nga Italia. Pastaj duket se kjo ka të

bëjë pothuajse e tëra dhe në mënyrë të posaçme me Italinë. Sot gjenden dhjetëra kombe ose kombësi më të mëdha, por edhe më të vogla se Shqipëria, të shpërndara nëpër ujërat e ndotura të politikës europiane, që ngjajnë aq shumë me mbeturinat pluskuese të anijeve të mbytura apo aeroplanëve të rrëzuar të Luftës Botërore. E ardhmja e saj është aq e pasigurtë dhe enigmatike si edhe e tyrja. Njeriu mund të kuptojë dëshirën e zjarrtë të Omar Khajamit për ta bërë dashurinë më të gjallë, pasi zbuloi botën e shformuar të ditëve kur jetonte. Ishte një mendim i bukur që ia vlen ta përsërisim këtu edhe për muzikën e vargjeve :

Ah, dashuri, me fatin si mund të loznim ti e unë, vallë?

Që tërë këtë skemë mjerane ta ngërthenim si në përrallë,

A nuk do ta thyenim njëherë copë-copë, e më pas;

Në dashuri zemre ta ngjisinim fort me t'shpiritit mall?¹³⁹

Sa keq që ai (Khajami) nuk pati dorë në farkëtimin e *Traktatit të Versajës*. Ndoshta nuk ishte krejt ashtu në ditët e tij, pasi ai dhe dashuria mund të kishin patur një kohë për të ardhur keq po të ishin bashkë në atë *Këshill* të urrejtjes, hakmarrjes dhe babëzisë. Fillimi i kësaj lufte kundër tërë shpresave tona më të bukura dhe frikës sonë më të errët, kërkon një arsye më të përshtatshme sesa ato naziste dhe hitleriane. Arsyeja e vërtetë, nëse mund të guxoj ta them, është *Vilet e zemërimit*,¹⁴⁰ të cilat u mbollën dhe u rritën që në Versajë. Ndoshta mund

¹³⁹ Kjo strofë është përkthim në shqip nga variant anglisht i Fitzgeraldit, përkthyesi më i madh i Omer Khajamit në gjuhën angleze.

¹⁴⁰ *Vilet e zemërimit* (*The Grapes of Wrath*) u shkrua nga Xhon Shteinbeku (John Steinbeck) dhe u botua në vitin 1939. Një vit më pas, Xhon Shteinbeku fitoi Çmimin Pulitzer. Ai është, gjithashtu, fitues i Çmimit Nobel në Letërsi në vitin 1962. Ngjarjet zhvillohen në periudhën e *Depresionit të Madh* dhe në qendër janë Xhodët (Joads), një familje fshatare e varfër, e cila detyrohet të largohet nga Oklahoma për shkak të thatësisë, vështirësive ekonomike dhe ndryshimeve që ndodhin në sektorin e bujqësisë dhe financës. Thuajse pa shpresë, Xhodët marrin rrugën për në Kaliforni. Bashkë me mijëra "Okies" (banorë të Oklahomës) ata kërkojnë punë, tokë, dinjitet, të ardhme. Teksa përgatitej të shkruante këtë roman, Shteinbeku do të shkruante: "Dua t'u vë damkën e turpit bastardëve lakmitarë që mbajnë përgjegjësi për këtë situatë dhe pasojat e saj". Me këtë libër ai u bë shumë popullor në radhët e klasës punëtore, ndoshta falë notave pozitive që ka libri për lëvizjen punëtore dhe prozës lehtësisht të kuptueshme. *Vilet e zemërimit* është pjesë e programit të letërsisë në shkollat e mesme dhe të larta në Amerikë. Në vitin 1940, mbi bazën e këtij libri u xhirua filmi i njohur i Hollivudit me aktorin Henri Fonda dhe regji të Xhon (John) Fordit. (Shënimi im – MB)

të shkruhet një libër tjetër dikur me këtë titull, me më shumë domethënie dhe përshtatshmëri se sa ata që janë tani më të shiturit dhe më në modë. Një libër i tillë duhet të merret me diçka më shumë se sa me patosin, tragjedinë dhe djallosjen kolosale, e cila ishte etiketuar në mënyrë kaq mbresëlënëse.

Nga njëra anë kemi Shtetet e Bashkuara, Perandorinë e Britanisë së Madhe, Francën, Italinë dhe Japoninë. Nga ana tjetër kemi fuqi të caktuara në *Traktatin* e tashëm si Aleate kryesore dhe fuqi që ju shkojnë pas atyre si Belgjika, Bolivia, Brazili, Kina, Kuba, Ekuadori, Greqia, Guatemala, Haiti, Hondurasi, Liberia, Nikaragua, Panamaja, Peruja, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia-Kroacia-Slovenia, Siami, Çeko-Slovakia dhe Uruguaji, ndërsa Gjermania e vetme në anën tjetër. Shkurt, këto solli i famshmi ose i turpshmi *Traktati i Versajës*.

A mundet që dikush mendje mprehtë, i cili ka bërë studim rreth kësaj dukurie botërore, të vejë në dyshim për një çast që jo vetëm forcat njerëzore, por edhe ato kozmike ishin të përfshira në atë betejë *gargantuane* të racave, feve dhe qytetërimeve? Përse duhen lutjet, në qoftë se Zotat nuk janë ay? Po edhe Allahu, Marsi dhe Jovi, edhe vetë Zoti i Gjithëfuqishëm i të krishterëve, çfarë do të bënte? Çfarë mund të bëjë ai me pasuesit e tij në tërë frontet e betejave që thërrasin me të madhe për ndihmë në shkatërrimin e njëri-tjetrit? Sikur Zoti t'u ishte përgjigjur tërë lutjeve, ai do të kishte dërguar engjëjt e tij, do t'i fshinte tërë fushat dhe do t'i pastronte ato nga tërbimi i gjakut. Jezui nuk do të kishte ndenjur indiferent por, mjerisht, përderisa ai pranoi që njeriu duhet t'i dojë armiqtë e vet, nuk do të ishte aq i dobishëm në arritjen e fitores me mjete të tilla si mitrolozë dhe bajoneta.

“*Vilet e zemërimit*” do të duhej të merrte parasysh këto male të përgatitura për betejë. Pala që arriti fitoren përfundimtare dhe që diktoi *Traktatin e Paqes*, nuk humbi kohë që ta quante atë fitore morale dhe shpirtërore. Në dritën e pasojave të *Luftës Botërore*, unë mendoj se ajo që është më e mira të themi, është proverbi i njohur: “*Zoti është në anën e batalionit më të fortë*”. Kjo pikëpamje, të paktën, na ndihmon të përkufizojmë fushën e hamendjes se çfarë na pret në të ardhmen, jo

vetëm për këtë pikë të errët në Ballkan apo në Shqipëri, por edhe në vetë Europën dhe qytetërimin e saj të lashtë.

Ndërkohë Shqipëria thithte gjoksin bujar të Italisë dhe duket se ndihej rehat pranë mëndeshës së saj, tani në rolin e mëmës së adaptuar. Thuhet se shqiptarët e punësuar në qeveri merrnin një rrogë më tepër. Gjithashtu edhe ushtria italiane, e përbërë prej rreth tetëdhjetë mijë burrash, merr pagesa dyfishë për shërbimin në Shqipëri, e cila është diçka si një *bonne bouche*¹⁴¹ për tregtarët dhe shitësit e tregut fshatar në pazar, pas shumë vjetësh të racioneve tmerrësisht të kufizuara. Kam marrë vesh se kur një njeri i famshëm, siç është ministri i Jashtëm italian apo kreu i partisë fashiste, vjen në Shqipëri, shpërndahen lirshëm lirat italiane midis turmave, për të siguruar njerëz që duartrokasin për vizitën e tyre. Në këtë rast, romët gjenden gjithmonë të parët tek dera, të gatshëm për të duartrokitur.

Një fis malësor, pasi kishte dëgjuar se po shpërndaheshin para falas, vendosi të zbriste në Tiranë dhe t'i gëzohej “bujarisë fisnike italiane”. Meqë ai nuk kishte parë para të vërteta për shumë kohë, nuk e dinte se si dukeshin ato. Ishte një udhëtim i vështirë dhe i gjatë për ta, me disa nëna me fëmijët nëpër djepe dhe me të moshuar që duhej të ndihmoheshin nëpër tërë rrugët malore. Por, më në fund, ata edhe pse rrëzohu e çohu, arritën aty ku deshën.

Por, mjerisht, aty nuk kishte mbetur asgjë për ta. Ata patën fatkeqësinë të ishin malësorë të Ahmet Zogut. Kemi mësuar gjithashtu se zyrtarët e rinj shqiptarë, të cilët bujarisht shkuan në Romë për t'i ofruar kurorën e rrënuar shqiptare Viktor Emanuelit, panë se kishin mjaft kohë të lirë për shkak se kishin vetëm një punë formale për të bërë, dorëzimin e saj. Ata u çliruan nga përgjegjësia e marrjes së ndonjë vendimi, formulimit të ndonjë projekti të ri, ushtrimit të ndonjë autoriteti real apo drejtimit të ndonjë gjëje e cila vërtet do të përbënte diçka me rëndësi për jetën e shtetit shqiptar. Duket se ata nuk kishin asnjë propozim për të paraqitur, as ndonjë ide për të shfaqur. Ndoshta ata donin vetëm aq sa të thithnin gjirin dhe të

¹⁴¹ E ardhur e mirë.

ktheheshin në shtëpinë e tyre. Fatkeqësisht, unë kam vënë re gjatë përvojës sime prej më shumë se tridhjetëvjeçare se një numër zyrtarësh dhe udhëheqësish politikë shqiptarë janë si këta, duart e të cilëve zgjateshin drejt favoreve dhe bakshisheve të ndonjë përfaqësuesi të huaj, i cili u kërkonte të bënin punë të pandershme për të.

Një prej ironive më të hidhura të kësaj toke tragjike është ajo që krejt në kundërshtim me një traditë aq të vyer e aq të vjetër të saj, në fakt sa vetë kjo racë, pra në kundërshtim me *besën shqiptare* që e ka bërë këtë racë të dallueshme dhe të shquar midis tërë popujve të Lindjes së Afërme, në jetën politike të gjendeshin ca burra që ishin të gatshëm dhe të vullnetshëm ta shisnin këtë të drejtë të dhënë nga kombi i tyre, në këmbim të disa favoreve për veten e tyre. Le ta marrim situatën e sotme në Shqipëri si fakt të kryer, ashtu siç është dhe të mendojmë se cila është perspektiva e së ardhmes së kombit shqiptar.

Le të pranojmë për një çast se Italia e ka pushtuar vendin, bazuar në një ndjenjë të arsyeshme të detyrimeve të saj, me një kuptim të qartë të faktit se ajo ishte vlerësuar si një kujdestare e vërtetë e kombit shqiptar. Por, në një rast të tillë, asaj i duhej të përballej me pikëpyetjen:

A ia vlente Shqipëria të cilën e kishte pushtuar, të ishte shtet apo jo? A ishin kufijtë e vendosur në *Traktatin e Londrës*, i cili pasoi luftërat ballkanike, si dhe kufijtë e përcaktuar me shumë pak modifikime prej *Komisionit* të emëruar nga *Konferenca e Ambasadorëve*, të tillë që të lejonin zhvillimin e një shteti? A e përcolli ajo këtë çështje tek *Traktati i Versajës*, në të cilin ajo vetë ishte palë, për të treguar se brenda këtij shteti kishte një minimum burimesh natyrore që i nevojiten ndërtimit të një shteti, të asaj mase që kap standardet moderne? Është e qartë se Italia nuk do ta ushtronte pafundësisht rolin e mëndeshës që do t'i jepte gjë këtij kombi thjesht për t'i mbajtur frymën gjallë.

Edhe pse pozicioni strategjik i Shqipërisë në Ballkan është i vlefshëm, nuk besoj se ia vlente aq. Italia është njëra prej Fuqive të mëdha europiane dhe nuk duhej t'i lejonte vetes t'i mbante shqiptarët në situatën e tashme të primitivizmit, ku

mungonin thujse tërë pajisjet e jetës moderne perëndimore. Dhe ngritja në këtë vend deri afër standardit të jetesës me shtëpi moderne, me arsim të përgjithshëm, shëndetësi, kontroll ndaj malarjes, zhvillim industrial, bujqësi të modernizuar, tregti të zhvilluar dhe, më e rëndësishmja e të rëndësishmeve, qëndrim korrespondues mendor ndaj jetës së qytetërimit perëndimor – kjo do të ishte në vetvete një detyrë gjigande.

A është një arritje e tillë e mundur në rrethanat e tanishme apo jo, kjo është një çështje me të cilën duhet të ballafaqohemi ndershmërisht dhe pa frikë. Malet me granit, kënetat, moçalet, lumenjtë e rrëmbyer dhe vija bregdetare që ndan kufirin e saj perëndimor, kërkojnë financime pafund për t'i tharë, disiplinuar, kthyer në burime ujtitjeje, porte dhe burime të ardhurash. Po ashtu shfrytëzimi i drurëve, të cilët tani për tani janë të paarrtshëm nëpër male, për shkak të mungesës së rrugëve, e njësoj me këtë, shfrytëzimi i burimeve minerale të vendit. Me barrën e rëndë financiare që mbante tashmë Italia, dhe me rritjen e kërkesave që i bëheshin Perandorisë së saj të re, dukej thujse e pamundur që të kishte ndonjë rritje thelbësore në buxhetin vjetor që ajo kishte ruajtur disa vite për Shqipërinë. Kur shpenzimet e domosdoshme të administratës dhe mbështetja për ushtrinë tejet të madhe që duhej të mbahej atje u mbaruan, ishte e tepërt të shpresoje ose të prisje ndonjë shumë thelbësore për zhvillimin dhe modernizimin e vendit. Atje mbetet alternativa e marrjes prej saj të tokave që i kishin takuar një race tjetër që në agimin e historisë europiane, me përjashtim të disa kohërave si ato kur ajo racë ishte tronditur prej valëve të pushtuesve të huaj. Më e rëndësishmja midis tërë këtyre valëve, padyshim, ishte ajo sllave, siç janë përmendur tashmë në këtë libër.

Që prej shekullit të trembëdhjetë, kur perandori Car Dushani i sundoi këto toka, ka patur një fluks ardhjeje dhe zaptimi prej kësaj race. Por përsa i takon Vilajetit të Kosovës, parë edhe nga ana raciale, edhe nga ana historike, nuk mund të ketë asnjë dyshim në mendjen e një studiuesi të paanshëm se pretendimet shqiptare kanë mbështetje të jashtëzakonshme. Ai vilajet, po t'i bashkëngitej territorit të vet shqiptar, thujse do ta dyfishonte tokën e tij të punueshme dhe do t'i shtonte

shtatëdhjetë e pesë përqind popullsisë së vet. Kjo do të siguronte në mënyrë të padiskutueshme edhe burimet bujqësore, edhe forcën e nevojshme njerëzore dhe, për rrjedhojë, siç besoj unë, edhe bërjen e Shqipërisë një shtet të vlefshëm. Por cili është mendimi i Jugosllavisë ndaj këtij sugjerimi? Padyshim, ajo e përbuz këtë ide, prandaj edhe mban atë pjesë qenësore të territoreve shqiptare.

Lakmia për një shtet është po aq vetëvrasëse sa dhe uria. Të dyja njësoj janë sfiduese ndaj ligjit të natyrës. Një ligj që po të ishte kuptuar më mirë prej shteteve dhe qeverive të Europës, mund ta kishte ruajtur botën dhe vetë Europën prej këtij tmerri të ri. Në fakt do ta ruante atë jo vetëm prej luftës dhe vrasjeve të saj masive, prej vetëvrasjes kombëtare dhe raciale, por edhe prej ndotjes morale dhe shpirtërore që ushqehet prej qytetërimit tonë të plagosur, që i ngjan një tufe grabitqare të lëshuar mbi prenë e vet.

Nëse Italia është e joshur ta bëjë këtë luftë, është e pashmangshme që Shqipëria të mos bëhet edhe një herë fushë beteje për probleme që nuk kanë të bëjnë me çështje të saj jetësore. Ky është mallkimi i gjeografisë së saj, një rrugë kalimi e gjerë që përshkon tërë zemrën e Ballkanit deri në Konstandinopojë, dhe me brigjet e saj bregdetare perëndimore të detit Adriatik, në tërë drejtimin verior deri në zemrën e Europës Qendrore. Nëse kjo është luftë, Malësorët¹⁴² shqiptarë do ta gjenin veten përsëri aty. Cilësitë e tyre luftarake janë aq të shquara, saqë edhe fisi matjan i Zogut do të vazhdonte të sulmonte kudo që ta kërkonte nevoja. Madje, edhe nën Italinë, sikundër nën Turqinë dhe një numri kombesh të tjera që herë pas here e kanë mbajtur atë nën skllavëri, ata do të shfaqnin një pamje të mirë të vetes. Ndoshta ata do t'i marrin përsëri vëllezërit e tyre të çatdhesuar dhe toka e tyre në Kosovë do t'u kthehet, çka do të ishte një kthim i shkëlqyer dhe i merituar, dhe vënie në vend e një drejtësie të merituar dhe të jashtëzakonshme. Nxitimi i Italisë për të marrë kontrollin mbi Shqipërinë, duke dëbuar mbretin dhe detyruar shqiptarët të pranojnë fashizmin, nuk është ogur i mirë. Dhe ndërsa dikush po luan rolin e vet të hershëm, duke thithur gjirin e kujtdo që ia afron, Malësori do të qëndrojë në

142 Shqip në original.

malet e tij të lashta. E vetmja gjë që ata besojnë në këtë botë është se malet nuk i kanë tradhtuar kurrë.

Zotat i kanë lënë në baltë, njerëzimi i ka tradhtuar edhe kur kanë qenë shoqërues të mbretërve dhe perandorëve, sundimtarëve të botës prej gjakut dhe miqve. Integriteti i shpirtit të tyre është shkëmbyer, tradhtuar, është bërë instrument i kohëve të tyre të zhbëra, të panumërta. Përsëri malet janë ato që nuk i kanë tradhtuar. Të zymta, prej graniti, të hirta, të ftohta, të egra dhe të qeta si fati i tyre. Nën hijen e vellos së purpurt e të gjatë që shqiptarët shpesh herë e kanë mbajtur në historinë e tyre, është vulosur fati i shumë kombeve, popujve, perandorive. Ndërsa tani?!

Unë besoj dhe gjykoj se sekretet e së ardhmes së Shqipërisë qëndron tek vetë ajo. Koha nuk është aq e rëndësishme për të. Një vit, një shekull, një mijëvjeçar nuk ka shndërruar qoftë edhe një linjë të vetme të fytyrës së tyre dhe as ka çrregulluar themelet e tokës së tyre malore. Vendbanimi i tyre nuk është bërë me duar. Toka është shtroja e tyre, guri është nënkresa, malet janë muret e shtëpisë së shqiptarit, shtyllat e tempullit të tij. Me fjalë të tjera, forcat kozmike që luajtën rreth këtyre altarëve të lashtë në Dodona dhe Deilos, parake, të rrepta, shpesh të papërkulshme, i rrethojnë këta djem të shqipës edhe sot. Dora që kontrollon fatin e tyre, nuk është në Romë, as në Berlin, Londër, Paris, Moskë apo gjetkë në ndonjë vend perandorak. Ajo dorë është aty, në Shqipëri. Duke mos pretenduar se e njoh tërë botën anë e mbanë, prapëseprapë, me aq sa e njoh unë, nuk gjej dot një paralele midis tyre dhe kombeve e popujve të tjerë të botës. Dhe unë besoj se një ditë do t'i shoh të lirë, siç besova qysh atë ditë shtatori të vitit 1908 kur shkela për herë të parë në tokën e tyre.

Charles Telford Erikson, viti 1939.

